



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCOR
SHTATOR 2021

REVISTA USHTARAKE

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2021

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 1, datë 23.07.2021
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i Bordit

Gjeneral Brigade **Dr. Albert Mullai**

Anëtarët e Bordit

Gjeneralmajor **Prof. Asoc. Dr. Bajram Begaj**

Kolonel **Dr. Ahmet Leka**

Kolonel **Msc. Fatmir Neziraj**

Kolonel (R) **Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi**

Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti

Dr. Etleva Smaçi

Kolonel **Msc. David Rroku**

Msc. Blerina Vorpsi

Përgatiti për botim

Grupi i Redaktimit dhe Publikimit

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2021 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Copyright © 2021 by the Military Scientific Research Institute of the Academy of Albanian Forces.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: shtator 2021

PËRMBAJTJA

Defender Europe 21, angazhimi ynë më i madh

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj
Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura7-19

Shërbimi i detyrueshëm kombëtar-sfidë për vlera

Gjeneral Brigade Dr. Albert Mullai
Komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura
Kolonel (R) Prof. Dr. Kristaq Xharo 21-30

Rishikimi i strategjive, baza e zhvillimit të FARSH

Kolonel Dr. Ahmet Leka
Drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak 31-46

RUBRIKA E PARË: Analiza, sinteza dhe vlerësime të sigurisë47-49

Shqiptarët në kompleksin rajonal të sigurisë

Dr. Xhavit Shala
Drejtor i Kërkimit Shkencor, Akademia e Sigurisë 51-66

Mjedisi i sigurisë në rang global, gjeopolitika dhe ndikimi i saj në zhvillimet e ardhshme

Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa
Oficer shtabi/ Specialist për Kërkimin, Sfidat e Sigurisë Kombëtare, IKSHU 67-77

Ndikimi i pandemisë në sigurinë kombëtare

Drejtues i Lartë, Dr. Bilbil Memaj
Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë 79-89

Informacioni, Teknologjia dhe Mjedisi Operacional

Kolonel Msc. Fatmir Neziraj
Zëvendësrektor i AFA 91-106

Sfidat e Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes – përballja me natyrën, kërcënimet dhe rreziqet hibridet ndaj vendit tonë

Kolonel Msc. David Rroku
Shef i Departamentit të Kërkimit për Mbrojtjen dhe Sigurinë Kombëtare, IKSHU
Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj
Specialist në Institutin Kërkimor Shkencor Ushtarak107-116

Inteligenca ushtarake në operacion dhe roli në vendimmarrje

Kolonel Hysni Gjergji
Shef i Grupit të Kërkimit RSM, IKSHU 117-127

Ndërhyrjet humanitare

Kur forca është e justifikuar

Kolonel Mehmet Metko

Shef i Departamentit të Publikimeve Doktrinare, IKSHU

Dr. Urim Qinami

Specialist në Grupin e Publikimeve Doktrinare të Mbështetjes, IKSHU 129-138

Fatkeqësitë natyrore dhe siguria njerëzore – Përfshirja e fatkeqësive natyrore

në axhendën e sigurisë njerëzore

Kolonel Irela Nebiaj

Shef i Grupit Kërkimor për Analizë Strategjike për SS/SSK/PM/SU, IKSHU

Nënkolonel (R) Alqi Nikolla

Oficer shtabi/specialist për Politikat e Mbrojtjes dhe SU, IKSHU 139-156

RUBRIKA E DYTË: Punime nga AFA 157-158

Zhvillimet e kurrikulës në arsimin ushtarak në shekullin e 21-të

Dr. Etleva Smaçi

Zëvendësdekan i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA 159-166

Emocionet dhe Lidshipi

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi

Pedagog për Udhëheqjen Ushtarake, AFA

Dr. Valbona Zeka

Shef i Grupit të Përgatitjes Fizike, AFA 167-175

Komunikimi i drejtuesve ushtarakë – element i rëndësishëm

për realizimin e objektivave dhe rritjen e kohezionit

Kolonel Msc. Editson Zarka

Shef i Departamentit të Lidshipit dhe Shkencave Shoqërore, AFA 177-184

Zhvillimi i profesionit ushtarak dhe sfidat bashkëkohore

Major Edval Zoto

Oficer Ekzekutiv në Departamentin për Simulim dhe Eksperimentim, IKSHU 185-196

RUBRIKA E TRETË: Studime historike..... 197-197

Siguria në hapat e para të shtetit shqiptar

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi

Akademia e Sigurisë, Tiranë 199-215

Analizë strategjike: plani italian i pushtimit të Shqipërisë më 1919 dhe

situata e brendshme shqiptare

Dr. Albert Hitoaliaj

Akademia e Sigurisë, Tiranë 217-229

Përmbledhje në anglisht 231-245

Kujtesë për bashkëpunëtorët 247-248

DEFENDER EUROPE 21, ANGAZHIMI YNË MË I MADH

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram BEGAJ
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar.

Stërvitja ushtarake shumëkombëshe “Defender Europe 21”, e cila u zhvillua pjesërisht edhe në vendin tonë para pak kohësh, ishte e një rëndësie të veçantë si në aspektin ushtarak edhe atë politik, duke demonstruar aftësinë e forcave tona por edhe angazhimin e Shqipërisë si një vend anëtar i NATO-s për mbrojtjen dhe shkurajimin e zonës euroatlantike. Ajo u realizua në bashkëpunim me palën amerikane, në kuadrin e partneritetit strategjik që vendi ynë ka me SHBA në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, me pjesëmarrjen e 26 vendeve aleate dhe partnere.

Pjesëmarrja e Forcave tona në këtë stërvitje i aftësoi ato për të pritur, koordinuar, për t’u stërvitur dhe trajnuar me forcat amerikane e ato të NATO-s në operacione të përbashkëta. Komanda e ushtrisë amerikane në Evropë zhvillon stërvitje të niveleve të ndryshme në Evropë, por edhe në disa vende të Ballkanit si: Kroaci, Slloveni, madje edhe në Maqedoninë e Veriut. Por “Defender Europe 21” ishte hera e parë që një stërvitje e përmasave të tilla u zhvillua edhe në territorin e vendit tonë, në hapësirat tona detare dhe ajrore.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë synojnë që të kontribuojnë me kapacitete cilësore në NATO dhe gjithashtu të vendosin infrastrukturën e tyre për NATO-n dhe aleatët e saj strategjikë siç është edhe SHBA. Ndaj, planifikimi i stërvitjes “Defender Europe” nga ana e Shtabit të Përgjithshëm kontribuon jo vetëm në rritjen e ndërveprueshmërisë, por edhe në testimin e kapaciteteve kombëtare të vendit pritës dhe promovimin e infrastrukturës tonë ushtarake për vendbazime dhe stërvitje të tjera të NATO-s dhe me aleatët.

Stërvitja, siç edhe do të trajtohet në këtë shkrim, u vlerësua maksimalisht si nga lidershipi ushtarak amerikan dhe i NATO-s, ashtu dhe nga titullarët e zinxhirit të komandim-kontrollit të FARSH, ndaj kjo stërvitje parashikohet të pasohet edhe nga simotrat e saj në vitet 2022 dhe 2024 në rajonin e Detit Baltik, ndërsa në vitin 2023, 2025 në rajonin e Evropës Juglindore, përfshirë edhe Shqipërinë.

Trajtimi i kësaj stërvitjeje në mbledhjen e Zyrtarëve të Lartë të Sigurisë Kombëtare¹, e drejtuar nga Presidenti i Republikës dhe në Komisionin i Sigurisë Kombëtare² në Kuvendin e Shqipërisë tregoi mbështetjen e pakufizuar të Shqipërisë ndaj aleatëve tanë, deklaratë e cila u parashtrua edhe nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë në samitin e fundit të NATO-s të mbajtur më datë 14 qershor 2021.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe me të gjitha autoritetet lokale të zonave ku u zhvillua stërvitja ishte po ashtu një arritje për t'u vlerësuar. Stërvitja përveçse dislokimit në territorin e RSH, gjithashtu u shoqërua me një fluks të madh kalimesh transit ku me mijëra ushtarakë dhe kontraktorë, mjete e pajisje u procesuan në pikat tona hyrëse, u ruajtën dhe shoqëruan nga institucionet tona të sigurisë edhe përtej FARSH, tregues i një bashkëpunimi dhe profesionalizmi të lartë. Gjatë periudhës 3-mujore, nga fillimi në mbarim, nuk u identifikua asnjë rast i rëndë aksidentesh apo incidentesh gjatë kryerjes së detyrës.

Të tilla stërvitje të mëdha, janë shkolla të mëdha. Për të gjithë pjesëmarrësit në to, veçanërisht për mikpritësit, doemos për ne...

¹ Mbledhja e Zyrtarëve të Lartë të Sigurisë Kombëtare e drejtuar nga Presidenti i Republikës, 3 shkurt 2021. Shih në: <https://president.al/presidenti-meta-therret-mbledhjen-e-zyrtareve-te-larte-te-sigurise-kombetare/>

² Komisioni për Sigurinë Kombëtare për shqyrtimin e projektligjit “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “DEFENDER EUROPE 21”, 25.02.2021. Shih në: <https://www.parlament.al/News/Index/11683>

“Biznesi” i NATO-s është paqja

Në vitin 2003, gjatë një vizitë të shkurtër në Tiranë, ish-ministri amerikan i Mbrojtjes, Donald Rumsfeld zhvilloi një takim me struktura të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe të drejtimit civil. Thënia e tij “Zotërinj, NATO-ja nuk ka biznese dhe qëllime ekonomike. I vetmi “biznes” i NATO-s, është paqja”..., ka përbërë në të kaluarën, vazhdon e do të vazhdojë të përbëjë thelbin e angazhimit të NATO-s, ndër kohëra. Kjo frymë përshkoi edhe stërvitjen që u zhvillua në Shqipëri, “DE 21”....

Emëruesi i përbashkët i problemeve me të cilat përballemi sot, por edhe zgjidhjet e tyre, tanimë ndodhen në dokumentin “NATO 2030: Të bashkuar për një epokë të re”.

Në këtë kuadër, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ka theksuar se: “Ne duhet të demonstrojmë përkushtimin tonë për solidaritetin transatlantik jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra. NATO është platforma unike që bashkon Evropën dhe Amerikën e Veriut çdo ditë. Aleatët duhet të angazhohen në këshillime për të gjitha çështjet që ndikojnë në sigurinë tonë”.¹ Rëndësia e bashkëpunimit transatlantik u rikonfirmua edhe nga Presidenti amerikan Biden në Konferencën e Sigurisë së Mynihut, në shkurt të vitit 2021, i cili deklaroi se: “Amerika është kthyer” (“*America is back*”) e kur jemi të gjithë bashkë, nuk ka asgjë të paarritshme për ne”.

Duke vlerësuar sfidat e sigurisë për të ardhmen nën moton “NATO 2030”, duhet theksuar se vendet e Ballkanit Perëndimor, pas një periudhe luftime dhjetëvjeçare dhe situatash të paqëndrueshme të sigurisë, po përpiqen të orientohen drejt harmonizimit të marrëdhënieve me njëri-tjetrin. Ato, me gjithë veçantitë e tyre, kanë të njëjtën qasje dhe perceptim sa i takon rreziqeve, kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë.

Por edhe pse është kështu, asnjë pjesë e hapësirës euroatlantike dhe rajonale, përfshirë Shqipërinë, nuk është e sigurt nga kërcënimet bashkëkohore. Kërcënimet që ndikojnë ndjeshëm mbi sigurinë janë shumëplanëshe, në ndryshim të vazhdueshëm e të paparashikuara, vlerësim i cili u komunikua edhe nga Kryetarët e Shteteve të NATO-s në Samitin e muajit qershor 2021, ku thuhet se “*Ne jemi duke u përballur me kërcënime të gjithanshme, konkurrencë sistematike nga fuqi autoritare luftënxitëse, siç edhe rritja e sfidave të sigurisë për vendet dhe popujt tanë nga të gjitha drejtimet strategjike*”².

¹ Konferenca e Sigurisë së Mynihut, shkurt 2021.

² Komunikatë e Kryetarëve të Shteteve-Samiti i NATO-s, qershor 2021, https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_185000.htm?selectedLocale=en

Këto situata kërkojnë akte, veprime si dhe qasje “të zgjuara” bazuar në zgjidhjet ndërshtetërore dhe rajonale. Gjetja e qasjeve të përbashkëta, mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe zhvillimi i projekteve të ndryshme me interes reciprok në fushën e sigurisë e të mbrojtjes janë domosdoshmëri jetike për rajonin dhe secilin vend.

Qysh kur u aneksua Krimea nga Rusia në vitin 2014, SHBA dhe NATO kanë bërë shumë për të forcuar mbrojtjen në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke shtuar praninë ushtarake në shtetet baltike, si dhe duke pasur një përqendrim të ri në rajonin e Detit të Zi. Gjithashtu, anëtarët e NATO-s kanë rritur shpenzimet për forcat e tyre të armatosura, ku edhe Shqipëria ka deklaruar arritjen e kontributit prej 2% duke filluar nga viti 2024.

Shtetet anëtare mbështesin një strategji të përbashkët për forcimin e bashkëpunimit me njëri-tjetrin në përbaljen me një konkurrencë të re sistematike në një botë të paparashikueshme, e cila ndryshon me shpejtësi. Njëra nga fushat konkrete të bashkëpunimit në fushën e sigurisë e të mbrojtjes është zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta.

Për këtë qëllim, NATO ka zhvilluar shumë stërvitje në shkallë të gjerë me aleatët dhe partnerët. Stërvitja e radhës, “DE-21”, synonte rritjen e gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë strategjiko-operacionale midis forcave amerikane dhe aleatëve e partnerëve të NATO-s. Stërvitje të ngjashme në këto nivele janë kryer nga SHBA në Evropë ndër vite, pas Luftës së Dytë Botërore³. Stërvitje të tilla testojnë proceset vendimmarrëse të Aleancës, sistemet dhe taktikat për të garantuar bashkëpunimin e NATO-s me partnerët në mënyrë ndërvepruese. Ato luajnë rol të rëndësishëm në qëndrimin parandalues, duke ndihmuar Aleancën të zhvillojë kapacitete të reja e të shpalosë aftësitë e saj ndaj çdo kundërshtari të mundshëm.

Aleatët dhe partnerët e NATO-s kryejnë stërvitje për të provuar procedurat dhe taktikat, për të zbatuar praktikat më të mira dhe për të identifikuar fushat që duhen përmirësuar. Në kuadër të Aleancës, stërvitjet shërbejnë për të siguruar forca të trajnuara, të afta të veprojnë së bashku dhe të gatshme për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi. Ato ndryshojnë në varësi të përfshirjes së trupave, detyrave dhe aftësive të demonstruara ushtarake, që aleatëve të NATO-s iu duhen për t’i mbajtur kombet tona të sigurta.

Stërvitja “DE 21” pasqyroi pikërisht këtë frymë, në tërësinë e saj nga të gjithë pjesëtarët e Aleancës Euroatlantike. Ishte stërvitje e përbashkët shumëkombëshe në reagim të krizave, e drejtuar nga Komandat amerikane në Evropë dhe në Afrikë. Kjo stërvitje synoi rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe realizoi ndërveprimin midis ushtrisë së SHBA-së, NATO-s dhe ushtrive partnere, në mënyrë që bashkërisht të jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi.

Stërvitja vërtetoi aftësinë e SHBA-së si partner strategjik sigurie në rajonet e Ballkanit Perëndimor dhe të Detit të Zi, në mbështetje të aktiviteteve në Evropën Veriore dhe në Afrikë. Ajo përfshiu një numër të madh kombesh aleate dhe partnere të NATO-s, të cilët zhvilluan aktivitete të njëkohshme në më shumë se 30 zona, të shtrira në 12 vende, shumë më gjerë sesa stërvitjet e mëparshme. Stërvitja ishte gjithashtu *pikënisje për objektiva edhe më ambiciozë, të cilët i takojnë të ardhmes.*

³ Jen Hudson, *Reforged redux? Defender 2020 to be 3rd largest exercise in Europe since Cold War*, Defense News, 7 tetor 2019. Shih në: <https://www.defensenews.com/land/2019/10/07/reforged-redux-defender-2020-exercise-to-be-3rd-largest-exercise-in-europe-since-cold-war/>

Stërvitja “Defender Europe” është një stërvitje e përvitshme ku në vitet çift zhvillohet në rajonin e Detit Baltik, ndërsa në vitet tek në rajonin e Detit të Zi. Ndër vite Komanda e Ushtrisë Amerikane ka zgjeruar pjesëmarrjen e vendeve aleate dhe partnere, si dhe numrin e pjesëmarrësve. Stërvitja e planifikuar në rajonin e Detit Baltik gjatë vitit 2020⁴, ishte ndër më të mëdhatë e planifikuara ndonjëherë, por SHBA i reduktoi veprimtaritë në plan të gjerë në fazat e para të zbatimit të stërvitjes, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia “Covid-19”, për dy arsye: për mbrojtjen e shëndetit të trupave pjesëmarrëse dhe për mospërhapjen e mundshme të virusit, në vendet e populluara ku do të zhvillohej stërvitja.⁵

Megjithatë, pavarësisht reduktimit në forca dhe hapësirë të veprimtarive, në kuadër të “Defender Europe 20”, gjatë muajit janar 2020 u realizua për herë të parë, që nga vitet ’90-të, një ushtrim konvoji detar në oqeanin Atlantik, me lëvizjen e anijeve në formacion konvoji nga SHBA në Evropë. Gjithashtu, në kuadër të kësaj stërvitjeje, në Poloni gjatë muajit qershor 2020 u realizua stërvitja “Allied Spirit”. Në këtë stërvitje u realizua një ushtrim kolektiv në nivel divizioni, duke kapërcyer me sukses pengesën ujore lumore nga të gjithë elementët e divizionit në rajonin stërvitor të tij.⁶ Ndërkohë që pati kufizim dhe pezullim të veprimtarive stërvitore në mes të vitit 2020, si pasojë e pandemisë “Covid-19”, programi stërvitor dhe objektivat e stërvitjes u zhvendosën për t’u realizuar për vitin 2021, në rajonin e Detit të Zi dhe Ballkanin Perëndimor.

Përfshirja e konsiderueshme e Forcave Ajrore dhe e Marinës së SHBA, përdorimi i rugëve kryesore tokësore dhe detare që lidhin Evropën me Azinë dhe Afrikën, integrimi i asetëve të mbrojtjes ajrore dhe raketore amerikane kishin natyrë mbrojtëse dhe përqendroheshin në përgjigjen ndaj një krize të mundshme.

Zhvillimi i kësaj stërvitjeje në këto përmasa gjeostrategjike rikonfirmoi angazhimin e SHBA për sigurinë evropiane përmes Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, me prezencën e tyre në Evropë dhe angazhimin e tyre në bashkëpunim. Një ushtrim i tillë në shkallë të gjerë u mundësoi SHBA-së dhe aleatëve të zbatojnë në praktikë logjistikën e lëvizjes së mijëra ushtarëve dhe pajisjeve të tyre. Lëvizje, e cila në kushtet e pandemisë së përbotshme, ishte edhe më e vështirë. Vitet e fundit, një preokupim i Bashkimit Evropian ka qenë çështja e kalimit të kufijve dhe lëvizshmërisë ushtarake në përgjithësi, duke mundësuar lehtësimin e procedurave për kalimin e trupave dhe mjeteve.

Stërvitje të tilla ushtarake të ngjashme, të quajtura “REFORGER”(Return of FORces to GERmany) - Kthimi i Forcave në Gjermani, - janë kryer nga NATO në fundvitet ‘60-të, deri në fillimvitet ’90-të, për të treguar aftësinë e aleatëve të NATO-s për vendosjen me shpejtësi të forcave në Evropë.

⁴ Rikard Jozwiak, *NATO Launches 'Biggest Military Exercise Since The End Of The Cold War*, RFERL, 25 tetor 2018, Shih në: <https://www.rferl.org/a/nato-set-to-start-biggest-military-exercise-since-the-end-of-the-cold-war-/29561371.html>

⁵ Christopher Woody, *The US Army's biggest European exercise in 25 years was canceled as it started, but it's already planning the next one*, Business Insider, 9 korrik 2020, Shih në: <https://www.businessinsider.com/army-planning-defender-europe-21-exercise-after-covid-cancellation-2020-7>

⁶ Cody Kellum, *Polish, US joint exercise Allied Spirit successfully concludes in Poland*, Army.mil, https://www.army.mil/article/236689/polish_us_joint_exercise_allied_spirit_successfully_concludes_in_poland

Ato stërvitje synonin forcimin e pozicioneve të NATO-s në kontinent, duke demonstruar angazhimin përëndimor për t'u mbrojtur nga agresioni i Traktatit të Varshavës⁷.

Kuptohet, ndërsa ato stërvitje synonin vendosjen e një force reagimi në një vend të vetëm (Gjermani), "DE 21" përshkoi një territor të gjerë që nga Afrika në Evropë, i cili në vijë frontale përfshin vendet e Evropës Veriore, nga Baltiku, Deti i Zi dhe Ballkani Përëndimor.

Stërvitja do të përbënte një ngjarje të rëndësishme në teatrin euroatlantik dhe do të vijonte të ruante karakterin e saj mbrojtës, por duke spostuar qendrën e zbatimit të aktiviteteve stërvitore në rajonin e Ballkanit dhe të Detit të Zi. Stërvitja kishte natyrë mbrojtëse me qëllim shkurajimin e agresionit ndaj rajonit, njëherazi përgatitjen e forcave tona për t'iu përgjigjur krizave, për të kryer operacione luftarake në shkallë të gjerë, nëse është e nevojshme. Ndërkohë që për të shmangur çdo keqkuptim, stërvitja u zhvillua në mënyrë transparente, duke i kushtuar vëmendje të veçantë komunikimit publik.

"DE 21" demonstroi gatishmërinë, ndërveprimin dhe forcën e angazhimit të përbashkët, duke përforcuar angazhimin e SHBA-së ndaj aleatëve dhe partnerëve, duke realizuar një mundësi të jashtëzakonshme, për të treguar publikisht punën që bëjnë aleatët dhe partnerët në rajonet e Ballkanit dhe Detit të Zi e në gjithë Evropën. Gjatë stërvitjes, vëmendje e veçantë nga Komanda e ushtrisë amerikane për Evropën dhe Afrikën iu kushtua menaxhimit në nivelin më të lartë të mbrojtjes së shëndetit të trupave pjesëmarrëse nga infektimi me virusin. Megjithëse kryesisht një çështje e shëndetit publik, pandemia ka pasur ndikim të rëndësishëm në sektorin e mbrojtjes. Rreziku i infektimit çoi në ndryshimin e mënyrës së kryerjes së trajnimit dhe stërvitjeve, deri në shtyrjen e tyre apo anulimin e disa të tjerave. Këto vendime të matura i lejua NATO-s të përshtatej në mjedisin "Covid-19", duke ndjekur një nivel të lartë ambicieje për realizimin e misioneve dhe programin e saj të stërvitjes.

"Edhe më parë ne e kemi provuar se kemi aftësinë për t'u trajnuar në mënyrë të sigurt pavarësisht nga pandemia. Pavarësisht nga situata, kombet tona mbështeten në forcat tona, të cilat janë të gatshme kurdoherë për të mbrojtur paqen"- deklaroi Komandanti i ushtrisë amerikane në Evropë dhe Afrikë, në fillim të aktiviteteve të para të stërvitjes në mars 2021⁸.

Një strategji e rreptë parandaluese dhe mbrojtëse ndaj virusit u zbatua nga SHBA dhe kombet pjesëmarrëse duke zbatuar një sërë masash, ku përfshihej vaksinimi, karantinimi paraprak, testimi në disa faza, si dhe ruajtja e masave mbrojtëse gjatë gjithë periudhës së stërvitjes. Organizimi i kësaj stërvitjeje në kushtet e "Covid-19" ishte një arritje e madhe sepse, pavarësisht situatave të pazakonta, u arrit të realizohet një stërvitje e këtyre përmasave.

⁷ *Defender 2020-Europe Military Exercise, Historical (REFORGER) Exercises, and U.S. Force Posture in Europe.* <https://fas.org/sgp/crs/natsec/IF11407.pdf> fq.1.

⁸ *US Army Europe and Africa Press Release, DEFENDER-Europe 21 activities begin this month, include two dozen nations, 16 mars 2021. Shih në:* <https://www.eucom.mil/article/41133/defender-europe-21-activities-begin-this-month-include-two-dozen-nations>

Stërvitjet e përbashkëta në Evropë dhe...

“Ndërveprimi mbetet çelësi i gatishmërisë së aleancës. “DE 21” është dëshmi e angazhimit të vendosur të SHBA-së për NATO-n, tregues kryesor i kapaciteteve tona kolektive dhe vërteton se aleatët dhe partnerët e NATO-s janë më të fortë së bashku”⁹.

Stërvitja “Defender Europe 21” u krye në periudhën mars-qershor 2021, sipas veprimtarive kryesore të planëzuara me lëvizjen e mjeteve, pajisjeve dhe personelit nga Shtetet e Bashkuara në Evropë dhe lëvizjen e rezervave të Ushtrisë Amerikane të pozicionuara paraprakisht në vendstacionimet në Gjermani, Itali dhe Holandë, drejt zonave të ndryshme të trajnimit, përmes rrugëve tokësore. Kjo demonstroi aftësinë e komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën në shkujtimin e akteve të agresionit, përmes shfaqjes së kapaciteteve, por edhe për sigurimin e kapaciteteve parandaluese dhe lëvizjen e tyre nga Evropa Veriore në teatro të tjerë operacionalë.

Lëvizja në shkallë të gjerë e trupave dhe pajisjeve për stërvitjen pati mbështetjen e gjerë nga secili prej dymbëdhjetë kombeve pritëse, me aktivitete që u zhvilluan në të gjithë teatrin, thuajse njëherazi. Koordinimi

dhe bashkëpunimi për “Defender Europe 21” demonstuan angazhimin e aleatëve dhe partnerëve të NATO-s për gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë ushtarake evropiane. “Defender Europe 21” realizoi disa ushtrime të përbashkëta si: “**Immediate Response**”, “**Swift Response**”, “**Saber Guardian**” dhe “**Command Post Exercise**”. Këto stërvitje të përbashkëta kanë pasur në zhvillimin e tyre tre elemente bazë të rëndësishme: **komandën** e bashkërenduar të misionit, **mbështetjen** e ndërsjellë dhe një **mjedis** partneriteti të misionit.

Gjatë zhvillimit të stërvitjeve më të vogla të lidhura me njëra-tjetrën u realizuan një sërë detyrash si: qitje luftarake, operacione zbarkimi logjistik në bregdet, operacione të mbrojtjes ajrore dhe raketore, evakuim mjekësor në shkallë të gjerë, parashutime trupash dhe pajisjesh, mbështetje e komandave të përparuara në mjedis detar, ajror dhe tokësor, përforsim i kapaciteteve.

Gjithashtu u krye edhe një stërvitjeje komando-shtabi, ku u demonstuan aftësitë e shtabeve për të komanduar forcat shumëkombëshe tokësore në një mjedis stërvitor të

Defender 21: Synimet dhe Objektivat

- **Rritja** e gatishmërisë operacionale dhe ndërveprimit
- **Përmirësimi** i aftësisë mbrojtëse dhe kapaciteteve në përgjigje ndaj krizave
- **Demonstrimi** i angazhimit dhe aftësive të SHBA-së si një partner strategjik i sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonin e Detit të Zi
- **Testimi** i aftësive dhe kapaciteteve në një operacion në shkallë të gjerë
- **Integrimi** i bashkëveprimit të forcave ushtarake shumëkombëshe
- **Zbatimi** i masave parandaluese dhe zbutëse për pandeminë Covid-19
- **Shfrytëzimi** i rrugëve kyçe tokësore dhe detare që lidhin Evropën, Azinë dhe Afrikën.

⁹ General Christopher Cavoli, <https://www.europeafrica.army.mil/ArticleViewPressRelease/Article/2663573/us-forces-redeploy-as-defender-europe-21-concludes/>

përbashkët (Joint) dhe të kombinuar (Combined), duke ruajtur dhe realizuar operacione reale në 104 vende të përhapura në dy kontinente të ndryshme.

Stërvitja përfundoi në muajin korrik me rikthimin e forcave dhe pajisjeve në bazat e tyre respektive në SHBA.

Pavarësisht pjesëmarrjes në nivele të ndryshme të aleatëve të NATO-s dhe partnerëve në stërvitjen “Defender Europe 21”, ajo ishte një ngjarje e rëndësishme në tërësi për Aleancën, në aspektin strategjik. Kemi parasysh këtu, qëllimet e stërvitjes, nivelin operacional dhe planifikimin stërvitor të organizatës, në përbashkëti me situatën e krijuar nga pandemia e “Covid-19”.

Pandemia ndikoi në zbatimin e plotë të Programit të Stërvitjeve të NATO-s të planifikuara. Disa nga këto stërvitje u modifikuan ose u anuluan. Por ndikimi i përgjithshëm i pandemisë mbi realizimin e programit stërvitor ishte i parëndësishëm dhe nuk e cenoi dot gatishmërinë e lartë të Aleancës.

...roli i Forcave tona të Armatosura

Forcat e Armatosura Shqiptare u përfaqësuan me dinjitet dhe profesionalizëm, si aleat i denjë i Aleancës dhe partner strategjik i SHBA-së, në fushën e sigurisë e të mbrojtjes.

Përfshirja e Shqipërisë dhe e Forcave të Armatosura në stërvitjen “Defender Europe 21” pati një rëndësi të madhe politiko-strategjike, madje dhe historike, pasi ishte stërvitja më e madhe për nga natyra, lloji dhe pjesëmarrja, e kryer ndonjëherë, në rajonin e Ballkanit. “Bëhet fjalë për një ngjarje historike, e cila është stërvitja më e madhe e zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri dhe rajon. Është një stërvitje, e cila jep mesazhe të rëndësishme për rëndësinë strategjike të Shqipërisë dhe për rolin që vendi ynë ka dhe do të ketë në të ardhmen në të gjitha zhvillimet gjeopolitike, duke qenë përkrah aleatëve shumë të fortë.”¹⁰

¹⁰ Fjala e Ministrit të Mbrojtjes z. N. Peleshi gjatë inspektimit për përgatitjet e FA për “Defender 21” Shih në: <https://www.mod.gov.al/index.php/newsroom-2/4910-ministri-peleshi-inspekton-përgatitjet-e-fa-per-defender21-presim-stervitjen-me-te-madhe-te-zhvilluar-ndonjehere-ne-shqiperi>

Defender 21: Fakte dhe Statistika

- **28,000 trupa pjesëmarrëse** në veprimtari stërvitore.
- **1,000 pajisje dhe mjete** që lëvizën nga vendbazimet e rezervës ushtarake të vendosura në 3 vende: Gjermani, Itali, Holandë.
- **31 zona stërvitore në 12 vende**, ku u realizuan aktivitetet stërvitore: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Rumania.
- **26 vende pjesëmarrëse** në veprimtaritë stërvitore: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kanadaja, Kroacia, Estonia, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Kosova, Letonia, Lituania, Moldavia, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Sllovenia, Spanja, Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, SHBA.
- **16 vende** që vendosën në përdorim rajone stërvitore për stërvitjen: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Kosova, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Rumania, Sllovenia.
- **12 vende të cilat ofruan aeroporte:** Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Rumania, Sllovenia.
- **5 vende që ofruan porte detare:** Shqipëria, Kroacia, Greqia, Mali i Zi, Sllovenia.
- **5 qendra logjistike** të vendosura në: Shqipëri, Kroaci, Greqi, Mali i Zi dhe Slloveni.
- **1 operacion i përbashkët logjistik** zbarkimi bregdetar i cili u zhvillua në Shqipëri.
- **1 stërvitje spitalore**, duke përfshirë një evakuim të përbashkët nga teatri i cili u zhvillua në Hungari.

Krahas synimeve dhe objektivave madhorë të trupave pjesëmarrëse, strukturat planëzuese dhe vendimmarrëse të Forcave tona të Armatosura gjatë stërvitjes realizuan një sërë objektivash siç ishin: testimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale dhe gatishmërisë së Forcave të Armatosura; trajnimi i Shtabit të Përgjithshëm në planëzim, koordinim dhe zbatim të operacioneve të përbashkëta; rritja e ndërveprueshmërisë midis strukturave pjesëmarrëse; përmirësimi i zbatimit të procedurave të përbashkëta, taktikave, kapaciteteve dhe teknikave të përdorimit të forcave, në mjedis të përbashkët operacional; demonstrimi i aftësive të FARSH për të pritur kapacitete luftarake në kuadër të NATO-s; bashkëpunimi dhe koordinimi me autoritetet civile lokale, popullatën civile, OQ, OJF etj.

Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, arsyet e vendimit mbi përzgjedhjen e Shqipërisë si një nga vendet ku do të kryheshin veprimtari kryesore të stërvitjes, (veprimet logjistike bregdetare në Durrës, ngritja e qendrës ndërkombëtare CIMIC në Pashaliman, vendosja e sistemeve raketore “Patriot” në Kuçovë e më tej veprimtaritë taktike tokësore në Bizë dhe në rajone të tjera stërvitore), i shikon jo vetëm në pozitën gjeostrategjike të Shqipërisë në Ballkan, por edhe në partneritetin strategjik dhe frymën pro perëndimore të popullit shqiptar.

“Së pari, roli i Shqipërisë në NATO është më i rëndësishëm se kurrë. Shqiptarët kanë luftuar krah për krah me ne, në konflikte të shumta nëpër botë. Ne kurrë nuk do ta harrojmë sakrificën tuaj dhe do të jemi gjithmonë mirënjohës që kur Amerika ka nevojë për ju - kur aleatët tuaj kanë nevojë për ju, NATO është atje dhe Shqipëria është gjithmonë në anën tonë. Ne e njohim trimërinë tuaj dhe jemi të nderuar t’ju njohim si Aleatin tonë.

Së dyti, Shqipëria është një vend i veçantë dhe një vend strategjik. Si anëtare e Aleancës, Shqipëria ofron një pikëmbështetje të rëndësishme që mund t’i lejojë NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të përgjigjen ndaj krizave dhe krizave rajonale shpejt dhe në mënyrë efektive. Stërvitja “Defender Europe 21” ngrihet mbi këtë koncept dhe demonstroi aftësinë për të hyrë në Evropën Juglindore përmes Shqipërisë. Ajo vërteton aftësinë e Shqipërisë për të pritur forca shumëkombëshe.

Në fund, ne vlerësojmë gatishmërinë e Shqipërisë për të marrë përgjegjësi. Ju keni qenë të zëshëm në mbështetjen tuaj për Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n. Ju kurrë nuk keni hezituar të ofroni trupat tuaja ose të ofroni pritjen e Aleatëve tanë në vendin tuaj. Ju na keni theksuar vazhdimisht potencialin strategjik dhe taktik të Shqipërisë. Ne ju dëgjuam dhe ne jemi këtu. Dhe ne ju jemi shumë mirënjohës për mikpritjen tuaj, partneritetin tuaj dhe guximin tuaj.¹¹”

Përtej rëndësisë strategjike dhe veçantisë historike, stërvitja angazhoi thuajse të gjitha kapacitetet ushtarake shqiptare.

Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë stërvitje ishte ...“demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura për të pritur, koordinuar dhe për t’u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe të NATO-s në operacione të

¹¹ *US Embassy in Albania, Remarks by Ambassador Yuri Kim at Defender Europe 21 Opening Ceremony Distinguished Visitors Day at the Port of Durrës, 4 maj 2021. Shih në: <https://al.usembassy.gov/remarks-by-ambassador-kim-at-defender-europe-21-opening-ceremony-distinguished-visitors-day-at-the-port-of-durres/>*

përbashkëta, në një ambient operacional kompleks, në poligone dhe terrene stërvitore”.¹² Ndërkohë, gjithë vendbazimet kryesore të FARSH u angazhuan në funksion të kësaj stërvitjeje: Komandat e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe strukturat vartëse, garnizoni “Skënderbej”, baza ajrore e Farkës dhe e Kuçovës, baza detare e Pashalimanit, si dhe poligonet stërvitore të Bizës e Fekenit, duke përfshirë këtu sigurisht portin e Durrësit dhe aeroportin e Rinasit.

Në gjithë këtë infrastrukturë ushtarake e civile shqiptare duhet të krijoheshin kushte për pritjen dhe bashkëveprimin e 3.100 trupave aleate, 10 anijeve, 18 avionëve, 19 helikopterëve, 6 sisteme raketash “Patriot” dhe 1.000 automjete, të cilat parashikohej të kryenin lëvizje sipas veprimtarive stërvitore.¹³

Stërvitja “DE-21” angazhoi në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi 3.000 trupa të FARSH gjatë gjithë zhvillimit të veprimtarive taktike të saj, brenda dhe jashtë vendit. Por krahas tyre në mbështetje ishin të angazhuar gjithë efektivat ushtarakë dhe civilë, pjesëtarë të FARSH. Gjithashtu, në mbështetje të strukturave të mbrojtjes funksionoi edhe një grup ndërlidhës me institucionet e tjera civile, me pjesëmarrës nga të gjitha strukturat e ekzekutivit të shtetit shqiptar, por edhe të qeverisjes lokale.

Pjesëmarrja në këtë stërvitje e gjithë strukturave të FA ishte mundësia e shkëlqyer për testimin e kapaciteteve tona, si ato njerëzore, infrastrukturore, planëzuese, zbatuese të FA, ashtu edhe ato civile si: infrastruktura aeroportuale, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërinstytucional në nivel kombëtar e më gjerë.

Në këtë mënyrë, krijuam pamje më të qartë për të ardhmen, për realizimin e investimeve strategjike, zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve ushtarake dhe civile, si dhe kontributet më cilësore të Forcave të Armatosura në Aleancë.

Disa përfundime

Stërvitja “Defender Europe 21” për nga natyra dhe lloji ka ndikime të shumëfishta në aspektin e sigurisë në disa përmasa të saj e, konkretisht:

Në rrafshin ndërkombëtar, kjo stërvitje komplekse e shkallës së gjerë demonstroi më së miri aftësitë dhe kapacitetet e pakonkurrueshme të SHBA-së për projektimin e forcës domethënëse ushtarake në çdo pikë të globit, për të ruajtur paqen dhe forcuar sigurinë ndërkombëtare. Gjithashtu, angazhimi i një numri të madh aleatësh dhe partnerësh në realizimin e këtij operacioni stërvitor masiv e tepër kompleks tregoi aftësinë e SHBA-së për udhëheqje dhe bashkërendim të shkëlqyer të iniciativave të sigurisë globale.¹⁴

Po kështu, përballja me sukses e realizimit të një ndërmarrjeje kaq masive dhe komplekse në kushtet e pandemisë globale të shkaktuar nga “Covid-19” tregon nivelet e larta

¹² Ligji nr. 29/2021, datë 8 mars 2021 “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”.

¹³ Po aty, shih në: Fletore Zyrtare nr. 42/2021, 17 mars 2021, f. 4991. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/fz/2021/42/6d5fe9eb-a4d5-49ae-8930-c4422946e4d2;q=defender>

¹⁴ Luke Coffey, *US sending a clear message through Defender-Europe 21*, Arab News, 7 May 2021, Shih në: <https://www.arabnews.com/node/1855346>

shëndetësore e mjekësore, si dhe kujdesin e përpiktë amerikan për masat mbrojtëse. Të gjitha këto aftësi ishin një leksion i hapur për të gjitha vendet pjesëmarrëse në këtë stërvitje.

Për më tepër, transparenca në qëllimet, veprimtaritë dhe pjesëmarrësit e stërvitjes tregoi vlerat më të mira demokratike të vendeve pjesëmarrëse.

Në rrafshin evropian, “DE 21” rikonfirmoi angazhimin cilësor dhe të padiskutueshëm të SHBA-së për sigurinë dhe paqen në gjithë rajonin euroatlantik. Riaktivizimi i stërvitjeve “Defender Europe” është gjithashtu një përgjigje e fortë ndaj veprimeve të viteve të fundit, të aktorëve jo dashamirës ndaj NATO-s dhe atyre sfidues të stabilitetit e paqes në kontinentin evropian.

Në rrafshin rajonal, përzgjedhja e territorit të Ballkanit Perëndimor për të realizuar zbatimin e pjesës kryesore të veprimtarive stërvitore ushtarake nga ushtria amerikane shpalos qartazi angazhimin e SHBA-së për paqen dhe sigurinë në rajon, por dhe rolin e padiskutueshëm të saj si promovues i demokracisë, zhvillimit dhe bashkëpunimit shumëplanësh rajonal.

Në rrafshin rajonal, kjo stërvitje përbën një shtysë të rëndësishme për të rritur bashkëpunimin e ndërsjellë, për të përmirësuar procedurat dhe teknikat, si dhe për të modernizuar pajisjet e mjetet, në përshtatje me sfidat e përbashkëta të sigurisë në nivel Aleance.¹⁵

Në rrafshin kombëtar, përzgjedhja e Shqipërisë si një vend me rëndësi thelbësore për stërvitjen “DE 21” tregon shkallën e lartë të besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë Shqipëri-SHBA, një aleancë e cila gëzon si askund tjetër, një mbështetje të gjerë popullore.

Përtej marrëdhënieve ndërshtetërore dhe dashamirësisë popullore ndërmjet dy vendeve, stërvitja “DE 21” përbën një arsye të fortë në shtysën për modernizimin dhe zhvillimin e Forcave tona të Armatosura, në të gjithë sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë publike në Shqipëri.

Përvoja e fituar nga pjesëmarrja dhe veprimtaria e Shqipërisë në “DE 21” duhet të jetë në qendër të vëmendjes së udhëheqjes politiko-ushtarake të vendit, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura në planin e brendshëm; zhvillimin e kapaciteteve luftarake dhe operacionale në fushën e bashkëpunimit me aleatët dhe në përbërje të aleancës, duke siguruar ndërveprim efikas, nëpërmjet teknikës, mjeteve dhe procedurave të përshtatshme standarde.

Forcat e Armatosura duhet të përmirësojnë dhe zhvillojnë kapacitete në planin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë vendas përtej partnerëve tradicionalë, siç janë forcat e rendit apo strukturat e tjera të sigurisë. Përvoja e “DE 21” në Shqipëri tregoi qartë se Forcat e Armatosura duhet të zgjerojnë fushën e bashkëpunimit dhe të krijojnë “ura” të përhershme, të qëndrueshme e të besueshme bashkëveprimi, me sektorin privat dhe shoqërinë civile, me qëllim përmbushjen me sukses të misionit të tyre kushtetues dhe patriotik.

Ndër detyrat parësore të strukturave tona del përshkrimi i problematikave që u paraqitën

¹⁵ G. Thomas, P. Williams, Y. Dyakova, *Exercise Defender-Europe 20: enablement and resilience in action*, NATO Review, 16 June 2020. Shih në: <https://www.nato.int/docu/review/articles/2020/06/16/exercise-defender-europe-20-enablement-and-resilience-in-action/index.html>

(aq sa janë), të cilat duhet të jenë studime të thelluara në Mësimet e Nxjerra nga kjo stërvitje. Mungesat apo mangësitë që mund të jenë vërejtur patjetër duhen hedhur në letër si objekt analize.

Në trajtesën e shkurtuar në fillim të këtij materiali nënvizuar se “Stërvitjet e mëdha janë shkolla të mëdha”. Ka përfunduar stërvitja, por jo shkolla. Madje dera e asaj shkolle qëndron gjatë hapur, pas mbarimit të stërvitjes.

Duhet të fillojë “çmontimi” i asaj stërvitjeje, duke nisur nga “finishi”- dita e fundit e saj dhe duke ecur në drejtim të “startit”- ditës së fillimit të saj. Duke e marrë në diskutim në mënyrë analitike në çdo hap të saj, në çdo segment të saj.

Gjithashtu, duhet të realizohet kthimi i problemeve të identifikuar në Mësimet e Nxjerra, të cilat duhet të shërbejnë si bazë për trajtimin e tyre në të gjithë auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe qendrat stërvitore të forcave, si dhe të shërbejnë si objekt i punës kërkimore e studimore për të ardhmen.

Analizat e hollësisht dhe plotësimi i mungesave e mangësive do ta forcojnë më tej gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë e FA-ve përkrah aleatëve, në çdo lloj rrethane.

Forcat tona do të ndjekin në vazhdimësi iniciativën “NATO 2030”, e cila synon ta bëjë Aleancën edhe më të fortë ushtarakisht dhe politikisht, në një botë të paparashikueshme...

Bibliografia:

- Jen Hudson, Reforger redux? Defender 2020 to be 3rd largest exercise in Europe since Cold War, Defense News, 7 tetor 2019. Shih në
- Rikard Jozwiak, NATO Launches ‘Biggest Military Exercise Since The End Of The Cold War, RFERL, 25 tetor 2018. Shih në: <https://www.rferl.org/a/nato-set-to-start-biggest-military-exercise-since-the-end-of-the-cold-war-/29561371.html>
- Christopher Woody, The US Army’s biggest European exercise in 25 years was canceled as it started, but it’s already planning the next one, Business Insider, 9 korrik 2020. Shih në: <https://www.businessinsider.com/army-planning-defender-europe-21-exercise-after-covid-cancellation-2020-7>
- Cody Kellum, Polish, US joint exercise Allied Spirit successfully concludes in Poland, Army.mil, https://www.army.mil/article/236689/polish_us_joint_exercise_allied_spirit_successfully_concludes_in_poland
- US Army Europe and Africa Public Affairs, Defender-Europe 21 activities begin this month, include two dozen nations, 22 qershor, 2020. Shih në: <https://www.army.mil/article/244260/defender-europe-21-activities-begin-this-month-include-two-dozen-nations>
- C. Todd Lopez, Defender Europe 21 Exercises Multinational Interoperability, Readiness, Transparency, Defense.gov, 3 maj 2021. Shih në: <https://www.defense.gov/Explore/News/Article/Article/2593494/defender-europe-21-exercises-multinational-interoperability-readiness-transpare/>
- US Army Europe and Africa Press Release, Defender-Europe 21 activities begin this month, include two dozen nations, 16 mars 2021. Shih në: <https://www.eucom.mil/article/41133/defender-europe-21-activities-begin-this-month-include-two-dozen-nations>
- US Army Europe and Africa, Defender Europe 21 Fact Sheet, 20 maj 2021. Shih në:

- NATO, Key NATO and Allied Exercises in 2021 Factsheet, Mars 2021, Shih në: https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2021/3/pdf/2103-factsheet_exercises.pdf
- NATO Media Center Press Release, NATO ANNOUNCES OFFICIAL KICK-OFF OF FLAGSHIP EXERCISE STEADFAST DEFENDER 2021, NATO.INT, 6 maj 2021. Shih në: <https://shape.nato.int/steadfast-defender/newsroom/news/nato-announces-official-kickoff-of-flagship-exercise-steadfast-defender-2021>
- Fjala e ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi në ditën e hapjes së “DE 21”.
- US Embassy in Albania, Remarks by Ambassador Yuri Kim at Defender Europe 21 Opening Ceremony Distinguished Visitors Day at the Port of Durrës, 4 maj 2021. Shih në: <https://al.usembassy.gov/remarks-by-ambassador-kim-at-defender-europe-21-opening-ceremony-distinguished-visitors-day-at-the-port-of-durres/>
- Ligj nr. 29/2021, datë 8 mars 2021, “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate, në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”. Shih në: “Fletore Zyrtare” nr. 42/2021, 17 mars 2021, f. 4991. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/42/6d5fe9eb-a4d5-49ae-8930-c4422946e4d2;q=defender>
- Luke Coffey, US sending a clear message through Defender-Europe 21, Arab News, 7 May 2021. Shih në: <https://www.arabnews.com/node/1855346>
- G. Thomas, P. Williams, Y. Dyakova, Exercise Defender-Europe 20: enablement and resilience in action, NATO Review, 16 qershor 2020. Shih në: <https://www.nato.int/docu/revieë/articles/2020/06/16/exercise-defender-europe-20-enablement-and-resilience-in-action/index.html>

SHËRBIMI I DETYRUESHËM KOMBËTAR-SFIDË PËR VLERA

Gjeneral Brigade Dr. Albert Mullai
Komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura
Kolonel (R) Prof. Dr. Kristaq Xharo

Trajtesë e shkurtuar.

Qysh në mesin e dhjetëveçarit të parë të shekullit të 21-të, kur u hodh ideja e Ushtrisë profesioniste, pati mendime të ndryshme, pro dhe kundër kësaj rryme, të argumentuara, duke theksuar argumentin që më së paku një pjesë e Forcave tona të Armatosura të ishin me efektivë të shërbimit të detyrueshëm. Ashtu siç pati argumente edhe nga ana tjetër, në favor të kalimit në një Forcë tërësisht profesioniste.

Argumenti që mbizotëroi ishte kostoja në buxhetin e shtetit e mbajtjes së një ushtari të shërbimit të detyrueshëm.

Ky debat natyrshëm u zhvillua dhe në vendin tonë madje është bërë ndër vite, por kuptohet me konotacionin që ka pasur sistemi ynë politik i atëhershëm dhe me liritë apo kufizimet që sistemi lejonte rreth këtij debati. Kalimi në vitet e pasluftës në ushtri vullnetare, e cila ishte trashëgimtare e drejtpërdrejtë e ushtrisë partizane, dalë nga Lufta Nacionalçlirimtare, erdhi si vijimësi dhe jo si zgjidhje e studiuar, ndërkohë që nuk ishte vetëm e jona si zgjidhje, por e Lindjes në tërësi.

Fqinjët tanë sot, anëtarë të NATO-s apo jo, pjesën kryesore të trupave e kanë me ushtarë të shërbimit të detyrueshëm. Ata njëherazi, sidomos vitet e fundit, janë pajisur me armatime, mjete dhe teknike të gjeneratës së fundit, me qëllim mbrojtjen e vendeve respektive duke e parë si detyrim kombëtar, ndërsa ushtrinë, si detyrë dhe si profesion.

Koha është kriteri, por kryesisht prova e prekshme dhe e pakundërshtueshme e drejtësisë së një vendimi të marrë, ndaj mbajtja e një qëndrimi pro apo kundër ushtrisë profesioniste do të ishte thjesht semplist.

11 vite nga heqja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, na japin të gjithëve ne sot luksin, të vendosim në peshore plus-et dhe minus-et e këtij apo atij modeli. E meqenëse është kështu, përmes këtij shkrimi nuk pretendojmë se kemi sjellë variantin më të mirë për zgjidhjen e problemit.

Prandaj, le të shërbejë ky shkrim si rihapje e një debati, i cili do të zgjidhë përfundimisht dilemën e mësipërme. Cilado qoftë zgjidhja...

Një përcaktim termi

Shërbimi i detyrueshëm i njerëzve në shërbim kombëtar, kryesisht një shërbim ushtarak, është përgjegjësi e shtetasve ndaj kombit të vet, në çështjet më të rëndësishme të interesit kombëtar ...

Ky është përcaktimi që jepet nga fjalori i famshëm Merriam-Webster Online¹. Shërbimi i detyrueshëm, shpesh i quajtur edhe rekrutimi, daton që nga antikiteti dhe vazhdon edhe në ditët e sotme me emra të ndryshëm. Sistemi modern i rekrutimit kombëtar, pothuajse në rang botëror, daton në Revolucionin Francez në vitet 1790 ku ky model, pra rekrutimi, u bë baza e ushtrisë më të madhe dhe më të fuqishme, asaj të Napoleonit. Më vonë, shumica e kombeve evropiane e kopjuan këtë sistem duke e përdorur edhe në kohë paqeje, fillimisht për të shërbyer në detyrë aktive dhe më pas të gatshëm në forcat rezervë.

A ka një histori shërbimi i detyrueshëm ushtarak?

Rekrutimi nisi si strategji e përdorur, fillimisht nga Franca, në kohën e Napoleonit, nga nevoja për të ndërtuar forca të fuqishme, të afta dhe të gatshme për të realizuar strategji mbrojtëse apo mësymëse, për të mbrojtur vendin apo për të përcaktuar sjelljen e vet kombëtare. Kur shtetet fituan monopolin e luftës, Traktati i Vestfalisë, 1648, ushtritë mercenare dominuan teatrin e luftës. Pas një periudhe prej më shumë se 150 vitesh, Napoleoni e përmbysi sistemin mercenar. “Përplasja - do të shkruante Jomini, filozofi determinant i kësaj periudhe, - midis modelit francez (rekrutimit) dhe ushtrive mercenare dërrmoi keqas të dytët.” Në vazhdim, për më shumë se 200 vjet, deri në fund të Luftës së Ftohtë, në të gjitha vendet zotëroi modeli i mobilizimit.

Nga fillimi i shekullit të 21-të, shumë shtete e kanë shmangur shërbimin e detyrueshëm ushtarak, duke u mbështetur kryesisht në ushtrinë profesioniste, mbi baza vullnetare. Aftësia për t’u mbështetur në një model të tillë, sidoqoftë, presupozon një farë shkalle të parashikueshmërisë në lidhje me kërkesat e luftës dhe konflikteve veçanërisht në fushën operacionale. Por disa shtete, që kanë hequr rekrutimin, ende rezervojnë të drejtën për të rifilluar rekrutimin gjatë kohës së luftës ose në kohë krize². Shtetet e përfshira në luftëra ose rivalitete ndërshtetërore ka më shumë të ngjarë të zbatojnë rekrutimin e detyrueshëm. Në një numër shtetesh reflektohet tradita për shërbimin e detyrueshëm, ndërsa disa të tjera, nisur nga vështirësitë ekonomike apo nga modelet e huazuara, e kanë shmangur shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

¹ <https://en.wikipedia.org/wiki/Conscription>

² Asal, Victor; Conrad, Justin; Toronto, Nathan (2017-08-01), “I Want You! The Determinants of Military Conscription”. Journal of Conflict Resolution.

Evoluimi i konceptit ose motivimi moral e politik

Jean Jacques Rousseau në *“Kontrata Sociale”*, fuqishëm, argumentoi për shërbimin e detyrueshëm, se “ishte e drejta dhe privilegji i çdo qytetari të merrte pjesë në shërbim dhe mbrojtje të të gjithë shoqërisë”. Për atë ishte një shenjë e rënies morale që t’ia linte shërbimin ndaj atdheut (ushttrinë) vetëm strukturave profesioniste. Ai iu referua kronologjisë së Perandorisë Romake, e cila sipas tij, mori fund kur ushtria romake u shndërrua nga shërbim i detyrueshëm në një forcë profesionale³. Në mënyrë të ngjashme, Aristoteli në veprën e tij të famshme *“Politics”* lidhi nga afër shërbimin e armatosur nga radhët e popullatës me rendin politik të shtetit⁴. Niccolò Machiavelli, autor i *“Princi”*⁵ shfaqej gjithashtu një përkrahës i zjarrtë i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ndaj edhe i shihte ushtritë profesioniste si shkakun e dështimit të unitetit social në Itali.

Studiues të tjerë si William James në *“Ekuivalentet morale të luftës”*⁶, që në fillim të shekullit e konsideronin shërbimin e detyrueshëm ushtarak apo kombëtar si mënyra e vetme për të forcuar unitetin e një kombi, duke filluar nga të rinjtë. Disa përkrahës të mëvonshëm të këtij koncepti si Jonathan Alter dhe Mickey Kaus mbështesin shërbimin e detyrueshëm ushtarak si një mënyrë për të forcuar barazinë sociale, për të krijuar vetëdijen kombëtare, për të “kapërcyer” ndarjet klasore dhe të lejojnë shtetasit (të rritur e të rinj) të angazhohen në përgjegjësi publike. Charles Rangel bëri thirrje për rivendosjen e shërbimit të detyrueshëm gjatë luftës në Irak, jo sepse priste seriozisht që ai të miratohej, por për të dhënë alarmin se si situata aktuale socio-ekonomike shfaqte hapur pamjen, që shumë pak fëmijë të shtresës së lartë shërbenin në forcat e armatosura amerikane vullnetare.

Samuel Huntington, shkencëtari më i madh politik i këtij shekulli në veprën e tij *“Soldier and State”* bën një analizë të shkëlqyer të zhvillimit të shërbimit ushtarak dhe gjithë forcave të armatosura⁷. Edhe pse ai nuk dyshon për asnjë çast që pozicionin e ushtarakut ta konsiderojë një *‘profesion të pastër’*, ai nëpërmjet analizës vendos një raport sa më objektiv midis modeleve të shërbimit kombëtar. Duke kërkuar një harmoni midis qytetarit, shtetit dhe ushtarit, ai rekomandon mënyrën e zgjidhjes së dilemave që lindin në trekëndëshin ushtar-shtet-qytetar. Nuk është rastësi që libri i Huntingtonit sot përdoret si material referues edhe në pozicionin që merret lidhur si me llojet ashtu edhe me vendin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Përse shërbimi i detyrueshëm ushtarak...

Nisur nga fakti i pamohueshëm që shërbimi i detyrueshëm ushtarak, në një masë të konsiderueshme, është sfiduar nga ushtria profesioniste, ekziston një debat i dukshëm midis përkrahësve dhe kritikëve të këtij procesi. Ithtarët e kësaj çështjeje përkrahin

³ Rousseau, J-J, Social Contract, Chapter “The Roman Comitia”.

⁴ Aristotle, “Politics”, Book 6, Chapter VII and Book 4, Chapter XIII.

⁵ Harris, Phil; Lock, Andrew; Rees, Patricia (2002), Machiavelli, Marketing and Management. Routledge. p. 10.

⁶ James, William (1906), “The Moral Equivalent of war”. Burimi elektronik: <https://www.uky.edu/~eushe2/Pajares/moral.html>

⁷ Huntington, Samuel “Soldier and State”.

mendimin se shërbimi i detyrueshëm promovon unitetin në nivel makro në disa mënyra. Së pari, mundëson individët të jetojnë, të angazhohen dhe të përjetojnë së bashku sfida të rëndësishme, duke krijuar përvojën e përbashkët të shërbimit dhe të përgjegjësisë në nivel shoqërie apo kombi. Kjo krijon kontekstin për të qenë të vetëdijshëm për një mirëkuptim të përgjithshëm në lidhje me atë se çfarë forme ka dhe si është përgjegjësia qytetare, çfarë duhet bërë dhe çfarë kërkohet nga secili për t'i shërbyer vendit dhe shoqërisë. Shtetasit mund të kuptojnë dhe madje të zhvillojnë një vlerësim për formën dhe veprimin që secili duhet të ndjejë për kombin e vet. Mbi të gjitha, studiuesit argumentojnë se gjëra të tilla mund t'i sjellin njerëzit së bashku, veçanërisht kur kemi të bëjmë me lindjen e 'mjediseve' të kërcënimeve sociale, kulturore, religjioze, krahinore, të brendshme apo nga jashtë.

Përveç kësaj, jeta në ushtri mund t'u mësojë individëve më shumë sesa të përshëndesin njëri-tjetrin apo të mësojnë si dhe kur të përdorin armët. Trajnimi i ofruar shkon përtej të mësuarit të aftësive teknike. Këtu mund të përfshihen përgjegjësitë individuale, puna në ekip, iniciativa, diversiteti, menaxhimi i stresit dhe vetëdija në nivel kolektiv. Por këtu mjaft njerëzve do t'iu mundësohet të mësojnë zakone jetësore dhe tiparet e vetë-disiplinës, por edhe aftësitë për vetëmbrojtje. Rekrutimi i detyrueshëm do të thotë se "askush" nuk do të kursehet nga përballja me vështirësitë deri në rastet më ekstreme.

Në anën tjetër, kritikët e shërbimit të detyrueshëm besojnë se një angazhim i tillë shkel vullnetin e lirë të qytetarëve, të drejtat e njerëzve për të praktikuar këtë vullnet. Asnjë individ nuk ka fjalën e fundit nëse duhet të angazhohen ose jo në trajnimin ushtarak dhe të hyjnë në ushtri, nëse ekzekutohet një mandat i detyrueshëm në të gjithë vendin. Ndryshe nga ushtarët vullnetarë të cilët janë të gatshëm të përjetojnë stërvitje në kushte të veçanta e të vështira dhe t'i shërbejnë kombit, të tjerët shpesh nuk kanë përvojë dhe aftësi thelbësore, duke siguruar cilësi të ulëta të aftësive të nevojshme. Ndërkohë, ata që janë kundërshtarë të idesë së shërbimit ushtarak të detyrueshëm, besojnë se kjo mund të çojë në një shkallë të lartë vështirësish për njerëzit që detyrohen të kryejnë këtë shërbim.

Shërbimi i detyrueshëm trend apo traditë

Pak kohë më parë, Suedia vendosi sistemin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ndërkohë rreth dy javë më herët, Norvegjia e shtriu sistemin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak edhe për femrat. Danimarka nuk e ka vënë ndonjëherë në diskutim, as Zvicra, Austria, Greqia e Turqia. SHBA kryen detyrim selektiv⁸. Kosova ndërkohë po angazhohet fuqishëm për krijimin e Forcave të saj të Armatosura. Mjaft vende të tjera, që e kanë ndërprerë përkohësisht, po e rikonsiderojnë sistemin e detyrueshëm si një çështje për zgjidhje. Pak kohë më parë, kjo temë u prek edhe në vendin tonë, por më shumë si shiu i beharit, ndërkohë që tradita është jo e vogël, madje në kontekstin e edukimit e të marrjes së përgjegjësisë ne kemi pasur edhe shprehjen popullore që "ushtria të bën burrë".

Shërbimi i detyrueshëm, që lidhet drejtpërdrejt me kapacitetet e fuqisë (ushtarake), si komponentë të fuqisë kombëtare dhe që përcaktohet në çështjet e sigurisë kombëtare, ka mbetur i harruar në kohë në vendin tonë. Natyrisht që disa studiues për këtë mund të na

⁸ https://en.wikipedia.org/wiki/Military_service, 2018.

shpallnin kampionë rajonalë të pacifizmit por, përtej kësaj, ky debat tashmë është bërë imediat. Disa mendojnë se jo vetëm në realitet, por edhe të debatosh për çështje të tilla, duket se jeton njëkohësisht në dy kohë, në kohën e shkuar dhe në të ardhmen, por jo në të sotmen. E sotmja i takon politikës së ditës, halleve të përditshme, të cilat rëndom lidhen me shqetësimet e ditës, e jo të perspektivës. Aq më tepër që një çështje e tillë, si ajo e shërbimit të detyrueshëm, lidhet me strategjinë kombëtare, e cila në formatin e interesave kombëtarë pavarësisht se është në ravijëzim, mbetet në krye të prioriteteve.

Shërbimi i detyrueshëm - a është koha për debat?

Debati është i nevojshëm dhe thelbësisht i rëndësishëm, ndonëse jemi sipas mendimit tonë modest, të vonuar në kohë. Debati lidhet me një çështje të prekshme dhe mungesa e reflektimit mund të ketë pasoja të dhimbshme. Çështja përmban jo vetëm dimensione të sigurisë, por edhe sociale, çështje të edukimit, të mbarëvajtjes qytetare e familjare e natyrisht, të kulturës kombëtare. Askush nuk e mohon që siguria në rajonin tonë edhe të paktën për një ardhme të afërt do të vazhdojë të mbetet mjaft e ndikueshme, por edhe fluide. Muajt e fundit, vendet fqinje kanë demonstruar se ndjehen më të “sigurta dhe më të qeta” kur rrisin dhe shfaqin kapacitetet e tyre të fuqisë, specifiku të asaj ushtarake vetëm apo edhe në kuadër të aleancave sipas orientimit që ato kanë. Me gjithë vështirësitë ekonomike, në veri dhe në jug të gadishullit nuk e fshehin angazhimin e tyre në rritjen e kapaciteteve të fuqisë konvencionale; në blerje armatimi modern dhe në rritje të buxheteve ushtarake. “Çuditërisht”, edhe pse janë vende anëtare apo partnere të NATO-s, ashtu si edhe ne, ato u janë rikthyer rritjes dhe forcimit të kapaciteteve kombëtare. Askush prej tyre, në situata të qeta apo të tensionuara, nuk shfaqin “dehjen” në idenë se janë vende anëtare të NATO-s. Ndoshta më qartë se ne, ata e njohin “artikullin V” të Aktit Themeltar të NATO-s, detyrimin për mbrojtjen kolektive, por nuk harrojnë “artikullin III”, për përballimin fillestar të rrezikut me kapacitetet kombëtare⁹. Natyrisht që të gjithë e kanë të qartë se NATO është aleancë, e cila kërkon kohën e vet të vendimmarrjes me konsensus, veçanërisht e komplikuar kur çështja diskutohet brenda anëtarëve të saj.

Përse shërbimi i detyrueshëm? Nuk është thjesht dhe vetëm çështje ushtarake. Të tjerë më parë janë shprehur se në një vend ku nuk ekziston asnjë institucion formal apo joformal i unitetit kombëtar, shërbimi i detyrueshëm ushtarak është i vetmi institucion që mund të vendosë në mënyrë të barabartë shtetasit e vet përballë të njëjtës përgjegjësi. Të rinj/ të reja, që vijnë nga shtresa të pasura deri në ato të varfra, do të ndjehen të barabartë mes tyre përballë një përgjegjësie sublimë siç është kombi. Më shumë se kur shohin një ndeshje të kombëtares, atyre u jepet mundësia të sfidohen dhe të sensibilizohen përballë të njëjtës përgjegjësi që është më e madhe se bindjet politike, që shkon përtej besimit fetar, përtej kulturave apo lokalizmave. Dhe jo vetëm për atë që ndjejnë, por edhe për atë që marrin, shërbimi i detyrueshëm nuk mund të zëvendësohet me asgjë tjetër në një shoqëri të goditur jo pak në të gjitha vlerat e saj. Padyshim që ndikon më tepër se gjithçka në kapacitetet e fuqisë kombëtare. Shërbimi ushtarak apo më saktë shërbimi ndaj atdheut është fuqi

⁹ Treat of Washington 1949.

njerëzore dhe siç shprehet Kaplan në *“Anarkia që po vjen”* është më e rëndësishme se çdo lloj teknologjie.

A është shërbimi i detyrueshëm ushtarak një nocion i tejkaluar?

Sipas US Global Issues (2016), numri i vendeve ku zbatohet rekrutimi, shërbimi i detyrueshëm është mbi 64 dhe i atyre me rekrutim selektiv është 8. Numri i vendeve ku rekrutimi mundësohet në kohë emergjence është 13. Numri i vendeve që kanë shmangur përkohësisht rekrutimin është 87, ndërsa numri i vendeve pa forca aktive të armatosura është 21¹⁰. Ka dy lloje debatesh: në vendet që e kanë dhe në vendet ku përkohësisht është shmangur. Debatu u shoqërua me referendume në Norvegji, Suedi, Danimarkë, Austri, Izrael, vende që e zbatojnë shërbimin e detyrueshëm. Referendumet dërrmuan rëndë idenë e heqjes së shërbimit të detyrueshëm apo atij alternativ ushtarak. Çuditërisht, në këto referendume gati 70% e atyre që kërkonin të ruhej shërbimi ushtarak ishin të rinj. Sipas *“Parameters”*, revistës prestigjioze amerikane për studime strategjike, ky debat nuk po zhvillohet vetëm në vendet që e zbatojnë rekrutimin, por ai po dominon përherë e më shumë mendimin publik në vendet që e kanë hequr këtë detyrim¹¹. Ka zëra kundërshtues, por ka një opinion mjaft të gjerë që e mbështet. Kritikët, ku shumica janë të orientuar nga frymëzime pacifiste por edhe religjioze, e konsiderojnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak si shmangie nga liritë individuale dhe nga parimet e besimit, një mundësi për të nxitur çështje të militarizmit. Mbështetësit e idesë së shërbimit të detyrueshëm ushtarak argumentojnë se shërbimi i detyrueshëm është më shumë se një komponent i fuqisë dhe ndërgjegjes kombëtare. Argumenti tejkalon kontekstin e forcave të armatosura. Ai shkon përtej kësaj të vërtete. Pozitivistët e lidhin procesin shumë më thellë të ideuar në vlerat, interesat dhe karakterin individual e kombëtar, në ndërgjegjen kolektive të popullatës, por edhe në përgjegjësinë e elitave. Trendet në tërësi janë të tilla, që ato vende që e kanë, nuk duket se kanë ndërmend ta ndryshojnë. Pothuaj se në të gjitha vendet nordike ai është pranuar në nivelin e krenarisë kombëtare. Referendumi që u zhvillua në Finlandë në 2013 për heqjen e shërbimit të detyrueshëm dështoi me sukses në shumicë dërrmuese. Në Suedi, mbi 70% e të rinjve u shprehën kundër ndërprerjes së shërbimit të detyrueshëm. Referendume të tilla dështuan edhe në Zvicër dhe Austri. Ndërkohë që edhe Gjermania ka një debat mjaft sensibilizues për vendosjen e detyrimit për shërbim ndaj atdheut.

A ka NATO apo BE një model standard për shërbimin ushtarak?

Jo. Vendet anëtare të NATO-s apo BE-së zbatojnë modele që përcaktohen tërësisht në referenca kombëtare. Nuk ka kërkesë standarde të NATO-s apo të BE-së që përcaktojnë modelin e shërbimit. Danimarka, Norvegjia, Greqia, Turqia e anëtarë të tjerë në NATO zbatojnë modelin e shërbimit të detyrueshëm. Ndërkohë edhe vende të tjera evropiane (jo anëtare të NATO-s) si: Austria, Finlanda, Suedia, Zvicra etj., zbatojnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Gjithsesi, duhet saktësuar se, kur flitet për shërbim të detyrueshëm, nuk konceptohen vetëm

¹⁰ US Global Issues 2019.

¹¹ Parameters Quarterly 2019.

forca luftimi, por edhe lloje shërbimesh ndihmëse apo dhe komunitare. Për ata që angazhohen në lëvizje pacifiste apo religjioze nuk iu kërkohet apo nuk detyrohen të mbajnë armë, por e kryejnë shërbimin në organizata humanitare (Kryqi i Kuq etj.), apo në shërbim të komunitetit, në spitale, azile, qendra sociale etj. Për gjini të ndryshme ofrohen shpesh edhe shërbime të ndryshme. Nuk është vetëm Izraeli, por edhe në Norvegji u vendos shërbimi i detyrueshëm për femrat. Ligji u vendos pas kërkesës së femrave për mosdiskriminim. Koha e shërbimit të detyrueshëm dhe mënyra e realizimit të tij ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin¹².

Në ndihmë të idesë së shërbimit të detyrueshëm

A nxit shërbimi i detyrueshëm nacionalizmin? JO - Ai promovon vlerat më të larta kombëtare. Edhe pse është i vetmi mjedis ku aktiviteti nis me betimin solemn dhe himnin kombëtar, ai nuk promovon nacionalizëm, por vlera vitale. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak edukon dhe nxit vlerat kombëtare në shumë mënyra. Së pari, është nga të paktit, në mos i vetmi mjedis që ofron unitetin kombëtar mbi baza dhe interesa vitalë të kombit. Të rinjtë mund të kuptojnë e të zhvillojnë konceptet për kombin, kulturën dhe interesat kombëtarë, të trajnohen së bashku dhe të ndajnë përvoja të përbashkëta. Në ditët e sotme asnjë mjedis tjetër nuk e zhvillon këtë proces më mirë se sa shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak mundëson që njerëzit të ndjehen të bashkuar, sidomos kur përballen me sfida apo kërcënime të identitetit, me ndarje kulturore apo religjioze, politike apo ideologjike, nga çfarëdo lloj drejtimi që mund të veprojë. Ai ua mundëson të rinjve për të mësuar dhe trajnuar së bashku, duke mundësuar që të ndajnë eksperiencën të përbashkëta. Për më tepër, ndihmon në realizimin e një kuptimi të përgjithshëm për jetesën, vështirësitë dhe përgjegjësitë, që janë të nevojshme për çdo lloj angazhimi të mëvonshëm, përfshirë padyshim edhe atë familjar. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak nuk nxit nacionalizmin, por ndërgjegjëson qytetarët për konceptin real të kombit dhe përgjegjësinë e secilit për vendin dhe kombin e vet. Në këtë kontekst, për ne shqiptarët, për ato që kanë ndodhur historikisht, por edhe për të sotmen dhe të ardhmen, ky shërbim është JETIK.

Shërbimi i detyrueshëm ndihmon afrimin dhe bashkimin e njerëzve në një vend.

Thelbi i qytetarisë qëndron në faktin se nuk është një përpjekje individuale, por ajo është një “sport në ekip”. Përkufizimi i patriotizmit është uniteti që vendosin individët privatë për të krijuar një jetë më të mirë publike për vendin. Kur je qytetar ndjen kërkesa specifike për të siguruar të drejtat që gëzojnë të gjithë, duke u krijuar ndjenja se kjo realizohet vetëm në afrimet social. Etërit Themelues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e përkufizuan virtytin nëpërmjet simbolit të individit, i cili ishte i gatshëm të linte mënjatë interesin individual, për të ndjekur një të mirë të përbashkët¹³.

Shumica e vendeve tashmë u kërkojnë njerëzve të kryejnë veprime në interes të publikut. Për disa individë, rekrutimi mund të jetë një ide paksa e “frikshme” ose mund të krijojë dilema rreth etikës dhe moralit personal, por kjo mund të zgjidhet duke u vendosur përballë detyrave të shumta që janë në interes të gjithë shoqërisë. Ndoshta kjo do të kërkojë

¹² Carl Mosko (2018) “Evolution of military conscription”. Parameters.

¹³ Huntington ‘Soldier and State’ 1956. Uashington.

një “sakrificë” nga ana e individit të përfshirë, për të siguruar të mirën e përbashkët për të gjithë. Nëse do të vendoset në raport me shembuj të tillë ‘sakrificë’ si pagimin e taksave apo edhe aktivitetin e shkollave publike në komunitet, shërbimi i detyrueshëm ushtarak (kombëtar) është thjesht një tjetër nga ato ‘sakrificë’. Duke lënë mënjanë angazhimin personal për një periudhë specifike, zakonisht deri në një vit, është e mundur që çdo individ të fitojë përvoja të tjera të ndryshme jetësore dhe njohuri profesionale që mund t’i ndihmojë për të kapërcyer mjaft sfida dhe të jenë të suksesshëm në jetë.

Shërbimi ushtarak krijon sensin e identitetit publik. Kur të gjithë futen në kategorinë e shërbimit, atëherë ekziston një ndjenjë e identitetit të përbashkët që shteti është në gjendje dhe mundet të krijojë në të gjithë vendin. Qytetarët kanë një ndjenjë të qëllimit kombëtar që ndihmon në identifikimin e të gjithëve në frymën e shpirtit të grupit. Një nga avantazhet e shërbimit të detyrueshëm në demokraci është se ka më shumë larmi, por edhe më shumë mundësi se çdo strukturë tjetër shtetërore. Shërbimi i detyrueshëm krijon bazë të përbashkët për të gjithë, kështu që edhe në debatin më të ashpër ekziston gjithmonë një nivel i përbashkët që përfundimisht mund të çojë drejt momentit të një kompromisi.

A funksionon shërbimi ushtarak në këtë model shoqërie? Shërbimi ushtarak ofron përvoja të paçmueshme për çdo individ. Ai është një ndryshim i rëndësishëm nga përvojat e mëparshme për të rinjtë/të rejtat; një ndryshim në perspektivë që mund t’i ndihmojë ata të shohin të ardhmen në një nivel tjetër nga ai spontan, të frymëzojë ata që të punojnë më shumë në të ardhmen dhe të nxisë një ndjenjë më të madhe të interesit jo vetëm kombëtar, por edhe të përgjegjësisë qytetare. Për të rinjtë (por jo vetëm) shërbimi i detyrueshëm kthehet në një benefit që prodhon tipare të rëndësishme dhe po aq të vlefshme të karakterit të individit. Natyrisht, është e vërtetë që gjatë shërbimit të detyrueshëm të rinjve iu mësohet jo vetëm respektimi i autoritetit, i vetëdisiplinimit, të sjellurit dhe të punuarit në grup, por edhe aftësi të tjera, si: të përballesh me problemin apo vështirësinë; aftësi menaxhuese apo drejtuese, cilësi këto për të cilat shërbimi i detyrueshëm është unik.

Në të kundërt, mungesa e tyre, siç po provohet dita-ditës, po kthehet në një fenomen viral. Armstrong (William) shkruan për News Max (2016) se shërbimi ushtarak i detyrueshëm kuron shumë nga sëmundjet e shoqërisë së sotme: “Doni të shihni djalin tuaj, vajzën tuaj, nipin dhe mbesën, fëmijët e fqinjët, adoleshentë që të jenë seriozë, këmbëngulës, të respektueshëm, të disiplinuar, të nderuar e të përgatitur për jetën?”¹⁴ Nuk është një reklamë për një pilulë magjike - është thjesht një argument për shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Në të kundërt, ju gjeni pamjen që nuk do të dëshironit ta shihnit, të rinj pa objektiva, pa iniciativë, pa vetëbesim deri në të rinj të pleksur me krimin, abuzimet, prostitucionin që në adoleshencë...”¹⁵. Le të zgjedhim.

Rekrutimi shton një shtresë tjetër të përgjegjësisë ndaj shtetit. Kur ekziston shërbimi i detyrueshëm ushtarak, atëherë më shumë pjesëtarë të shoqërisë janë të përfshirë e të interesuar drejtpërdrejt në punët e përditshme të shtetit të tyre, të cilët qëndrojnë vigjilentë

14 Armstrong (William) News Max (2016).

15 Po aty.

ndaj ngjarjeve aktuale; në mënyrë që ata të dinë sa të sigurtë do të jenë të afërmit e tyre në çdo situatë të caktuar. Sigurisht do të shtohet edhe një dëshirë e konsiderueshme për të kuptuar më shumë sfidat rreth kërcënimeve ndaj vendit, duke siguruar kështu një faktor që ofron më tepër mbështetje. Në të njëjtën kohë, ky nivel i ndërveprimit i bën shtetarët të japin llogari për vendimet e tyre.

Shërbimi ushtarak iu siguron njerëzve aftësi të dobishme profesionale. Shërbimi ushtarak në forcat e armatosura do të thotë më shumë sesa të dish të marrësh një armë dhe si ta përdorësh atë. Jeta ushtarake mund t’u mësojë njerëzve aftësi specifike teknike që mund t’i përdorin gjatë gjithë jetës së tyre. Shumë njerëz do të fillojnë një karrierë pas kohës së tyre në shërbim për shkak të asaj që kanë mësuar gjatë kohës së tyre në trajnim. Përgjegjësia, udhëheqja dhe puna në ekip janë vetëm disa nga tiparet që futen te secili person, ndërsa mësojnë se si të disiplinojnë, shfaqin apo mbrojnë veten dhe vendin e tyre.

Ka mundësi për të fituar aftësi lidershipi në dispozicionin tuaj. Edhe nëse nuk mendoni se shërbimi ushtarak është rruga më e mirë për t’u marrë në jetën tuaj, koha që kaloni në shërbim mund t’ju ndihmojë të pasuroni kurrikulën tuaj me aftësi për të vazhduar një karrierë të preferuar. Ju do të keni aftësi dhe përvoja të provuara e të fituara, që do t’ju lejojnë të merrni përvoja zgjidhjeje apo drejtimi aq të nevojshme. Disa individë madje mund të kenë përfunduar diplomën pas rekrutimit për shkak të talenteve që u tregojnë eprrorëve të tyre. Nëse ju jepet një zgjedhje midis punësimit të dikujt direkt nga kolegji ose një individ me 2-3 vjet përvojë praktike, shumica e menaxherëve të punësimit zgjedhin opsionin e fundit.

Editorialisti Kenneth Andresen, kur Suedia ndërpreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak në vitin 2010, shkroi: “...është një bazë e fortë për t’u frikësuar, se me ndërprerjen e shërbimit ushtarak, të deritanishmes do t’i shtohet edhe një nivel tjetër i zhdukjes së ndërgjegjes publike ... lidhja mes detyrimeve dhe të drejtave po bëhet gjithmonë më pak dhe më pak e qartë.”¹⁶ Shërbimi ushtarak nxit ndjenjën e ndërgjegjes qytetare, një fenomen i dërrmuar aq rëndë nga ndasitë politike, kulturore, religjioze, të origjinës apo të vendlindjes.

Shoqëria jonë gjithmonë e më tepër po demonstroi frikshëm ndarjet dhe dallimet sociale. Asnjë strukturë institucionale ose fare pak e në mënyrë joprofesionale, po përballem me këtë fenomen. Shërbimi i detyrueshëm është një ambient ku mundësohet që dallimet të shkrihen dhe unifikohen. Ari Bussel shprehet në *New Blaze*: “Forcat e Armatosura janë një terren i të gjithëve, të atyre që vijnë nga shtëpitë e pasura e të varfra, nga grupe religjioze të ndryshme e me praktikë në besime fetare, por edhe laike, me ngjyra të ndryshme të lëkurës, të zgjuar apo edhe të ngadalshëm, me aftësi të kufizuara, por edhe të shëndetshëm, të guximshëm dhe hezitues. Shërbimi i nxit të gjithë brenda një procesi më të njëjtin standard, duke i trajtuar në mënyrë të barabartë, duke i vendosur nën të njëjta kërkesa dhe duke iu besuar të njëjtat përgjegjësi të mëdha, pavarësisht nga besimi, përkatësia, gjendja sociale apo etiketat e përkatësive tjera”.¹⁷

16 Kennet Andreson (2011), *National Dilemma*. Stockholm.

17 Ari Bussel (2017), *New Blaze*.

Në përfundim

Ekziston një debat për shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si një përgjegjësi që duhet të ndejnë shtetasit për vendin e tyre. Në këtë epokë, është shumë e rëndësishme që brezi i ri të përfshihet në shërbime të tilla, pasi zhvillon ndjenjën e identitetit e të patriotizmit mes tyre, i bën ata të kuptojnë se çdo shtetas ka edhe detyrime ndaj vendit.

Shërbimi ushtarak përgatit dhe ndihmon të rinjtë të zhvillojnë cilësi të domosdoshme, të cilat nuk mund t'i marrin në asnjë vend tjetër. Kjo i bën të rinjtë e të rejtat më seriozë për jetesën duke i veshur me një ndjenjë përgjegjësie që lind dhe zhvillohet së bashku me ata.

Në një botë ku krimi dhe dhuna janë të zakonshme, kryerja e shërbimit ushtarak do t'u mundësojë atyre të jenë të përgjegjshëm, mendërisht të mbrojtur dhe fizikisht të përgatitur kundër çdo kërcënimi të perceptuar. Kjo, jo vetëm që do t'i krijonte siguri si koncept, por gjithashtu do ta bënte më të sigurt gjithë shoqërinë në fakt.

Për më tepër, shërbimi ushtarak mund të promovojë unitetin kombëtar në shumë mënyra: duke iu mundësuar të rinjve të mësojnë dhe stërviten së bashku, duke krijuar përvojën e përbashkët të shërbimit në ushtri. Shërbimi ushtarak dhe shërbimi ndaj komunitetit ngulitin ndjenja të patriotizmit dhe dashurisë për vendin në ndërgjegjen e të rinjve dhe kontribuojnë në edukimin e tyre, prandaj besohet se të gjithë të rinjtë duhet të ndejnë përgjegjësinë e kalimit në një periudhë të shërbimit ushtarak apo atij komunitar.

Bibliografia:

- S. Huntington: *The Soldier and the State: The theory and Politics of Civil-Military Relations*
- M. Janovitz: *The Professional Soldier: A Social and Political Portrait* (London: The Free Press of Glencoe Collier-Macmillan Ltd. 1960).
- Max Weber: *Essays in Sociology* (Oxford University Press, 1946).
- Peter Feaver: *Guarding the Guardians: Civil-Military Relations and the Control of Nuclear weapons.*
- H. Lasswell: *The Garrison State* (*American Journal of Sociology* 46, 1941).
- Charles Moskos, John Allen Williams and David Segal, eds., *the Postmodern Military: Armed Forces after the Cold War S.*
- B. Abrahamson: *Military Professionalization and Political Power* (Beverly Hills & London: Sage Publications, 1972)
- Major Isaiah Wilson: *Thinking Beyond War: Civil-Military Operational Planning in Northern Iraq* (Cornell University, October 2004).
- Mark Lewis: *Armed Forces and Society*, (Fall 2004) "Army Transformation and the Junior Officer Exodus"
- Sean Naylor: *Not A Good Day To Die – The Untold Story of Operation Anaconda*, (forthcoming, summer 2005).
- "Learning to Adapt to Asymmetric Threats," (Institute of Defense Analysis, Dec 2004).

RISHIKIMI I STRATEGJIVE, BAZA E ZHVILLIMIT TË FARSH

Kolonel Dr. Ahmet Leka

Drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Jo thjesht dhe vetëm për faktin se duhen respektuar afatet për rishikimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë Ushtarake, por edhe për shumë arsye të tjera, duhet trajtuar kjo temë.

Artikulli trajton nevojën dhe disa arsye themelore, përse është i nevojshëm rishikimi i dokumenteve strategjike, cilët janë faktorët që kanë ndikim në përpilimin e dokumenteve strategjike të sigurisë, cilat janë sfidat e ardhshme të sigurisë dhe në fund, disa rekomandime për procesin e rishikimit dhe formulimit të këtyre dokumenteve.

Dokumenti zyrtar i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK), edhe pse një libërth teorik në dukje, është dhe duhet të jetë kuadrati rrethues i gjithë politikës, që i mundëson kombit shqiptar sigurinë e jetës në çdo aspekt e në çdo nivel. Në nivel qytetari dhe në nivel shteti. Fundja, pak rëndësi ka se si emërtohet, pra cili është emri që i vendoset. Me rëndësi është theksimi i rëndësisë që ka ky dokument.

Dhe emërtimin e kemi me vend, ashtu siç e ka shumica e shteteve të botës: Strategjia e Sigurisë Kombëtare. Por shtetet quhen të tillë, pasi për jetësimin e atyre materialeve, të kësaj rëndësie, të nesërmen e miratimit të tyre, përveshin mëngët për të bërë çdo ditë punën për realizimin e saj. Aq sa ecin, por ecin përpara, drejt objektivit madhor që kanë vendosur. Qoftë edhe një centimetër në ditë. Por vetëm drejt objektivit, e jo në kahun e kundërt.

Me rëndësi madhore është fakti që ai libërth, jo vetëm duhet punuar me baza shkencore, me dashuri dhe patriotizëm të lartë për Kombin dhe shtetin, por do të duhet të kthehet në plan

Kolonel Dr. Ahmet Leka _____

të përditshëm pune, për institucionet e shtetit.

Dokumentet kryesore strategjike, përjashtuar ato doktrinare, nga ana hierarkike, për vetë rëndësinë që kanë, duhet të vijnë menjëherë pas Kushtetutës.

Miratimi i dokumenteve strategjike dhe doktrinare, sipas një radhe të caktuar, tregon pjekurinë e elitës politike dhe të kuptuarit nga ana e saj, të rëndësisë që ka kompletimi si duhet i kuadrit strategjik doktrinar.

Këto mëton të trajtojë ky shkrim, i pari për këtë çështje.

Fjalët kyçe: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, FARSH, Aleanca

STRATEGJIA KOMBËTARE DHE...

Nisur nga thelbi përmbajtësor i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, del se janë dy shtresat përbërëse kuptimore: “Strategjia” dhe “Siguria Kombëtare”.

Në qendër qëndron Siguria - siguria e një kombi. Ajo çka e mbështjell këtë sferë është Strategjia - strategjia si art luftimi për mbijetesë kombëtare, për fuqizim kombëtar, për vazhdimësi, për ... Siguri.

Por, çfarë është Siguria? Fjalori i Gjuhës Shqipe e përshkruan kështu:

“Siguri-a: *Të qenët jashtë çdo rreziku dhe të papriture; gjendje pa ndonjë rrezik a të keqe të papritur; sigurim.* [Vërtetësia e plotë e diçkaje; mungesa e çdo dyshimi në lidhje me diçka; bindja e plotë se diçka është e vërtetë, e përpiktë a e drejtë. Dihet (nuk dihet) me siguri. Me siguri matematike me siguri të plotë.] *Besimi në diçka; bindja e plotë a besimi i patundur për t’i dalë në krye një pune ose se gjithçka do të shkojë mirë, ashtu siç duhet, siç parashikohet, siç dëshirohet. Siguria në të ardhmen* [në ditën e nesërme]”¹

Nuk është e thënë që strategjitë të kenë doemos një emër të tillë, por në një pjesë të mirë të tyre vihet re përdorimi i një lloji motoje.

Le të përmendim disa prej strategjive të SHBA-së. Në vitin 1994, SSK-ja amerikane kishte emërtimin: “A National Security Strategy of Engagement and Enlargment”(Një SSK për angazhim dhe zgjerim)².

Një vit më pas, në shkurt 1995, SSK-ja amerikane mbante përsëri të njëjtin emër. Këtë emër e mbajti edhe në shkurt 1996, kur u miratua SSK-ja e SHBA-së për vitin në vijim. Emri ndryshoi në vitin 1997, kur ajo u quajt “A National Security Strategy, for a New Century”(Një SSK për një shekull të ri).³

Këtë emër SSK amerikane e mban edhe në versionet e mëvonshme, të viteve 1998 dhe 2000.

Në vitin 2001 ndërron sërish emër dhe quhet “A National Security Strategy For A Global Age”(Një SSK për një erë globale).⁴

¹ “Fjalor i Gjuhës Shqipe”; njihet gjerësisht si: Fjalori i vitit 1954, viti i botimit të parë, i ribotuar, “Shtëpia Botuese Çabej”, Tiranë, 2005. ÇABEJ E., CIPO K., DOMI M., KRAJINI A., MYDERRIZI O.

² “A NATIONAL SECURITY STRATEGY, OF ENGAGEMENT AND ENLARGMENT”, White House, July 1994, US Government Printing Office, Washington DC.

³ “A NATIONAL SECURITY STRATEGY, FOR A NEW CENTURY”, White House, May 1997, US Government Printing Office, Washington DC.

⁴ “A NATIONAL SECURITY STRATEGY FOR A GLOBAL AGE”, White House, December 2000, US Government

Strategjitë e miratuara në vitet 2002, 2006 dhe 2010 nuk mbanin asnjë emër, përveç atij standard “National Security Strategy of USA”.

Por praktika e vendosjes së një emri apo motoje për një SSK nuk është vetëm amerikane.

“**Strategji** - arti dhe shkenca e zhvillimit dhe përdorimit të instrumenteve të fuqisë kombëtare në një mënyrë të sinkronizuar dhe të integruar, me qëllim që të arrihen objektivat në një mjedis, kombëtar ose ndërkombëtar”-shkruajnë amerikanët.⁵

“**Strategjia kombëtare e sigurisë** - Arti dhe shkenca e zhvillimit dhe përdorimit të diplomacisë, ekonomisë dhe fuqisë informative të një kombi, së bashku me Forcat e tij të Armatosura, në kohë paqeje e lufte, për të siguruar objektivat kombëtare”.⁶ Le të shikojmë se si e emërton Britania e Madhe.

SSK britanike nënvizon gjithashtu... “Strategjia Kombëtare përfshin *gjithë instrumentet e fuqisë së kombit*”...⁷ Sepse SSK-ja e Britanisë mban moton: “A Strong Britain in an Age of Uncertainty: The National Security Strategy”(Një Britani e fortë në një epokë pasigurie: SSK).⁸

E konceptuar sipas teorive të studimeve mbi sigurinë, përgjigjja mbi pyetjen “*Çfarë është Siguria?*” do të përcaktohej kështu nga Walter Lippmann:

“Një komb quhet i sigurt, kur ndodhet në atë gjendje, ku nuk ekziston rrezik që ta detyrojë atë të sakrifikojë vlerat themelore, nëse do të donte të shmangte luftën, e nëse do sfidohej, të ishte i aftë që t’i ruante ato nëpërmjet fitores, në një luftë të tillë”.⁹

Këto dokumente integrojnë dhe bashkërendojnë kontributet e aktorëve të sigurisë kombëtare në raport me interesat, sfidat dhe rreziqet, që konsiderohen më të rëndësishme për vendin. Përveç kësaj, dokumentet janë pasqyrim i pozicionit gjeografik dhe zhvillimit social-ekonomik të vendit.

Shpesh dëgjohet shprehja: “Shqipëria është një shtet i vogël, që ka zgjedhur të ketë dokumentet e veta strategjike të sigurisë”. Ekziston një përkufizim për shtetet e vogla.

“Shtete të vogla janë ato shtete me popullsi, territor, nivele prodhimi, pasuri dhe kapacitete ushtarake të vogla”¹⁰.

Por kjo nuk do të thotë asgjë, nëse marrim si shembuj krahasimi shtete të tjera “të vogla”. Kështu për shembull, Izraeli nuk bën pjesë në shtetet e “mëdha”, nëse iu referohemi

Printing Office, Washington DC.

⁵ JOINT PUBLICATION 1-02; “Department of Defense dictionary of military and associated terms”; DIANE Publishing, DOD USA, April 2001, f. 507.

⁶ JOINT PUBLICATION 1-02; “Department of Defense dictionary of military and associated terms”; DIANE Publishing, DOD USA, April 2001, f. 358.

⁷ SSK e Britanisë së Madhe. 2010. f. 5.

⁸ “BRITAIN IN AN AGE OF UNCERTAINTY: THE NATIONAL SECURITY STRATEGY”; Printed in the UK for The Stationery Office Limited on behalf of the Controller of Her Majesty’s Stationery Office, London 2010.

⁹ BUZAN, Barry; “People, States & Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era”; ECPR Press Classics, 2008, f.36.

¹⁰ Panke, D., (2011): Small States in EU Negotiations: Political Dwarfs or Power Brokers: University College Dublin Press: 2011.

kritereve të sipërcituara. Po kështu, Kroacia, Sllovenia etj., për të mos kërkuar shembuj të ngjashëm në botë, që ka plot, për hir të së vërtetës.

Së brendshmi: - Republika e Shqipërisë ka bërë ndryshime të jashtëzakonshme në aspektin e rritjes ekonomike, sociale dhe kulturore. Por fakti që ka zhvillim dhe rritje të fuqisë ekonomike, në vetvete nuk do të thotë asgjë për çështjen që po trajtojmë, nëse nuk kanalizohen e nuk orientohen drejt energjitë dhe frytet e zhvillimit.

Së “jashtmi”: - Kemi faktin që shqiptarët kufizohen me veten e tyre, për shkak të lënies së mbi gjysmës së kombit jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme, e cila jo rastësisht mbiquhet londineze, nga e ashtuquajtura “konferencë” e Londrës.

Ajo padrejtësi historike e para 118 viteve, në rrjedhën e zhvillimeve të reja dhe të konfigurimit të Ballkanit të 30 viteve të fundit, ia rrit kredencialet shtetit shqiptar sot.

Shqipëria ka rol të rëndësishëm në rajon e më gjerë, sa i takon stabilitetit dhe sigurisë. Thuhet kjo, mbështetur edhe në mendjet e ndritura të botës që e kanë trajtuar këtë çështje. Dhe më konkretisht: “Vërehet se lidhur me vlerësimin e sigurisë, mirëqenies dhe ndikimit gjeopolitik të shteteve të vogla, nuk ka rëndësi se sa milion banorë është, pasi nuk është e thënë që shtetet me popullsi më të vogël janë doemos më të dobëta sesa shtetet me popullsi më të madhe”.¹¹

Po kështu, edhe një argument tjetër: “Në të njëjtën mënyrë, sipërfaqja e vogël nuk përkthehet automatikisht në dobësi në arenën ndërkombëtare”.¹²

Në përgjithësi dokumentet strategjike të sigurisë nuk janë shumë të ngurta, pra të prera, të periudhës kohore në të cilën ato synojnë arritjen e objektivave të tyre të sigurisë. Kjo nuk duhet ngatërruar me afatet e vendosura në këto dokumente (3-5-vjeçare) për rishikimin e tyre. Duke qenë se përcaktimi i periudhave kohore paraqet vështirësi, një numër dokumentesh të sigurisë e kanë zgjidhur këtë duke përcaktuar objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.¹³

Natyrisht, këtu bëhet kujdes që arritja e objektivave të fazës së sotme të mbështesë arritjen e objektivave të fazës tjetër.

Në këtë këndvështrim, në përputhje me ndryshimet e mjedisit të sigurisë, si fillim duhet rishikuar SSK, e cila vetiu përcakton drejt objektivat e politikës së sigurisë kombëtare dhe trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse rreziqet e mundshme. Ajo duhet të optimizojë kontributet duke rritur efektivitetin e sektorit të sigurisë, të orientojë drejt politikën e sigurisë kombëtare, të arrijë konsensusin e brendshëm të shoqërisë, duke rritur besimin e pjesëtarëve të shoqërisë e duke rritur emrin e mirë në bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar.

“Barometri” i Ballkanit, i kryer kohët e fundit, nuk i rendit nga kreu shqiptarët, sa i takon optimizimit për jetesën. Këtu nuk pretendohet që për pak vite shqiptarët të shndërrohen në...

¹¹ Pertez D., Faruqi R. and Kisanga J. E., (2007): Small states in the global economy. *Background papers presented to the Commonwealth Secretariat/ World Bank Joint Task Force on Small States, 200*, Vol. (5)

¹² Hey Jeanne, A. K., (2003): Small states in world politics: explaining foreign policy behavior: USA, Colorado, Lynne Rienner Publishers: 2003.

¹³ Përgjithësisht pranohet që periudha afatshkurtër të jetë 3-5 vjet, ajo afatmesme 5-10 vjet, ndërsa afatgjatë mbi 10 (ndonjë herë edhe mbi 15 vjet).

“danezë”!

Shteti ynë, i cili ka arritje të mëdha, mundet të gjejë mekanizma për përmirësimin e klimës së brendshme, e cila doemos ka rolin e saj.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare, dokumenti kuadër, i cili shpreh në mënyrë të përmbledhur interesat themelore kombëtare të shtetit, paraqitet si një guidë e trajtimit të mundësive, rreziqeve dhe kërcënimeve aktuale dhe potenciale.

Koncepti i sovranitetit të shtetit modern, i lindur nga Paqja e Vesfalisë, sipas Morgenthaut, kuptohet si “autoriteti legal suprem i kombit për të detyruar zbatimin e ligjeve, brenda një territori të caktuar dhe si pasojë, pavarësia nga autoriteti i çdo kombi tjetër dhe barazia me të, sipas ligjit ndërkombëtar”.¹⁴

Pyetja që lind natyrshëm është: Përse ka nevojë një shtet për një dokument si Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK)?

Janë disa arsye themelore që shtetet duhet të kenë një politikë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të sigurisë kombëtare.

Së pari, ajo ka të bëjë me përcaktimin dhe trajtimin e rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme ndaj shtetit dhe shoqërisë.

Së dyti, ka të bëjë me angazhimin e frytshëm të të gjithë aktorëve të sigurisë, duke rritur kontributet dhe burimet në fushën e sigurisë.

Së treti, ajo rrit kohezionin dhe konsensusin e brendshëm ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë e shoqërorë për domosdoshmërinë e një politike të qartë zyrtare në fushën e sigurisë.

Kur arrihet marrëveshja e brendshme për çështjet themelore shtetërore, doemos që rritet besimi që gëzon shteti, në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Në formulimin e dokumentit të SSK, ashtu si dhe në dokumentet e mëparshme, janë disa çështje kyçe që duhen ritrajtuar nga një bazë e re analize dhe vlerësimi, të cilat lidhen kryesisht me formulimin e një politike sa më të efektshme të sigurisë kombëtare. Konceptet për sigurinë kombëtare, të shprehura më lart, pikënisja për një dokument cilësor SSK-je, shpesh përmbledhen në treshen: “Qëllimi-Rrugët-Mjetet”.¹⁵

Konkretisht, aktorët që do të përfshihen në procesin e shqyrtimit, mënyra se si është e përcaktuar siguria kombëtare, duhet t’iu japin përgjigje pyetjeve: Cilat janë sfidat e tanishme? Po ato që mund të ndodhin në të ardhmen për sigurinë kombëtare? Çfarë instrumentesh kemi të gatshme për sigurinë kombëtare? Çfarë instrumentesh të reja mund të kërkohen? Deri në çfarë mase do të trajtohet raporti midis transparencës dhe nevojës, për të ruajtur konfidencialitetin në fusha jetike për sigurinë kombëtare? Si është vlerësuar, analizuar dhe realizuar dokumenti paraardhës? Çfarë masash duhen marrë për të ardhmen, që të kemi një dokument të SSK sa më koherent dhe të pranueshëm nga shoqëria?

...“Procesi i të shkruarit të strategjisë së re ka rëndësi. Ai i imponon qeverisë të rivlerësojë objektivat e veta thelbësorë dhe të bëjë vetëm korrigjimet e domosdoshme të kursit të saj.

¹⁴ Morgenthau, H. J., (1978): *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*. New York: Alfred A. Knopf, 1987: pp. 4-15.

¹⁵ Në literaturën e huaj: “Ends – Ways – Means”.

Ky proces [...] i mundëson pjesës tjetër të shtetit, madje edhe botës, njohjen e objektivave të vendit. Në qoftë se kombinohet me vendimet për buxhetin - dhe këtu ka një “në qoftë se” të madhe, ai mund të formësojë në mënyrë efektive mënyrën se si politikat marrin jetë”¹⁶.

Natyrisht, dokumenti i SSK nuk është zgjidhja me “shkop magjik” e problemeve të sigurisë, pasi këto lloj dokumentesh nuk mundin të parashikojnë çdo të papritur. “Atë që sjell ora, nuk e sjell viti”-thotë populli ynë.

Ai dokument paraqet parimet dhe principet kryesore të zhvillimit të politikës në fushën e sigurisë kombëtare. Ndaj për miratimin e SSK, lind si nevojë që aktorët përgjegjës të sigurisë të bëjnë vlerësime dhe analiza të hollësishtme rreth rreziqeve dhe kërcënimeve, zhvillimit dhe përshtatjes së instrumenteve të sigurisë sipas rolit përkatës, burimeve dhe shpërndarjes së tyre ndërmjet aktorëve të ndryshëm, pra duke parë në dinamikë zhvillimin e SSK-së.

“Sfidat ndaj sigurisë i detyrojnë politikëbërësit që t’i adresojnë ndjeshmëritë e shoqërisë që i voton, tek institucionet shtetërore, te përgjegjësitë që ato duhet të kenë, në çdo nivel vendimmarrjeje¹⁷.

Kurse historiani ushtarak Liddell Hart ka një qasje unike ndaj diskutimeve mbi strategjinë. Ai mendon se strategjia është diçka e ngjashme por jo e njëjtë me strategjinë e madhe: “Sikurse taktika është një zbatim i strategjisë në një plan më të ulët, ashtu edhe strategjia është një zbatim në një plan më të ulët i “strategjisë së madhe”.¹⁸

Nëse do të përipiqeshim të gjenim një copëz të ngjashme me atë të vizionit të strategjisë së madhe, atë mund ta vëmë re te preambula e Kushtetutës së RSH:

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, *me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar*, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, vendosim këtë Kushtetutë”. Kjo aspiratë shekullore mund të jetë ajo që flisim më sipër, - shtrati shekullor në të cilin lëvizin strategjitë e mëdha.

Sidoqoftë, kjo aspiratë shekullore e përmendur në Kushtetutë nuk është e përmendur në SSK, të paktën në versionin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Parathënia e SSK, 2014 fillon kështu:

“Siguria, liria dhe mirëqenia janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuar dhe përfaqësojnë themelet mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe *progresi i kombit. Garantimi i*

¹⁶ Smith & Stokes, 2014: “Obamës i duhet një Strategji e re Sigurie”. http://www.politico.com/magazine/story/2014/03/white-house-national-security-strategy-104491_Page2.html#.U57_iXbNxyU

¹⁷ Buzan, B., (1992): Great Regional Powers in International Politics: The Macmillan Press: London: 1992.

¹⁸ B. H. Liddell Hart IN Keane, Michael: “Dictionary of Modern Strategy and Tactics”; Naval Institute Press, 2005; f.133.

një mjedisi që ofron siguri dhe liri për qytetarët, është përgjegjësia parësore e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) të Republikës së Shqipërisë”¹⁹...

Strategjia e madhe duhet të llogaritet e të zhvillojë burimet ekonomike dhe fuqinë njerëzore të kombeve duke përfshirë patjetër burimet morale. Sepse ngjizja e Frymës së vullnetit të njerëzit, shpeshherë është po aq i rëndësishëm sa edhe të zotërosh format më konkrete të fuqisë. Sepse njeriu, më së pari është Frymë, e po kështu edhe familja. Vetë shteti është e duhet doemos të jetë Frymë, e cila duhet kultivuar dhe injektuar me kujdes, nga pak, por çdo ditë.

Strategjia e madhe duhet të rregullojë gjithashtu shpërndarjen e fuqisë ndërmjet shërbimeve të ndryshme dhe mes shërbimeve dhe industrisë. Veç kësaj, fuqia luftuese nuk është veçse njëri prej instrumenteve të strategjisë së madhe, e cila duhet të llogaritet dhe të aplikojë fuqinë e presionit financiar e jo më pak, të presionit etik, për të dobësuar vullnetin e kundërshtarit.

Nëpërmjet rishikimit dhe miratimit të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, arrihet një vlerësim më i drejtë rreth kërcënimeve dhe rreziqeve aktuale, instrumenteve qeveritare, zhvillimit të politikave rreth çështjeve të tilla si: aleancat, përdorimi i forcës ushtarake, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe roli i demokracisë e i zhvillimit ekonomik, në vizionin e vendit për sigurinë.

Për shkak se në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë, shumica e rreziqeve dhe kërcënimeve thuajse janë të njëjtat, një rëndësi të madhe merr respektimi i të drejtës ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë instrumentet ligjore ndërkombëtare ku është e anëtarësuar Shqipëria, por edhe të drejtën zakonore, e cila është e detyrueshme për të gjithë.

Pra, në këtë kuptim asnjë shtet nuk mund të formulojë një politikë sigurie, bazuar vetëm brenda territorit të tij.

“Në mjedisin në të cilin zhvillohen marrëdhëniet ndërkombëtare, shtetet shikojnë me dyshim njëri-tjetrin për shkak të keq perceptimeve dhe keqkuptimeve reciproke”²⁰...

Në këtë mënyrë, siguria bëhet një ndër prioritetet kryesore të shteteve. Kjo do të thotë se, një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm ku duhet të reflektohet në rishikimin e dokumenteve strategjike, janë tendencat e mjedisit global të sigurisë. Në kontekstin e sotëm, mjafton të përmendim efektet afatgjata të “COVID-19” që po ndikon në trajektoren e zhvillimit të këtyre dokumenteve, për të pranuar se sa të vështira janë parashikimet për të ardhmen.

Rishikimi i këtyre dokumenteve të rëndësishme duhet të bëhet në përputhje me kushtet e reja të mjedisit të sigurisë dhe natyrisht bazuar në Konceptin Strategjik të Aleancës të 2010, por dhe në ndryshimet aktuale të këtij mjedisi, në kuadër të NATO-s. Mjedisi i sigurisë së jashtme të NATO-s ka ndryshuar ndjeshëm, që nga viti 2010. Siç dihet, Koncepti Strategjik i Aleancës rekomandoi partneritetin strategjik me Rusinë, përmendi në mënyrë të kufizuar terrorizmin dhe nuk trajtoi si rrezik të mundshëm Kinën. Qysh atëherë, ndryshime thelbësore

¹⁹ “Strategjia e Sigurisë Kombëtare”, qershor 2014; shih në: http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf; f.3.

²⁰ Ingebritsen, C. (2006): Small States in International Relations: University of Washington Press: 2006.

kanë ndodhur në mjedisin e sigurisë së NATO-s, të cilat ka të ngjarë të intensifikohen gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm. Ato kërkojnë përpjekje më të mëdha si në kohezionin politik, ashtu edhe në përshtatjet me strategjinë e NATO-s.

Vendet e Ballkanit vazhdojnë të ballafaqohen me një sërë sfidash sigurie në sferën e mbrojtjes dhe të sektorit të sigurisë, drejtësisë dhe të punëve të brendshme, si: ekstremizmit të theksuar, diferencave etnike, korrupsionit, krimin të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, pa përmendur luftën kundër përhapjes së armëve të vogla dhe të menaxhimit efektiv të kufijve, parandalimit të kërcënimeve potenciale të terrorizmit.

Të gjitha vendet e rajonit, kur paraqesin pozicionin e tyre, përdorin formulime të ngjashme si: “*vendi ka evoluar nga pozita e konsumatorit të sigurisë*” në atë të “*ofruesit të stabilitetit*”, “*kontribuuesit të paqes dhe marrëdhënive të mira me fqinjët*”. Është një çështje tjetër, se sa kjo është një realitet apo mbetet vetëm një dëshirë.

Kështu, SSK-ja e Serbisë (2009) thekson në mënyrë të qartë se “*shpallja joligjore dhe e njëanshme e pavarësisë nga Kosovë-Metohia është kërcënimi më i madh për sigurinë e Republikës së Serbisë*”, ndërsa sfidat, rreziqet apo kërcënimet e tjera nuk i kategorizon qartë.

Gjithashtu, ato do të sfidohen vazhdimisht nga ideologjitë radikale, regjimet e korruptuara, pikëpamjet e kundërta për rendin botëror, si nocioni i “demokracisë sovrane” i mbështetur kryesisht nga Rusia dhe Kina, të cilat e shikojnë mbështetjen amerikane për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në këto vende, si një ndërhyrje në punët e brendshme të shteteve sovrane.

Fatkeqësitë natyrore, pandemitë, por edhe çdo lloj tjetër fuqie madhore janë të rralla. Me gjithë humbjet e jetëve njerëzore dhe kostot financiare tmerrësisht të mëdha që sjellin për shtetin dhe shoqërinë, ato janë të rralla, një herë në kaq vite.

David Baldwin, studiues për shkencat politike në Universitetin Princeton dhe profesor Emeritus në Universitetin Kolumbia, nënvizojnë:

...“Por kur vjen rasti i një fuqie madhore kërcënuese si tërmetet, duke mos pasur në dorë uljen e probabilitetit të ndodhjes të tij, shtetet serioze adoptojnë rregulla e kode ndërtimi (*zgjdhja*), për të minimizuar probabilitetin e dëmeve. Në këtë mënyrë, ndërsa përcaktimi i parë (pra tërmeti) e vendos fokusin te “kërcënimi”, përcaktimi i dytë (pra shteti) fokusohet te vlerat”²¹....

Doemos që shteti do të duhet të ketë parashikuar edhe fonde rezervë për “Ditën e kijametit”.

Por armiku më i madh për sigurinë dhe mirëqenien e shtetasve është ai “i përditshmi” ai i “pa zhurmshmi”, është korrupsioni. Jo rrallë, nga goja e “analistëve”, por edhe e ndonjë politikani, dëgjohet shprehja: “korrupsioni është fenomen bashkëshoqërues i sistemit”. Gjë që nuk është aspak e vërtetë. Sepse lind pyetja: Si ia kanë gjetur zgjidhjen, luftës kundër korrupsionit ato shtete, që sot kanë timonin e Evropës në dorë?

²¹ David Baldwin, studiues për shkencat politike në Universitetin Princeton dhe profesor Emeritus në Universitetin Kolumbia. Libri “Shtetformimi ekonomik” u cilësua publikimi më i mirë në shkencat politike për politikën kombëtare amerikane, për vitin 1985.

Shoqëria njerëzore e ka zgjedhur këtë sistem pikërisht për të kundërtën e korrupsionit. E ka zgjedhur këtë sistem në emër të vlerave njerëzore, shoqërore dhe shtetërore, në emër të garantimit të jetës dhe të drejtave të njeriut, në emër të shtetit të së drejtës, në emër të transparencës shtetërore dhe shoqërore.

Në respekt të kësaj zgjedhjeje që bëri shoqëria shqiptare, shteti ka detyrimin të ndërtojë institucione të forta dhe garante, të hartojë ligje të pastra, e jo evazive në përmbajtjen e tyre, të cilat lenë “dritare daljeje” në favor të keqbërësve, të ndërtojë mekanizma të pathyeshëm kontrolli, të krijojë shtresën e nëpunësve të betuar të shtetit dhe ligje që vetiu ndëshkojnë korrupsionin si krimi më i madh, i cili cenon sigurinë kombëtare.

...STRATEGJIA USHTARAKE

Është e vështirë të vendosësh vijën ndarëse mes këtyre dy Strategjive. Më saktë, ajo vijë nuk ekziston e nuk mund të ekzistojë kurrë. Sepse të dyja strategjitë janë plotësuese të njëra-tjetrës, në mënyrë që e dyta mbështet dhe plotëson të parën. Dhe e para nuk mund të ekzistojë pa të dytën.

Rreziqe të reja janë zgjuar në kohët e sotme për botën, doemos edhe për vendin tonë. Rreziqet për shkak të fenomeneve ekstremeve të natyrës, sëmundjet infektive pandemike apo sfidat e sigurisë në fushën kibernetike. Në këto kushte, paqëndrueshmëria ka mundësi të përbëjë tiparin dominues për një të ardhme të papërcaktueshme.

Në këtë pikëpamje, këto dokumente duhet të hartohen në përputhje me këto ndryshime, si dhe nivelin e ambicies kombëtare, me burimet financiare në fushën e mbrojtjes, të parashikuara në përmbushje me detyrimet ndaj Aleancës.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare, e cila përmbledh të gjitha aspektet e jetës së një kombi, mund të jetë e ndarë në disa nënstrategji, ku secila ka një objektiv madhor. Strategjia Ushtarake (SU) është dokumenti i dytë themelor, pas SSK, që përshkruan politikën e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të siguruar mbrojtjen e vendit. Ajo përcakton se si përmbushen detyrat kryesore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe përbën dokumentin kryesor për procesin e planifikimit në perspektivë.

Faktorët që ndikojnë në rishikimin e Strategjisë Ushtarake

Strategjia Ushtarake është një dokument, me të cilin Ministria e Mbrojtjes përcakton qëllimin strategjik të arritjes së objektivit themelor të vendosur në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Forcat e Armatosura janë dhe do të jenë një institucion themelor për garantimin e sigurisë kombëtare. Kjo përgjegjësi bëhet gjithnjë e më komplekse, duke mbajtur njëherazi fuqinë e duhur luftarake dhe duke kryer ristrukturimin, kur ky konsiderohet i nevojshëm. Disa faktorë të tjerë që kushtëzojnë rishikimin e Strategjisë Ushtarake, përveç udhëzimeve që rrjedhin nga politika e mbrojtjes, pjesë kryesore në përmbajtjen e SSK, janë ndryshimet e mjedisit gjeostrategjik dhe operacional.

Historiani ushtarak Liddell Hart ka një qasje unike ndaj diskutimeve mbi strategjinë: “Lufta është “çështje shumë serioze” në lidhje me fatet e kombeve, për t’u lënë në dorë të strategëve të çfarëdoshëm. Ekziston një nevojë për horizontin më të gjerë të *strategjisë së*

madhe, e cila përfshin gjendjen e paqes, e cila shtrihet përtej çdo lufte”.²²

Mjedisi strategjik sot është shumë më i ndryshëm nga ai i mëparshmi, një ndryshim që ka sjellë një mënyrë tjetër për konceptimin dhe përballimin e rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sigurisë globale dhe kombëtare. Mjedisi strategjik i ndryshuar iu ka dhënë një dinamikë të re operacioneve ushtarake të sotme e të ardhshme dhe ka zgjeruar së tepërmi spektrin e tyre nga operacionet luftarake klasike, deri tek ato paqeruajtëse e humanitare.

Në vijim, le të japim disa nga faktorët, të cilët mund të vlerësohen në rishikimin e ardhshëm të Strategjisë Ushtarake:

- Ndryshimet në mjedisin strategjik dhe operacional, ristrukturimi i forcës dhe zhvillimi i aftësive të kapaciteteve të FA, në funksion të procesit të planifikimit të ri të mbrojtjes së NATO-s, llojit të operacioneve, nivelit të gatishmërisë, aftësisë për të qenë ndërveprues, i qëndrueshëm dhe efikas në operacionet me aleatët dhe partnerët.
- Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake, për rrjedhojë zhvillimi i kërkesave për planifikim dhe rivlerësimin e doktrinave të përdorimit të forcës.
- Mbështetja e objektivave kombëtarë dhe synimeve politike në dokumentet si: SSK, SU, RSM, si pika kryesore e referencës për Planifikimin e Përgjithshëm të Mbrojtjes.

Sistemi i mbrojtjes së RSH do të jetë një sistem në ndryshim, fleksibël dhe modern, i aftë t’i përgjigjet ndryshimeve në mjedisin e sigurisë dhe të ofrojë kushte për funksionimin e sistemeve të tjera të mbështetjes sociale, për një mjedis jetësor cilësor, zhvillim dhe prosperitet, duke u krijuar perspektiva edhe brezave të ardhshëm.

Në rajonin tonë, fqinjët tanë vertikalë, prej vitesh armatosen dhe përforcohen me të gjitha mjetet dhe mënyrat. Më 20 nëntor të vitit të kaluar, parlamenti i njërit prej vendeve fqinje, njëzëri vendosi Mobilizimin e Përgjithshëm të pronave ushtarake, pa iu njohur asnjë të drejtë financiare atyre që i kishin marrë nga shteti me qira (se për t’u shitur nuk bëhet fjalë). Shoqëruar kjo masë edhe me një paketë 7 miliardë euro për blerjen e armëve të gjeneratës së fundit, për tokën, ajrin dhe detin.

Ndryshimi dhe zhvillimi i disa kapaciteteve të caktuara ushtarake nga FARSH më vete, por dhe i atyre që do të sigurohen brenda Aleancës, ose përmes marrëveshjeve të përshtatshme me vendet aleate individuale ose partnere, kanë ndikim në dokumentin e Strategjisë Ushtarake.

Ndoshta ka ardhur koha të rishikohet niveli i ambicies në nivel kombëtar dhe në detyrim të Aleancës. Niveli i ambicies së RSH në realizimin e objektivave politikë në fushën e sigurisë kombëtare, si dhe të gjitha ndryshimet e lartpërmendura në sfondin e sigurisë janë bazë reale dhe e mjaftueshme për rishikimin e dokumentit kryesor strategjik, siç është Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK).

Pra, nga sa më sipër, del qartë se rishikimi i dokumenteve strategjike, përkatësisht të

²² B. H. Liddell Hart IN KEANE, Michael: “Dictionary of Modern Strategy and Tactics”; Naval Institute Press, 2005; f.133.

SSK (miratuar në vitin 2014) dhe SU (miratuar në vitin 2015) është domosdoshmëri për pasqyrimin e të gjitha këtyre zhvillimeve më të fundit në mjedisin e sigurisë, për të evidentuar më mirë dhe qartë rreziqet eventuale ndaj vendit tonë, kapacitetet e nevojshme që duhen për përbalimin e tyre nga ana e strukturave të sigurisë dhe mbrojtjes së RSH.

Ato do të analizojnë, vlerësojnë dhe pasqyrojnë efektet e mjedisit të sigurisë, qasjet e reja teknologjike dhe prirjet demografike në RSH, si dhe do të shprehin vendosmërinë e RSH për të forcuar sistemin e saj të mbrojtjes dhe nevojën për zbatimin e masave për mbrojtjen, me qëllim sigurimin e sovranitetit kombëtar dhe përmbushjen e detyrimeve si anëtar i denjë i organizatave të ndryshme ndërkombëtare si: NATO, BE, OKB, etj.

“Askush nuk mund të parashikojë të ardhmen”²³, por nga ana tjetër, do të ishte mungesë përgjegjësie të mos bëhen përpjekje të gjithanshme për identifikimin dhe analizën e tendencave të zhvillimit të sotëm dhe shkaqeve të tyre, si dhe të përcaktohen rrugët përkatëse për të shfrytëzuar efektet pozitive dhe për të evituar ato negative të këtyre tendencave.

Në dy dekadat e fundit ka pasur ndryshime gjeostrategjike, që lidhen me arritjet teknologjike dhe që kërkojnë një përdorim konceptualisht të ri të forcës ushtarake. Përparimet teknologjike po i ndryshojnë vërtet operacionet ushtarake në mënyrën se si ato do të zhvillohen, si dhe në mënyrën se si Forcat e Armatosura do të organizohen. Ato diktojnë ndryshime të mëdha në doktrinat ushtarake dhe në mënyrën e stërvitjes. Kërcënimet asimetrike për sigurinë globale e kombëtare tashmë janë bërë më të shpeshta.

Në këtë aspekt, rëndësi merr trajnimi dhe arsimimi i personelit ushtarak, zhvillimi i karrierës dhe profesionalizimit, nëpërmjet një sistemi të besueshëm, si dhe trajtimit financiar dhe motivimit të tyre.

Kështu, me VKM nr. 156, datë 19.02.2020, Akademia e Forcave të Armatosura merr për herë të parë statusin e veçantë si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare. Është me rëndësi të madhe fakti që u hap programi “Bachelor”, duke u përmbyllur si cikël shkollimi, po në këtë Akademi.

Rritja e cilësisë në arsimimin dhe stërvitjen institucionale do të përbëjë rrugën kryesore për rritjen profesionale të kësaj trupe, duke synuar përgatitjen e oficerëve si drejtues dhe stërvitës të ushtarëve, grupeve të ushtarëve dhe nënoficerëve vartës, teknikisht e taktikisht kompetentë, zotërues të aftësive të larta drejtuese që demonstrojnë besim, integritet, gjykim e përgjegjësi të fortë, e që veprojnë në një gamë të gjerë misionesh.

Procesi i reformimit në sistemin arsimor ushtarak duhet të vazhdojë si në zhvillimin e strukturës akademike, ashtu dhe në zhvillimin e programeve e të kurrikulave.

Reformat e mbrojtjes, të fillim-shekullit të 21-të, kishin një ndryshim thelbësor nga reformat e fund-shekullit të 20-të. Ndërsa ato të fund-shekullit të 20-të u projektuan kryesisht për shkurtime drastike në sasinë e Forcave të Armatosura, ato të fillim-shekullit të 21-të po konceptohen kryesisht për një rritje të cilësisë së tyre.

²³ Martin Van Creveld: *The Transformation of War* (New York: The Free Press, 1991), fq.198.

Strukturat në letër janë diagrame të vdekura. Është personeli, ai që i bën këto struktura të gjalla dhe funksionale. Edhe struktura më e mirë mund të dështojë nëse nuk ka personel cilësor, nëse nuk ka kriteret e mirëstudiuara e të zbatuara me rreptësi në përzgjedhjen e personelit, nëse nuk ka procedura të sakta veprimi, ashtu siç edhe struktura më e keqe mund të funksionojë me sukses, kur ka cilësi profesionale, kur ka vullnet të plotë për punë e stërvitje. Do të synohet që stafi akademik të vijë nga trupa e oficerëve nëpër njësi dhe reparte, pasi për ne, “laboratorët” e vërtetë, janë njësitë dhe repartet e FA-ve.

Parakusht i realizimit të të gjithë këtyre objektivave është disiplina e hekurt, si ajo formale, ashtu edhe ajo shkencore. Ka ardhur koha që në kuadër të sfidave të reja të sigurisë dhe të nevojës për ndryshime strukturore duhet të rishikohet e të vlerësohet edhe numri total i FARSH. Më tej, koncepti i forcës rezerviste do të marrë një rëndësi të veçantë, duke pasur si tendencë rritjen e numrit të tyre.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i sfidave të sigurisë sot janë ato që lidhen kryesisht me sigurinë kibernetike. Kapacitetet e mbrojtjes kibernetike të FARSH janë të integruara në sistemin gjithëpërfshirës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në sistemin kombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike.

Kapacitetet e mbrojtjes kibernetike duhet të jenë në gjendje të zbulojnë, parandalojnë e të përgjigjen ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike në kohë reale. Ato do të bazohen në një qasje gjithëpërfshirëse që siguron kanale të sigurta komunikimi dhe mbrojtjen e sistemeve të informacionit ushtarak. Në zhvillimin e këtyre kapaciteteve, FARSH duhet të përfshihen nga afër në projektet e NATO-s apo BE-së, si dhe në kontekstin e bashkëpunimit dypalësh me partnerët kryesorë strategjikë.

Rishikimi, hartimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike do të jetë bazë për zhvillimin afatgjatë të Forcave të Armatosura. Programi për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare do të vazhdojë të mishërojë standardet dhe parimet e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Ndër parimet bazë të saj, siguria kombëtare përbën themelin për një zhvillim demokratik dhe rritje të qenësishme ekonomike të vendit.

Rivlerësimi dhe hartimi i Strategjisë Ushtarake do të jetë vetëm njëri nga hapat e shumtë që duhet ndërmarrë për të forcuar dhe siguruar mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë. Sistemi i Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes përfshin të gjitha aspektet e rishikimit të dokumenteve kryesore të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat shohin mundësitë e objektivave madhore për të rritur aftësitë dhe kapacitetet e Forcave të Armatosura. Strategjia Ushtarake siguron kornizën unifikuese për këto masa. Në të njëjtën kohë, krijon një bazë solide të domosdoshme për të rritur elasticitetin e përgjithshëm të organeve dhe agjencive qeveritare, administratave lokale dhe qytetarëve kundër fenomeneve negative të mjedisit të paqëndrueshëm të sigurisë dhe për të mbështetur aftësinë për t’i përballuar ato.

Ky dokument duhet të jetë në kohën e duhur për t’iu përgjigjur paparashikueshmërisë së mjedisit aktual të sigurisë duke rritur ndjeshëm investimet tona në mbrojtje. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme të garantohet menaxhimi në mënyrë efektive i burimeve të konsiderueshme që shoqëria jonë po investon në mbrojtjen e vendit. Kjo është gjithashtu një nga qëllimet kryesore të strategjisë së përditësuar të mbrojtjes.

Qasja e çështjeve reale që duhet të demonstrojë Strategjia Ushtarake (SU) do të plotësohet me një përgjigje pozitive nga institucionet përgjegjëse të shtetit dhe shoqëria civile shqiptare, e cila i jep kuptim qëllimit dhe sistemit të mbrojtjes së vendit tonë. Përpjekjet për të kuptuar dhe parashikuar sfidat e ardhshme janë thelbësore për planifikimin efektiv në fushën e sigurisë. Në mungesë të këtyre vlerësimeve, jo vetëm përcaktimi realist i karakterit dhe nivelit të resurseve të nevojshme për të përballuar sfidat e ardhshme është i pamundur, por edhe rreziqet që rrjedhin nga kërcënimet mund të rriten.

Klauzeviçi, një nga autoritetet më të njohur për kuptimin dhe zhvillimin e strategjisë, duke studiuar fushatat ushtarake të kohës, dha kontribute të shquara e të shumëllojta në mendimin strategjik. Ai, për herë të parë, tregoi rëndësinë e lidhjes midis drejtimit politik dhe ushtarak, tregoi se lufta është një zhvillim social dhe akt politik njëkohësisht, duke theksuar se “Lufta nuk është thjesht një akt ushtarak, por është edhe një instrument real politik, një vazhdim i politikës me mjete të tjera”²⁴.

Ai, vazhdimisht theksonte se strategjia ushtarake dhe politika duhet të ecin krahas njëra-tjetres. ...“Lufta, - deklaronte ai, ka gramatikën e saj, por jo logjikën e saj...”²⁵.

Disa rekomandime

1. Pavarësisht nga forma përfundimtare që do të ketë SSK, ajo duhet të sanksionojë ngritjen e institucioneve, me autoritetin dhe kapacitetet përkatëse, të cilat duke vepruar nën vartësinë e institucioneve të larta kushtetuese (Presidenti, Parlamenti, Qeveria), të sigurojnë zbatimin e “përditshëm” të detyrave të kësaj Strategjie.

2. Trendet strategjike të viteve të fundit tregojnë një potencial të konsiderueshëm për riformimin e marrëdhënieve midis aktorëve globalë, me efekte të drejtpërdrejta në stabilitetin dhe parashikueshmërinë e sistemit ndërkombëtar.

3. Shqipëria, ashtu si vendet e tjera anëtare, ndan të gjitha rreziqet dhe kërcënimet që prekin Aleancën në tërësi dhe secilin nga vendet e tjera të saj, sa i takon rrethanave të tyre specifike.

4. Mjedisi i sigurisë është matësi për zhvillimin e institucioneve të sigurisë. Prirjet e mjedisit të sigurisë janë themeli i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë Ushtarake. Evolucioni i mjedisit strategjik të sigurisë është një faktor vendimtar për formësimin e qasjeve të institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes dhe dokumenteve themelore strategjike.

5. Në rishikimin e dokumenteve strategjike, krahas identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve që janë të pasqyruara në dokumentet e mëparshme, duhet të merren në konsideratë rreziqet dhe kërcënimet e reja si “cyber defence”, ekstremet natyrore, sëmundjet pandemike, siguria mjedisore, etj.

6. Strategjia e Sigurisë Kombëtare shërben për të bërë lidhjen e misionit të shtetit me objektivat, qëllimet, burimet, gjendjen e Forcave të Armatosura dhe mjetet e mënyrat që

²⁴ Clausewitz, C. V., (1984): Strategjia Ushtarake Vol. I.: Princeton University Press: 1984.

²⁵ Po aty. Clausewitz, C. V., (1984): Strategjia Ushtarake Vol. I.: Princeton University Press: 1984.

duhen përdorur për të përmbushur objektivat e sigurisë.

7. Strategjia Ushtarake duhet të zhvillohet si vijuese e dokumentit të mëparshëm. Thelbi i saj duhet të përfshijë katër koncepte strategjike: aftësi mbrojtëse të besueshme, ristrukturim dhe modernizim bashkëkohor, partneritet dypalësh dhe shumëpalësh, si dhe integrim i vazhdueshëm e i plotë në strukturat Evropiane dhe euroatlantike.

8. Kapacitete të rëndësishme në përgatitjen apo punën me dokumentet strategjike të sigurisë po spikaten e po fuqizohen edhe në një numër organizatash të shoqërisë civile në Shqipëri. Institucionalizimi i kontakteve dhe bashkëpunimit me to, në interes të sigurisë, është me përfitim reciprok për të dyja palët. Përsa i përket përgatitjes së dokumenteve kombëtare të sigurisë, ekspertiza e shoqërisë civile, jo vetëm që u rrit cilësinë, por ekonomizon edhe përpjekjet për përgatitjen e tyre.

9. Republika e Shqipërisë ka krijuar përvojë mjaft të mirë në rishikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike. Në këtë pikëpamje iniciimi, nga Ministria e Jashtme, i rishikimit të SSK, nëpërmjet një Direktive të nënshkruar nga Kryeministri, do të krijonte bazën referuese edhe për një Direktivë nga Ministri i Mbrojtjes, për rishikimin dhe hartimin e SU.

Bibliografia:

- ÇABEJ E., CIPO K., DOMI M., KRAJNIA., MYDERRIZI: Fjalor i Gjuhës Shqipe”; njihet gjerësisht si: Fjalori i vitit 1954, viti i botimit të parë, i ribotuar, “Shtëpia Botuese Çabej”, Tiranë, 2005.
- “A NATIONAL SECURITY STRATEGY, OF ENGAGEMENT AND ENLARGMENT”, White House, July 1994, US Government Printing Office, Washington DC.
- 3-“A NATIONAL SECURITY STRATEGY, FOR A NEW CENTURY”, White House, May 1997, US Government Printing Office, Washington DC.
- “A NATIONAL SECURITY STRATEGY FOR A GLOBAL AGE”, White House, December 2000, US Government Printing Office, Washington DC.
- JOINT PUBLICATION 1-02; “Department of Defense dictionary of military and associated terms”; DIANE Publishing, DOD USA, April 2001.
- JOINT PUBLICATION 1-02, “Department of Defense dictionary of military and associated terms”; DIANE Publishing, DOD USA, April 2001.
- SSK e Britanisë së Madhe. 2010.
- “BRITAIN IN AN AGE OF UNCERTAINTY: THE NATIONAL SECURITY STRATEGY”; Printed in the UK for The Stationery Office Limited on behalf of the Controller of Her Majesty’s Stationery Office, London 2010.
- BUZAN, Barry: “People, States & Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era”; ECPR Press Classics, 2008.
- Panke, D., (2011): Small States in EU Negotiations: Political Dwarfs or Power Brokers: University College Dublin Press: 2011.
- Pertz D., Faruqi R. and Kisanga J. E., (2007): Small states in the global economy. *Background papers presented to the Commonwealth Secretariat/ World Bank Joint Task Force on Small States*,

200, Vol. (5)

- Hey Jeanne, A. K., (2003): Small states in world politics: explaining foreign policy behavior: USA, Colorado, Lynne Rienner Publishers: 2003
- Përgjithësisht pranohet që periudha afatshkurtër të jetë 3-5 vjet, ajo afatmesme 5–10 vjet, ndërsa afatgjatë mbi 10 (ndonjë herë edhe mbi 15 vjet).
- Morgenthau, H. J., (1978): Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace. New York: Alfred A. Knopf, 1987.
- Smith dhe Stokes, 2014: “Obamës i duhet një Strategji e re Sigurie” http://www.politico.com/magazine/story/2014/03/white-house-national-security-strategy-104491_Page2.html#.U57_iXbNxyU
- Buzan, B., (1992): Great Regional Powers in International Politics: The Macmillan Press: London: 1992.
- B. H. Liddell Hart IN KEANE, Michael: “Dictionary of Modern Strategy and Tactics”; Naval Institute Press, 2005.
- “Strategjia e sigurisë kombëtare”, qershor 2014; http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf.
- Ingebritsen, C. (2006): Small States in International Relations: University of Washington Press: 2006.
- David Baldwin, studiues për shkencat politike në Universitetin Princeton dhe profesor Emeritus në Universitetin Kolumbia. Libri “Shtetformimi ekonomik” u cilësua publikimi më i mirë në shkencat politike për politikën kombëtare amerikane, për vitin 1985.
- B. H. Liddell Hart IN KEANE, Michael: “Dictionary of Modern Strategy and Tactics”; Naval Institute Press, 2005.
- Clausewitz, C. V., (1984): Strategjia Ushtarake Vol. I.: Princeton University Press: 1984.
- Martin Van Creveld: *The Transformation of War* (New York: The Free Press, 1991), 1984.
- Clausewitz, C. V., (1984): Strategjia Ushtarake Vol. I.: Princeton University Press: 1984.

RUBRIKA E PARË

Analiza, sinteza dhe vlerësime për sigurinë

Në shkrimet e kësaj rubrike, autorët sjellin mendime dhe vlerësime për probleme të rëndësishme të aktualitetit në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë, duke shprehur pikëpamjet e tyre ndaj situatës dhe rrugëzgjdhjeve për kohën dhe hapësirën që na rrethon.

Dr. Xhavit Shala, Drejtor i Kërkimit Shkencor në Akademinë e Sigurisë vjen në faqet e Revistës Ushtarake me një studim mbi çështjen shqiptare dhe kompleksin ballkanik të sigurisë, të cilat paraqesin interes në planin kombëtar dhe rajonal. Në shkrimin e tij *“Shqiptarët në kompleksin rajonal të sigurisë”*, autori analizon lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare (siç e përcaktoi Konferenca e Ambasadorëve në Londër) me sigurinë rajonale, e cila mund të arrihet duke përdorur teorinë e kompleksit rajonal të sigurisë së Shkollës së Kopenhagës. Analiza e kompleksit rajonal të sigurisë na jep çelësin për shpjegimin e çështjeve të sigurisë në rajonin e Ballkanit dhe të raporteve të ndërsjella të çështjes shqiptare me të.

Msc. Muhamet Buçpapa në shkrimin e tij *“Mjedisi i sigurisë në rang global, gjeopolitika dhe ndikimi i saj në zhvillimet e ardhshme”* trajton gjeopolitikën, fuqinë, renditjen e aktorëve në rang global, rajonal e kombëtar, si dhe ndikimin e tyre në procesin e gjatë e të ndërlikuar të formësimit të sistemit botëror aktual, duke u përballur me intensitetin e ndryshimeve gjeopolitike. Rishikimi dhe analiza e mjedisit të sigurisë në rang global dhe gjeopolitikës dhe ndikimi i tyre në zhvillimet e ardhshme ka një rëndësi të veçantë jo vetëm në aspektin e njohjes dhe studimit të çështjeve me ndikim mbarë botëror, por edhe në përpilimin dhe zhvillimin e doktrinave dhe strategjive në çdo nivel, me qëllim për të parandaluar përkeqësimin e mjedisit të sigurisë dhe përmirësimin e tij në progres.

Në historinë e saj, shoqëria njerëzore nuk ka qenë e goditur në mënyrë të tillë gjithëplanetare nga një kërcënim vrastar si pandemia COVID-19. Kjo pandemi shkaktoi shok strategjik shumëdimensional global duke prekur dhe shkaktuar *lockdown* total në gjithë hapësirat tokësore, ajrore dhe detare. Goditjet pandemike kanë treguar se përveç vuajtjeve e humbjeve të jetëve njerëzore ato krijojnë panik, terror, pasiguri, shkaktojnë kolaps financiar, rrisin presionet sociale dhe mund të pengojnë zhvillimin në komunitetet e prekura e më gjerë. Në shkrimin e tij *“Ndikimi i pandemisë në sigurinë kombëtare”* Dr. Bilbil Memaj shtjellon kornizën e madhe të sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, duke sjellë argumente se pandemi të tilla si Covid-19 kanë lidhje me sigurinë kombëtare.

Ashtu siç autori shprehet, lind nevoja që në skenarët e ardhshëm i gjithë informacioni dhe përvoja e përfituar nga situata e COVID-19 të përdoret e të studiohet, me qëllim krijimin e zgjidhjeve parandaluese ndaj kërcënimeve të tilla pandemike, të cilat përbëjnë sot një kërcënim për sigurinë kombëtare.

Një analizë të hollësishme rreth zhvillimeve të teknologjisë së informacionit gjatë viteve të fundit dhe ndikimit që ajo ka në mjedisin operacional, ka sjellë me shkrimin e tij *“Informacioni, Teknologjia dhe Mjedis Operacional”* Kolonel Fatmir Neziraj. Fillimisht vlerësohet mjedisi i sotëm i informacionit duke vijuar me kërcënimet që e shoqërojnë përfshirë kërcënimet kibernetike, dezinformacionin dhe propagandën. Më tej, autori bën një analizë mbi zhvillimet teknologjike në fushën e sistemeve autonome të kontrollit e të drejtimit në distancë, robotëve, duke u fokusuar në zhvillimet e Mjeteve Fluturuese Pa Pilot (MFP), kërcënimet dhe avantazhet që kanë dhe si po ndikojnë në transformimin e fushës së luftimit në ditët e sotme. Duke u nisur nga ndryshimet e shpejta e të paparashikuara të mjedisit operacional dhe zhvillimet e vrullshme teknologjike, autori vë theksin se Forcat tona të Armatosura duhet t’i vlerësojnë pandërprerë ato në kuadrin e modernizimit dhe përdorimit të kapaciteteve operacionale për përmbushjen e misionit të tyre.

Kolonel David Rroku dhe Nënkolonel (R) Kanan Himaj në shkrimin *“Sfidat e Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes – përballja me natyrën, kërcënimet dhe rreziqet hibridet ndaj vendit tonë”* vlerësojnë situatën në të cilën ndodh agresioni hibrid, i cili kërkon një qasje si nga perspektiva e faktorëve klasikë përmes analizës së situatës, ashtu edhe prej faktorëve shoqërorë, siç janë kultura, feja dhe nivelet e rezistencës së popullsisë, pasi konfrontimet ushtarake përfshijnë një bashkim të taktikave, teknikave dhe procedurave, të cilat janë klasike/konvencionale dhe asimetrike/jokonvencionale.

Diferenca e kërcënimeve hibride të pranishme nga ato që janë manifestuar në konfliktet e kaluara ushtarake janë kërcënimi klasik ose konvencional, i cili dallohet në sfond ose mund të mungojë plotësisht në konfliktet moderne hibride.

Në shkrimin *“Inteligenca ushtarake në operacion dhe roli në vendimmarrje”* Kolonel Hysni Gjergji ka përgatitur një analizë lidhur me rolin dhe rëndësinë që merr aktualisht inteligenca ushtarake në operacione dhe vendimmarrje, në optikën e zhvillimeve aktuale.

Përdorimi i burimeve të fundit të përditësuar shqiptare dhe të NATO-s i japin vlerë dhe e bëjnë më të dobishme këtë analizë studimore.

Realiteti ndërkombëtar në vitin 1999 në aspektet e ndërhyrjes humanitare, me rastin e 50-vjetorit të NATO-s në Kosovë, vjen nëpërmjet një analize strategjike të bërë nga Kolonel Mehmet Metko dhe Dr. Urim Qinami në shkrimin “*Ndërhyrjet humanitare. Kur forca është e justifikuar!*”. Autorët synojnë të identifikojnë disa trende që kanë kushtëzuar dhe vazhdojnë të kushtëzojnë ndërhyrjet ndërkombëtare në raste specifike, duke i trajtuar ato nga këndvështrimi politik, etik, moral si dhe doktrinar.

Shkrimi “*Fatkeqësitë natyrore dhe siguria njerëzore – Përfshirja e fatkeqësive natyrore në axhendën e sigurisë njerëzore*”, përqendrohet në qasjen e sigurisë njerëzore, e cila e identifikon individin si referent kryesor të sigurisë. Autorët e tij, Kolonel Irela Nebiaj dhe Nënkolonel (R) Alqi Nikolla e analizojnë sigurinë njerëzore si një qasje individuale dhe të orientuar drejt sigurisë, e cila pranon se stabiliteti i qëndrueshëm, jo vetëm i shteteve por edhe i shoqërive që ata përfaqësojnë, është i pamundur derisa të garantohet siguria njerëzore. Gjithashtu theksohet se në konfliktet civile, FA-të, me kapacitetet e tyre të rëndësishme operacionale dhe përvojën në terren, janë një ofrues kryesor i sigurisë njerëzore.

SHQIPTARËT NË KOMPLEKSIN RAJONAL TË SIGURISË

Dr. Xhavit Shala

Drejtor i Kërkimit Shkencor, Akademia e Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim është çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë. të cilat paraqesin interes në planin kombëtar dhe rajonal.

Ky punim ka për qëllim që të provojë lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me sigurinë rajonale. Për të provuar këtë lidhje, do të përdorim ndërmjet të tjerave teorinë dhe analizën e kompleksit rajonal të sigurisë të Shkollës së Kopenhagës. Në përfundim të punimit, konkludohet se çështja shqiptare në rajon dhe shkalla e zgjidhjes së saj ka ndikuar në vazhdimësi dhe vazhdon të ndikojë në sigurinë rajonale e me gjerë.

Fjalët kyçe: siguri rajonale, Ballkan, gjeohapësira shqiptare, Shkolla e Kopenhagës

1. Hyrje

Balkani ka qenë dhe mbetet një rajon jo vetëm në aspektin gjeografik. Popujt e këtij rajoni, përveç afërsisë gjeografike, i kanë bashkuar shqetësimet e përbashkëta në fushën e sigurisë. Gjatë historisë ata shpesh janë përballuar me të njëjtin pushtues dhe kanë përjetuar të njëjtat rreziqe në fushën e sigurisë. Për këtë, shpesh, ata janë rreshtuar nëpër aleanca dhe kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin për t'i bërë ballë kërcënimeve të njëjta në fushën e sigurisë. Të tilla janë koalicioni i krishterë i princave ballkanas në betejën e Fushë Kosovës në vitin 1389¹ dhe shekuj më vonë aleancat që çuan në Luftën I Ballkanike,² pjesëmarrja në koalicionin antifashist gjatë Luftës II Botërore apo pjesëmarrja sot në NATO e pjesës më të madhe të shteteve ballkanike, si dhe rruga e përbashkët e tyre drejt Bashkimit Evropian. Pra, marrëdhëniet dhe bashkëveprimi mes tyre, përveç afërsisë gjeografike, ka qenë i përcaktuar edhe nga perceptime e shqetësime të përbashkëta në fushën e sigurisë, ndonëse shpesh në raporte armiqësie, duke krijuar kështu “një grup aktorësh në nivel më të lartë se kombëtar, por më i ulët se ai i global”.³

Berri Buzan, një nga themeluesit e Shkollës së Kopenhagës, e shpjegon sigurinë si një çështje që vjen nga ndërveprimet midis kombeve,⁴ ndërsa kompleksin rajonal të sigurisë si një grup të kombeve që nuk mund të ndahet, sepse siguria dhe shqetësimet e tyre janë të përbashkëta.⁵ Sipas tij, këto kombe mund të ishin në marrëdhënie miqësore, por dhe kundërshtuese dhe të ballafaquara me kërcënime për njëri-tjetrin, siç është rajoni i Ballkanit, i cili përbën një kompleks rajonal sigurie më vete, me katër elementet e tij strukturore: kufijtë, strukturën anarkike, polaritetin si dhe ndërtimin social.

Nga Kongresi i Vjenës i vitit 1815, Fuqitë e Mëdha të kohës, pas marrëveshjes për të respektuar reciprokisht interesat dhe ekuilibrin e forcave, arritën të mënjanonin luftërat e përgjithshme dhe të ruajnë paqen dhe sigurinë e përgjithshme në Evropë për gati 100 vjet. Por, nëse patën sukses në nivel të përgjithshëm, Fuqitë e Mëdha dështuan në arritjen e paqes dhe sigurisë në Ballkan, në nivel rajonal. Kjo sepse, vetë Fuqitë e Mëdha, por edhe aktorë të tjerë shtetërorë ballkanikë, nuk i vlerësuan marrëdhëniet midis kombeve si dhe fqinjësinë e mirë mes tyre, përfshirjen e të gjithë aktorëve në vendosjen e ekuilibrit të fuqisë si dhe shpërndarjen e drejtë të kësaj fuqie në nivel rajonal si përcaktuese për paqen dhe sigurinë në rajon.

¹ Beteja e Fushë-Kosovës e 15 qershorit 1389 u zhvillua midis koalicionit të krishterë të princave ballkanas dhe ushtrisë osmane.

² Traktati i Miqësisë dhe i Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë, 13 mars 1912; Traktati i Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Greqisë, 29 maj 1912.

³ Sugio Takahashi “*Redefinition of Cooperative Security and Regional Security...*”. Po aty.

⁴ Barry Buzan, *People, States and Fear*, second edition (Colorado: Lynne Rinner Publishers, 1991), p. 187.

⁵ Po aty, fq. 190.

Në llogaritjen, vendosjen e ekuilibrit dhe shpërndarjen e fuqisë në Ballkan, aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë që në fillim përjashtuan faktorin shqiptar dhe interesat e tyre kombëtare. Kjo u bë sidomos nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës në vitet 1912-1913, gjatë procesit të konfigurimit të ekuilibrave rajonalë pas përmbyesjes së Perandorisë Osmane. Moszgjdhja në kohë e çështjes shqiptare dhe përjashtimi i tyre gjatë procesit të konfigurimit të ekuilibrave rajonalë ka bërë që ekuilibrat e vendosur në rajon të ishin të brishta dhe siguria e kërcënuar. Në këtë punim, për të provuar lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare (siç e përcaktoi Konferenca e Ambasadorëve në Londër) me sigurinë rajonale, përveç teorisë së ekuilibrit të fuqisë, do të përdorim dhe teorinë e kompleksit rajonal të sigurisë të Shkollës së Kopenhagës. Analiza e kompleksit rajonal të sigurisë na jep çelësin për shpjegimin e çështjeve të sigurisë në rajonin e Ballkanit dhe të raporteve të ndërsjella të çështjes shqiptare me të. Kjo analizë, sipas B. Buzan dhe O. Wæver⁶ përfshin katër nivelet (elementet konstitutive) të lidhura mes tyre. Në kontekstin ballkanik këto janë: rendi, stabiliteti dhe siguria e brendshme e shteteve ballkanike (niveli brenda shtetit); marrëdhëniet midis shteteve të rajonit të Ballkanit (niveli rajonal); bashkëveprimi i rajonit të Ballkanit me rajonet fqinje (niveli ndër rajonal) si dhe roli i fuqive botërore në rajon (niveli global) të cilat, të ndërlidhura së bashku, përbëjnë konstelacionin ballkanik të sigurisë (modeli i formuar nga bashkëveprimi i katër elementeve konstitutive).

Nga ana tjetër, katër elementet konstitutive (katër nivelet) e një kompleksi rajonal sigurie përcaktojnë strukturën thelbësore të atij kompleksi. Kjo strukturë thelbësore përbëhet nga katër variabla, të cilat janë: kufijtë e kompleksit, struktura anarkike, polariteti dhe ndërtimi social.⁷ Ndërveprimi mes katër niveleve (elementeve konstitutive) të kompleksit rajonal të sigurisë përcaktojnë ndryshimet në strukturën thelbësore të kompleksit. Dhe ndryshimet në strukturën thelbësore i krijojnë kompleksit rajonal tre mundësi zhvillimi. Së pari, ruajtja e status quo-së, që do të thotë se nuk ka ndryshime të rëndësishme në strukturën e tij thelbësore; së dyti, janë transformimet e brendshme të rajonit, që do të thotë ndryshime në strukturën anarkike, të polaritetit, (për shkak të shpërbërjes, bashkimit, pushtimit, niveleve të ndryshme të zhvillimit), ose për shkak të ndryshimeve në modelin dominues e miqësi/armiqësi, (për shkak të ndryshimeve ideologjike, të ndryshimeve të lidhshme); dhe së treti, transformime të jashtme, që ndodhin kur kufijtë e kompleksit rajonal të sigurisë ndryshojnë⁸ nga tkurrje ose zgjerimi. Pavarësisht se siguria është një konstruktion shoqëror që merr një kuptim të caktuar brenda një konteksti të caktuar shoqëror, teoria e Buzanit për sigurinë dhe kompleksin rajonal të sigurisë mund të përdoret me sukses për të shpjeguar zhvillimet në Ballkan në këto njëqind vitet e fundit dhe sidomos lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me sigurinë rajonale. Në këtë punim do të merremi me pasojat që solli në kompleksin ballkanik të sigurisë zgjidhja e pjesshme e çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës në vitet 1912-1913. Për këtë, le ta studiojmë dhe analizojmë fillimisht lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me katër nivelet (elementet konstitutive) të kompleksit ballkanik të sigurisë.

⁶ Barry Buzan and Ole Wæver: "Regions and Powers, The Structure of International Security". P.52-53. Burim i cituar.

⁷ Michaela Cruden, Regional Security Complex Theory: Southeast Asia and the South Pacific, The University of Waikato, p.15, 2011.

⁸ Barry Buzan and Ole Wæver, po aty, faqe 381.

2. Ndikimi i çështjes shqiptare në rendin, stabilitetin dhe sigurinë në nivel shtetëror të aktorëve rajonalë

Kongresi i Berlinit, që u mbledh për të revizionuar vendimet e Shën Stefanit e la gjeohapësirën shqiptare të ndarë mes katër shteteve pushtuesve: Turqisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Shqiptarët vazhduan luftën për të siguruar të drejtat e tyre kombëtare duke tronditur kështu në vazhdimësi sigurinë e këtyre shteteve.

Elita politike shqiptare, që në fillimet e çështjes shqiptare dhe në vazhdimësi, e ka parë paqen dhe sigurinë në rajon si një çështje që vjen nga ndërveprimet midis kombeve që jetojnë aty, ndryshe nga elitat e vendeve fqinjë, të cilat synonin vetëm zgjerimin e territoreve të tyre, kryesisht në drejtim të gjeohapësirës shqiptare. Por, fqinjët nënvleftësonin faktin se bashkë me pjesë të gjeohapësirës shqiptare po i shtonin vendit të tyre, por edhe rajonit, një kërcënim permanent për sigurinë, stabilitetin dhe paqen. Pa një zgjidhje të drejtë të çështjes shqiptare as këto vende që po rrëmbenin pjesë të gjeohapësirës shqiptare, por as dhe rajoni nuk do të kishin më paqe dhe siguri.

2.1. Çështja shqiptare dhe siguria e Perandorisë Osmane

Moszgjidhja e çështjes shqiptare ka pasur ndikim vendimtar në çështje të sigurisë dhe ka minuar vetë Perandorinë Osmane. Kjo ishte paralajmëruar më herët nga shkrintari dhe studiuesi i njohur Ami Boue, i cili, pasi u kthye nga udhëtimet që bëri në vitet 1836-1838 në territoret shqiptare dhe territoret e tjera evropiane të Perandorisë Osmane, paralajmëroi se “mund të jemi të sigurt se sapo të kërcasë një zjarr në perandorinë turke, shqiptarët do të revoltohen dhe mund të para vështrohen ndryshime të mëdha...Shqipëria mund të formojë fort mirë një shtet të pavarur ndërmjet Serbisë dhe Greqisë”.¹ Ndikimi i çështjes shqiptare në sigurinë e Perandorisë Osmane u bë më evident jo vetëm pas krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por edhe në rezistencën antiosmane në vitet 1901-1908, në lëvizjen xhonturke² e deri në shpërbërjen e asaj perandorie. Kryengritjet shqiptare në planin e brendshëm dobësuan pozitat e Turqisë në Ballkan, ndikuan në ndryshimin e raportit të forcave në rajon dhe e bënë Perandorinë Osmane një target të lehtë përballë aleancës së shteteve ballkanike, duke ndikuar kështu në zhvillimet në vijim në kompleksin rajonal të sigurisë së Ballkanit.

2.2. Çështja shqiptare dhe siguria e Serbisë

Konferenca e Ambasadorëve të Londrës lejoi përfshirjen brenda kufijve të Serbisë pjesë të gjeohapësirës shqiptare nga Shqipëria e Veriut, gjithë Kosovën si dhe pjesë të Shqipërisë Lindore. Këto u legalizuan përfundimisht në Konferencën e Versajës, në Memorandumin e 9 dhjetorit 1919 të Fuqive të Mëdha³. Serbia dhe Fuqitë e Mëdha nuk

¹ “La Turquie d’Europe”.Vëllimi IV. Paris 1840. Marrë citimi nga Lumo Skëndo “Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX”, fq. 134-135, Tiranë 2012.

² Prof. Dr. Zekeria Cana:Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908- 1912. Faqe 259.Botuar “8 Nëntori”Tiranë 1982.

³ Pika nr.2 e Promemorjes së Qeverive të SHBA, Britanisë së Madhe dhe Francës mbi Çështjen Shqiptare. Pjesë e Memorandumit Anglo-Franko-Amerikan lidhur me çështjen e Adriatikut. Adriaticus, “La Question Adriatique Recueil de documents officiels”, Paris, 1920, f.57-58,65-67. Përkthyer në shqip në “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar” Vëllimi I. F.490-492.Tiranë 1975.

vlerësuan paralajmërimet e shqiptarëve⁴ se, pa zgjidhjen e drejtë të çështjes së tyre, paqja dhe siguria në rajon do të ishin në vazhdimësi të kërcënuara. Kështu, bashkë me pjesën e gjeohapësirës shqiptare që përfitoi, Serbia “importoi” dhe një kërcënim ekzistencial për sigurinë e vet. Jo më kot kryeministri serb Nikolla Pashiq e vlerësonte Shqipërinë si “Thembra e Akilit e Serbisë”, domethënë krahu i dobët i Serbisë, mjaft i rrezikshëm për sigurinë e saj,⁵ prandaj ata e kanë mbajtur në vazhdimësi të sigurizuar Shqipërinë. Në strategjinë e saj, pas sigurizimit të këtij kërcënimi dhe për ta minimizuar sa të jetë e mundur më shumë atë, Serbia taktikisht planifikoi dhe investoi në tre drejtime kryesore. E para të gjente një pretekst dhe të realizonte pushtimin e Shqipërisë. Për këtë, ajo e dinte se do të kishte një reagim të fuqishëm ndërkombëtar. Nëse dështonte varianti i parë, do të kalonte në variantin e dytë, duke punuar për të realizuar një bashkim të butë të Shqipërisë me Serbinë. Paralelisht do të punohej edhe për një variant të tretë, duke investuar për të mbajtur në vazhdimësi një Shqipëri të dobët që të mos kishte mundësi të ngrinte zërin për çështjen shqiptare në Serbi.

Le të shqyrtojmë një nga një këto variante. Pas Konferencës së Londrës, në fillim të tetorit 1913, me pretekstin e sulmit kundër kryengritësve shqiptarë, ushtria serbe hyri në territorin shqiptar duke dalë përsëri në bregdet në Durrës. Austro-Hungaria i kërkoi në mënyrë ultimative largimin e trupave serbe përndryshe “qeveria perandorake dhe mbretërore, ... do ta shihte veten të detyruar që të përdorte mjetet e nevojshme për të siguruar plotësimin e kërkesës së saj.”⁶ Pas këtij kërcënimi Serbia tërhoqi trupat e saj nga Shqipëria. Pra, përplasja për çështjen shqiptare po rrezikonte sigurinë e Serbisë me një sulm të mundshëm nga Austro-Hungaria. Kjo rrezikonte të destabilizonte më tepër kompleksin ballkanik të sigurisë.

Pasi dështuan në variantin e pushtimit të përhershëm të Shqipërisë, serbët kaluan në opsionin e dytë, mundësinë për bashkimin e butë me Shqipërinë. Për ta arritur këtë, fillimisht Serbisë i duhej të poziciononte njeriun e saj në krye të pushtetit në Shqipëri. Dhe ky personi i zgjedhur prej saj ishte Esat Toptani. Kështu, ushtria serbe pushtoi dy herë Shqipërinë vetëm për të mbështetur Esat Toptanin, në tetor të vitit 1914 për të mbështetur ardhjen e tij në pushtet dhe në qershor 1915 për ta shpëtuar Esatin nga kryengritësit e Haxhi Qamilit. Me Esatin serbët nënshkruan dy marrëveshje të cilat po të zbatoheshin, e bënin Shqipërinë pjesë të Serbisë.⁷ Por as Esati, as Zogu, i cili nuk i qëndroi marrëveshjes dhe angazhimeve që kishte marrë në Beograd për “lidhje të privileguara me Jugosllavinë”,⁸ as përpjekjet

⁴ Memorandum i Delegacionit të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, paraqitur në Konferencën e Paqes. Paris 12 shkurt 1919. Burim i cituar.

⁵ Për më tepër shih: Vështrim i shkurtër mbi politikën që Nikolla Pashiq ka zhvilluar ndaj Shqipërisë, si kryeministër i qeverisë së Serbisë dhe Ministër i Punëve të Jashtme në fillim të shekullit XX. Sreten Draskic “Evropa dhe Çështja Shqiptare (1830-1921)”. Beograd 2000.

⁶ Documents Diplomatiques Français, 3 eme serie, t. VIII, D.Nr.341, pp.429-431.

⁷ Për më tepër shih: Dispozita kryesore të Marrëveshjes së Nishit mes Esat Pashës e Nikolla Pashiqit, më 4 shtator 1914 si dhe Protokollin e Tiranës, datë 28 qershorit 1915, mes Ljube Jovanoviçit e Esat Pashës. Sreten Draskic, burim i cituar, faqe 257-259 dhe 266-270.

⁸ DDI, VII serie, vol VII, p.223. Cituar nga Prof. Dr. Arben Puto. Po aty faqe 380.

e Titos gjatë periudhës së komunizmit për trajtimin e çështjes kombëtare në Kosovë edhe Maqedoni sipas këtij stili komunist⁹ dhe as spastrimi i hapur etnik i shqiptarëve nga Milosheviçi nuk ia eliminuan dot kërcënimin që përbënte për sigurinë e Serbisë çështja e pazgjidhur shqiptare.

Në të vërtetë kriza e federatës jugosllave në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve 90 ka qenë fokusuar në çështjen e Kosovës. Madje në opinionin kosovar dhe në analizat e kohës "pritej që lufta në Jugosllavi do të fillonte në Kosovë"¹⁰. Vetë autorë serbë janë të bindur se "Jugosllavia në të vërtetë është shkatërruar në Kosovë"¹¹. Bashkë me territoret shqiptare që përfitoi nga Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1912-1913, Serbia "importoi" dhe një kërcënim të përhershëm për sigurinë e vet.

2.3. Çështja shqiptare dhe siguria e Greqisë

Çështjen shqiptare në Greqi, të njohur dhe si çështja çame, zyrtarisht e krijoji Konferenca e Londrës e vitit 1913. Në datat 1 dhe 11 gusht 1913, Konferenca vendosi që në jug, kufiri të përfshinte Korçën brenda Shqipërisë dhe të dilte në bregdet në Kepin e Stillos¹². Para mbylljes së saj më 12 gusht 1913, Konferenca ngriti dhe komisionin për caktimin në terren të kufirit me Greqinë. Mbetja e Çamërisë brenda kufijve të shtetit grek u konfirmua dhe legalizua përfundimisht edhe nga Konferenca e Paqes e Parisit e vitit 1919. Çështja shqiptare në Greqi, është pjesë e rëndësishme e çështjes shqiptare në rajon, e cila nuk ka gjetur ende zgjidhje. Si e tillë, ajo ka qenë në vazhdimësi e sigurizuar nga shqiptarët. Historikisht, deri në një zgjidhje optimale të saj, kjo çështje do të vazhdojë të ndikojë në çështjet e sigurisë së shtetit helen dhe do të mbahet e sigurizuar prej tyre.

Në zbatim të "Megali Idheas", programit të tij politik ekspansionist, shteti grek ishte përpjekur qysh në Kongresin e Berlinit që të përfitonte sa më shumë nga territoret shqiptare në kufijtë e tij veriorë. Këtë tendencë të shtetit helen për të përfshirë sa më shumë territore shqiptare nga Kongresi i Berlinit, Fuqitë e Mëdha po e shihnin si një investim të keq që Greqia po bënte kundër sigurisë së vet. I pari që e shfaqti hapur këtë shqetësim ishte Princi Bismark i Gjermanisë. "Ne mendojmë, -shprehej ai - se ruajtja e paqes dhe e ardhmja e Greqisë do të përfitonin në rast se Greqia do të përfshinte në gjirin e saj sa më pak elementë shqiptarë që të jetë e mundur. Greqia nuk do të ishte në gjendje as t'i sundonte e as t'i asimilonte këta elementë. Qetësia e saj do të kërcënohej në qoftë se aneksonte një pjesë të madhe të kësaj race/kombësie luftarake dhe pak të nënshtrueshme."¹³ Bismarku propozonte

⁹ Viktor Meier: "Yugoslavia A History of its Demise", Published in the Taylor & Francis e-Library, 2005.p.181.

¹⁰ The Kosovo Report, p.42-43.

¹¹ Vesna Pesic, "Rat za nacionalne drzave", in Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju / edited by N. Popov, Beograd 1996.f.35.

¹² Procesverbal mbi kufirin jugor të Shqipërisë dhe çështjen e ishujve. Londër 1 gusht 1913. Botim i përkthyer nga Prof.Dr. Arben Puto: "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit" Vëllimi II. Dok.Nr.40, f. 282.

¹³ Shtojcë e letrës së departamentit datë 18 shkurt 1881. Legatës së Francës në Athinë. Paris 11 Shkurt 1881. Botuar në dokumentin nr. 227 të librit "Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" Pjesa II. Faqe 436-438. Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Tiranë 1986.

që në vend të territoreve shqiptare, grekëve t'i jepej ishulli i Kretës. “Ishulli i Kretës ... ka jo vetëm një sipërfaqe pothuajse të barabartë me pjesën shqiptare të Epirit, por si për nga popullsia me shumicë dërmuese greke, ashtu edhe për nga pozita gjeografike, ai paraqet përfitime thelbësore sa që nuk mund të krahasohen kurrsesi me Shqipërinë”¹⁴.

Shteti grek e vlerëson si kërcënim për sigurinë e tij faktin që tokat pranë kufirit me Shqipërinë nuk ishin greke. Për këtë ata duheshin bërë greke me të gjitha format dhe mundësitë. Që nga kjo kohë, qeveritë greke ndërhyjnë dhunshëm në këtë pjesë të hapësirës gjeopolitike shqiptare dhe nëpërmjet spastrimit etnik të shqiptarëve, kryesisht të besimit mysliman¹⁵, arritën ndryshimin e raporteve demografike.¹⁶

Ndonëse qeveria greke nuk e pranon ekzistencën e çështjes çame,¹⁷ krizat e shpeshta në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë janë nxitur jo rrallë nga moszgjidhja e problemit të pronave të komunitetit çam, larguar si pasojë e spastrimit etnik grek. Pas përmbysjes së komunizmit çështja çame ka përjetuar një ringjallje të menjëhershme. Çështja çame përbën sfidën e radhës së çështjes shqiptare dhe “ka gjasa që të ndiqet me energji nga çamët dhe përkrahësit e tyre të shumtë nga i gjithë spektri politik shqiptar”¹⁸.

Ky rigjallërim i çështjes çame dhe përfshirja e saj në axhendat politike në Shqipëri dhe Bruksel është perceptuar nga ana e Greqisë si një kërcënim për sigurinë e saj dhe se “Greqia ndjeu një kërcënim të mundshëm nga kufijtë e saj veriorë, në krahasim me kërcënimin tradicional nga ana e Turqisë në lindje”.¹⁹ Sa më sipër, dalim në përfundim se çështja çame, si pjesë e rëndësishme e çështjes shqiptare, e ngjizur nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, do të vazhdojë të ndikojë në çështjet e sigurisë së shtetit helen deri në një zgjidhje optimale të saj. Është në interes të Greqisë dhe sigurisë së saj njohja dhe pranimi i çështjes çame “para se kjo çështje të ketë marrë hov dhe ... kur ankesat legjitime të çamëve do shndërroheshin në çështje më të thella kombëtare.”²⁰

2.4. Çështja shqiptare dhe siguria e Malit të Zi

Çështja shqiptare në Malin e Zi është pjesë e rëndësishme e çështjes shqiptare në rajon dhe në vazhdimësi ka ndikuar në çështjet e sigurisë së Malit të Zi. Konferenca e Ambasadorëve të Londrës në vitin 1913 i dha Malit të Zi edhe Hotin e Grudën dhe Plavën e Gucinë,²¹

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Dr. Lambros Baltiotis: The Muslim Chams of Northwestern Greece. European Journal of Turkish Studies, 12 | 2011, p.7.

¹⁶ Raport i ICG-së për Evropë N°153, 25 Shkurt, 2004. Faqe 27.

¹⁷ Athinë - “Çështja çame nuk ekziston”. Shekulli 28/06/2006

¹⁸ International Crisis Group: “Albania, State of the Nation”. Europe Report nr. 871. Tirana/ London/ Brussels, 1 March 2000.

¹⁹ Miranda Vickers: The Cham Issue – Where to Now? p.8, Published By: Defence Academy of the United Kingdom, Conflict Studies Research Centre, London 2007.

²⁰ Raport i ICG-së për Evropën N°153, 25 shkurt, 2004. Faqe 4 Po aty.

²¹ Raport i Pol Kambonit, datë 14 prill 1913 “ Mbi përcaktimin e kufijve të Shqipërisë në Veri dhe Verilindje”, Documents Diplomatiques, 3-eme serie, t. VI, D.Nr. 301, pp347-358. Botuar e përkthyer ne shqip në “Çështja

pjesë të hapësirës gjeopolitike shqiptare. Konferenca e Paqes e Parisit e vitit 1919 i dha përfundimisht “tapinë” e këtyre territoreve Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, në të cilën ishte shkruarë Mali Zi.

Mbreti Nikolla i Malit të Zi e lidhi vetë vazhdimësinë e kurorës dhe qeverisjes së tij me çështjen shqiptare. Ai kishte planifikuar që Shkodrën ta bënte si kryeqytetin e Malit të Zi²² dhe betejën për Shkodrën e mori si sfidë personale. Ai mendonte se dështimi në marrjen e saj rrezikonte vetë dinastinë malazeze dhe kishte deklaruar mundësinë se, nëse nuk pushtonte Shkodrën, do të tërhiqej dhe do të ikte në Amerikë²³. Në rrethimin e Shkodrës, Mali i Zi vetëm në sulmet e datave 25, 26 dhe 27 janar 1913 la rreth pesë mijë të vranë dhe të plagosur ose 40% e të gjithë trupave të tyre. Lufta për Shkodrën ishte një humbje e madhe materiale e njerëzore, me ndikime në sigurinë e mbretërisë së vogël malazeze. Por atë që nuk e arritën me luftë, malazetët e arritën në bisedime me Esat Pashën, i cili më 9 prill 1913, nënshkroi marrëveshjen për dorëzimin e Shkodrës princit Danillo të Malit të Zi.

Synimi për të mbajtur me çdo kusht Shkodrën, edhe pas vendimit që mori Konferenca e Ambasadorëve për ta lënë atë brenda kufijve të shtetit shqiptar, rrezikoi seriozisht vetë sigurinë e shtetit malazez. Duke mbajtur Shkodrën, Mali Zi ishte futur në zonën e interesave italiane e austro-hungareze, çka rrezikonte dhe një reagim të armatosur nga ana e tyre.

Edhe pas përmbysjes së komunizmit udhëheqësit e shqiptarëve në Malin e Zi asnjëherë nuk e sfiduan ekzistencën e shtetit të Malit të Zi me kërkesa të shprehura për ndarje²⁴. Shqiptarët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në pavarësimin e Malit të Zi në vitin 2006. Në konsultim dhe me Tiranën zyrtare²⁵, në referendumin e vitit 2006, shqiptarët morën pjesë masivisht në votime dhe mbështetën pavarësinë e Malit të Zi nga Unioni Serbi-Mali i Zi²⁶. Ky ishte një investim i rëndësishëm i shqiptarëve në krijimin dhe sigurinë e shtetit të pavarur të Malit të Zi. Pavarësisht se nuk kanë kërkuar ndarjen e Malit të Zi, shqiptarët nuk i kanë ndërprerë asnjëherë përpjekjet për t'i dhënë një zgjidhje të pranueshme çështjes së tyre kombëtare në Malin e Zi.

Mosplotësimi dhe injorimi i kërkesave të shqiptarëve etnikë në Malin e Zi, mund të radikalizojë pozicionin e tyre, mund t'i krijojë probleme republikës së vogël malazeze lidhur me çështjet e sigurisë dhe mund të implikojë në këtë çështje edhe Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë, me pasoja kjo edhe për paqen dhe sigurinë në kompleksin ballkanik të sigurisë.

Sa më sipër, dalim në përfundimin se çështja e pazgjidhur shqiptare ka ndikuar negativisht në rendin, stabilitetin dhe sigurinë e shteteve fqinje, të cilave Konferenca e Ambasadorëve

shqiptare në aktet ndërkombëtare ...” Dok. Nr. 19. Vëllimi II. faqe 243-244.

²² Sreten Draskic, faqe 182. Burim i cituar.

²³ Po aty.

²⁴ Keneth Morrison: “Montenegro, A Modern History”, p.126. Burim i cituar.

²⁵ Berisha mbështet pavarësinë e Malit të Zi. Takimi Ferhat Dinosh Sali Berisha, 5 prill 2006. Lajmet.com, 06.04.2006.

²⁶ Emri e ri “Unioni Serbi-Mali Zi” u miratuar zyrtarisht më 4 shkurt, 2003. Shih Michael A. Schuman: “Nations in Transition: Serbia and Montenegro”, p.75.

të Londrës iu dha pjesë nga gjeohapësira shqiptare, duke krijuar kështu probleme jo vetëm për sigurinë e këtyre shteteve, por edhe më gjerë për kompleksin ballkanik të sigurisë.

3. Marrëdhëniet mes shteteve në rajon, çështja shqiptare dhe kompleksi rajonal i sigurisë

Le të studiojmë dhe analizojmë tani, për të njëjtën periudhë kohore, ndikimin e marrëdhënieve midis shteteve në Ballkan në kompleksin rajonal të sigurisë si dhe lidhjen e ndërsjellë të tyre me çështjen shqiptare në rajon.

Greqia, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, secila më vete, por edhe së bashku, të suportuara edhe nga Rusia, janë përpjekur që të përfitojnë sa më shumë nga territoret osmane. Por një pjesë e territoreve osmane në Ballkan dhe konkretisht Vilajetet e Shkodrës, Shkupit, Manastirit dhe Janinës, ishin pjesë e gjeohapësirës shqiptare. Në këtë mënyrë, synimet dhe veprimet e tyre për t'u zgjeruar në territoret osmane ishin në të vërtetë synime dhe veprime kundër interesave dhe çështjes shqiptare në rajon. Prandaj raportet armiqësore të këtyre shteteve me Perandorinë Osmane, mos pranimi prej tyre të shqiptarëve si aleat të barabartë në aleancën ballkanike antiosmane, mbajtja e raporteve armiqësore dhe përjashtimi i shqiptarëve si dhe interesave të tyre kombëtarë nga ekuilibrat e projektuara rajonale, do të mbanin për shumë kohë Ballkanin në gjendje lufte më një kompleks rajonal sigurie të mbizotëruar më tepër nga modeli social i armiqësisë midis kombeve.

Në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane shtetet ballkanike kishin nënshkruar mes tyre një seri marrëveshesh e traktatesh dypalëshe. I tillë ishte traktati mes Serbisë e Bullgarisë në mars 1912,²⁷ mes Bullgarisë dhe Greqisë më 29 maj 1912,²⁸ marrëveshja mes Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi në gusht 1912 si marrëveshja mes Greqisë dhe Serbisë më 19 maj 1913. Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Mali i Zi nënshkruajnë mes tyre aleanca jo për paqe, por për luftë në Ballkan, jo për mbrojtje, por për të pushtuar territore, duke përfshirë dhe ato shqiptare, duke kërcënuar kështu paqen dhe sigurinë në kompleksin ballkanik.

Pas kësaj, në tetor 1912, shtetet ballkanike, pasi përmyllën përgatitjet ushtarake, njëri pas tjetrit i shpallën luftë Turqisë, filluan operacionet ushtarake kundër saj dhe pushtuan pjesën më të madhe të gjeohapësirës shqiptare në Ballkan. Për këtë, Fuqitë e Mëdha organizuan Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Përfitimi prej fqinjëve ballkanikë më shumë se gjysmës së gjeohapësirës shqiptare do të bënte që, edhe në të ardhmen, në kompleksin ballkanik të sigurisë të mbizotëronte modeli social i armiqësisë midis kombeve.

Fuqitë e Mëdha, pothuajse për më shumë se një shekull, kishin vlerësuar si burim për sigurinë e Ballkanit vetëm ekuilibrin mes Fuqive të Mëdha dhe nuk ishin të interesuara për një klimë besimi reciprok në rajon. Gjithashtu, shtetarët ballkanas, në kulturën e tyre strategjike, e kuptonin sigurinë si një aleancë me njërin nga Fuqitë e Mëdha të kohës. Për

²⁷ Traktati i Miqësisë dhe Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë. Nënshkruar në Sofje më 13 mars 1912. Përkthyer në shqip nga Prof.Dr. Arben Puto në "Çështja Shqiptare në aktet ndërkombëtare ..." Vëllimi I, faqe 370-376. Dokumenti nr.48.

²⁸ Traktati i Aleancës mes Bullgarisë dhe Greqisë si dhe dhe Konventa Ushtarake në zbatim të Traktatit.

ta ishte më mirë të sigurosh përkrahjen e një shteti të fuqishëm se sa të shkosh mirë më fqinjët. Politikat qeverisëse të mbështetura në përfundime të tilla, për shumë kohë do të ushqenin armiqësinë në marrëdhëniet mes shteteve në rajon, do të minonin bashkëpunimin rajonal dhe do të prodhonin pasiguri të vazhdueshme për paqen në Ballkan. Të dy palët, Fuqitë e Mëdha dhe ato rajonale, në vazhdimësi kishin injoruar peshën që luan në sigurinë rajonale bashkëpunimi dhe fqinjësia e mirë mes shteteve të rajonit, kishin injoruar faktin se “siguria është një çështje që vjen nga ndërveprimet midis kombeve”.²⁹

Zgjidhja gjysmake e çështjes shqiptare në vitet 1912-1913, duke lënë më shumë se gjysmën e gjeohapësirës shqiptare së bashku me tre nga katër qendrat e vilajeteve shqiptare jashtë kufijve të shtetit të cunguar shqiptar, ndikoi negativisht në polaritetin e kompleksit ballkanik të sigurisë, në shpërndarjen e padrejtë të fuqisë në disfavor të shqiptarëve, në shkeljen sistematike deri në ditët e sotme të të drejtave kombëtare të shqiptarëve në rajon, në marrëdhëniet mes vetë shteteve fqinje, si dhe pengoi zhvillimin dhe prosperitetin e kombit dhe shtetit shqiptar, duke ndikuar kështu negativisht dhe në konstelacionin e sigurisë të kompleksit ballkanik.

4. Bashkëveprimi i Ballkanit me rajonet fqinje, çështja shqiptare dhe kompleksi rajonal i sigurisë

Në kompleksin rajonal të sigurisë është i rëndësishëm dhe ndërveprimi me rajonet fqinje³⁰. Historikisht, Ballkani, sidomos ai i Jugut, ka luajtur një rol të madh në zhvillimet evropiane. Nga viti 1700 në vazhdim, Evropa konsolidohet jo vetëm si kompleks rajonal sigurie e cila kishte filluar zgjerimin drejt kompleksit tjetër fqinjë, Ballkanit, por shumë shpejt arriti të bëhet qendra e politikës botërore. Më pas, deri në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane në vitin 1913, kompleksi ballkanik sigurizohet dhe mbulohet në aspektet e sigurisë nga fuqitë e kompleksit evropian, por edhe nga Rusia³¹. Fuqitë evropiane luajtën rol kryesor në ruajtjen e status quos-së Perandorisë osmane në kompleksin ballkanik, pasi i frikoheshin depërtimit sllav dhe synimeve të Rusisë³² për sllavizimin e tij. Në këtë kohë, me pretekstin e vendosjes së paqes mes fuqive,³³ të cilat e kishin sigurizuar Ballkanin, si dhe të aleatëve të tyre të kompleksit ballkanik, u sakrifkua çështja shqiptare në rajon, duke ndikuar kështu negativisht në kompleksin rajonal të sigurisë.

²⁹ Barry Buzan, *People, States and Fear*, second edition (Colorado: Lynne Rinner Publishers, 1991), pp. 187.

³⁰ Barry Buzan and Ole Wæver: “Regions and Powers, The Structure of International Security”. P.50.

³¹ Për më tepër shih: “Marrëveshja e arritur ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Rusisë në lidhje me Ballkanin”, Përkthyer në shqip nga Prof.Dr. Arbem Puto në “Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të Periudhës së Imperializmit”. Vëllimi I. Faqe 322; Marrëveshja e Rakonixhit, nënshkruar më 24 tetor 1909, Viktor Emanueli III, Mbreti i Italisë dhe Nikolaj II, Mbreti i Rusisë.

³² Prof.Dr.Arben Puto: “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit” Vëllimi I.f. 12.

³³ Deklaratë e Eduart Grey mbi caktimin e kufijve të Shqipërisë. Botuar e përkthyer në “Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare” V.II. Dokumenti Nr. 44.Fq. 292-293.

5. Roli i fuqive botërore në rajon, çështja shqiptare dhe kompleksi rajonal i sigurisë

Një nga rastet tipike ku fuqitë botërore kanë ndërhyrë ose ndikuar së bashku në kompleksin ballkanik të sigurisë me organizimet dhe aktet juridike ndërkombëtare është Konferenca e Londrës e ambasadorëve të Fuqive të Mëdha e vitit 1912-1913 me vendimet e protokollet e saj³⁴. Në prag dhe pas kësaj konference, një rëndësi të madhe ka luajtur për çështjen shqiptare por edhe për kompleksin ballkanik të sigurisë, bashkëpunimi, rivaliteti dhe më pas armiqësia austro-italiane.

Këto dy Fuqi të Mëdha të kohës, pavarësisht kundërshtive mes tyre për supremaci në çështjen shqiptare, bënë aleancë mes tyre dhe për të larguar Serbinë nga bregdeti Adriatik, mbështetën çështjen shqiptare duke propozuar krijimin e një shteti shqiptar në Ballkan. Propozimi i tyre më 17 dhjetor 1912 u kthye në vendim nga Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha të Londrës³⁵. Por kjo konferencë, duke iu dhënë fqinjëve ballkanikë më shumë gjysmën e gjeohapësirës shqiptare gjoja në emër të vendosjes së paqes dhe ekuilibrit në Ballkan,³⁶ cenoi rëndë interesat kombëtare të shqiptarëve dhe bëri investimin më të keq ndërkombëtar për paqen në kompleksin ballkanik të sigurisë.

Rreth dy vite më vonë, pasi Austro-Hungaria sulmoi Serbinë, Italia kërkoi kompensim në bazë të nenit 7 të Traktatit të Tretë të Aleancës Trepalëshe³⁷ dhe konkretisht që Austro-Hungaria të ndërpriste interesimin për Shqipërinë. Pasi Austro-Hungaria refuzoi kërkesën e Italisë lidhur me Shqipërinë, qeveria italiane refuzoi pjesëmarrjen e mëtejshme në Aleancën Treshe (Fuqitë Qendrore). Italia krahas bisedimeve me Austro-Hungarinë rreth çështjes shqiptare, kishte zhvilluar bisedime edhe me fuqitë e Marrëveshjes Trefishe (Antanta), rreth kalimit nga Aleanca Treshe në Marrëveshjen Trefishe. Këto bisedime përfunduan me marrëveshjen mjaft të favorshme për Italinë, atë të Londrës të 13 prillit 1915, ku asaj i pranuan pretendimet për Shqipërinë³⁸. Kështu këmbëngulja italiane për të pasur kontrollin

³⁴ Shih raportin e ambasadorit Pol Kambon, përfaqësues i Francës në konferencë, datë 17.12.1912. Dokuments Diplomatiques Francais, 3-eme serie, te,t. V. D. n° 78, pp .94-96. Përkthyer në shqip në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare ...” V.II, Faqe 187-190. Burim i cituar; Illyrisch-Albanische Forschungen, Ludwig von Thalloeyz, II band, Munchen und Leipzig 1916, p.173. Përkthyer në shqip në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare” V.II, Faqe 187-190. Dokumenti Nr.38; Si dhe Procesverbali i Konferencës Londrës në vazhdim të vendimit të saj përfundimtar të datës 29 Korrik 1913. Përkthyer në shqip në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...” V.II, Faqe 280-281.

³⁵ Pjesë nga raporti i ambasadorit të Francës, Pol Kambon, datë 17.12.1912. Dokuments Diplomatiques Francais, 3 eme serie, te,t. V. D. n° 78, pp .94-96. Përkthyer në shqip në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare.....” V.II, faqe 187-190.

³⁶ Deklaratë e Eduart Grey mbi caktimin e kufijve të Shqipërisë. Botuar e përkthyer në “Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare ...” V.II. Dokumenti Nr. 44. Faqe 292-293.

³⁷ Shih neni 7, Trakta i Tretë i Aleancës Tripalëshe ndërmjet Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe Italisë. A.F. Pribram, Les traites politiques secrets de l'Autriche-Hongries, t, I, Paris 1923, pp.60-62. Përkthyer në shqip në “Çështja Shqiptare në aktet ndërkombëtare ...” Vëllimi I, faqe 307-308. Dokumenti Nr.35.

³⁸ Shih Traktati i Fshehtë i midis Fuqive të Antantës dhe Italisë. Londër 26 prill 1915. Botuar i përkthyer në shqip nga Prof.Dr.Arben Puto në “Çështja Shqiptare në aktet ndërkombëtare ...” Vëllimi II, faqe 634-622. Dokumenti

mbi territorin dhe bregdetin shqiptar është një nga shkaqet kryesore të largimit të Italisë nga koalicioni me Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë.

Por, me kalimin e Italisë tek Antanta, u prish ekuilibri i forcave në Evropë mes dy aleancave, përkatësisht Aleancës Treshe (Fuqitë Qendrore) dhe Marrëveshjes Trefishe (Antanta). Kështu u bë një rigrupim i fuqive në Evropë. Marrëveshja Trefishe tashmë u bë Katërfishe dhe peshorja anoi në dobi të fuqive të Antantës, duke i ndryshuar kështu rrjedhat e Luftës I Botërore. Pra, çështja shqiptare ishte një ndër faktorët që çoi në thellimin e përplasjes mes dy aleancave më të mëdha të kohës, duke mundësuar kështu daljen e konfliktit të armatosur jashtë kompleksit ballkanik të sigurisë, në kompleksin rajonal të sigurisë fqinjë, në atë të Evropës.

Pas përmbysjes së komunizmit, kur fuqitë botërore, kryesisht ato perëndimore, filluan të kenë një qasje tjetër për sigurinë në rajon, duke e trajtuar atë si një çështje që vjen nga ndërveprimi mes kombeve, kur Ballkanin filluan të mos e trajtojnë thjesht si një rajon gjeografik që prodhon vazhdimisht pasiguri, por si një grup të kombeve që nuk mund të ndahet për shkak se proceset e sigurizimit dhe desigurizimit i kanë të lidhura mes tyre aq shumë sa problemet e tyre të sigurisë nuk mund t'i zgjidhin veç e veç, kur krijuan bindjen se pa zgjidhjen e çështjeve nacionale dhe të çështjes shqiptare nuk mund të ketë paqe e siguri në Ballkan, vetëm atëherë ndërhyrjet e tyre filluan të ndikojnë pozitivisht në kompleksin ballkanik të sigurisë. Ndikimi dhe mbështetja që fuqitë kryesore botërore i dhanë procesit të zgjidhjes së çështjes shqiptare në rajon, nëpërmjet krijimit dhe njohjes së shtetit të pavarur të Kosovës ka ndikuar pozitivisht në kompleksin ballkanik të sigurisë.

6. Çështja shqiptare dhe transformimet e kompleksit ballkanik të sigurisë

Sikurse e theksuam në fillim të këtij punimi, ndërveprimi mes katër elementeve konstitutive (katër nivelet) e një kompleksi rajonal sigurie përcaktojnë ndryshimet në katër variabilet e strukturës thelbësore të atij kompleksi të cilat janë: kufijtë e kompleksit, struktura anarkike, polariteti dhe ndërtimi social.³⁹ Dhe ndryshimet në strukturën thelbësore i krijojnë kompleksit rajonal tre mundësi zhvillimi të cilat janë ruajtja e status quo-së, transformimet e brendshme të kompleksit si dhe transformime të jashtme të tij⁴⁰.

Siç provuam më lart, çështja shqiptare ka ndikuar e vazhdon të ndikojë në katër nivelet (elementet konstitutive) e kompleksit rajonal të sigurisë e, për rrjedhojë, në konstelacionin (modelin) e kompleksit ballkanik e në strukturën thelbësore të këtij kompleksi, duke mundësuar dhe duke i bërë njëkohësisht të domosdoshme transformimet e brendshme të kompleksit ballkanik të sigurisë. Kjo do të thotë se çështja shqiptare në rajon ka ndikuar dhe në ndryshimin e strukturës anarkike, të polaritetit dhe të modelit social dominues miqësi / armiçësi dhe potencialisht do të vazhdojë të ndikojë deri në një zgjidhje optimale të saj, të

Nr.161.

³⁹ Barry Buzan and Ole Wæver: "Regions and Powers, The Structure of International Security". P.53. Burim i cituar; Michaela Cruden, Regional Security Complex Theory: Southeast Asia and the South Pacific, The University of Waikato, p.15, 2011.

⁴⁰ Barry Buzan and Ole Wæver, po aty, faqe 381.

pranueshme nga shqiptarët.

Lënia jashtë kufijve të shtetit shqiptar nga Konferenca e Londrës e më shumë se gjysmës së gjeohapësirës shqiptare së bashku me tre nga katër qendrat e vilajeteve shqiptare, ndikoi negativisht në polaritetin e kompleksit ballkanik të sigurisë, në shpërndarjen e padrejtë të fuqisë në disfavor të shqiptarëve, në marrëdhëniet mes shteteve në rajon dhe në vetë sigurinë rajonale, duke u kthyer kështu në një faktor që do të diktonte në vazhdimësi transformimet e brendshme në kompleksin rajonal të sigurisë, deri në gjetjen e një zgjidhjeje optimale për çështjen shqiptare në rajon.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe shuarjes së konfliktit në nivel global, kompleksi ballkanik shoqërohet me transformime të vrullshme të brendshme, por dhe të jashtme, pasojë kjo e ndryshimit të strukturës së tij thelbësore. Kështu filloi procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë. Moszgjidhja e çështjes shqiptare kërcënonte jo vetëm Ballkanin, por edhe kompleksin fqinjë, Bashkimin Evropian si dhe për interesat e aktorëve të tjerë të fuqishëm ndërkombëtarë shtetërorë e joshtetërorë, si SHBA dhe NATO. Prandaj çështja shqiptare u sigurizua prej tyre. Përveç luftës dhe përpjekjeve të shqiptarëve, ishte ndërhyrja e fuqishme e këtyre aktorëve që bëri të mundur krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ishte gjithashtu ndërhyrja dhe presioni i tyre faktori kryesor që i bëri shqiptarët të nënshkruajnë Marrëveshjen e Ohrit dhe atë të Konculit.

Kjo shkallë e zgjidhjes së çështjes shqiptare në rajon, ndonëse jo përfundimtare, ka ndikuar pozitivisht në konstelacionin e sigurisë në Ballkan dhe më gjerë si dhe ndryshoi përsëri strukturën e nënkompleksit ballkanik të sigurisë, duke diktuar kështu transformime të brendshme në të. Kështu, në strukturën anarkike të nënkompleksit është shtuar një shtet i ri, Kosova. Ka zhvillime në drejtim të polarizimit të fuqisë në rajon. Krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës çoi në fillimin e procesit të korigjimit dhe rishpërndarjes së fuqisë në rajon në dobi të shqiptarëve dhe në një rivendosje të ekuilibrave të fuqisë në Ballkanin Perëndimor si nënkompleks rajonal sigurie, mes sllavëve, shqiptarëve dhe grekëve. Grekët, sllavët dhe shqiptarët nuk janë vetëm tre popuj bashkë në zonat e veta, “por janë tri qytetërimi, me tri kultura, me tri gjuhë. Ballkani nuk mund të përfytyrohet, qoftë dhe pa njërin prej këtyre përbërësve.”⁴¹ Boshti Beograd-Tiranë-Athinë duhet të jetë kyç në vendosjes e politikave në Ballkan, do të deklaronte në Tiranë më 10 qershor 2007, Presidenti amerikan Bush.⁴²

Si përfundim, pasi studiuam dhe analizuam për një periudhë më shumë se njëqindvjeçare, lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me kompleksin ballkanik të sigurisë, dalim në përfundimin se çështja shqiptare në rajon dhe shkalla e zgjidhjes së saj ka ndikuar në vazhdimësi dhe vazhdon të ndikojë në sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Bibliografia:

I. Dokumente arkivore, traktate, raporte etj.:

- AQSH. Fondi Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Dosja Nr.2. Dokumenti Nr.5523.
- Traktati i Berlinit, ndërmjet Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë,

⁴¹ Ismail Kadare, Intervistë për revistën NIN të Beogradit. Ribotuar në gazetën “Shqip”, 25 Prill 2012.

⁴² Ridefinimi i kufijve me marrëveshje shtetërore. Telegrafi.com, 4.9.2010.

Rusisë dhe Turqisë, nënshkruar në Berlin, më 13 korrik 1878. Botuar në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. I. Dokumenti Nr. 16.

- “Traktatit Paraprak i Paqes ndërmjet Turqisë dhe Rusisë”. Shën Stefan (Stamboll), 3 mars 1878. Nënshkruar nga Konti N.Ignatiev Nelidov dhe Safet Sadullah.
- Marrëveshje mes Austro-Hungarisë dhe Italisë. Romë 8 maj 1913. “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. II. Dokumenti Nr.27.
- Traktati i Miqësisë dhe Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë. Nënshkruar në Sofje, më 13 mars 1912. Botuar në Prof. dr. Arben Puto në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. I, Dok. Nr.48.
- Marrëveshja sekrete midis Greqisë dhe Serbisë mbi ndarjen e sferave të influencës në Shqipëri, nënshkruar në Selanik, më 19 maj 1913. Documents Diplomatiques, Ministere des Affaires Etrangères, oktobre 1915 - juin 1916, Athenes, 1921, pp. 19-20.
- Traktati i fshehtë midis fuqive të Antantës dhe Italisë. Londër, 26 prill 1915. Botuar në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll.II, Dok. Nr.161.
- Traktati i Paqes midis Greqisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Turqisë, nënshkruar në Londër më 30 maj 1913. Botuar në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. II. Dok. Nr. 45.
- Ultimatum i Austro-Hungarisë drejtuar Serbisë në 18 tetor 1913, për tërheqjen e trupave nga Shqipëria. Documents Diplomatiques Francais, 3eme serie, t. VIII, D.Nr.341, pp.429-431.
- Procesverbal i Konferencës Londrës në vazhdim të vendimit të saj përfundimtar të datës 29 korrik 1913. Botuar në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. II.
- Memorandum drejtuar lordit Bikonsfild, përfaqësues i Anglisë në Kongresin e Berlinit. Botuar nga prof. Arben Puto në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit”, vëll. I, f. 140. Dokumenti Nr.6.
- Memorandum i Anglo-Franko-amerikan lidhur me Çështjen e Adriatikut. Adriaticus, “La Question Adriatique Recueil de documents officiels”, Paris, 1920. f. 57-58, 65-67. Botuar në “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar”, vëll. I, f. 490-492, Tiranë 1975.
- Adriaticus. La Question Adriatique Recueil de documents officiels. Paris, 1920, f. 109-110. Botuar në “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar”, vëll. II, f. 34-35.
- Memorandum i Qeverisë Serbe drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Janar 1913. Botuar në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. II.
- Memorandum i qeverisë greke, datë 3 janar 1913, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Botuar në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. II, Dok. Nr. 4.
- Letër e Sen Kanten, i ngarkuar me punë i Francës në Cetinë, dërguar ministrit të Jashtëm të Francës Dë Frejsines, në Janar 1880. “Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” II. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1986.
- Memorandum i Delegacionit të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, paraqitur në Konferencën e Paqes.Paris 12 Shkurt 1919
- Notë e presidentit Willson, datë 6 mars 1920, në përgjigje të notës së aleatëve të datës 26 shkurt 1920, te “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...”, vëll. II.
- Dokumente të përkthyer dhe të botuara në “Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, vëll. II, f.37-41, Tiranë 1986. Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH
- Documents Diplomatiques Francais, 3 eme serie, t. VIII, D.Nr.341, pp.429-431.
- Raport i Pol Kambonit, datë 14 Prill 1913 “ Mbi përcaktimin e kufijve të Shqipërisë në Veri dhe Verilindje”, Documents Diplomatiques, 3-eme serie, t. VI, D.Nr. 301,pp347-358. Botuar e përkthyer ne shqip në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare” Dok. Nr. 19. Vëllimi II. Faqe 243-244.
- Vendim i Konferencës së Ambasadorëve për Kufijtë e Shqipërisë. Pika 1. Paris 9 nëntor 1921
- Raport i ICG-së për Evropë N°153, 25 Shkurt, 2004.Faqe 27.International Crisis Group:“Albania, State of the Nation”. Europe Report nr. 871. Tirana/ London/ Brussels, 1 March 2000.

II. Botime, studime e artikuj:

- Buzan B: "People, States & Fear: The National Security Problem in International Relations", 1983.
- Buzan, B. and Wæver O: "Regions and Powers; The Structure of International Security", Cambridge University Press, Cambridge, 2003.
- Collins, Alan: "Studimet bashkëkohorë të sigurisë", Tiranë 2009.
- Sarah Terry, University of Calgary: Defining Security: Normative Assumptions and Methodological Shortcomings.
- Stolberg, Alan G.: Sistemi Ndërkombëtar në Shekullin e 21-të. Botuar në "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare", vëll. II. Botim i Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu".
- Wolfers, Arnold: "National Security as an Ambiguous Symbol", Political Science Quarterly, Vol.67, No.4, December 1962.
- Emmers, Ralf. Sigurizimi, "Studime bashkëkohore të sigurisë". Tiranë 2009.
- Grizold, Anton: "Paradigma e sigurisë pas Luftës së Ftohtë. Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve - rasti i Maqedonisë", Shkup 2009.
- Takahashi, Sugio: Redefinition of Cooperative Security and "Regional" Security in the Asia-Pacific. The National Institute for Defense Studies (NIDS), Security Reports, No.1 (March 2000).
- Fürstenberg, Michael: "Conflict Beyond Borders", Conceptualizing Transnational Armed Conflict, Nr. 97, September 2010, ISSN-Nr. 1614-7898.
- Wallensteen, Peter and Sollenberg, Margareta: Armed Conflict and Regional Conflict Complexes, 1989-97. Journal of Peace Research, Vol. 35, No. 5.
- Cruden, Michaela: Regional Security Complex Theory, Southeast Asia and the South Pacific, The University of Waikato, 2011.
- Meta, Beqir: Tensioni greko-shqiptar 1939, Tirane 2007.
- Meta, Beqir: Shqipëria dhe Greqia 1949-1990, Paqja e veshit. Tirane 2007
- Frashëri, Kristo: "Shqiptarët dhe Kriza Lindore" në "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", Tiranë 1989
- Hoti, Ukshin: "Filozofia politike e Çështjes Shqiptare", "Rozafa", Tiranë 1995.
- Qosja, Rexhep: "Çështja shqiptare. Historia dhe politika", "Toena" 1998.
- Stavaleci, Esat: "Statusi i kombit shqiptar dhe sfidat e tij", Prishtinë 13 gusht 2007.
- Prof.Dr.Arben Puto: "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit" Vëllimi I.
- Draskic, Sreten: "Europa i Allbansko Pitanje 1830-1921". Beograd 2000.
- Miličević, Milič: Pat za Mope. Medija Centar "Odrana". Beograd 2011.
- Pesic, Vesna, "Rat za nacionalne drzave", in Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju / edited by N. Popov, Beograd 1996.
- Belegu, Xhafer: "Lidhja e Prizrenit", Tiranë 1939.
- Petifer, Xhejms: "Southern Balkans 2009– Stability and Stasis", Published By: Defence Academy of the UK. ISBN 978-1-905962-71-6.
- Shala, Xhavit: "Ballkani, gjeopolitika dhe siguria", vëll. I dhe II, Tiranë 2009.
- Boriçi, Gjon: "Marrëdhëniet ndërkombëtare në vorbullën e diplomacisë", "UFO", Tiranë 2009
- Nathalie, Clayer: "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", Tiranë 2009.
- Skëndo, Lumo: "Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX", Tiranë 2012.
- Jablonsky, David & Craig. R. Nation: "Fuqia kombëtare dhe siguria". Botuar në "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare", vëll. II. Botim i Akademisë Ushtarake "Spiro Moisiu", Tiranë 2009.
- Cana, Zekeria: "Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912", "8 Nëntori", Tiranë 1982.

- “Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh”, “8 Nëntori, 1982.
 - “Hasan Prishtina, Dokumente”, Tiranë 1983.
 - Baltiotis, Lambros: The Muslim Chams of Northwestern Greece. European Journal of Turkish Studies, 12 / 2011.
 - Rich, Norman: “Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914”, “Toena” 2006.
- Joseph S. Nye Jr: “Soft Power: The Means To Success In World Politics”, 2004.
- Kisinger, Henri: “Diplomacia”, Tiranë 1999.
- Kadare, Ismail: Intervistë për revistën NIN të Beogradit. Ribotuar në gazetën “Shqip”, 25 prill 2012.
- Viktor Meier: “Yugoslavia A History of its Demise”, Published in the Taylor & Francis e-Library, 2005.p.181
- The Kosovo Report, p.42-43.
- Vesna Pesic, “Rat za nacionalne drzave”, in Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju / edited by N. Popov, Beograd 1996.f.35.
- Keneth Morrison: “ Montenegro, A Modern History”

MJEDISI I SIGURISË NË RANG GLOBAL, GJEOPOLITIKA DHE NDIKIMI I SAJ NË ZHVILLIMET E ARDHSHME

Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa

*Oficer shtabi/ Specialist për Kërkimin, Sfidat e Sigurisë
Kombëtare, IKSHU*

Trajtesë e shkurtuar.

Rishikimi dhe analiza e mjedisit të sigurisë në rang global dhe gjeopolitikës dhe ndikimi i tyre në zhvillimet e ardhshme ka një rëndësi të veçantë, jo vetëm në aspektin e njohjes dhe studimit të çështjeve me ndikim mbarë botëror, por ajo që është më e rëndësishme dhe në përpilimin dhe zhvillimin e doktrinave dhe strategjive në çdo nivel, me qëllim për të parandaluar përkeqësimin e mjedisit të sigurisë dhe përmirësimin e tij në progres.

Mjedisi i sigurisë është një koncept i gjerë i ndërlikuar që mbart me vete ngarkesa të mëdha në të cilin ndërthuren interesa të shumtë të aktorëve me ndikim në rrafshin global, rajonal e kombëtar dhe ndikohen nga trendi dhe sjelljet gjeopolitike.

Në këtë studim do të trajtoj në kontekstin politik, historik e gjeografik përbërjen e mjedisit të sigurisë në tërësi, mënyrën e evoluimit të aktorëve dhe interesave të tyre, si dhe cilat kanë qenë konjunkturat që kanë frymëzuar këtë mjedis në transformim të pandërprerë pavarësisht ulje-ngritjeve në përshtatje me zhvillimet social-ekonomike apo rrethanave të tjera të kohës të ndikuara ose të imponuara nga ndërhyrjet, zhvillimet dhe implikimet gjeopolitike.

Materiali trajton gjeopolitikën, fuqinë dhe renditjen e aktorëve në rang global, rajonal e kombëtar dhe ndikimin e tyre në procesin e gjatë e të ndërlikuar të formësimit të sistemit botëror aktual dhe në perspektivë duke u përballur me intensitetin e ndryshimeve gjeopolitike.

Fjalët kyçe: Mjedisi i sigurisë, Ballkani Perëndimor, NATO, BE, OSBE, OKB, zonë gjeostrategjike, gjeopolitikë, luftë, paqe, ngrohje globale, emigrim, bashkëpunim.

1. Hyrje

Ky shkrim është konceptuar si një material studimor që trajton në vija të përgjithshme mjedisin e sigurisë, gjeopolitikën, aktorët dhe faktorët që ndikojnë në formësimin e tij, si dhe strategjitë, doktrinat që orientojnë angazhimin e burimeve njerëzore, financiare në interes të ruajtjes dhe përmirësimit të tij të vazhdueshëm përkundrejt ndërhyrjeve e zhvillimeve gjeostrategjike e gjeopolitike në rajon e më gjerë.

Materiali trajtohet në tre çështje kryesore, me qëllim studimin sa më të detajuar të këtij koncepti si nga ana e përmbajtjes, ashtu dhe e orientimit mbi ndikimin dhe influencën e aktorëve të ndryshëm, politiko-historik, diplomatik, gjeografik, ekonomik e kulturor me ndikim gjeopolitik si në nivelin global ashtu edhe rajonal e kombëtar.

Në çështjen e parë, trajtohen aktorët kryesorë të mjedisit të sigurisë, fuqitë dhe renditja e tyre mbi konceptin e fuqisë kombëtare, si dhe roli e vartësia e secilës fuqi në raport me sistemin global apo rajonal të mjedisit të sigurisë.

Në çështjen e dytë kam analizuar gjeopolitikën, aktorët mbizotërues të mjedisit të sigurisë, gjeografinë politike, si dhe ndryshimet dhe ndikimet në raport me njëri-tjetrin në procesin e gjatë e të ndërlikuar, nëpër të cilin kalon, zhvillohet e përshtatet sistemi i ri botëror.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, disa përfundime mbi ndikimin e mjedisit të sigurisë në zhvillimet e ardhshme globale, rajonale e kombëtare dhe ndërhyrjen dhe ndikimin reciprok të aktorëve kryesorë gjeopolitikë, sipas rrethanave, të kohës, hapësirës dhe burimeve në dispozicion.

Njëkohësisht është mjaft e rëndësishme të ndiqen nga afër trendet e zhvillimit, me qëllim adaptimin e qëndrimeve tona për të mbështetur dhe zhvilluar interesat dhe objektivat tanë kombëtarë në një mjedis në ndryshim të vazhdueshëm gjeopolitik.

2. Mjedisi i sigurisë globale

Siguria është një koncept i rëndësishëm së veçantë, komplekse dhe gjithëpërfshirëse, por njëkohësisht i diskutueshëm dhe pragmatist. Perceptimi, konceptimi dhe masat për realizimin e saj janë përgjegjësi e aktorëve shtetërorë dhe jo vetëm, por edhe të organizmave të sigurisë globale. Sot, gjendja e mjedisit të sigurisë është dinamike, me mjaft sfida, ku pleksen aktorë të ndryshëm me ndikim afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë. Ambienti i sigurisë ka kuptim dhe vlerësohet në aspektin global, rajonal dhe kombëtar sipas rëndësisë dhe ndikimit nga ngjarje madhore. Ato janë me sfond politiko-diplomatik, social-ekonomik, ushtarak, etj.

Mjedisi i sigurisë globale është duke u zhvilluar në të gjitha dimensionet e tij, veçanërisht

me synimin për rritjen e vazhdueshme të fuqisë ekonomike, politike dhe ushtarake të aktorëve më të rëndësishëm të tij.

Ai vazhdon të jetë kompleks dhe i ndërlikuar, si në nivelin global, ashtu edhe në lidhje me aktorët, faktorët dhe ndryshimet gjeopolitike në të gjitha nivelet, të imponuar dhe nga struktura e kërcënimeve, përkatësisht për shkak të përdorimit të qasjeve hibride apo të natyrave tradicionale të tyre dhe ndërthurjes së interesave të këtyre aktorëve në këtë proces.

Sjellja dhe veprimet nga forca të caktuara do të përcaktojnë si një faktor kryesor zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit të sigurisë. Përdorimi i fuqisë nga disa aktorë në ndjekjen e objektivave të tyre në skenën ndërkombëtare do të zvogëlojë më tej stabilitetin; të cilët do të kenë ndikim të konsiderueshëm në arenën botërore dhe rajonale.

Efektiviteti i institucioneve ndërkombëtare, veçanërisht aftësia e tyre për të siguruar garantimin e sigurisë dhe funksionet e parandalimit të konflikteve, do të luajë rol të rëndësishëm në formësimin e mjedisit të sigurisë si në nivelin global, ashtu edhe në atë rajonal.

Harku i paqëndrueshmërisë që shtrihet në disa vende ka terrenin e vet në vendet e dobëta e të dështuara, ku sistemet politike dhe qeveritë e tyre nuk mund të përballen me faktorët ekonomikë dhe teknologjikë globalë, ndryshimet mjedisore, zhvillimi demografik, korrupsionin dhe mosbesimin e njerëzve ndaj institucioneve të tyre shtetërore. Këto shtete dhe qeveritë e tyre nuk mund të reagojnë ndaj ndryshimeve politike, sociale dhe fetare, të cilat më pas rriten në konflikte të brendshme, ndërshtetërore e më gjerë, duke shkaktuar kriza humanitare dhe migrimi masiv me pasoja të pallogaritshme.

Cilat janë trendet kryesore të mjedisit të sigurisë?

Shpërndarja e fuqisë politike, potencialit ekonomik dhe aftësive ushtarake në të gjithë globin vazhdon të jetë e larmishme dhe e paekuilibruar. Aktorë të rëndësishëm rajonalë jashtë NATO-s dhe BE-së vazhdojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre ushtarake. Ka shtete ambicioze që nuk hezitojnë të përdorin forcën dhe të shkelin të drejtën ndërkombëtare si një instrument në përparimin e objektivave të tyre dhe ndjekjen e politikës së avancimit të pushtetit.

Globalizimi i vazhdueshëm ekonomik dhe i informacionit, ndryshimi i klimës, i kombinuar me zhvillime të pabarabarta teknologjike dhe demografike do të jenë burimet e konflikteve të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në interesat strategjikë të aktorëve gjeografikisht shumë të largët. Përpjekjet për të zgjidhur konflikte të tilla në mënyrë të njëanshme mund të destabilizojnë shumë vende, duke pasur një ndikim të fortë në ekonominë e tyre.

Lëvizshmëria e shtuar së bashku me një dendësi të lartë të popullsisë do të rrisë rrezikun e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë disa me potencial pande mik, siç është Covid-19.

Teknika moderne e informacionit dhe komunikimit, interneti dhe shpejtësia e mediave sociale mundësojnë transferimin e tensioneve dhe paqëndrueshmërisë. Këto mjete mund të përdoren për informacione dhe operacione psikologjike në një shkallë të gjerë.

Kur avancojnë objektivat e tyre politikë, agresorët mund të përdorin metoda hibride në vend të përdorimit të hapur të forcave të rregullta ushtarake. Fushatat hibride i kombinojnë

me të tjera instrumente si ato ushtarake dhe civile, duke përfshirë presionin diplomatik, ekonomik, dezinformimin dhe propagandën.

Ekzistojnë një sërë faktorësh, siç janë: zhvillimi i pabarabartë demografik në pjesë të ndryshme të botës, ndryshimet klimaterike, ngrohja globale, degradimi i mjedisit, mungesa e ujit ose kërkesa në rritje për burime energjetike, të cilat sjellin një përplasje të interesave të aktorëve të ndryshëm dhe kanë potencialin për të gjeneruar kriza të reja ose thelluar tashmë ato ekzistuese.

Varësia në rritje e shoqërive moderne nga teknologjitë e informacionit e bën sigurinë në veprimtarinë kibernetike një çështje kritike për qeveritë dhe për funksionet që ato ofrojnë, përfshirë sektorin e sigurisë e të mbrojtjes. Një numër i aktorëve shtetërorë dhe joshitetërorë po zhvillojnë aftësi kibernetike me qëllim për të sulmuar sistemet dixhitale dhe infrastrukturën kritike të institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore. Vështirësia për të identifikuar autorët e sulmeve kibernetike zvogëlon aftësinë tonë për t'i parandaluar ata dhe gjithashtu rrit rrezikun për mjedisin e sigurisë.

3. Gjeopolitika dhe ndikimi i saj në zhvillimet e ardhshme

Aktorët kryesorë që kontribuojnë për mjedisin e sigurisë janë fuqitë dhe organizmat shtetërorë dhe jo vetëm, si në rang global, rajonal ashtu edhe kombëtar. Me qëllim që të njohim nga afër impaktin e tyre mbi mjedisin e sigurisë, është e domosdoshme t'i studiojmë, njohim dhe të nxjerrim deduksionet tona rreth këtyre aktorëve dhe ngjarjeve, që ndërvaren nga veprimi apo mosveprimi i tyre në kushte dhe rrethana të caktuara të tij dhe të ndërmarrim masat adekuate kundërvepruese.

Gjeopolitika dhe gjeografia e marrëdhënieve ndërkombëtare janë dy faktorët vendimtarë mbi të cilat mbështetet dhe zhvillohet dhe mjedisi i sigurisë në çdo nivel. Gjeografia politike në rang global përbëhet nga:

- Sfera gjeostrategjike.
- Rajonet gjeopolitike.
- Brezat e përplasjes.¹

Dy ishin sferat gjeostrategjike pas Luftës së Dytë Botërore që dominuan sistemin global të sigurisë deri në rënien e Murit të Berlinit, SHBA plus Evropa Bregdetare dhe ish-Bashkimi Sovjetik, sot Federata Ruse. Ndryshimet e mëvonshme në rang botëror ishin ndryshime të mëdha rrënjësore, duke sjellë aktorë të rinj në këtë konkurrencë globale që vazhdon edhe në kohët që po kalon njerëzimi sot, ku Kina gëzon këtë status. Kina me energjinë dhe potencialin e saj, kryesisht ekonomik, kristalizon një realitet të ri të mjedisit të sigurisë globale, me një produkt të ri, siç mund të emërtohet si zona e tretë gjeostrategjike dhe përfundimisht këto zona aktualisht mund t'i përcaktojmë si më poshtë:

- Në aspektin e sigurisë, rajonet gjeopolitike rreth të cilave janë apo po lindin fuqitë rajonale siç mund të vlerësohen: Turqia, Irani, Afrika e Jugut etj.
- Kategoria e tretë, brezat e përplasjes, siç mund të konkretizojmë: rajonet e Ballkanit,

¹ Saul Bernard Kohen, *Geopolitics: The geography of international relations*; viti 2014, f.36-44.

Kaukazi, Lindja e Mesme, Rajoni i Afrikës Qendrore, Kashmirit etj.

Shtetet e ndryshme në kohë apo periudha të ndryshme zotërojnë potenciale të caktuara të fuqisë kombëtare, të cilat ndërvarën nga faktorë të ndryshëm e të shumtë me karakter historikë, gjeografikë, social-ekonomikë, ushtarakë, kulturorë etj. Këta faktorë të brendshëm apo të jashtëm, të ndërthurur me burimet njerëzore e natyrore që ato zotërojnë dhe efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të tyre në interes të cilësisë, vlerës dhe potencialit të fuqisë kombëtare kanë rëndësi jetike mbijetese, zhvillimi apo ndikimi të të tjerët. Mbi analizën e këtij produkti që quhet fuqi kombëtare, mund të klasifikojmë, përcaktojmë apo edhe renditim potencialin dhe influencën e shteteve të ndryshme në një periudhë të caktuar kohore, në raport me njëri-tjetrin e më gjerë, atë rajonal, apo global.

Renditja e shteteve në bazë të konceptit të fuqisë kombëtare dhe influencave të tyre në ambientin e sigurisë bëhet mbi vlerat e standardeve që përcaktojnë fuqinë kombëtare.

Fuqia kombëtare e një vendi është ndërthurja e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore e natyrore për zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor në fushën e diplomacisë, kapaciteteve ushtarake të një vendi dhe ndikimin e tij në zhvillimet e brendshme e të jashtme të vendit a rajonit ku shtrihet e më gjerë, në shkallë globale, për përmbushjen e objektivave strategjike dhe avancimin e interesave kombëtarë. Rrethanat specifike të çdo vendi, në një mënyrë apo tjetër, lidhen me një periudhë të veçantë kohore apo historike zhvillimi dhe marrëdhëniet me aktorët e tjerë globalë apo rajonalë. Fuqia kombëtare përbëhet nga disa elemente kryesore, të cilat mund të klasifikohen, si më poshtë vijon:

- Kapacitete diplomatike të afta, kualifikuese dhe proaktive.
- Fuqi ushtarake dhe gatishmëri për ta përdorur atë.
- Energji e tepërt ekonomike që i jep mundësi të akordoje ndihma dhe investime në vendet e tjera.
- Udhëheqje ideologjike që shërben si një model për t'u implementuar nga kombet e tjera.
- Një sistem të lidhur qeverisjeje.

Kapacitetet diplomatike sot marrin përparësi në evidentimin, parashtrimin dhe zgjidhjen e çështjeve të komplikuar dhe delikate me fqinjët në rang rajonal e më gjerë, pa pasur nevojë për përdorimin e kapaciteteve ushtarake apo instrumenteve të tjera të forcës. Në krahasim me të kaluarën ka një ndryshim në peshën specifike apo rolin e elementeve të fuqisë kombëtare dhe ushtrisë, në raport me elementet e tjera. Parë në këtë këndvështrim, kapacitet apo kërcënimi ushtarak sot është spostuar, duke i lënë hapësirë, por jo dhe aq të qartë, kapaciteteve diplomatike apo ekonomike.

Një diplomaci proaktive sot është arma më efektive për parandalimin e konflikteve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në një botë që gradualisht po kalon nga dominimi i një superfuqie, në një sistem fuqie policentriste, e karakterizuar nga ndryshimet e mëdha të natyrës së luftës, siç tani më dihen dhe janë vërtetuar jo në pak raste në terrenin konkret të aplikimit të saj. Në këtë sfond shohim dy vlerësime të kundërta që do të kenë edhe ndikimin e tyre specifik në zhvillimet jo vetëm në SHBA por edhe më gjerë e në nivel global. Në antitezë me qasjen proteksioniste të ish-presidentit amerikan Trump "Make America great again", "Ta bëjmë Amerikën të madhe përsëri", apo "America the first", "Amerika në plan

të parë”², u pa dukshëm qasja tjetër nga kandidati kundërshtar për president, Joe Biden, gjatë prezantimit të ekipit të tij të politikës së jashtme, ku ai theksoi se: “Jemi gati të ngremë zërin në mbështetje të vlerave tona...; këta individë mishërojnë bindjen time esenciale se Amerika është më e fortë kur punon me aleatet e saj. Në këtë mënyrë do ta mbajmë Amerikën vërtet të sigurt, pa u angazhuar në konflikte të armatosura të panevojshme dhe do të mbajmë nën kontroll kundërshtarët tanë si dhe terroristët...”³ Me këtë qasje të re shumëplanesh, qëllimi kryesor është të rikuperojë marrëdhëniet e Uashingtonit me aleatët kryesorë të saj, në veçanti me Bashkimin Evropian, si dhe të kërkojë rrugë e qasje të reja për çështje të tilla siç janë: ndryshimet klimaterike, qëndrimet ndaj institucioneve ndërkombëtare, marrëveshjet bërthamore me Iranin etj., me qëllim që SHBA-ja të kthehet në rolin e saj historik si udhëheqës global kudo në Paqësor, Atlantik dhe për pasojë në të gjithë globin.

Nga sa me sipër, mund të theksojmë se befasia, shpejtësia, dinamizmi dhe paqartësitë e ndryshimit të mjedisit të sigurisë edhe për vende kaq të rëndësishme e të fuqishme siç janë SHBA-të janë kaq të papritura sa askush nuk mund t’i parashikonte.

Për sa i përket fuqisë ushtarake dhe gatishmërisë për ta përdorur atë, sot ajo luan rolin parësor kryesisht në konfliktet e jashtme, por edhe në planifikimin, zhvillimin dhe ekzekutimin e operacioneve për të mbështetur paqen, në menaxhimin e luftës kundër terrorizmit, deri tek operacionet me sfond kibernetikë apo hapësinor. Si zona më të ndjeshme mund të vlerësojmë territore nga Afrika Qendrore, Lindore, vendet e Magrebit, Lindja e Mesme, deri në konfliktin në Ukrainën Lindore, i cili kohët e fundit po zhvillohet me një intensitet në rritje. Mjedisi i sigurisë ka specifika të reja në “menunë” e interesave kombëtarë, të cilët sot janë subjektet e ekspozuara ndaj kërcënimeve hapësinore, ndërhyrjes dhe intensifikimit me ato të natyrës kibernetike.

SHBA ka krijuar strukturë të re ushtarake, atë hapësinore, për t’u përballur me sfidat e ardhshme të ndryshimit të mjedisit të sigurisë globale. Edhe vendet e tjera po hulumtojnë për të krijuar mundësi të reja në këto drejtime, në çdo fushë apo nivel. Mbetet që këto kapacitete të vlerësohen, zhvillohen e të merren në konsideratë nga instrumentet e sigurisë në vend.

Kapacitetet ekonomike janë një element apo shtyllë e fuqisë kombëtare më evidente se sa të tjerat e veçmas, ushtrisë/forcave të armatosura, apo kapacitetet ushtarake. Kapacitetet ekonomike dhe mundësitë e investimeve dhe ndikimeve nëpërmjet tyre u paraprijnë të gjitha zhvillimeve të tjera sot, e veçmas nëpërmjet të ashtuquajturës diplomacia ekonomike.

Kapacitete apo potencialet ekonomike dominojnë përpjekjet e tjera për aksione gjeopolitike apo gjeostrategjike. Kjo është parë dukshëm dhe reflektohet pas krizave të mëdha siç ishte ajo financiare e viteve 2008, apo ajo më e rënda e vlerësuar që nga Lufta e Dytë Botërore që po kalon globi sot “Covid 19”, me efekte shëndetësore, financiare, ekonomike e sociale-psikologjike në të gjitha vendet, duke përfshirë të gjitha shtresat e shoqërisë me shumë pak

² *Presidenti Trump gjatë fushatës për zgjedhjet Presidenciale në SHBA.*

³ *Presidenti Biden gjatë prezantimit të ekipit të tij të politikës së jashtme. WDC, nëntor 2020.*

dallime. Në këtë periudhë shihet qartë mungesa e dëshirës dhe vullnetit e kushtëzuar nga burimet dhe kapacitetet ekonomike për ndërhyrje në menaxhimin e krizave apo me qëllime të tjera të diktuar nga influencat globale apo përkatësive ideologjike siç ndodhi edhe me qëndrimet e lidhshpimit amerikan ndaj OBSH-së. Kina nga ana tjetër mbajti të fshehtë informacionin për shpërthimin e epidemisë dhe pasojat që ajo solli.

Udhëheqja ideologjike vlerësohet si një element vendimtar i fuqisë kombëtare, teori kjo e aplikuar nga perëndimi, ku SHBA-ja vlerësohet si përfaqësuesja më domethënëse e saj. Ata krenohen me idetë e tyre që konstatojnë në një përzierje të parimeve të lirisë së shprehjes dhe ato fetare, të lidhura me të drejtat e njeriut, mbështetjen e sipërmarrjes së lirë dhe zbatimin e demokracisë në qeverisje, por përpos kësaj qasjeje edhe ajo ka pasur dritëhijet e veta. Predikimi i demokracisë nuk i ka penguar ata për një qëndrim mjaft pragmatist ndaj mbështetjes apo përmbytjes së regjimeve që jo gjithmonë shkojnë sipas shijes dhe idealeve të kësaj qasjeje.

Lidhja politike është një element tjetër i rëndësishëm në hierarkinë e fuqisë kombëtare. SHBA-të shprehin më dukshëm se uniteti i strategjisë së të dy partive të mëdha dominuese në vend ka luajtur rol vendimtar për udhëheqjen dhe zhvillimet globale. Ngërçi i kohëve të fundit gjatë presidencës Trump ka ndikuar dukshëm negativisht mbi këto vlera dhe aftësi. Nga ana tjetër, Kina apo Rusia, vendet një-partiake, kanë pasur avantazhe në disa politika më të shpejta apo zhdërvjellëta pasi diktohen nga ky tipar qeverisjeje. Megjithatë këtyre u kanë munguar kapacitete, sidomos ato ushtarake, për të shtrirë influencat apo rritur dominancën e tyre, veçanërisht në aspektin global.

Renditja e vendeve në rang global, në raport me fuqinë kombëtare që ato zotërojnë:

1. Shtetet e rendit të parë janë fuqitë kryesore që zotërojnë kapacitete dhe kanë ambicie për të shtrirë influencën e tyre përtej rajoneve gjeopolitike si dhe jashtë zonave gjeostrategjike të tyre. Këto karakteristika dalluese vlerësojnë këtë kategori ku bëjnë pjesë apo i përkasin: SHBA, Kinë, BE, Rusia, Japonia.
2. Fuqitë rajonale apo shtetet e rendit të dytë janë ato shtete që kapacitetet dhe ambiciet e tyre nuk kalojnë hapësirat gjeopolitike të rajonit ku shtrihen apo ndodhen. Në këtë kategori mund të vlerësojmë shtete si: Irani, Turqia, Australia, Afrika e Jugut.
3. Në rendin e tretë të fuqisë mund të vlerësohen ato shtete me kapacitete unike, ideologjike, kulturore për të influencuar mbi fqinjët e tyre, në këtë kategori vlerësojmë se bëjnë pjesë apo rreshtohen vende si: Kuba, Koreja e Veriut, Ukraina.
4. Në rendin e katërt të fuqisë mund të vlerësojmë ato shtete që nuk kanë kapacitete dhe aftësi për të ndikuar apo influencuar mbi fqinjët e tyre.
5. Në rendin e pestë të fuqisë mund të vlerësojmë shtete, të cilat nuk zotërojnë kapacitete të mjaftueshme për mbijetesë dhe mbështetjen për këtë qëllim tek aktorët apo shtete të tjera. Është disi e diskutueshme kush përfshihet në këtë kategori por më tepër këtu vlerësojmë shtetet e reja apo ato që nuk kanë fituar ende njohjen nga organizmat ndërkombëtarë e kryesisht nga OKB-ja.

Ky rend hierarkik nuk është i dhënë apo paracaktuar njëherë e përgjithmonë pasi ai ka pësuar ndryshime të vazhdueshme në kushte e rrethana të ndryshme nga ku ka kaluar

shoqëria njerëzore apo sistemi politik botëror. Kështu shtete të tilla si, Brazili dhe India vlerësohen si shtete që janë në një fazë tranzitore apo kalimtare nga rendi i dytë drejt rendit të parë të fuqisë, pra në ngjitje të vazhdueshme, por kemi vende si Venezuela, Nigeria që për shkaqe të krizave të brendshme e sidomos atyre ekonomike, konflikteve të ndryshme kanë humbur renditjen në këtë hierarki.

Aktualisht, po flitet shumë për ndryshime të thella në sjelljen botërore të fuqive të niveleve apo rretheteve të ndryshme gjatë dhe pas pandemisë që ka mbërthyer globin “Covid 19”, por duhet t’ia lëmë kohës në perspektive për ta vërtetuar atë. Megjithatë gjasat dhe arsyet janë të shumta për ndryshime, transformime apo përshtatje të këtij rendi i cili ka disa shkaqe kryesore që ndikojnë në këtë trend, ku nga më kryesoret mund të theksojmë:

- Ekonomike.
- Akumulimet negative si shkak i mungesës së kohezionit për përballje globale apo ndihmën ndaj rajoneve më të goditura.
- Ngjallje e forcave nacionaliste për t’u tërhequr më shumë në çështjet e brendshme apo të natyrës kombëtare.
- Tkurrje të interesave të huaja drejt vendeve apo rajoneve të veçanta nga fuqitë dominuese.
- Tërheqje e kapitaleve apo bonove të thesarit.
- Zbeheje apo dobësim të interesit dhe pranisë së organizatave në rang global apo rajonal.

Sidoqoftë kjo periudhë do të ballafaqohet me luhata dhe përplasje të fuqive të mëdha, atyre që mund t’i vlerësojmë në tranzicion dhe të fuqive rajonale, për përcaktimin e:

- a. interesave të sigurisë kombëtare,
- b. strategjisë ekonomike,
- c. objektivave ideologjikë,
- d. aleancave të reja apo qëndrimeve për largimin prej tyre, si p.sh., rasti “Brexit”.

Për sa theksuam më lart, ekonomia, ideologjia, gjeografia, demografia, mjedisi natyror, ngrohja globale etj. kanë ndikime të thella gjeopolitike. Nëse i referohemi vetëm kësaj të fundit, pra ngrohjes globale mund të shohim se sa dramatike mund të jetë ndikimi i saj në problemet jetësore të njerëzimit në të ardhmen, nëse ruhet ky trend, Deti i Ngrirë i Veriut mund të kthehet në një rrugëkalim të zakonshëm duke krijuar rrugë të reja tregtare ushtarake, apo për qëllime të tjera, duke rritur ambicinet dhe përplasjet mes fuqive dominuese për hapësira me ndikim në zhvillimet strategjike. Nga ana tjetër, ndryshime të tilla mund të çojnë në migrime masive, duke shkaktuar njëkohësisht katastrofa të mbivendosura humanitare shëndetësore dhe mjedisore. Të imagjinojmë për një moment që Momby të shpërngulej drejt Evropës si pasojë e shkakut të asaj çfarë theksuam më latë pra të ndryshimeve klimaterike dhe gjeografisë nga ngrohja globale. Në këtë aspekt mund të sjellim shembuj të pafund që do të mund të ndikojnë në një rend të ri botëror.

Megjithatë, si përfundim mund të vlerësojmë se perspektiva gjeopolitike është dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Dinamizmi gjeopolitik më së shumti është dominuar në këto dekadat e fundit nga zhvillimi i burimeve të jashtme masive të prodhimit industrial

kinez, sidomos në brigjet e saj jugore e qendrore të ashtuquajtura “Bregu i saj i artë”⁴, i shoqëruar nga një teknologji e lartë e kushtëzuar deri diku për t’u hapur ndaj botës. Nga ana tjetër ka pasur edhe modelim të politikave amerikano-evropiane-japoneze e me gjerë ndaj Kinës, sidomos për kufizimin e shtrirjes së dominimit në Detin e Kinës Lindore dhe Jugore e me gjerë në këtë rajon. Për sa më sipër, duke shtuar këtu edhe luftën mes Evropës dhe Rosisë për dominim të Ukrainës, lufta ndaj ISIS, deri diku dështimi i pranverës arabe kanë “sabotuar” planin e ri amerikan, për “Boshtin e tij aziatik”⁵, që parashikonte zvogëlim trupash në Evropë, pakësim të rolit të saj në Lindjen e Mesme dhe të përqendrohej te mbështetja e lirisë së transportit detar në ujërat midis Kinës dhe brezit të Azi – Paqësorit (Japoni, Australi, K. e Jugut, Filipine). Duke dhënë impulse gjallërimi politikave të fuqisë së butë, siç shprehet Joseph Ney, themeluesi i teorisë liberale: “Fuqia e butë e lidhur me ndërvarësinë ekonomike, raportet me aktorët ndërshtetërorë dhe ndërveprimi në çështjet ndërkombëtare në kornizën e veprimeve të sinkronizuara pa shkurajuar fuqinë ushtarake, mbetet e vetmja rrugë mbijetese dhe sukcesi”.⁶ Kjo mund të vlerësohet shumë aktuale edhe për vendet tona të papërfillshme në tregun e madh global, por që ka etje për të penetruar e përfituar sa më shumë nga konjunkturat dhe mundësitë e afrimit apo përshtatjes në këto dallgëzime të vazhdueshëm të një ambienti sigurie në lëvizje dhe transformim të përhershëm.

Renditja apo rendi hierarkik i fuqisë kombëtare tashmë po ballafaqohet me qëndrime, analiza, deduksione apo vlerësime se do të jetë shekulli kinez, apo SHBA do të vazhdojë të ruajë influencën e saj globale. Këtij problemi deri diku i dha përgjigje në një nga daljet e fundit të tij, Presidentit Joe Biden, para se të merrte detyrën ku theksoi se: “...edhe ky shekull do të jetë shekulli amerikan”.⁷

Në këtë gjetje u theksua se pandemia ka goditur rendin ekonomik ndërkombëtar, ka luhatur mjaft bashkëpunimin në këto nivele duke evidentuar e nxjerrë gjithnjë e më shumë në pah pamundësinë dhe fuqinë jo të mjaftueshme për t’u përballur në mënyrë adekuate e të qenësishme me pandeminë, ndryshimet klimaterike, duke rritur papunësinë, varfërinë e thelluar më tej, polarizimin e shoqërisë njerëzore.

Gjithashtu, në analizën e bërë nga Global Trends 2040, SHBA, të pasqyruar te Shqiptarja.com më dt. 09.04.2021, zbulimi amerikan paralajmëron për sfida madhore për botën në 20 vitet e ardhshme, theksohet se: “Këto sfida do të vënë në provë në mënyrë të vazhdueshme aftësitë e rimëkëmbjes dhe përshtatjes së komuniteteve, shteteve dhe sistemit ndërkombëtar, shpesh duke e tejkaluar kapacitetin e sistemeve dhe modeleve ekzistuese”, paralajmëron raportin, duke shtuar se disa nga zhvillimet mund të jenë katastrofike.

“Rivaliteti mes Shteteve të Bashkuara dhe Kinës ka gjasa të përcaktojë parametrat e gjera të ambientit gjeopolitik në dekadat e ardhshme, duke u imponuar aktorëve të tjerë

⁴ Saul Bernard Kohen, *Geopolitics: the geography of international relations*, viti 2014, f.104.

⁵ *Po aty*, f.139.

⁶ Joseph Ney, *The Future of Power*. New York: Public Affairs, 2011, f. 85.

⁷ Joe Biden, *Fjala e rastit në ceremoninë e marrjes detyrës*, Janar, 2021.

⁸ *Global Trend 2040. Zbulimi amerikan. Shqiptarja.com 09.04.2021*

zgjedhje të vështira”,⁹ thuhet në raport.

Në skenarin më optimist, analistët e zbulimit parashikojnë epërsi për Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre demokratë pjesërisht, sepse kundërshtarë si Kina dhe Rusia dobësohen nga kontrolli në shoqëri që ka paralizuar novacionin.

E ashtuquajtura “Rilindje e Demokracive” nënkupton një Perëndim që përparon falë teknologjisë së avancuar, rritjes ekonomike dhe shtimit të të ardhurave, që zbusin tensionet shoqërore.

4. Përfundime

1. Bota në nivel global duhet të orientohet nga bashkëpunimi dhe ndërveprimi për një përfaqje gjithëpërfshirëse për t’u dhënë zgjidhje problemeve që lidhen me ngrohjen globale pra ndryshimet klimaterike në tërësi, përpalljes me katastrofat natyrore, terrorizmit, varfërisë shpërndarjes më të balancuar të burimeve jetësore dhe të ardhurave, ato shëndetësore si dhe zgjidhjen e konflikteve mbi bazën e dialogut dhe mirëkuptimit reciprok.
2. Në planin rajonal, të rritet bashkëpunimi i të gjithë aktorëve shtetërorë e privatë për t’u përballur me sfidat që vijnë kryesisht nga aktorët e tjerë me ndikim, duke pasur parasysh presionet ekonomike pas “Sars 2, COVID-19”. Mënyra e vetme se si mund të realizohet një mbrojtje me të vërtetë evropiane do të ishte përmes një mbrojtjeje të integruar evropiane të udhëhequr nga BE dhe një partneriteti radikal evropian strategjik i sektorit publik-privat që të shfrytëzojë siç duhet revolucionin teknologjik në të gjithë spektrin e tij.
3. Në planin kombëtar, të avancohet në rrugën e anëtarësimit evropian, në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve shtetërore në bashkëveprim me aktorë të tjerë joshtetërorë e privatë për zhvillimin e vendit dhe ndryshimet rrënjësore të përfaqjes ndaj shtetit ligjor, duke mundësuar rritjen e shpejtë të mirëqenies së gjithë shtresave të shoqërisë, duke kthyer vendin në një aset të çmuar dhe kontribuues të një mjedisi të sigurt për veten dhe rajonin.

Bibliografia:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2014.
- Christopher Stevens dhe Jane Kennan në parathënien e librit “Reform in Eastern Europe and the Development Country Dimension”, Overseas Development Institute, 1992, ISBN 0850031818
- Global Trend 2040. Zbulimi amerikan. Shqiptarja.com 09.04.2021
- Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg “Raisina Dialog”, prill 2021.
- Saul Bernard Kohen, Geopolitics: “The geography of international relations”. Shtëpia botuese Rowman & Littlefield Publishers, edicioni 3, viti 2014, ISBN978-1442223493

⁹ Po aty.

- Yuval Noa Harari “21 Lessons for the 21-st Century”, Shtëpia botuese Vintage books, viti 2019 ISBN: 9781784708283.
- Johan R Allen; Frederik Ben Hodges and Julian Linden “ Future war and the defence of Europe”, 8 tetor 2020
- Thomas L. Friedman, “Hot, Flat and Crowded”, 1st edition, *Farrar, Straus and Giroux*, 2008, *ISBN 978-0-374-16685-4* and 2nd edition viti 2009.
- Joseph Ney, *The Future of Power*. New York: Public Affairs, 2011.
- Konferencat për sigurinë, Mynih 13.02.2020; 19.02.2021.
- Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Mars 2021.
- Presidenti SHBA, Joe Biden, fjala përshëndetëse me rastin e përmbylljes së fushatës për zgjedhjet presidenciale të SHBA-së , Nëntor 2020.
- Gani Mehmeti në “Dardania Press Janar 2021”
- Shaban Murati, “Ne, Rusia dhe NATO”, shkrim i botuar më 7 prill 2021, gazeta Dita.
- Presidenti George W. Bush, letër dërguar Presidentit të Serbisë, 25 dhjetor 1992.
- Ramush Hajradinaj, fjala përshëndetëse me rastin e përvjetorin të çlirimit të Kosovës 17.02.2020.

NDIKIMI I PANDEMISË NË SIGURINË KOMBËTARE

Drejtues i Lartë, Dr. Bilbil Memaj
Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Vështirë se do të ketë një kërcënim tjetër në gjysmëshekullin e fundit, krahasuar me pandeminë Covid-19, i cili të ketë pasur kaq ndikim në mbarëvajtjen dhe sigurinë e jetës së gjithë globit. Termi “pandemi” përdoret kur kemi të bëjmë me epidemi të cilat kapërcejnë kufijtë ndërkombëtarë, duke infektuar popullsitë e mbarë botës dhe shkaktuar një rrezikshmëri botërore të nivelit sipëror. Pavarësisht se në momentin që flasim kjo pandemi njihet me emrin “Covid-19”, në të shkuarën pandemi të tilla kanë pasur emra të ndryshëm dhe në të ardhmen mund të kenë të tjerë. Për këtë arsye, në titullin e shkrimit nuk është përmendur një emër specifik pandemie por është trajtuar koncepti. Pyetja kryesore është: “A ka lidhje një pandemi me sigurinë kombëtare?” Nisur nga kjo pyetje, në këtë material shtjellohet korniza e madhe e sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, duke sjellë argumente se pandemi të tilla si Covid-19 kanë lidhje me sigurinë kombëtare. Këto vëzhgime synojnë që në të ardhmen të kryhet një reflektim më i gjerë për sa i përket kërcënimeve që lidhen me sigurinë kombëtare dhe masave që duhen marrë kundrejt tyre.

Fjalë kyçe: pandemi, siguri kombëtare, Covid-19, kërcënim

1. Hyrje

Në historinë e saj, shoqëria njerëzore nuk ka qenë e goditur në mënyrë të tillë gjithëplanetare dhe me një kërcënim vrastar se sa pandemia Covid-19. Pandemitë e ndodhura në të kaluarën kanë përfshirë disa rajone në disa zona të caktuara të botës, ndërsa kjo pandemi ka gllabëruar gjithë globin, madje duke prekur dhe majën më të lartë të botës, Everestin në Himalajë, Antarktidën dhe deri në Arktik. Të tilla goditje pandemike përkundër atyre të armatosura kanë shumë veçori, pasi ato nuk kanë vija fronti, as armë konvencionale, as ushtri, as bombardues me avion apo dronë inteligjentë: ajo është një luftë e padukshme, mikroskopike është si një variant i luftës bakteriologjike/biologjike. Ndërsa armët biologjike janë projektuar që të përdoren si opSION i fundit në një territor ose vend të caktuar perimetri i të cilit nuk i kalon disa km², sepse në të kundërt ato do të shkatërronin edhe forcat sulmuese dhe popullsinë civile, pandemia koronavirus/ ka rreze veprimi gjithëplanetare të paparashikueshme për njerëzimin.

Pandemia shkaktoi shok strategjik shumëdimensional planetar duke prekur dhe shkaktuar *lock down* total kudo në hapësirat tokësore, ajrore dhe detare, gjë që nuk ishte dëgjuar apo ndodhur më parë. Dihet se pandemitë janë një fenomen shekullor që shpesh ka ndryshuar rrjedhën e historisë dhe jetës njerëzore duke shkaktuar drama dhe fatkeqësi shumë të mëdha në disa periudha. Goditjet pandemike kanë treguar se përveç vuajtjeve e humbjeve të jetëve njerëzore ato krijojnë panik të madh, terror, pasiguri, shkaktojnë kolaps financiar, rrisin presionet sociale dhe mund të pengojnë zhvillimin në komunitetet e prekura e më gjerë.

2. Pse kriza e pandemisë është kërcënim për sigurinë kombëtare

Kur ne studiojmë konceptin e sigurisë kombëtare, shpeshherë nisemi nga vlerësimi i kërcënimeve që pëson kjo siguri, të cilat janë të ndryshme dhe me një spektër të gjerë, ku përfshihen shumë fusha jetike të çdo vendi, duke përfshirë dhe goditjet pandemike. Sipas konceptit teorik, çdo gjë që kërcënon jetën, shëndetin dhe mirëqenien fizike të popullsisë apo rrezikon stabilitetin e ekonomisë ose institucioneve të një kombi konsiderohet si një kërcënim i sigurisë kombëtare¹.

Nisur nga ky vlerësim dhe nga ky qëndrim mund të shprehemi tashmë të sigurt se kriza e pandemisë COVID-19, përbën jo vetëm kërcënim, por rrezik të konsiderueshëm për shëndetin publik dhe për ekonominë e vendit; gjithashtu përmasat e saj për nga mënyra se si

¹ Joseph Romm, *Defining National Security: The Nonmilitary Aspects* (New York: Council on Foreign Relations, 1993), p.1-3.

shfaqet ose se si nuk shfaqet, paraqet rreziqe thelbësore për sigurinë kombëtare. Si për çdo dukuri tjetër pikësëpari është njohja e burimit të rrezikut dhe pastaj menaxhimi i rreziqeve për të ulur në maksimum pasojat. Mos menaxhimi si duhet mund të çojë në dëmtimin e sigurisë kombëtare me shumë pasoja ndaj kërkohen masa të efektshme gjithëpërfshirëse.

Një pandemi si kjo e COVID-19, paraqet një kërcënim ekzistencial për sigurinë njerëzore dhe nisur nga efekti, edhe për sigurinë kombëtare. Pandemitë nuk shkaktojnë vetëm një rritje të nivelit të vdekshmërisë, por gjithashtu ndikojnë negativisht në indet ekonomike, sociale dhe politike të një vendi. Për shkak të hiperglobalizimit dhe ndërlihdjes në rritje, sëmundjet infektive tani përhapen në të gjithë botën më shpejt, duke mos njohur kufij dhe duke u bërë kërcënime shumë më serioze².

Në këtë qasje, pandemia COVID-19 kërcënon direkt jetën dhe mirëqenien fizike të popullsisë dhe si e tillë është shkaktare e humbjeve, dramave dhe vuajtjeve të qindra mijëra jetëve njerëzore te planetit, duke sjellë implikime të mëdha edhe në sigurinë kombëtare. Askush më parë nuk mund ta imagjinonte fuqinë kërcënuese dhe goditëse ndaj sigurisë kombëtare, të pandemisë së koronavirusit, krahasuar me kërcënimet e tjera të listuara në strategjitë e sigurisë së çdo shteti, përfshi edhe vendin tonë.

Pandemia solli një përmbysje të piramidës së prirjeve të sigurisë kombëtare dhe globale. Sipas vlerësimeve të institucioneve globale të sigurisë, pandemia COVID-19 kaloi në kryelistën e 10 prirjeve kryesore të kërcënimeve ndaj shëndetit me të cilën po përballlet sot njerëzimi³. Kjo pandemi për shkak të shkallës së lartë të humbjeve njerëzore, agresivitetit, virulencës së transmetimit dhe pamundësisë për të ndaluar përhapjen e saj, sjelljes së panjohur etj., është bërë burimi i një ankthi të madh pasigurie dhe frike të pashembullt që nga Lufta e Dytë Botërore.

Pak kohë më parë ka pasur një debat të konsiderueshëm për lidhjen midis pandemisë dhe sigurisë kombëtare. Disa akademikë dhe teoricienë politikë janë shprehur me forcë për të hedhur poshtë rëndësinë dhe vlefshmërinë e lidhjeve dalluese midis pandemisë dhe sigurisë së shteteve. Deri atëherë ishte argumentuar se nuk ekziston asnjë provë për të përcaktuar faktin se prania e virusit apo e epidemive në çdo shoqëri të caktuar është drejtpërdrejt përgjegjëse për një ngjarje që rrezikon stabilitetin, sigurinë kombëtare, kapacitetin ose qëndrueshmërinë e shtetit etj.

Vështruar në kontekstin e tanishëm faktet dhe analizat e shumta dëshmojnë se ekziston një lidhje kritike midis pandemisë COVID-19 dhe sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Sipas të dhënave të fundit koronavirus ka prekur mbi 200 vende duke infektuar 200 milionë njerëz dhe duke vrarë mbi 4 milionë njerëz, kjo gjendje na bënë ta shqyrtojmë situatën kërcënuese jo vetëm nga pikëpamja shëndetësore, ose mjekësore, por nga një perspektivë më e gjerë e sigurisë kombëtare⁴.

² Leslie Pray, Stanley Lemon, Adel Mahmoud, Stacey Knobler, red., *The Impact of Globalization on Infectious Disease Emergence and Control* (Washington: US National Academies Press, 2006), 21.

³ Kamaljeet Sandhu, red., *Handbook of Research on Advancing Cybersecurity for Digital Transformation* (Pennsylvania: IGI Global, 2021), 334-335.

⁴ WHO Coronavirus (COVID-19) Dashboard. Sipas të dhënave të rifreskuara në korrik 2021. Burimi elektronik: <https://covid19.who.int/table>

Tradicionalisht, siguria kombëtare është përcaktuar ngushtë si mbrojtja e shtetit nga kërcënimet fizike, ndërsa dekadat e fundit është dëshmuar një rritje e mprehtë e kërcënimeve jotradicionale, të tilla si terrorizmi, ekstremizmi i krahut të majtë, ekstremizmi i krahut të djathtë, trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, migrimi, spastrimi etnik dhe sëmundja. Me shumë vend mund të shprehemi se sëmundjet që shfaqen dhe rishfaqen, potenciali i tyre pandemik, paraqesin një sfidë për sigurinë kombëtare në shekullin 21, e cila nuk mund të injorohet.

Pandemia e koronavirusit, por edhe pandemitë e tjera tradicionale po lënë gropa të zeza në shoqëri duke u bërë kërcënim shumë, shumë serioz për sigurinë njerëzore. Përveç emergjencës shëndetësore, pandemia COVID-19, na demonstroi implikime të gjera dhe shumëdimensionale në jetën komunitare pasi shoqërohet me një spektër të gjerë krizash, si ajo ekonomike, sociale, financiare dhe potencialisht bëhet një katalizator pararendës i paqëndrueshmërisë politike dhe sigurisë kombëtare. Pandemia globale e koronavirusit paraqet sfidën e një strategjie të re brenda fushave politike, ushtarake, ekonomike, sociale, infrastrukturës, informacionit dhe inteligjencës së shtetit.

Pandemia është një makinë vrasëse mikroskopike që nuk mund të mposhtet ose kufizohet me masa dhe mjete tradicionale pasi nuk është racionale; ajo kërkon goditje specifike shumë dimensionale dhe mjete të dedikuara. Njerëzimi duhet ta fitojë këtë luftë me kosto sa më minimale. Karakteristike është se pandemia ka shtuar rreziqet në jetën e individëve dhe komuniteteve të tyre, si dhe ka frenuar veprimtaritë publike dhe ato të bizneseve. Impakti i kësaj krize është shumë kompleks dhe tepër më i fuqishëm se çdo lloj tjetër goditjeje pasi nuk përfshin vetëm një rajon, vend apo disa vende, por gjithë globin, me kohëzgjatje të papërcaktuar, shkakton miliona viktima njerëzore, frikë, kërcënim, terror psikologjik, kolaps shëndetësor, ekonomik, financiar, mungesë furnizimesh etj.

Kriza të tilla pandemike me këto përmasa na treguan se janë rrezik për rendin juridik, godit dhe dobëson institucionet e sigurisë, nxit kaosin, pasigurinë në komunitet, krimin e organizuar dhe atë kibernetik etj.⁵

Për këtë situatë OBSH-ja konfirmon se siguria njerëzore globale sot është më e kërcënuar se asnjëherë tjetër, nga kriza shëndetësore pandemike. Koronavirusi kërcënon jo vetëm shëndetin njerëzor por edhe paqen dhe stabilitetin e një vendi, rajoni apo të mbarë globit. Pandemia ka potencial për të rritur trazirat sociale dhe dhunën, e cila do të dëmtonte shumë aftësinë e vendeve për të menaxhuar dhe luftuar sëmundjen pandemike. Nga ana tjetër, pandemia rrit mundësinë e goditjeve terroriste, rënien e besimit ndaj institucioneve publike, pastabilitet ekonomik, tensione politike, nxitjen e konflikteve, mashtrime kibernetike, rrit sfidat ndaj disa të drejtave të njeriut, dhunën në familje etj.⁶

Përveç sfidave të drejtpërdrejta ndaj ekonomisë, pandemitë gjithashtu kanë potencialin

⁵ Cornelia Riehle, "Europol: How COVID-19 Shapes Serious and Organised Crime Landscape in the EU", *Eucrim*, 12 July, 2020.

⁶ EUROPOL, *Pandemic profiteering how criminals exploit the COVID-19 crisis*, (Hague, NL: European Union Agency for Law Enforcement Cooperation 2020, March 2020). Burimi elektronik: www.europol.europa.eu/sites/default/files/documents/pandemic_profiteering-how_criminals_exploit_the_covid-19_crisis.pdf

të shkaktojnë paqëndrueshmëri politike. Në rastet kur qeveritë kanë dështuar të sigurojnë kujdesin e nevojshëm publik dhe kanë performuar dobët në përgjithësi, një erozion i besimit në sistemin politik fillon të zërë rrënjë. Pamundësia e qeverive, veçanërisht në vendet e zhvilluara, për të reaguar me shpejtësi në fazën fillestare të një pandemie vetëm përkeqëson ndjenjën e pasigurisë të njerëzve. Paqëndrueshmërisë politike është shumë më e lartë në shtetet e dobëta që nuk kanë struktura të forta administrative dhe infrastruktura të shëndetit publik. Nëse situata del nga kontrolli, disa shtete mund të dështojnë.

Ndërkohë, në nivelin politik dhe të sigurisë globale, COVID-19 ka vendosur një stres shtesë në marrëdhëniet ndërkombëtare, veçanërisht ato që ishin tashmë të tensionuara para goditjes pandemike, të tilla si marrëdhëniet SHBA-Kinë. Vendet afrikane janë veçanërisht shqetësues pasi sistemet e tyre joadekuate të shëndetit publik mund të çojnë në trazira publike. Për më tepër, sëmundjet infektive mund të paraqesin gjithashtu një sfidë për fuqinë ushtarake të një vendi. Pandemitë mund të minojnë fuqinë ushtarake duke shkakuar humbje jete në radhët e figurave ushtarake si dhe në trupën e ushtrisë. Ata mund të pengojnë përkohësisht operacionet ushtarake për shkak të masave të karantinës. Për shembull, Kanada ndaloi lëvizjen e personelit të saj ushtarak jashtë vendit dhe SHBA-ja ndaloi stërvitjet e saj ushtarake në një përpjekje për të frenuar përhapjen e COVID-19. Në mënyrë të ngjashme, marina amerikane evakuoi shumicën e ekuipazhit të saj në bordin e aeroplanmbajtësit *USS Theodore Roosevelt* më 31 mars 2020 pasi mbi një mijë detarë u testuan pozitivisht.

Situata e këtyre krizave kërkon një qasje tjetër të veprimtarisë së forcave të armatosura duke u orientuar në përgjigje sa më me efikasitet, dhe duke hartuar politike të reja të angazhimit ushtarak. Deri më tani mund të themi se roli ushtrisë në përgjigjen ndaj krizës së COVID-19 është matur.

Ndërkohë që shqetësime të mëparshme sa i takon zbatimin të karantinave të detyrueshme apo rendit ushtarak janë venitur, në shumicën e SHBA-së pati trazira që lidheshin me vdekjen e George Floyd, çka e forcoi pikëpyetjen e rolit të ushtrisë në operacionet e brendshme, ende si një pjesë e vetëdijes publike. Normat themeltare kushtetuese si dhe koncepte historike mbi kontrollin civil mbi ushtrinë kanë qenë predominante deri më tani. Megjithatë, kriza e tanishme përfaqëson një mundësi për të riekzaminuar ligjet, politikat dhe rregullat të cilat qeverisin operacionet e brendshme ushtarake, duke na lejuar, – ose detyruar, – që të rikonfigurojmë rolin e ushtrisë në punët e brendshme të shtetit⁷.

Gjendja që krijoi pandemia gjithashtu mund të krijojë një mjedis të përshtatshëm nga i cili mund të përfitojnë grupet terroriste në dëm të rendit kushtetues të një vendi. Është momenti kur qeveritë janë të zëna me trajtimin e pandemisë, dhe këto grupe mund të përfitojnë nga situata e re për të çuar përpara objektivat e tyre të kriminale.

Ekziston një anë tjetër e medaljes: sigurimi nga pandemia i mundëson qeverive të marrin masa të jashtëzakonshme, deri në bllokim total. Po kështu, qytetarët duhet të tregojnë gatishmëri të heqin dorë përkohësisht nga liritë e tyre civile në këmbim të mbrojtjes dhe sigurisë. Sidoqoftë, ekziston një rrezik që shfaqet kur këto politika normalizohen

⁷ Mark Nevitt, "Domestic Military Operations and the Coronavirus Pandemic", *Journal of National Security Law and Policy*, Vol. 11, (Issue 1, 2020): 107, 129.

edhe pas eliminimit të kërcënimit. Drejtuesit dhe autoritetet mund ta shfrytëzojnë këtë situatë në mënyrë që të rrisin kontrollin e tyre të pushtetit ndaj popullsisë. Legjislacioni i koronavirusit të Hungarisë, i cili ka lejuar presidentin të qeverisë me dekret dhe ka hapur rrugën për një gjendje të jashtëzakonshme të pacaktuar, ka ngritur dyshime për drejtimin e ardhshëm të vendit. Për më tepër, praktikat demokratike mund të kufizohen. Shumë vende në të gjithë botën kanë shtyrë zgjedhjet kombëtare dhe lokale, dhe tubimet dhe protestat e mëdha janë të ndaluara⁸.

Përcaktimi i pandemive si një kërcënim i sigurisë kombëtare dhe globale mund të rrisë mundësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ndërsa pandemitë janë, nga përkufizimi, një sfidë globale dhe sjellin një përgjigje kolektive, qeveritë dhe agjencitë e sigurisë do të jenë shumë më të përfshira në luftën globale dhe të bashkëpunojnë me kolegët e tyre nga vendet e tjera. Mungesa e solidaritetit midis vendeve anëtare të BE-së, veçanërisht gjatë fazave të hershme të pandemisë ka demonstruar efektet e pafavorshme të qasjes “kombi i pari”⁹.

Prandaj, mirëqenia e qytetarëve, cilësia e jetës dhe prosperiteti ekonomik duhet të jenë të gjitha pjesë e agjendës së sigurisë kombëtare. Për këtë, duhet të miratohen strategji të reja dhe të përshtatshme. Një mendim i tillë i ri, i kombinuar me burime të rritura, gatishmëri publike, kërkime shkencore dhe bashkëpunim ndërkombëtar janë të një rëndësie të madhe për të dalë në pah një paradigme më e plotë dhe efikase e sigurisë kombëtare.

Fuqia kombëtare e një vendi mbështetet në zinxhirët e furnizimit tregtar, ekonomik, pajisjet mjekësore, teknologjike etj., – globalisht të efektshëm dhe të ndërthurur mes tyre. Këta zinxhirë furnizimi janë shumë të ndërlidhur dhe janë jetik në situata krize të sigurisë, duke sjellë përfitime dhe dobësi. Ndjeshmëria e zinxhirit të furnizimit shtrihet në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe është një çështje e sigurisë kombëtare në këtë kuptim: një grup interesash që nëse prishen mund të ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe mirëqenien e shteteve. Përgjigja ndaj COVID-19 ishte një shembull i një krize, të zinxhirit të furnizimit të pajisjeve mjekësore dhe infrastrukturës mbështetëse që nuk përfshinte aspak aktorë malinj; thjesht një sëmundje që ndikoi në zinxhirët e furnizimit në të gjithë botën, në mënyra të shumfishta¹⁰. Situata të tilla krijojnë probleme me mosgjatjen e një ekuilibri midis masave drastike për mbrojtjen nga pandemia dhe abuzimit me të drejtat e njeriut.

Për të qenë sa më të qartë, pushteti i shtetit nuk është absolut. Karantinat si dhe izolimi i detyrueshëm i individëve, për shembull, janë kryesisht të lejueshme vetëm në rast se zyrtarët e shtetit kanë arsye për të besuar se individët e caktuar janë ekspozuar ndaj sëmundjeve infektive, dhe si rrjedhojë vendimi për të karantinuar dhe izoluar personat, është subjekt i procesit të rregullt të ankimimit. Ndërkohë, masat emergjente për mbrojtjen e shëndetit publik, të cilat vendosin limitime ndaj lirive individuale, - siç janë liria e mbledhjes, liria e

⁸ Sarah Repucci, Amy Slipowitz, “The Impact of COVID-19 on the Global Struggle for Freedom”, *Special Report 2020, Democracy under Lockdown* (Freedomhouse, 2020).

Burimi elektronik: <https://freedomhouse.org/report/special-report/2020/democracy-under-lockdown>

⁹ European Foreign Policy in times of COVID-19.

¹⁰ Marc Helmold, Matthias Einmahl, Klaus Rassmann, red., *Lessons from the Covid-19 Situation: Rethinking Global Supply Chain Networks and Strengthening Supply Management in Public Procurement in Germany* (Erfurt, Germany: IUBH Internationale Hochschule, 2020).

udhëtimit dhe liria e praktikimit të riteve fetare, - kanë hasur rezistencë të fortë ligjore, por, gjykatat, duke përfshirë Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i kanë lehtësuar në mënyrë domethënëse zyrtarët shtetërorë lidhur me interpretimin mjaft të gjerë e veprimeve të pranueshme për të trajtuar rreziqet e shëndetit publik. Nuk ka asnjë dyshim që autoritetet shtetërore, vendore, si dhe fisnore, kanë të drejta të plota për të marrë masa agresive për të mbrojtur shëndetin publik¹¹.

Nga ana tjetër, implikimet shumëdimensionale të pandemisë COVID-19 kanë ripërcaktuar vijat e frontit të sigurisë kombëtare. Në këtë perspektivë shumica e vendeve të botës janë detyruar të ridrejtojnë burimet financiare për të investuar në sektorë jetikë siç janë shërbimet shëndetësore, shtimin e ndërtesave apo hapësirave për trajtimin e te sëmurëve, fondet për aparaturat e ventilimit, flotën e urgjencës, pajisjet mbrojtëse, sigurinë kibernetike dhe sektorë të tjerë¹². Për shkak të bllokimeve të qeverisë njerëzit nuk janë më të lirë të lëvizin ose hyjnë në hapësira publike ose fizike dhe përkundrazi janë të kufizuar në hapësira në internet. Kjo vlen për sektorët privatë dhe publik, duke përfshirë institucionet e sigurisë të tilla si ushtria, policia dhe shërbimet e inteligjencës.

3. Si ndikon pandemia në sigurinë ndërkombëtare dhe globale

Në teorinë e strategjisë së sigurisë, ekziston një korrelacion midis sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare e globale. Kjo do të thotë që çdo ndryshim i elementeve kritikë të sigurisë në një vendi ose të disa vendeve apo rajoni kanë ndikim në situatën e sigurisë në nivel ndërkombëtar ose global. Kjo po ndodh për shumë faktor por më me ndikim ka qenë dy faktorë: zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë dhe globalizimi të cilët ka bërë që bota të duket më e “vogël”. Në këtë arsyetim, kriza e pandemisë së kornavirusit jo vetëm që do të ndikojë në sigurinë kombëtare të vendeve, por gjithashtu do të ketë degëzime të rëndësishme për sigurinë ndërkombëtare apo globale.

Pandemia COVID-19 ndryshoi gjendjen aktuale të kujdesit shëndetësor, veçanërisht në drejtim të riorganizimit të burimeve. Ankesat kryesore të pacientëve të pranuar në spitale nëpër botë, ndryshuan në mënyrë drastike në muajt në vazhdim, gjë që përkeqësoi trajtimin e shumë situatave akute dhe kronike (të cilat përfshinin patologjitë e sistemit kardiovaskular), dhe burimet u zhvendosën tjetërkund, në mënyrë që të luftonin COVID-19. Për më tepër, pandemia kishte efekte afatgjata jo vetëm në kujdesin shëndetësor, por edhe në sigurinë kombëtare në shkallë globale. COVID-19 ndryshoi në mënyrë drastike perceptimin e shëndetit dhe të sigurisë globale, besimin tek profesionistët e kujdesit shëndetësor si dhe gatishmërinë e pacientëve për të kërkuar ndihmë mjekësore. Aktualisht mund të themi se tashmë njihet ndikimi i COVID-19 mbi sektorin e kujdesit shëndetësor dhe mbi atë të

¹¹ Emily Berman, “The Roles of the State and Federal Governments in a Pandemic”, *Journal of National Security Law and Policy*, Vol. 11, (Issue 1, 2020): 64.

¹² David Barno, Nora Bensahel, “After the Pandemic: America And National Security in a Changed World”, *War on the Rocks* (March 31, 2020).

Burimi elektronik: <https://warontherocks.com/2020/03/after-the-pandemic-america-and-national-security-in-a-changed-world/>

sigurisë kombëtare, bazuar kjo në të dhëna të bollshme që gjenden ngado¹³.

Kërkuesit brenda fushës së studimeve të sigurisë kanë luftuar për të përcaktuar nëse një sëmundje infektive, përfaqëson një kërcënim ekzistencial për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Me shfaqjen e SARS-CoV-2 (COVID-19), është e domosdoshme që të rishikohet marrëdhënia midis sëmundjeve infektive dhe sigurisë globale. Trajtimi i kërcënimit specifik të sigurisë nga COVID-19, duhet të ngrejë pyetjen themelore: “A është COVID-19 një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare?” Për të hetuar këtë pyetje, mund të përdoren dy qasje teorike: siguria njerëzore dhe biosiguria. Ekzistojnë argumentet se COVID-19 është një kërcënim për sigurinë globale. Kriza ontologjike është paraqitur tek individët përmes teorisë së sigurisë njerëzore dhe përmes politikës së lartë, siç dëshkohet nga biosiguria. Duke parë kërcënimet e sigurisë përmes lentave të individit dhe të shtetit, duket qartë se një sëmundje infektive duhet të konsiderohet si një kërcënim ndërkombëtar i sigurisë¹⁴.

Siguria kombëtare, në kuptimin e saj tradicional, shoqërohet me mbrojtjen e integritetit territorial dhe të sovranitetit të një shteti, si dhe të interesave të tij kritikë jashtë vendit. Sidoqoftë, natyra vdekjeprurëse e pandemive po rrit gjithnjë e më shumë ndërgjegjësimin shkencor për dimensionet e tyre brenda sigurisë kombëtare. Për këtë qëllim, *National Academy Press* vëren se siguria kombëtare nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen nga aktorët shtetërorë dhe joshetërorë, por gjithashtu përfshin edhe mbrojtjen nga shfaqja e sëmundjeve infektive dhe rezultateve të tjera shëndetësore që mund të kërcënojnë vitalitetin ekonomik të një kombi, dhe mënyrën e tij të jetesës¹⁵.

Për shembull, Shtetet e Bashkuara vuajtën nga këto gabime mosvlerësimi. Ky vend ka programin më ambicioz të sigurisë dhe të mbrojtjes në botë, - duke gjykuar nga ekstrakti vjetor prej afro 1 trilion dollarësh në sektor, - por kishte edhe numër shumë të lartë të infeksioneve dhe të fataliteteve nga COVID-19. Ndërsa buxheti për armët e reja bërthamore u rrit me 20 për qind, buxheti për Qendrat e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve (CDC) u ul me 15 për qind. Megjithëse buxheti federal për programet e lidhura me shëndetin ishte rreth 13.6 miliardë dollarë amerikanë më 2019-n, administrata e presidentit Trump propozoi 46 miliardë dollarë vetëm për financimin e programeve të armëve bërthamore më 2021¹⁶.

Për më tepër, “Programi PREDICT” i USAID-it i cili do të mundësonte parashikimin dhe përgjigjen ndaj skenarëve të ardhshëm të pandemive, përmes kërkimit dhe mbikëqyrjes, u mbyll në tetor 2019 nga presidenti Trump. Prandaj, nuk është për t’u habitur që Shtetet e

¹³ Filip Szymanski, Cezary Smuniewski, Anna Platek, “Will the COVID-19 Pandemic Change National Security and Healthcare in the Spectrum of Cardiovascular Disease?”, *Current Problems in Cardiology*, Volume 45 (Issue 9, 2020). Burimi elektronik: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0146280620301225>

¹⁴ Craig Albert, Amado Baez, Joshua Rutland, “Human security as biosecurity: Reconceptualizing national security threats in the time of COVID-19”, *Politics and the Life Sciences*, 40(1), 83-105.

¹⁵ Segun Oshewolo, Agaptus Nwozor, “COVID-19: Projecting the National Security Dimensions of Pandemics”, *Strategic Analysis*, (44, nr. 3): 269-275.

¹⁶ G. D. Koblenz, M. Hunzeker, “National security in the age of pandemics”, *Defense One* (April 3, 2020). Burimi elektronik: <https://www.defenseone.com/ideas/2020/04/national-security-age-pandemics/164365/>

Bashkuara patën një përgjigje jo të mirë ndaj pandemisë në vend, dhe dështuan në ofrimin e udhëheqjes botërore, aq shumë të nevojshme për luftimin e virusit¹⁷.

Duke shikuar përpara, të ardhmen, është e rëndësishme për vendet e zhvilluara dhe për të gjitha në tërësi, - në varësi të kapaciteteve të tyre, - që të investojnë në programe mbikëqyrjeje që do të përmirësojnë programet e tyre të gatishmërisë në rast të një shpërthimi sëmundjeje; dhe kombet në zhvillim apo shtetet e pazhvilluara gjithashtu mund të përfitonin nga kjo gjë.

4. Përfundime

Sëmundjet e dala dhe potenciali i tyre pandemik paraqesin ndoshta një kërcënim edhe më të madh të sigurisë kombëtare, veçanërisht në këtë epokë të globalizimit kur sëmundja mund të përhapet më shpejt sesa në epokat e mëparshme. Ashtu siç mund të pritej, linja e parë e “frontit” këtu, janë ekspertët dhe praktikuesit e sigurisë njerëzore që i shikojnë sëmundjet katastrofike infektive si shqetësime të sigurisë, për shkak të aftësisë së tyre shkatërruese dhe përçarëse. Është demonstruar se sëmundjet kërcënojnë sigurinë kombëtare në mënyra të ndryshme.

Së pari, ato janë përgjegjëse për sëmundshmëri dhe vdekshmëri të konsiderueshme në popullatat njerëzore.

Së dyti, mungesa e gatishmërisë për pandeminë mund të rrisë ndjeshmërinë e një shteti ndaj bioterrorizmit dhe pasojave/emergjencave shoqëruese.

Së treti, sëmundjet infektive mund të kufizojnë aftësinë e forcave të armatosura për t’iu përgjigjur në mënyrë adekuate kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme të sigurisë.

Ndërsa lidhja midis pandemive dhe sigurisë kombëtare tashmë qëndron përtej hamendjes, siç është demonstruar gjerësisht nga studiues të ndryshëm, udhëheqësit kombëtarë duhet të fillojnë që të trajtojnë kërcënimin e sëmundjeve infektive katastrofike, me seriozitetin dhe me urgjencën që meriton. Ekziston nevoja për një investim më të madh të parandalimi i sëmundjeve dhe të kontrollit të tyre. Nuk ka ndonjë kuptim në lidhje me sigurinë, që një komb të investojë shumë në ndërtimin e kapaciteteve të tija ushtarake, për konkurrencën e madhe mes fuqive shtet me shtet, por t’i nënshtrohet fare lehtë një pandemie shkatërruese. Nisur nga këto këndvështrime të analizës nevojitet që të ndryshojë edhe qasja ndaj sëmundjeve efektive me pasojë katastrofike e pandemike. Nevojitet një përcaktim i saktë i këtyre çështjeve si çështje që cenojnë sigurinë kombëtare. Përderisa efektet e pandemive shkojnë nga ato ekonomike, sociale, psikologjike, arsimore, etj., e deri te ato që lidhen me jetën e individëve, atëherë është më se e qartë që kemi të bëjmë me çështje të sigurisë kombëtare. Me shtrëngimin e masave dhe me mbylljen (*lock down*) e aktiviteteve, shumë qytetarë kanë shfaqur shenja të humbjes së kontrollit apo të durimit. Siguria publike në rastin e pandemisë ka pasur ndikime të shumëlloshme, por mbetet fakt që kërcënimi kryesor është goditja ekonomike që mund të shkaktojë mbylljet dhe pezullimet e ekzistencës së zinxhirëve furnizues. Ndërsa përmendëm këto, mund të themi edhe një problematikë tjetër që lidhet me forcat e armatosura. Një nga dimensionet më të rrezikshme të pandemisë, që lidhet me sigurinë kombëtare, është ai që paralizon përdorimin e forcave të armatosura,

¹⁷ Oshewolo dhe Nwozor, *Projecting the National Security Dimensions of Pandemics*, 273.

duke shkakuar mungesë rregulli në organizim dhe në operacionet që mund të kryejnë. Lind nevoja që në skenarët e ardhshëm i gjithë informacioni dhe përvoja e përfituar nga situata e COVID-19 të përdoret e të studiohet me qëllim krijimin e zgjidhjeve parandaluese ndaj kërcënimeve të tilla pandemike, të cilat përbëjnë sot një kërcënim për sigurinë kombëtare.

Bibliografia:

1. Joseph Romm, *Defining National Security: The Nonmilitary Aspects* (New York: Council on Foreign Relations, 1993).
2. Leslie Pray, Stanley Lemon, Adel Mahmoud, Stacey Knobler, red., *The Impact of Globalization on Infectious Disease Emergence and Control* (Washington: US National Academies Press, 2006).
3. Kamaljeet Sandhu, red., *Handbook of Research on Advancing Cybersecurity for Digital Transformation* (Pennsylvania: IGI Global, 2021).
4. WHO Coronavirus (COVID-19) Dashboard. Sipas të dhënave të rifreskuara në korrik 2021.
Burimi elektronik: <https://covid19.who.int/table>
5. Cornelia Riehle, "Europol: How COVID-19 Shapes Serious and Organised Crime Landscape in the EU", *Eucrim*, 12 July, 2020.
6. EUROPOL, *Pandemic profiteering how criminals exploit the COVID-19 crisis*, (Hague, NL: European Union Agency for Law Enforcement Cooperation 2020, March 2020).
Burimi elektronik: www.europol.europa.eu/sites/default/files/documents/pandemic_profiteering-how_criminals_exploit_the_covid-19_crisis.pdf
7. Mark Nevitt, "Domestic Military Operations and the Coronavirus Pandemic", *Journal of National Security Law and Policy*, Vol. 11, (Issue 1, 2020).
8. Sarah Repucci, Amy Slipowitz, "The Impact of COVID-19 on the Global Struggle for Freedom", *Special Report 2020, Democracy under Lockdown* (Freedomhouse, 2020).
Burimi elektronik: <https://freedomhouse.org/report/special-report/2020/democracy-under-lockdown>
9. European Foreign Policy in times of COVID-19,
10. Marc Helmold, Matthias Einmahl, Klaus Rassmann, red., *Lessons from the Covid-19 Situation: Rethinking Global Supply Chain Networks and Strengthening Supply Management in Public Procurement in Germany* (Erfurt, Germany: IUBH Internationale Hochschule, 2020).
11. Emily Berman, "The Roles of the State and Federal Governments in a Pandemic", *Journal of National Security Law and Policy*, Vol. 11, (Issue 1, 2020).
12. David Barno, Nora Bensahel, "After the Pandemic: America And National Security in a Changed World", *War on the Rocks* (March 31, 2020).
Burimi elektronik: <https://warontherocks.com/2020/03/after-the-pandemic-america-and-national-security-in-a-changed-world/>
13. Filip Szymanski, Cezary Smuniewski, Anna Platek, "Will the COVID-19 Pandemic Change National Security and Healthcare in the Spectrum of Cardiovascular Disease?", *Current Problems in Cardiology*, Volume 45 (Issue 9, 2020).

Burimi elektronik: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0146280620301225>

14. Craig Albert, Amado Baez, Joshua Rutland, "Human security as biosecurity: Reconceptualizing national security threats in the time of COVID-19", *Politics and the Life Sciences*, 40(1), 83-105.
15. Segun Oshewolo, Agaptus Nwozor, "COVID-19: Projecting the National Security Dimensions of Pandemics", *Strategic Analysis*, (44, nr. 3).
16. G. D. Koblenz, M. Hunzeker, "National security in the age of pandemics", *Defense One* (April 3, 2020).

Burimi elektronik:

<https://www.defenseone.com/ideas/2020/04/national-security-age-pandemics/164365/>

17. Oshewolo dhe Nwozor, *Projecting the National Security Dimensions of Pandemics*.

INFORMACIONI, TEKNOLOGJIA DHE MJEDISI OPERACIONAL

Kolonel Msc. Fatmir Neziraj *

Zëvendësrektor i Akademisë së Forcave të Armatosura

*Toka ishte lënda e parë për epokën agrokulturore
Hekuri ishte lënda e parë për epokën industriale
Të dhënat janë lënda e parë për epokën e informacionit.¹*

Trajtesë e shkurtuar.

Zhvillimet e shpejta teknologjike kanë bërë që mjedisi operacional dhe mjedisi i informacionit të ndryshojnë vazhdimisht dhe në mënyrë të paparashikueshme.

Kapacitetet që kanë lindur si rezultat i bashkimit të teknologjisë me informacionin kanë sfiduar elementet tradicionale të fuqisë duke përfshirë fuqinë ushtarake dhe faktorët ekonomikë dhe diplomatikë. Informacioni është një mjet shumë i fuqishëm në mjedisin operacional. Në konfliktin modern, informacioni është bërë po aq i rëndësishëm sa edhe fuqia e zjarrit vdekjeprurës në përcaktimin e rezultateve të operacionit.

Sistemet autonome të kontrollit dhe drejtimit në distancë/robotëve dhe sidomos mjetet fluturuese pa pilot/dronët (MFP) janë zhvilluar dhe përhapur gjerësisht, duke ndikuar drejtpërdrejt në transformimin e fushës së luftimit në ditët e sotme.

ikur një risi, dronët janë bërë sot pajisje standarde ushtarake. Deri tani të paktën 15 vende kanë krijuar akademi të dedikuara trajnimit për përdorimin e dronëve, ndërkohë që dhjetë vende kanë aktivizuar shkollat e trajnimit të MFP në dekadën e fundit.

* Kolonel Fatmir S. Neziraj mban titullin Master shkencor për Studime të Sigurisë Strategjike nga Universiteti Kombëtar i Mbrojtjes në Uashington DC, SHBA

¹ Alec Ross, the Industries of the Future; Publisher Simon & Schuster, 2016.

Roli dhe rëndësia e dronëve u vërtetua edhe në luftën e fundit ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit, në të cilën përdorimi tyre ishte vendimtar në përcaktimin e fitores duke shënuar një faqe të re në përdorimin e fuqisë ajrore.

Kompjuterizimi i shoqërisë ka sjellë edhe rritjen e kërcënimeve kibernetike. Siguria kibernetike tashmë është një element kryesor i mjedisit të sotëm operacional. Hapësira kibernetike është një mjedis i ri dhe vazhdimisht në zhvillim me kërcënime të mundshme të panjohura ose të kuptuara dobët.

Duke e nisur nga ndryshimet e shpejta e të paparashikuara të mjedisit operacional dhe zhvillimeve të vrullshme teknologjike, Forcat tona të Armatosura duhet t'i vlerësojnë pandërprerë ato në kuadrin e modernizimit dhe përdorimit të kapaciteteve operacionale për përmbushjen e misionit të tyre.

Fjalët kyçe: mjedisi operacional (MO), mjedisi i informacionit (MI), teknologjia, Mjete Fluturuese Pa Pilot (MFP)/ dronët, hapësira kibernetike

1. Hyrje

Sot vërejmë se pothuajse çdo aspekt i jetës sonë si: komunikimi, udhëtimet, transaksionet financiare, zhvillimi kulturor etj., po ndryshon me shpejtësi. Këto ndryshime kanë përfitime por në shumë raste, bashkë me progresin, vjen edhe rreziku.

Teknologjia aktuale u mundëson individëve dhe grupeve të krijojnë, të ruajnë, menaxhojnë, kontrollojnë, manipulojnë e të transmetojnë informacionin me shpejtësi dhe lehtësi. Kjo ka krijuar një varësi në rritje ndaj informacionit dhe teknologjisë së informacionit nga shtetet, aktorët joshitetërorë dhe individët.

Kapacitetet që kanë lindur si rezultat i bashkimit të teknologjisë me informacionin kanë sfiduar elementet tradicionale të fuqisë duke përfshirë fuqinë ushtarake dhe faktorët ekonomikë e diplomatikë. Informacioni është një mjet shumë i fuqishëm në mjedisin operacional (MO)¹. Në konfliktin modern, informacioni është bërë po aq i rëndësishëm sa edhe fuqia e zjarrit vdekjeprurës në përcaktimin e rezultateve të operacionit. Përderisa informacioni formëson perceptimet e popullsisë civile, ai gjithashtu formëson edhe mjedisin operacional. Doktrina ruse e trajton informacionin si “një armë të rrezikshme, të lirë, armë universale me rreze veprimi të pakufizuar, lehtësisht të posedueshme dhe që kapërcen kufijtë ndërshtetërorë”.

Në vijim të shkrimit do të trajtoj disa aspekte të zhvillimeve teknologjike e të teknologjisë së informacionit gjatë viteve të fundit dhe ndikimi që ato kanë në mjedisin operacional. Fillimisht do të vlerësohet mjedisi i sotëm i informacionit duke vijuar me kërcënimet që e shoqërojnë përfshirë edhe kërcënimet kibernetike, dizinformacionin dhe propagandën. Më tej, do të jepet informacion mbi zhvillimet teknologjike në fushën e sistemeve autonome të kontrollit e të drejtimit në distancë, robotëve, duke u fokusuar në zhvillimet e Mjeteve Fluturuese Pa Pilot (MFP), kërcënimet dhe avantazhet që kanë dhe si po ndikojnë në transformimin e fushës së luftimit në ditët e sotme. Në këtë kuadër, është bërë një analizë e zgjeruar e luftës së fundit ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit për të evidentuar rolin dhe mënyrën e përdorimit të MFP nga të dyja palët ndërluftuese. Në shkrim nuk janë trajtuar aspekte të teknologjisë 5G.

¹ Sipas AAP-6 NATO Glossary of Terms and Definitions, mjedisi operacional është një kombinim i kushteve dhe rrethanave që influencojnë dhe ndikojnë në përdorimin e kapaciteteve në përputhje me vendimet e komandantit.

2. Mjedisi i Informacionit (MI)²

Njerëzimi aktualisht po përjeton një revolucion të madh për sa i përket informacionit dhe përdorimit të tij. Në asnjë kohë tjetër nuk janë prodhuar kaq shumë të dhëna të cilat grumbullohen në internet. Kështu, kompania Google përpunon mbi 40,000 kërkime çdo sekondë; gjithsej 3.5 miliardë kërkime në një ditë. Çdo minutë, përdoruesit e “Snapchat” ndajnë 527.760 foto, ndërsa përdoruesit e “YouTube” transmetojnë më shumë se 4.1 milion video. Ka edhe sisteme të vjetra, të tilla si postat elektronike, që vazhdojnë të përjetojnë rritje të konsiderueshme. Çdo minutë dërgohen 156 milion mesazhe. Në një raport nga Korporata Ndërkombëtare e të Dhënave (IDC) e quajtur “Data Age 2025”, sasia e të dhënave të krijuara deri në vitin 2025 pritet të arrijë një shifër marramendëse prej 163 zetabajt. Kjo është afërsisht dhjetëfishi i sasisë së të dhënave në dispozicion në vitin 2017.³

Zhvillimet teknologjike kanë bërë që informacioni të lëvizë me shpejtësi. Sasia e informacionit të ruajtur rritet katër herë më shpejt se ekonomia botërore, ndërsa fuqia përpunuese e kompjuterëve rritet nëntë herë më shpejt. Nuk është çudi që njerëzit ankohen për mbingarkesë informacioni. Të gjithë janë goditur nga ndryshimet.⁴

Në veçanti, teknologjia dhe interneti luajnë një rol kryesor në formësimin dhe qarkullimin e informacionit në shoqëri. Përdorimi i operacioneve që synojnë të formësojnë perceptimet, besimet dhe sjelljet, sigurisht që nuk janë diçka e re në teorinë ose praktikën e luftës. Të drejtuara ndaj publikut ose kundërshtarëve në një fushëbetejë, këto aktivitete, në një masë më të madhe ose më të vogël, kanë kohë që kanë qenë pjesë e diskutimit të operacioneve psikologjike⁵, operacioneve të informacionit⁶, operacioneve joluftarake, operacioneve kundër kryengritësve, rebelimit dhe ndër të tjera edhe të diplomacisë publike.

Në kontekstin e internetit e të teknologjisë, konceptet e fundit të propagandës⁷ së kompjuterizuar përbëjnë një sfidë të jashtëzakonshme. Operacionet e informacionit kanë ndryshuar vendin me operacionet vdekjeprurëse të përdorimit të forcës. Më parë ato ishin

² Sipas AJP-3.10 Allied Joint Doctrine for Information Operations, Mjedisi i Informacionit është i përbërë nga informacioni, individët, organizmat dhe sistemet që marrin përpunojnë dhe transmetojnë informacionin si dhe hapësira fizike, virtuale dhe konjitive në të cilën ndodh. (STANAG 2508 Edition 4, AJP-3.10.1 Edition B, Version 1).

³ Émilien Vilas Boas, THE DIGITAL ENVIRONMENT AND THE RIGHT TO PRIVACY IN RELATION TO BIG DATA Reis1Escola Superior Dom Helder Câmara (ESDHC) Bruno Torquato de Oliveira Naves2Escola Superior Dom Helder Câmara (ESDHC; burimi elektronik në <http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:EPqbMZvLICIJ:revista.domhelder.edu.br/index.php/veredas/article/view/1795/24906+&cd=4&hl=en&ct=clnk&gl=al>

⁴ Po aty.

⁵ Sipas STANAG 2508 Edition 4, AJP-3.10.1 Edition B, Version 1 – Allied Joint Doctrine for Psychological Operations Operacionet psikologjike janë aktivitete të planëzuara që përdorin mënyrat e komunikimit dhe mjete të tjera kundrejt audiencave të aprovuara, me qëllim ndikimin e perceptimeve, sjelljes dhe qëndrimeve të tyre për të ndihmuar në arritjen e objektivave politikë dhe ushtarake.

⁶ Operacionet e informacionit janë një funksion ushtarak për të ofruar këshilla dhe koordinim të aktiviteteve të informacionit ushtarak për të krijuar efektet e dëshiruara në vullnetin, kuptimin dhe aftësitë e kundërshtarëve dhe audiencave të tjera të aprovuara nga NAC në mbështetje të objektivave dhe të misionit të Aleancës. (AJP-3.10)

⁷ Propaganda: Informacion i veçantë i një natyre jo të plotë, i pjesshëm, dykuptimësh, që krijon konfuzion dhe të çon qëllimisht në një drejtim të caktuar. Përdoret për të promovuar një politikë apo pikëpamje të caktuara (STANAG 2508 Edition 4, AJP-3.10.1 Edition B, Version 1).

operacione mbështetëse sot ato janë bërë operacion i mbështetur.⁸

Propaganda e kompjuterizuar është një formë e re e manipulimit politik që ndodh në internet. Termi përshkruan mbledhjen, grumbullimin e platformave të mediave sociale, agjentëve autonomë, algoritmeve dhe të “Big Data” të ngarkuara me manipulimin e opinionit publik. Kjo mënyrë e re e ndërprerjes dhe ndikimit të komunikimit është në rritje në të gjithë globin. Përparimet në teknologjinë e informacionit, veçanërisht rreth automatizimit social dhe inteligjencës artificiale, tregojnë që propaganda kompjuterike po bëhet më e sofistikuar dhe më e vështirë për t’u gjurmuar.⁹

Mjedisi Operacional (MO) është kompleks dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Informacioni po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm dhe në disa raste është përcaktues në arritjen e përfundimit të dëshiruar në një operacion luftarak ose joluftarak. Gjenerali Valery Gerasimov, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Rusisë vëren se në shekullin e 21-të kemi parë një tendencë drejt mjegullimit të vijave ndarëse midis gjendjes të luftës dhe paqes. Vetë “rregullat e luftës” kanë ndryshuar. Roli i mjeteve joushtarake për arritjen e qëllimeve strategjike politike është rritur dhe në shumë raste, ato e kanë tejkaluar fuqinë e forcës së armëve në efektivitetin e tyre.¹⁰

Natyrë komplekse e botës sonë moderne të paqëndrueshme, me sasi shumë të mëdha të të dhënave, vështirëson vendimmarrjen ushtarake sipas metodave tradicionale. Ndërsa përparimet në teknologjinë e informacionit rriten, shfaqen mundësi të reja për analizimin e të dhënave. Fuqia llogaritëse e kompjuterëve po përshpejtohet dhe robotët tani mund të mposhtin njerëzit në gara intelektuale. “Deep Blue” mundi mjeshtrin e shahut Garry Kasparov më shumë se 20 vjet më parë.¹¹

Historikisht, për të marrë vendime, udhëheqësit ushtarakë janë mbështetur në analizën e thjeshtë të të dhënave, të tilla si numri i armiqve të vvarë dhe raporti i forcave me trupat e armikut. Sot, ata kanë qasje në të dhëna të menjëhershme, në kohë reale që nuk janë imagjinuar më parë, të tilla si ndjekja satelitore e vendndodhjeve të trupave dhe gjendja e linjave të furnizimit logjistike, të gjitha të kërkuara e të analizuar nga grupe të dedikuara të analistëve.¹²

Në të njëjtën kohë, zhvillimet kompjuterike kanë sjellë një rritje të ndjeshme edhe të cenueshmërisë kibernetike. Kompjuterizimi i veprimtarisë tonë ka krijuar “thembra të Akilit” në të gjithë aktivitetin e përditshëm.

Në këtë pikëpamje edhe ushtritë më të zhvilluara kanë krijuar mundësi të mëdha për armiqtë e tyre të mundshëm. Fakti që të gjithë janë të cenueshëm, në një farë kuptimi,

⁸ Po aty.

⁹ Samuel C. Woolley and Philip N. Howard; *Computational Propaganda Political Parties, Politicians, and Political Manipulation on Social Media*, Published to Oxford Scholarship Online: November 2018; p. 24.

¹⁰ James Derleth, PhD; *Russian New Generation Warfare Deterring and Winning at the Tactical Level*, September-October 2020 Military Review, Army University Press; p.82.

¹¹ Po aty., p. 86.

¹² Scott S. Haraburda; *Benefits and Pitfalls of Data-Based Military Decisionmaking*; Small War Journal 2019. Burimi elektronik në: <https://smallwarjournal.com/jrnl/art/benefits-and-pitfalls-data-based-military-decisionmaking>.

tregon se nuk ka garanci për mbrojtje. Shkurajimi i disa veprimeve nuk është i pamundur në hapësirën kibernetike, por është sigurisht i vështirë dhe ka të ngjarë të dështojë në shumë situata të rëndësishme. Në hapësirën kibernetike, konflikti aktualisht karakterizohet më së miri si konkurrencë e vazhdueshme nën nivelin e konfrontimit ushtarak. Aktorët shtetërorë vazhdimisht po tentojnë të futen në rrjetet e kundërshtarëve, duke kërkuar të ndjekin e të jenë prezent pa shkaktuar konflikte të drejtpërdrejta.¹³

Mjedisi i Informacionit (MI) ka evoluar me shpejtësi dhe do të vazhdojë ta mbajë këtë ritëm. Zhvillimi kryesor është ai i internetit dhe komunikimeve elektronike, të cilët tani lehtësojnë dhe ndërmjetësojnë një pjesë të madhe të ndërveprimit njerëzor. Kjo nuk ka zëvendësuar gjeneratën e mëparshme të komunikimeve të tilla si: televizioni, radioja dhe telefoni të cilat ende kanë një audiencë të gjerë dhe përdorues që gëzojnë një besim të madh. Sidoqoftë, sistemi aktual i internetit, telefonave inteligjentë dhe mediave sociale ndryshon nga burimet tradicionale të komunikimit në atë që lidh në mënyrë interaktive individët në një rrjet gati universal në të cilin shpërndahet, shkëmbehet informacion vazhdimisht dhe me shpejtësi.

MI karakterizohet nga sfida që vijnë duke u rritur. Së pari, përhapja e dezinformimit e shoqëruar me një konkurrencë të vazhdueshme për kontrollin e “narracionit” që është një tipar i pashmangshëm dhe së dyti, infrastruktura përmes së cilës qarkullon informacioni është subjekt dhe i nënshtrohet kërcënimeve të shumta.¹⁴

Një aspekt tjetër i mjedisit bashkëkohor të informacionit është përdorimi i gjerë i teknologjive të spiunazhit. Ato mjafton të kenë vetëm një shkallë të moderuar sofistikimi, sepse informacioni që qarkullon në internet është përgjithësisht i pasigurt. Edhe ato forma të komunikimit të krijuara për të pasur një nivel të lartë të kriptimit, të tilla si “WhatsApp” nuk ofrojnë siguri. Sidoqoftë, kërcënimi ndaj integritetit të informacionit dhe vështirësia për të siguruar atë përbën shqetësim universal.¹⁵

Interneti e ka bërë gjurmimin më të lehtë, më të lirë dhe më të dobishëm. Agjencitë qeveritare nuk janë të vetmet që na spiunojnë. “Amazon” monitoron preferencat tona të blerjes dhe “Google” zakonet tona të kërkimit, ndërsa “Twitter” e di se çfarë ka në mendjet tona. “Facebook” duket se i kap të gjitha ato informacione, së bashku me marrëdhëniet tona shoqërore. Operatorët celularë e dinë jo vetëm me kë flasim, por edhe kush është afër nesh.¹⁶

Siguria kibernetike tashme është një element kryesor i mjedisit të sotëm operacional. Veprimi njerëzor mund të ndryshojë hapësirën kibernetike në mënyra që nuk mund të

¹³ A. Ertan, K. Floyd, P. Pernik, T. Stevens (Eds.); *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis*, NATO CCDCOE Publications. faqe 216.

¹⁴ Nick Reynolds; *Royal United Services Institute for Defence and Security Studies Performing Information Manoeuvr Through Persistent Engagement*, RUSI Occasional Paper, June 2020; faqe 14..

¹⁵ Po aty, faqe 23.

¹⁶ Émilien Vilas Boas; THE DIGITAL ENVIRONMENT AND THE RIGHT TOPRIVACY IN RELATION TO BIG DATA Reis|Escola Superior Dom Helder Câmara (ESDHC) Bruno Torquato de Oliveira Naves|Escola Superior Dom Helder Câmara (ESDHC); I aksesueshëm në: <http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:EPqbMZvLICIJ:revista.domhelder.edu.br/index.php/veredas/article/view/1795/24906+&cd=4&hl=en&ct=clnk&gl=al>

ndryshojë fusha të tjera. Hapësira kibernetike është një fushë globale e krijuar nga njeriu, e bazuar në teknologji informacioni dhe e kontrolluar prej tyre në MI. Është një mjedis në të cilin dhe përmes tij mund të përdoret pushteti në mënyra të udhëhequra nga idetë dhe besimet. Përmes burimeve të caktuara në dispozicion të tyre, shtetet mund të kontrollojnë dhe formësojnë hapësirën kibernetike dhe kështu të ndryshojnë karakteristikat dhe vetitë e saj. Hapësira kibernetike është një mjedis i ri dhe vazhdimisht në zhvillim me kërcënime të mundshme të panjohura ose të kuptuara dobët. Si pasojë, shtetet e formojnë hapësirën kibernetike në mënyra të veçanta të udhëhequra nga idetë dhe sipas burimeve, kapaciteteve që disponojnë.¹⁷

Zhvillimet e shpejta teknologjike që shfrytëzojnë hapësirën kibernetike dhe spektrin elektromagnetik¹⁸ paraqesin sfida të reja edhe për Aleancën, ndërsa kërcënimet nga kundërshtarët gjithnjë e më të sofistikuar bëhen më komplekse dhe të paparashikueshme. Aleatët kanë kërkuar të operacionalizojnë hapësirën kibernetike. Në Samitin e Varshavës 2016, ata zyrtarisht njohën kibernetikën si një fushë operationale, së bashku me ajrin, tokën, detin dhe që nga viti 2019, hapësirën. Kjo u pasua në 2018 me krijimin e Qendrës së Operacioneve Kibernetike si pjese e strukturës të NATO-s, me planet për të arritur aftësinë e plotë operationale deri në vitin 2023.

Suksesi në fushëbetejën shumëdimensionale varet nga aftësia jonë për të integruar konceptin me doktrinën, organizimin, trajnimin, drejtimin, arsimin dhe personelin. Përpjekjet për të operacionalizuar fushën kibernetike përfshijnë doktrinën e botuar së fundmi nga NATO-ja. Doktrina e Përbashkët e Operacioneve të Hapësirës Kibernetike AJP-3.20 përcakton parimet me të cilat mund të planifikohen, ekzekutohen dhe vlerësohen operacionet e përbashkëta kibernetike.¹⁹

3. Teknologjia dhe roli i saj

E thënë në mënyrë të thjeshtë e të shkurtër, teknologjia është përdorimi i njohurive shkencore për qëllime praktike, qoftë në industri, ushtri apo në jetën tonë të përditshme. Pra, në thelb, sa herë që përdorim njohuritë tona shkencore për të arritur një qëllim specifik, ne jemi duke përdorur teknologjinë. Teknologjia zakonisht përfshin një pajisje specifike që mund të jetë tepër e thjeshtë ose e komplikuar, mund të jetë gjithçka nga zbulimi i rrotës deri te kompjuterët dhe anijet kozmike.

Teknologjia është integruar në jetën e përditshme të njerëzve në të gjithë globin. Ajo po ndikon në gjeneratat e reja, duke formuar kulturën e civilizimeve dhe madje duke diktuar se si kombet bëjnë luftë. Në të ardhmen është e mundur që platformat autonome të armëve të zëvendësojnë nevojën që ushtarët të jenë fizikisht të pranishëm në konfliktet e ardhshme.

¹⁷ A. Ertan, K. Floyd, P. Pernik, T. Stevens (Eds.); *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis* 2020 by NATO CCDCOE Publications. Faqe 13

¹⁸ Spektër elektromagnetik (electromagnetic spectrum) – Shpërndarja e plotë dhe e rregullt e valëve elektromagnetike, në përputhje me frekuencën dhe gjatësinë e valës. Spektri elektromagnetik përfshin valët e radios, mikrovalët, dritën e dukshme, rrezatimin ultravjollcë, rrezet x, rrezet elektromagnetike kozmike dhe rrezet gama.

¹⁹ A. Ertan, K. Floyd, P. Pernik, T. Stevens (Eds.); *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis* NATO CCDCOE Publications. f. 128.

Ne duhet të përgatitemi për mjedisin e nesërm operacional duke zhvilluar doktrinën dhe studiuar e ndjekur shkencën dhe inteligjencën artificiale, për të bërë të mundur ruajtjen e epërsisë ndaj kundërshtarëve. Kjo do të bëjë që forcat e armatosura dhe aleatët e saj të jenë të aftë për të vepruar në mënyrë autonome në mjedise armiqësore, duke kombinuar artin e luftës me shkencën e luftës.

Teknologjitë e reja në radhë të parë ndikojnë në ekuilibrin e fuqisë përmes fuqisë ushtarake dhe ekonomike. Ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në aftësitë e vendeve për të luftuar dhe për të fituar luftëra. Teknologjitë gjithashtu mund të ndikojnë indirekt në ekuilibrin e fuqisë duke ndikuar në fuqinë ekonomike të një vendi. Mbi të gjitha, vendet nuk mund të mbajnë epërsinë ushtarake për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë pa një bazë ekonomike solide për atë fuqi. Në këtë kontekst mjafton të kujtojmë rënien e perandorisë osmane ose të Kinës Perandorake.

Automjetet autonome tokësore ashtu si automjetet autonome nënujore janë në zhvillim e sipër në të gjithë botën. Në pothuajse të gjitha rastet po bëhen përpjekje për hapin e rëndësishëm për të kaluar nga zhvillimi në zbatimin operacional. Gjithashtu, në të gjithë botën vendet po investojnë shumë në Inteligjencën Artificiale ku duket se Shtetet e Bashkuara dhe Kina janë më të avancuara.²⁰

Teknologjia, në formën e armëve dhe transportit, siguron format dhe mjetet e drejtpërdrejta me të cilat popuj të caktuar e kanë zgjeruar hapësirën e tyre dhe kanë pushtuar popujt e tjerë. Kjo e bën atë kursin kryesor të modelit më të përhapur të historisë.²¹ Nuk është sekret se një nga shtytësit më të rëndësishëm për përparimin shkencor dhe teknologjik është vullneti njerëzor për të zhvilluar luftë ose për t'u ndjerë i sigurt me mekanizmat e duhur të mbrojtjes.²²

Nevoja për të zhvilluar arsenalin ushtarak ka qenë pjesë e zhvillimit të shoqërisë. Historia është e mbushur me shembuj që e vërtetojnë këtë. Në vitin 1942, në mes të Luftës së Dytë Botërore qeveria amerikane filloi projektin “Manhattan” me qëllimin e qartë të shpikjes së teknologjisë së kërkuar për të ndërtuar një bombë atomike para se Gjermania naziste ta bënte këtë. Projekti pati sukses në tre vjet, me një kosto prej 2 miliard dollarësh (ekuivalent me mbi 20 miliardë dollarë sot).²³

Teknologjitë e reja do të konvertojnë dhe integrojnë sinjalet elektromagnetike nga burime të shumta në të dhëna dixhitale që mund të përpunohen me shpejtësi të paparë për të rritur aftësinë e luftëtarit, për të siguruar informacion edhe përkundër masave të maskimit e mashtrimit të armikut, duke identifikuar dhe neutralizuar kërcënimet në fushën e betejës. Përparimet teknologjike gjithashtu do të përmirësojnë në mënyrë dramatike aftësinë e

²⁰ Michael C. Horowitz; *Artificial Intelligence, International Competition, and the Balance of Power*, Texas National Security Review: Volume 1, Issue 3 (May 2018), faqe 42.

²¹ Jared Diamond; *Guns, Germs, and Steel: The Fates of Human Societies*; Published 2005 by W.W. Norton & Company (first published May 9th 1997) f. 241.

²² NATO Modern Warfare and Unmanned Aerial Vehicles, PRAŽSKÝ STUDENTSKÝ SUMMIT / XIX / NATO / III f. 1.

²³ Jared Diamond; *Guns, Germs, and Steel: The Fates of Human Societies*; Published 2005 by W.W. Norton & Company (first published May 9th 1997) f. 242.

forcave për të mohuar apo devijuar përpjekjet e grumbullimit të informacionit nga armiku nëpërmjet masave të përmirësuara të luftës elektronike.²⁴

4. Zhvillimi dhe përdorimi i Mjeteve Fluturuese Pa Pilot (MFP)/ Dronëve

Dikur një risi, dronët janë bërë sot pajisje standarde ushtarake, duke krijuar një rrjet globale të njësive, bazave dhe poligoneve të testimi dhe trajnimit. Fushat e betejës në Ukrainë, Siri dhe Jemen, zonat e konfliktit në Gjirin Persik dhe Detin e Kinës Lindore gjithnjë e më shumë janë mbushur me dronë me madhësi dhe sofistikime të ndryshme. Pavarësisht nëse ato përdoren për zbulim, sulme ajrore, zbulimin e artilerisë ose luftën elektronike, dronët janë një kontribuues kryesor në ndryshimin e karakterit të luftës moderne.

Përhapja e gjere e MFP ka vijuar me ritme të shpejta dhe këtë e vërtetojnë shifrat që pasojnë. Tetëdhjetë e pesë vende aktualisht kanë dhe operojnë MFP të klasit I²⁵, 44 vende operojnë me klasin II²⁶ të MFP dhe 31 vende operojnë me MFP të klasit III²⁷.

Të paktën shtatë vende që aktualisht nuk operojnë me sistemet e Klasit III besohet të jenë në procesin e blerjes së një MFP të klasit III. Aktualisht, janë gjithsej 171 lloje aktive të MFP nga të cilët 107 janë të klasit I, 36 janë të klasit II dhe 28 janë lloje të klasit III. Ekzistojnë 141 lloje aktive me krahë fiks të dronëve dhe 30 me helikë. Këto 171 lloje aktive të dronëve prodhohen nga 108 subjekte në 43 vende.

Ajo që vlen të theksohet është fakti se deri tani të paktën 15 vende kanë krijuar akademi të dedikuara trajnimit për operatorët e dronëve, megjithëse në shumë vende mund të kenë programe për MFP brenda shkollave të tjera trajnuese. 10 vende kanë aktivizuar shkollat e trajnimit të MFP në dekadën e fundit.

Të paktën 10 vende si: Azerbajxhani, Izraeli, Iraku, Irani, Nigeria, Pakistani, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Britania e Madhe dhe ShBA besohet të kenë përdorur MFP për të kryer sulme ajrore. 30 vende të tjera besohet të kenë marrë ose janë në proces të blerjes së dronëve që janë të aftë për të kryer sulme, megjithëse shumë dronë që mund të mbajnë armë janë përdorur për vëzhgim, zbulim ose për përcaktim të objektivëve për avionët e drejtuar.²⁸

²⁴ Lt. Col. Stephan Pikner, PhD; *Leveraging Multi-Domain Military Deception to Expose the Enemy in 2035*, 2020 Entry U.S. Army, Military Review, march-April 2021, <https://www.armyupress.army.mil/Journals/Military-Review/English-Edition-Archives/March-April-2021/Pikner-Military-Deception/>

²⁵ Klasa I përfshin një varg modelesh që variojnë nga dronë të vegjël që përdoren me dorë. Një avion tipik i klasit I ka një qëndrueshmëri midis një dhe tre orë, një distancë maksimale prej afërsisht 80 km, një kapacitet ngarkese prej 5 kg dhe një shpejtësi maksimale prej 100 kilometrash në orë. Avionët e klasit I lëshohen me dorë ose hekurudhë pneumatike dhe zakonisht vijnë të pajisura me paketën elektro-optike dhe të sensorit infra të kuqe.

²⁶ Klasa II ka një qëndrueshmëri prej 10 orësh, një diapazon maksimal midis 100 dhe 200 km, një kapacitet ngarkese deri në 70 kg dhe një shpejtësi maksimale prej 200 kilometra në orë. Sistemet e klasit II mund të jenë me krahë fiks - që zakonisht kërkojnë një pistë të vogël për nisjen ose rikuperimin.

²⁷ Klasa III ka një qëndrueshmëri deri në 24 orë ose më shumë, një kapacitet ngarkese prej disa qindra kilogramë dhe një shpejtësi maksimale deri në 300 kilometra në orë. Disa prej tyre mund të drejtohen në një distancë prej disa mijëra kilometrash ose më shumë, edhe pse kjo varet nga pajisjet e komunikimit të përdorura. Klasa III përfshin të dy krahët fiks të cilat kërkojnë një pistë për lëshimin dhe rikuperimin dhe helike. Shumë avionë të klasit III janë të aftë të mbajnë një përzierje armësh, edhe pse disa UAV në këtë klasa është krijuar vetëm për zbulim.

²⁸ Dan Gettinger; *The drone databook; the Center for the Study of the Drone at Bard College*, 2020, faqe 20.

Hapësira e ardhshme e betejës do të përfshijë jo vetëm anije, tanke, raketa dhe satelitë, por edhe MFP, algoritme, rrjete dhe sensorë. Si asnjë herë tjetër në histori, luftërat e ardhshme do të zhvillohen në infrastrukturën civile dhe ushtarake të sistemeve satelitore, rrjeteve të energjisë elektrike, rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të transportit, si dhe brenda lidhjeve e grupimeve njerëzore. Të dyja këto fushëbeteja si ajo elektronike dhe ato njerëzore janë të cenueshme nga manipulimi i algoritmeve të kundërshtarit.²⁹

Ushtarakët profesionistë dhe planëzuesit e ardhshëm do të duhet të mendojnë për zhvillimin dhe integrimin e taktikave për përdorimin e automjeteve të kontrolluara në distancë në mjedise operationale komplekse ku përfshihen edhe luftime të këtyre mjeteve në ajër dhe respektivisht për luftime midis platformave tokësore e detare pa pilot.³⁰

Në këtë kontekst, hyrja në arsenalin ushtarak e mjeteve me teknologji të avancuara kërkon edhe ndryshime në mënyrën e planifikimit dhe zhvillimit të luftërave, të cilat gjejnë pasqyrim në ndryshimet doktrinare. Një shembull i tillë është ai i “Blitzkrieg” të Gjermanisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në fazat e hershme të Luftës II Bot., Britania dhe Franca përdorën tanket në mënyrë të tillë që nuk ndryshuan bazat e luftës, ndërsa Gjermania integroi tanket me avionët duke formuar një model të ri më efektiv dhe më të fuqishëm të luftës. Sot sfida është të përcaktohet se si do të integrohen në fushëbetejë MFP që të luftosh më me efikasitet dhe në të njëjtën kohë edhe të mbrohesh prej tyre. Dy koncepte doktrinare tashmë kanë filluar të shfaqen. Koncepti i parë përfshin përdorimin e MFP të kushtueshëm që janë programuar për të gjurmuar, arritur një objektiv dhe më pas të kthehen në një venddislokim të përcaktuar. Ndërsa koncepti tjetër do të përfshinte futjen e shumë robotëve në forme tufe, grupi, me pak të kushtueshëm që veprojnë në mënyrë të pavarur, por në mënyrë sinergjike drejt një qëllimi. Secili robot në vetvete do të kishte pak aftësi, por do të ishte i paraprogramuar për të dërguar një sinjal nëse zbulon një objektiv, duke bërë që tufa, grupi i MFP të drejtohet pastaj në objektiv.

Zbatimi i konceptit të tufës, grupit do të shënonte një ndryshim në evolucionin historik të luftës. Për dy shekuj, fusha e betejës ka ardhur duke u zbratur (në pikëpamje të numrave) në mënyrë progresive. Njerëzimi shkoi nga dyndja masive e luftërave napoleonike, në makineritë më të vogla por ende shumë të mëdha të luftës së epokës industriale të Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore, në forca më të vogla, më të lëvizshme dhe të zhërvjellëta të epokës së informacionit. Masivizimi me dronë do të përfaqësonte një përmbysje në këtë trend. Sasia në këtë rast po rishfaqet si kritikë për të fituar një avantazh ushtarak.³¹

5. Teknologjia dhe informacioni në luftën e fundit ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit

Siç e përmendëm edhe më lart zhvillimet teknologjike kane ecur me ritme të shpejta.

²⁹ Cortney Weinbaum and John N.T. Shanahan; *Intelligence in a Data-Driven Age*; JFQ Nr. 90, 2018, faqe 6.

³⁰ William G. Braun, III Stéfanie von HlatkyKim Richard Nossa; *ROBOTICS AND MILITARY OPERATIONS*; KINGSTON CONFERENCE ON INTERNATIONAL SECURITYSERIES Edited 2018, faqe 29.

³¹ William G. Braun, III Stéfanie von HlatkyKim Richard Nossa; *ROBOTICS AND MILITARY OPERATIONS*; KINGSTON CONFERENCE ON INTERNATIONAL SECURITYSERIES Edited 2018, faqe 30.

Këto zhvillime do të reflektoheshin natyrshëm edhe në mënyrën si planifikohen dhe kryhen luftërat e sotme. Në vijim do të japim fakte dhe analizojmë veprimet e kryera gjatë luftës së fundit ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit.

Lufta e Dytë e Nagorni-Karabakut u zhvillua midis Armenisë dhe Azerbajxhanit më 24 shtator 2020 deri më 10 nëntor 2020. Kjo luftë 44-ditore rezultoi në një fitore ushtarake vendimtare për Azerbajxhanin. Armenia humbi edhe pse kontrollonte terrene dominuese në një rajon malor që favorizonte mbrojtjen tradicionale. Fakti që Azerbajxhani sulmoi Armeninë gjatë pandemisë ishte vetëm një faktor shtesë por ajo që është e jashtëzakonshme është se kjo ishte lufta e parë moderne e rezultatet e së cilës u vendosën kryesisht nga avionët pa pilot. Në këtë luftë, mjeti luftarak ajror BAYRAKTAR TB2 i prodhuar nga Turqia dhe HAROP (Avion pa Pilot kamikaz, vetëvrasës³²) i prodhuar nga Izraeli, dominuan luftimet dhe i siguruan Azerbajxhanit një fitore spektakolare.³³

“Përdorimi i dronëve nga Azerbajxhani ishte vendimtar”, theksoi Prof. Michael Clarke, një bashkëpunëtor i shquar në Royal United Services Institute (Rusi), një qendër studimore ushtarake. Rreth 5,000 ushtarë u vranë nga të dy palët, Armenia humbi 224 tanke krahasuar me 36 nga Azerbajxhani.³⁴

Në ndryshim me Azerbajxhanin, viktimat armene ishin të shpërndarë në të gjithë thellësinë e hapësirës së betejës. Forcat e Azerbajxhanit përdorën zjarr me rreze të gjatë dhe MFP për të goditur zonat e grumbullimit, vendkomandat, logjistikën dhe elementët e manovrës që po i afroheshin zonës së luftimit. Efekti i kësaj përqsajeje ishte që edhe pse forcat armene luftuan mirë në betejën e afërt, ato janë bërë më pak efektive ndërkohe që konflikti vazhdonte pasi përforcimet dhe furnizimi u dobësuan. Azerbajxhani më pas fitoi terriore të konsiderueshme.³⁵

Surpriza nuk ishte se Azerbajxhani fitoi, por si fitoi?. Mund të thuhet se ky ishte konflikti i parë, në të cilin avionët pa pilot mposhtën një forcë konvencionale tokësore deri në pikën e paralizimit, duke iu hapur rrugën forcave tokësore të Azerbajxhanit me qëllim që të merrnin e të zotëronin pikat strategjike. Armenia u detyrua të pranojë një armëpushim poshtërues që në thelb përbën humbjen e kontrollit të saj mbi Nagorni-Karabakun.

“Azerbajxhani përdori dronë luftarakë veçanërisht dhe intensivisht në ditët e para të luftës. Në ditën e parë të luftës, kishte rreth 1000 dronë luftarakë në qiell në zonat jugore dhe veriore të rajonit. Kjo nuk është një luftë për njerëzit me mitraloza, por për dronët, artilerinë dhe sistemet e raketave. “Luftëtarët armene konfirmuan që kane gene nën zjarrin e koncentruar e të vazhdueshëm nga dronët. “Kjo nuk është lufta që kemi luftuar në vitet

³² Është një tip MFP i projektuar për të goditur objektiva tokësorë që janë përtej rrezes së shikimit të drejtpërdrejtë. Goditja bëhet me lëndën shpërthyesë që është pjesë e tij. Ky mjet identifikon dhe godet objektivin në mënyrë autonome bazuar në programin që ka dhe jo nga operatori (personeli) në distancë. Ndryshe quhet MFP kamikaz, vetëvrasës.

³³ John Antal; *The First War Won Primarily with Unmanned Systems Ten Lessons from the Second Nagorno-Karabakh War*, 2021, faqe 5.

³⁴ Po aty, faqe 7.

³⁵ Jack Watling and Sidharth Kaushal; *The Democratisation of Precision Strike in the Nagorno-Karabakh Conflict*; Commentary, 22 October 2020 Military Sciences. Burimi elektronik në: <https://www.cacianalyst.org/publications/analytical-articles/item/13665-nagorno-karabakh-the-democratization-of-precision-strike-and-the-viability-of-military-power.html>

1992-1994," tha Narek Hovhannisyann, një pjesëmarrës i asaj luftime të parë dhe tani vullnetar në vijën e frontit. "Për dhjetë ditë, njësisia jonë përdori vetëm një herë automatikun. Të gjitha ditët e tjera, dronët dhe predhat e topave po binin si breshër mbi ne. Në këtë luftë ushtarët përdoren më shumë lopatat për të hapur llogore mbrojtëse sesa armët.³⁶"

Kjo luftë përbën një moment historik në çështjet ushtarake, sepse ishte konflikti i parë në të cilin MFP ishin vendimtarë duke vendosur edhe fatet e luftës. Çelësi i fitores të Azerbajxhanit ishte fuqia ajrore e mjeteve fluturuese pa pilot e kombinuar me luftën elektronike që verboi radarët armenë, duke lehtësuar kështu shkatërrimin e baterive të saj të mbrojtjes ajrore. Lufta ofroi një paraqitje të shkurtër të mjedisit të ardhshëm operacional në të cilin mjetet fluturuese pa pilot dhe lufta elektronike³⁷ mund të mbizotërojnë fushëbetejën.³⁸

Mjetet e goditjes me precizion nga ajri siç është mjeti izraelit Harop janë përdorur gjerësisht nga Azerbajxhani. Përdorimi më i dukshëm i Harop ishte në një sulm kundër një venddislokimi raketash armene tokë-ajër (SAM) S-300 në Shuskakend.

Mjete të tilla si Harpy dhe Harop janë funksionalisht të ngjashme me raketat, me rreze nga 500 deri në 1000 km, por kanë sisteme të ndryshme shtytëse dhe mbajnë ngarkesa më të vogla. Ngarkesat e tyre janë të mjaftueshme për të goditur pika me vlerë të lartë dështimi, të tilla si radari i sistemeve SAM, duke përdorur ose kthimin e rrezatimit, ose një kombinim të sensorëve infra të kuq dhe elektro-optik.

MFP Harop është një mjet i ri që në thelb është një MFP kamikaze ose vetëvrasëse. Një kombinim i bombës dhe dronit, ai qëndron mbi fushën e betejës dhe në momentin që e gjen/përcakton objektivin drejtohet drejt tij, duke shkatërruar si veten ashtu edhe objektivin. Harop ose Harpy mund të dëgjohej për shkak të motorit të tij, por modelet më të reja kamikaze MFP si Skystriker dhe Orbiter 1K, të furnizuar kohët e fundit nga Izraeli në Azerbajxhan, përdorin motorë elektrikë dhe janë praktikisht pa zhurmë derisa të fillojnë sulmin e tyre.³⁹

Kapaciteti tjetër i rëndësishëm ka qenë përdorimi i avionëve Bayraktar TB2 të prodhuar në Turqi. Me një kohë të arsyeshme dhe municione të drejtuara, këta i kanë dhënë mundësi forcave të Azerbajxhanit të fillojnë sulmet në thellësi të forcave armene për t'i gjetur,

³⁶ KARABAKH CRISIS UAVs a Gamechanger in Karabakh The scale of hostilities, including the use of precision-guided weapons, has already exceeded previous escalations. This publication was prepared under the "Giving Voice, Driving Change - from the Borderland to the Steppes Project" implemented with the financial support of the Foreign Ministry of Norway.

³⁷ Luftë elektronike (electronic warfare) – Veprim ushtarak për të shfrytëzuar spektrin elektromagnetik, i cili përfshin kërkimin, kapjen dhe identifikimin e emetimeve elektronike, përdorimin e energjisë elektromagnetike, duke përfshirë energjinë e drejtuar, për të pakësuar ose parandaluar përdorimin e spektrit elektromagnetik nga armiku, si dhe veprimet për të siguruar përdorimin e efektshëm të tij nga forcat e veta.

³⁸ Uzi Rubin; *The Second Nagorno-Karabakh War: A Milestone in Military Affairs*, THE BEGIN-SADAT CENTER FOR STRATEGIC STUDIES BAR-ILAN UNIVERSITY Mideast Security and Policy Studies No. 184. Burimi elektronik në: <https://besacenter.org/nagorno-karabakh-war-milestone/>

³⁹ Alex Gatopoulos; *The Nagorno-Karabakh conflict is ushering in a new age of warfare*, 11 Oct 2020. Burimi elektronik në: <https://www.aljazeera.com/features/2020/10/11/nagorno-karabakh-conflict-ushering-in-new-age-of-warfare#:~:text=Features%7CMilitary,The%20Nagorno%2DKarabakh%20conflict%20is%20ushering%20in%20a%20new%20age,conflict%20between%20Armenia%20and%20Azerbaijan.&text=Turkish%20Air%20Force%20fighter%20jets,alongside%20the%20Azerbaijani%20armed%20forces>

penguar dhe goditur ato. Ata gjithashtu kanë siguruar zbulim, vëzhgim dhe rikonicion, duke mundësuar përdorimin e saktë të artilerisë dhe sistemeve të raketave të padrejtuara, duke i kthyer kështu ato kapacitete jo të shtrenjta konvencionale në sisteme vdekjeprurëse zjarri me rreze të gjatë. Së bashku këto kanë shkatërruar mbi 100 tanke armene T72.⁴⁰

Nga pikëpamja operationale, këto sisteme ofrojnë një numër përparësish. **Së pari**, dronët janë më të lehtë për të operuar sesa shumë sisteme të përparuara të armëve të tilla si raketa ose avionë me krahë fiks. Teknologjia nuk është komplekse dhe është gjerësisht e disponueshme. Dronët më të mëdhenj të përdorur në sulmet e shtatorit 2019 ndaj objekteve Saudi Aramco në Khurais dhe Abqaiq (Arabia Saudite) vlerësohet se kanë kushtuar vetëm 15,000 dollarë ose më pak për t'u ndërtuar. Ky shpenzim është i krahasueshëm me shpenzimet e montimit të një makine bombe vetëvrasëse midis 13,000 dhe 20,000 dollarë. Për më tepër këto sisteme detyrojnë armikun të shpenzojë burime të konsiderueshme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj tyre.⁴¹

Gjithashtu, ajo që vlen të theksohet nga përvoja e kësaj lufte është fakti se sot maskimi i mjeteve dhe personelit për t'u fshehur nga vëzhgimi i armikut është pothuajse i pamundur. Përhapja e kamerave termike dhe infra të kuqe e bën fshehjen shumë të vështirë gjatë natës ose ditës. Madje edhe automjetet me mburojë termike të dedikuar mund të diktohen thjesht nga lëvizje për nevoja njerëzore apo të pakujdesshme të personelit.⁴²

Kjo luftë tregoi qartë se fushëbeteja sot është transparente. Sensorët⁴³ azerbajxhanas, kryesisht të montuar në MFP, i dhanë ushtrisë azerbajxhanase një pamje të qartë, 24-orëshe të hapësirës së betejës. Pozicionet armene që ishin të maskuara në mënyrën tradicionale identifikoheshin nga kamerat elektro-optike dhe termike. Platformat e Zbulimit, Vëzhgimit dhe Rikonicionit u integruan me aftësinë goditëse të dronëve TB2 dhe HAROP. Videot me rezolucion të lartë dhe në kohë nga platformat e Zbulimit, Vëzhgimit dhe Rikonicionit dhanë panoramë të qartë të sistemeve të shkatërruara dhe personelit të goditur duke ofruar vlerësime të sakta të dëmtimeve në fushëbetejë.

Megjithëse të dy palët kishin mjaft tanke, duket se ato rrallë futeshin brenda rrezes së goditjes dhe shumica e luftimeve zhvilloheshin në distancë. Integrimi i tankeve dhe këmbësorisë mund të jenë ende vendimtar në fushëbetejë, pasi platformat ajrore nuk mund të marrin dhe mbajnë terren, por vetëm nëse forcat tokësore mbijetojnë aq kohë sa të lëvizin brenda rrezes së drejtpërdrejtë të zjarrit. Gjatë luftës, kishte më shumë luftime të ngurta, pozicionale, sesa luftime të afërta luftarake.⁴⁴

⁴⁰ Austin C. Doctor and James I. Walsh; *The Coercive Logic of Militant Drone Use* ©2021 Austin C. Doctor and James I. Walsh 76 Parameters 51(2) Summer 2021, faqe 73.

⁴¹ Po aty, faqe 76.

⁴² Jack Watling, *The Key to Armenia's Tank Losses: The Sensors, Not the Shooters*, RUSI Defence Systems, 6 October 2020. Burimi elektronik në: <https://rusieurope.eu/publication/rusi-defence-systems/key-armenia-tank-losses-sensors-not-shooters>

⁴³ Sensor, ndjesor (sensor) – pajisje që zbulon dhe mund të tregojë ose të regjistrojë objekte e veprimtari nëpërmjet energjisë a grimcave që emetohen, pasqyrohen ose modifikohen nga objekti.

⁴⁴ *Drones after Karabakh: The age of permanent war is coming*, 01/11/2021. I aksesueshëm në: <https://uwidata.com/15106-drones-after-karabakh-the-age-of-permanent-war-is-coming/>

Përdorimi i dronëve ndikoi veçanërisht edhe në fitoren e luftës së informacionit. Të dy palët zhvilluan një fushatë të operacioneve të informacionit. Azerbajxhanasit mbizotëruan MI përmes përdorimit të pamjeve të plota video të siguruara nga sistemet ajrore të vëzhgimit dhe raketave të drejtuara. Imazhet e platformave të mbrojtjes ajrore armene, artilerisë, tankeve, automjeteve luftarake të këmbësorisë dhe trupave duke u shkatërruar në këto video shfaqeshin në të gjitha mediat sociale. Shumë prej sistemeve armene të mbrojtjes ajrore të prodhuara nga Rusia u regjistruan dhe u shfaqen me radarët e tyre që rrotulloheshin pak para se një dron tip HAROP ose mikro-municion i zgjuar të shkatërronte plotësisht sistemin. Këto video treguan se si Armenia po e humbte luftën dhe nuk mund të bënte asgjë për të ndaluar sulmet e Azerbajxhanit. Këto pamje ndikuan që Armenia të dorëzohet në kushtet e armëpushimit të Azerbajxhanit duke i dhënë një fitore vendimtare Azerbajxhanit. Këto video gjithashtu u bënë një mesazh i suksesshëm marketingu dhe TB2 dhe HAROP janë tashmë produktet më të kërkuara në tregun ndërkombëtar të armëve.⁴⁵

Dronët janë të pajisur me aparat fotografik dhe mund të fiksojnë pamje të disfatës të armikut. Një kundërshtar që nuk përdor vetë dron nuk mund të kundërshtojë asgjë. Kjo është e ngjashme me efektin e operacionit amerikan “Stuhia e Shkretëtirës”, ku SHBA demonstroi fuqinë e makinës së saj të luftës përmes goditjeve të sakta të raketave dhe të bombardimeve. Dronët na lejojnë të bëjmë të njëjtën gjë, por me një kosto më të ulët.

Në të ardhmen, ne do të shohim përdorimin gjithnjë e më të gjerë të dronëve në fushën e betejës. Përdorimi i dronëve heq pengesat përfshirë ato psikologjike për përdorimin masiv të fuqisë ajrore. Eksperti britanik Edward Davies vëren se “Përdorimi i dronëve nga Armenia dhe Azerbajxhani, të cilët posedojnë vetëm një numër të kufizuar të avionëve me krahë fiks, përfaqëson heqjen e barrierave teknologjike dhe financiare që normalisht kanë mjetet tradicionale të fuqisë ajrore. Në këtë mënyrë, dronët kanë mundësuar përdorimin e fuqisë ajrore nga aktorë të cilët përndryshe nuk do të kishin mundësi apo do të kishin një kufizim të theksuar në përdorimin e fuqisë ajrore në një shkallë të tillë.”⁴⁶

6. Përfundime

Zhvillimet teknologjike dhe informacioni kanë bërë që MO të ndryshojë vazhdimisht dhe në mënyrë të paparashikueshme. Njohja e teknologjisë së re dhe integrimi i saj në taktikat dhe metodat e sotme të luftës është parakusht për të arritur sukses në mjedisin e sotëm operacional.

Pavarësisht llojit të operacioneve, teknologjia dhe informacioni janë elemente thelbësore në planëzimin dhe zhvillimin e tyre. MFP, si një nga teknologjitë e reja, po përdoren gjithnjë e më shumë në operacione luftarake dhe joluftarake në kohë paqe, krize e lufte, duke rritur ndjeshëm fuqinë luftarake të palës që disponon dhe i përdor duke i integruar edhe me teknologji të tjera bashkëkohore.

Shembulli tipik për epërsinë që të krijon përdorimi i MFP ishte lufta e fundit e vitit 2020

⁴⁵ Po aty, faqe 6.

⁴⁶ Drones after Karabakh: The age of permanent war is coming, 01/11/2021. I aksesueshëm në: <https://uwidata.com/15106-drones-after-karabakh-the-age-of-permanent-war-is-coming/>

ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit. Format dhe llojet e MFP të përdorura tregojnë se fushëbeteja nuk është dhe nuk do të jetë kurrë si më parë.

MFP tashmë janë dhe do të jenë pjesë e rëndësishme e MO. MFP ose robotë të vegjël mund të veprojnë si tufa në tokë, në ajër ose në ujë, ata mund të krijojnë një hapësirë të caktuar për të vendosur se kur do të përdorin aftësitë e tyre vdekjeprurëse. Duke komunikuar me njëri-tjetrin dhe përpunuar informacionin në lidhje me armikun në kohë reale, ata mund të përqendrojnë sulmet atje ku mbrojtjet janë më të dobëta, në një formë shumë të shpejtë dhe me saktësi.

Zhvillimet kompjuterike kanë sjellë një rritje të ndjeshme edhe të cenueshmërisë kibernetike. Kompjuterizimi i veprimtarisë tonë ka krijuar edhe shumë pika të dobëta në të gjithë aktivitetin e përditshëm. Në këtë pikëpamje, siguria kibernetike është gjithnjë e më vendimtare në mbarëvajtjen e një operacioni por edhe të aktivitetit të përditshëm.

Duke u nisur nga ndryshimet e shpejta e të paparashikuara të MO dhe zhvillimeve të vrullshme teknologjike, Forcat tona të Armatosura duhet të vlerësojnë pandërprerë ato në kuadrin e përfitimit përsa i përket përdorimit të teknologjisë, si dhe njohjes për marrjen e masave të kundërveprimit kur ato përdoren ndaj tyre. Në këtë kuadër, tendencat e zhvillimit dhe përdorimit të teknologjisë, operacionet e informacionit, operacionet psikologjike, siguria kibernetike, kapacitetet operacionale të MFP duhet të njihen mirë nga personeli që merr pjesë dhe është përgjegjës për planëzimin dhe ekzekutimin e të gjitha llojeve të operacioneve në të tre nivelet.

Bibliografia:

1. Alec Ross, *The Industries of the Future*; Publisher Simon & Schuster, 2016
2. Jared Diamond; *Guns, Germs, and Steel: The Fates of Human Societies* ; Published 2005 by W.W. Norton & Company (first published May 9th 1997)
3. Dan Gettinger; *THE DRONE DATABOOK*; THE CENTER FOR THE STUDY OF THE DRONE AT BARD COLLEGE, 2020
4. AAP-6 NATO Glossary of Terms and Definitions.
5. AJP-3.10 Allied Joint Doctrine for Information Operations, (STANAG 2508 Edition 4, AJP-3.10.1 Edition B, Version 1).
6. STANAG 2508 Edition 4, AJP-3.10.1 Edition B, Version 1 – Allied Joint Doctrine for Psychological Operations
7. Samuel C. Woolley and Philip N. Howard; *Computational Propaganda Political Parties, Politicians, and Political Manipulation on Social Media*, Published to Oxford Scholarship Online: November 2018
8. James Derleth, PhD; *Russian New Generation Warfare Deterring and Winning at the Tactical Level*, September-October 2020 Military Review, Army University Press.
9. Scott S. Haraburda; *Benefits and Pitfalls of Data-Based Military Decisionmaking*; 201
10. A. Ertan, K. Floyd, P. Pernik, T. Stevens (Eds.); *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis*, NATO CCDCOE Publications.

11. Nick Reynolds; *Royal United Services Institute for Defence and Security Studies Performing Information Manoeuvre Through Persistent Engagement*, RUSI Occasional Paper, June 2020.
12. A. Ertan, K. Floyd, P. Pernik, T. Stevens (Eds.); *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis 2020* by NATO CCDCOE Publications.
13. Michael C. Horowitz; *Artificial Intelligence, International Competition, and the Balance of Power*, Texas National Security Review: Volume 1, Issue 3 (May 2018)
14. NATO Modern Warfare and Unmanned Aerial Vehicles, PRAŽSKÝ STUDENTSKÝ SUMMIT, XIX, NATO, III
15. Lt. Col. Stephan Pikner, PhD; *Leveraging Multi-Domain Military Deception to Expose the Enemy in 2035*, 2020 Entry U.S. Army, Military Review, march-April 2021, <https://www.armyupress.army.mil/Journals/Military-Review/English-Edition-Archives/March-April-2021/Pikner-Military-Deception/>
16. Courtney Weinbaum and John N.T. Shanahan; *Intelligence in a Data-Driven Age*; JFQ Nr. 90, 2018
17. William G. Braun, III Stéfanie von Hlatky Kim Richard Noss; *ROBOTICS AND MILITARY OPERATIONS*; KINGSTON CONFERENCE ON INTERNATIONAL SECURITY SERIES Edited 2018
18. Jack Watling and Sidharth Kaushal; *The Democratisation of Precision Strike in the Nagorno-Karabakh Conflict*; Commentary, 22 October 2020 Military Sciences
19. Uzi Rubin; *The Second Nagorno-Karabakh War: A Milestone in Military Affairs*, THE BEGIN-SADAT CENTER FOR STRATEGIC STUDIES BAR-ILAN UNIVERSITY Mideast Security and Policy Studies No. 184. I aksesueshëm në: <https://besacenter.org/nagorno-karabakh-war-milestone/> .
20. Austin C. Doctor and James I. Walsh; *The Coercive Logic of Militant Drone Use* ©2021 Austin C. Doctor and James I. Walsh 76 Parameters 51(2) Summer 2021
21. *Drones after Karabakh: The age of permanent war is coming*, 01/11/2021. I aksesueshëm në: <https://uwidata.com/15106-drones-after-karabakh-the-age-of-permanent-war-is-coming/>

SFIDAT E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK TË MBROJTJES – PËRBALLJA ME NATYRËN, KËRCËNIMET DHE RREZIQET HIBRIDET NDAJ VENDIT TONË

Kolonel Msc. David Rroku

Shefi i Departamentit të Kërkimit për Mbrojtjen dhe Sigurinë Kombëtare, IKSHU

Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj

Specialist në Departamentin e Kërkimit për Mbrojtjen dhe Sigurinë Kombëtare, IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Të kuptuarit e kontekstit në të cilin ndodh agresioni hibrid kërkon një qasje si nga perspektiva e faktorëve klasikë përmes analizës së situatës, ashtu edhe prej faktorëve shoqërorë, siç janë kultura, feja dhe nivelet e rezistencës së popullsisë, pasi konfrontimet ushtarake përfshijnë një bashkim të taktikave, teknikave dhe procedurave, të cilat janë klasike/konvencionale dhe asimetrike/jokkonvencionale.

Gjatë kësaj periudhe, shumë palë në konflikt, të përbërë nga aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, po përdorin armët moderne në veprimet e tyre. Ashtu si Carl von Clausewitz vuri në dukje se çdo epokë ka llojin e vet të luftës, kushtet dhe kufizimet e veta dhe paramendimet e pazakonta, nga ku konflikti i epokës moderne karakterizohet nga hibriditeti. Sipas mendimit të disa teoricienëve ushtarakë, teoria e konflikteve moderne përfaqëson një produkt të konceptimit të luftës me të gjitha veçoritë që rrjedhin prej saj, nga të cilat më të rëndësishmet do të detajojmë në këtë shkrim.

Fjalët kyçe: konflikt/luftë hibride, procesi i planifikimit dhe rreziqet e sigurisë, siguria kombëtare

1. Hyrje

Kuadri i përgjithshëm teorik i konfliktit modern ka imponuar dy nocione “siguria” dhe “mbrojtja”, ku siguria i referohet “të qenit i sigurt nga çdo rrezik, me ndjenjën e besimit e të qetësisë që jep mungesa e një rreziku” dhe mbrojtja përfaqëson “kundërshtim, rezistencë përballë një sulmi ose rreziku” ose nga pikëpamja ushtarake, “një nga format kryesore të luftimit që synon të ndalojë ofensivën e armikut.”

Është vërejtur se marrëdhënia midis sigurisë dhe mbrojtjes gjithnjë e më shumë përcaktohet nga perceptimi i qytetarëve se si ajo ndikohet në normalitetin e tyre ekzistencial dhe nga vetëdija për mundësinë e përdorimit të disa mjeteve dhe veprimeve mbrojtëse.

Nëse i referohemi fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe, termi “rrezik” përkufizohet si “mundësi e futjes në rrezik, të ballafaqimit me një problem ose duke pësuar një humbje; rrezik i mundshëm”.

Termi rrjedh nga fjala franceze “risque”, që do të thotë një rrezik ndaj të cilit eventualiteti mund të matet në një pikë, e cila mund të parashikohet në një masë të caktuar.

Pra, termi rrezik duhet të trajtohet nga perspektiva e mundësisë së qenies në rrezik mund të konsiderohet si një kërcënim, por edhe një rrezik.

Zakonisht, rreziqet shoqërohen me kërcënime, një nocion që individualizohet nga një shkas faktor në mënyrë që të arrihet një objektiv i caktuar.

Kështu, kërcënimi mund të përcaktohet si një rrezik potencial i shprehur përmes gjesteve ose fjalëve, përmes të cilave sponsori ndjek arritjen e objektivave, qëllimeve ose synimeve.

Në këtë kontekst, rreziku mund të përkufizohet si “karakteristikë e një veprimi ose mosveprimi duke dëmtuar gjërat e vlefshme të një shoqërie, personat ose mallrat e saj, në të cilat burimi, adresa, qëllimi, objektivat dhe efektet janë të mundshme”¹.

Por, dobësitë, kërcënimet dhe rreziqet janë analizuar në veçanti në lidhje me prirjet ekonomike, politike, ushtarake, shkencore dhe kulturore, në skemat që përfshijnë ekuilibrat, interesat dhe qëllimet.

Duke analizuar shkurtimisht trinomin e rrezikshmërisë - rrezikut dhe lidhjen e tij me binom i sigurisë dhe mbrojtjes, ne mund të vlerësojmë se niveli optimal i sigurisë mund të jetë plotësisht siguria duke zvogëluar dobësitë dhe parandaluar ose zvogëluar nivelin e kërcënimeve.

Në secilën nga këto raste, mjetet dhe metodat hibride përdoren kundër forcave

¹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare, botimi 2014.

konvencionale në variante të ndryshme, mbi bazën e të cilave mund të bëjnë parashikimin e mënyrave të mundshme të shfaqjes së tyre.

Sipas studimit të disa teorive nga analistë në fushën ushtarake, lloji i kërcënimit hibrid mund të përcaktohet si veprimi i një kundërshtari, entiteti shtetëror ose joshtetëror, që përdorin dhe bashkërendojnë aktivitetet politike, ushtarake, ekonomike, sociale ose informative brenda kombinimeve të metodave konvencionale ose jokonvencionale të veprimeve në mënyrë që të arrihet objektivat e ndjekura.²

Por ajo që diferencon kërcënimet hibride të pranishme nga ato që janë manifestuar në konfliktet e kaluara ushtarake është kërcënimi klasik ose konvencional (betejë e dhunshme midis dy ushtrive), i cili dallohet në sfond ose mund të mungojë plotësisht në konfliktet moderne hibride. Me fjalë të tjera, në hapësirën operationale hibride pjesa më e madhe e mënyrave të konfliktit migron nga ato të rregullta në ato jokonvencionale, veçanërisht në ato asimetrike.

Prandaj, hibriditeti i manifestuar në forcat e konflikteve të fundit (të përfunduara ose ende në progres) vendimmarrësit ushtarakë për të zbatuar detyrat e strukturave ushtarake, marrin masat procedurale dhe teknike të nevojshme për t'iu kundërvënë gjerësisht sfidave jokonvencionale. Si rregull, kërcënimi i tipit hibrid përdoret me një fuqi ushtarake më të ulët në mënyrë që të ekuilibrohet raporti i forcave dhe / ose të arrihen objektivat me sa më pak humbje të jetë e mundur.

Një tjetër tipar i kërcënimit hibrid është se ai përfshin përpjekjet kundërvepruese dhe e zgjat gjendjen e konfliktit derisa të bëhet luftë, në të cilën kombinimi i veprimeve luftarake klasike dhe asimetrike. Si të tilla, (p.sh. pritë ose sabotimi), të cilat zvogëlojnë ndjeshëm fuqinë luftarake të kundërshtarit konvencional.

2. Planifikimi sipas analizës së karakteristikave të kërcënimeve hibride

Nga analiza e teorive të specialistëve ushtarakë shqiptarë dhe të huaj shfaqen karakteristikat e mëposhtme të kërcënimeve hibride:

- **Kompleksiteti:** kërcënimet hibride janë shumë më të vështira për t'iu kundërvënë për shkak të ritmit të tyre të shpejtë, kompleksitetit, si dhe karakterit të tyre transnacional; përveç kësaj, kundërshtarët, mund t'i shfaqin veprimet e tyre në fushat e jetës shoqërore (politike, ekonomike, sociale, informuese, etj.), për të amplifikuar efektet e taktikave konvencionale luftarake.

- **Ndjeshmëri e ulët:** e krijuar kryesisht për shkak të mungesës së rrethanave të armikut; më së shumti ndryshimi i veçantë në karakterin e kërcënimeve hibride është mungesa e saktësisë në përcaktimin e natyrës së forcave dhe formave luftarake; komanda dhe struktura e kontrollit (C2) e një kundërshtari të tillë që nuk është e lehtë për t'iu zbuluar sidomos për shkak të mungesës së PSV-ve (Procedurat Standarde të Operimit).

- **Përfundimi:** efektet e kërcënimit hibrid vijnë nga aftësia për të përdorur përparësitë specifike të secilit lloj të forcave për të rritur efektin shkatërrues në veprimet tyre (për

² Cornel Văduva, Ndikimi i veprimeve hibride në operationet ushtarake, punim i gradës Master, "Carol I" Kombëtare Shtëpia botuese e Universitetit të Mbrojtjes, Bukuresht, 2016, f. 41-42.

shembull, cenueshmëria e një kundërshtari inferior mund të shndërrohet në një avantazh përmes përdorimit të taktikave inteligjente dhe mjeteve jokonvencionale).

- **Përshtatshmëri e lartë:** një konflikt hibrid përfshin jo vetëm zbatimin e njëkohshëm të teknikave, taktikave dhe procedurave konvencionale dhe jokonvencionale (TTP) në luftë, por gjithashtu, përshtatja e vazhdueshme e tyre; përveç kësaj, kundërshtari i cili do të fillojë një lloj agresioni hibrid mund të ndryshojë njësitë konvencionale në formacione të parregullta dhe të miratojë taktika të reja.

- **Rritja e vdekshmërisë:** kërcënimi hibrid kombinon natyrën shkatërruese të ndër-shteteve në konflikt me fanatizmin e luftës tepër asimetrike (terrorizmi), me efektin shkatërrues që amplifikohet nga qasja e lehtë në mundësitë e armëve moderne dhe mjetet e inteligjencës, etj.

- **Kapacitet i lartë riprodhues:** me shumëzimin global të burimeve të hapura të informacionit (OSINT)³ në sfond, kundërshtarët kanë aftësinë për të marrë TTP⁴.

- **Duke vepruar në kushte të vështira jashtë normave dhe ligjet ndërkombëtare:** ligjëruesit do të përpiqen të bëjnë manipulimin dhe ripërcaktojnë legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe institucionet, për të maksimizuar përfitimet e tyre.

- **Shfrytëzimi i hapësirës së informacionit:** kërcënimi hibrid zhvillohet brenda dimensionit të hapësirës informative (njohëse, materiale dhe informative), por veçanërisht në zonat e njohura.

3. Identifikimi i kërcënimeve, rreziqeve dhe dobësive hibride

Në një shikim të parë, të gjitha luftërat i ngjajnë njëra-tjetrës, duke u karakterizuar nga një tërësi universale ligjesh dhe parimesh të vlefshme, por, në të vërtetë, çdo konflikt ushtarak ka qenë unik dhe i papërsëritshëm.

Shfaqja e strategjive hibride ka sjellë një ndryshim rrënjësor të luftimeve të armatosura, e cila është përdorur si nga entitetet joshtetërore, ashtu edhe nga disa vende që aplikojnë strategji hibride në funksion të ballafaqimit të mundshëm të kërcënimeve jokonvencionale.⁵

Nëse, në të kaluarën, lufta konvencionale do të ishte një luftë e armatosur midis shteteve (ose koalicioneve / aleanca) në të cilën popullata në zonën e operacioneve zakonisht nuk ishte e përfshirë, hibridi i sotëm, konflikti vendos me theks për kontrollin ose ndikimin e popullatës (veçanërisht etnike, pakicat) dhe jo për kontrollin e forcave ose pushtimin e territorit armik.

Pra, ne mund të përfaqësojmë konfliktin hibrid si një luftë politike në të cilën qendra e gravitetit është kontrolli i popullatës. Nga ky këndvështrim, një çështje kritike gjatë konfrontimit hibrid është brezi i paqartësisë si në brendinë e popullatës, ashtu edhe brenda

³ OSINT, ose inteligjencë me burim të hapur, është praktika e mbledhjes së informacionit nga burime të botuara ose ndryshe, të disponueshme nga publiku.

⁴ Versione për printer në anglisht dhe të përkthyer në mënyrë profesionale (versioni i vjetër) frëngjisht, italisht, portugez, bisht, rusisht dhe kinezisht e thjeshtuar mund të gjenden KERETU. Versionet gjermane dhe spanjolle (më të vjetra) janë gjithashtu të disponueshme KTU, por ato përkthime janë bërë nga vullnetarë dhe saktësia e përmbajtjes nuk është vërtetuar (*mashtrim*). Përmbajtja është menduar vetëm për qëllime informative dhe nuk ka për qëllim të zëvendësojë konsultimin nga një profesionist i njohur.

⁵ C. Vardova, Ndikimi i veprimeve hibride në operacionet ushtarake, f. 32

bashkësisë ndërkombëtare për të fshehur synimet; paqartësia mund të paralizojë reagimin e kundërshtarit dhe të kufizojë aftësinë e bashkësisë ndërkombëtare për t'iu përgjigjur agresionit.⁶

Në mënyrë që një kërcënim të klasifikohet si hibrid, forcat ose mjetet (hibride) duhet të kenë të paktën dy përbërës: konvencional dhe jokonvencional dhe qasja duhet të jetë shumëdimensionale në mënyrë që të ndikojë në shumë zona dhe të jetë e mundur njëkohësisht.⁷

Me tiparin e përshtatjes së shpejtë me situatat e reja, përbërësit e hibridit, kërcënimet, azhurnohen vazhdimisht, gjë që çon në përditësimin e vazhdueshëm të listës së kërcënimeve hibride. Në këtë aspekt, ne mund të vlerësojmë se agresioni hibrid konsiston në një bashkim veprimesh që kryhet nga disa rregulla konvencionale dhe të tjera jokonvencionale (asimetrike ose hibride), si më poshtë:

- **Konvencionale:** si rregull, Forcat e Armatosura kryejnë operacione speciale, të përcaktuara nga autoritetet kombëtare; kanë aftësi sulmuese dhe mbrojtëse, shërbejnë interesat e shtetit ose aleancës dhe veprojnë në përputhje me legjitimitetin e tyre.

- **Jokonvencionale:** të gjitha forcat, mjetet dhe metodat e tjera ato të rregullta; në nivelin shtetëror, forcat përfaqësohen nga Forcat e Operacioneve Speciale (SOF) dhe forcat paraushtarake që i përkasin sistemit të mbrojtjes e të sigurisë së një shteti; në nivelin e njësisë joushtetërore, gjejmë forca të parregullta të përbëra nga grupe paramilitare, kryengritëse, grupe terroriste, guerile, mercenare, partizane; llojet e tjera të mjeteve e të mënyrave të veprimit janë informative, psikologjike, ekonomike, radio-elektronike, kibernetike, gjeofizike, migrimet, etj.

Sidoqoftë, në literaturën e specializuar, termi “kërcënim hibrid” shpesh përdoret në vend të agresionit hibrid të paktën për dy arsye: nga njëra anë, qëllimi është të nxjerrë në pah natyrën pro aktive të veprimit për të kundërshtuar agresionin hibrid (për të eliminuar kërcënimin para se të manifestohet dhe bëhet një agresion) dhe, nga ana tjetër, për shkak të një boshllëku ligjor.

Prandaj termi kërcënim përdoret kur siguron kornizën ligjore për iniciimin dhe kryerja e veprimeve parandaluese kundër kërcënimeve të mundshme të konsideruara si një agresion.

Gjithashtu, termi hibrid shfaqet të paktën në tre kombinimet e mëposhtme:

- **Kërcënimi hibrid**, që përfaqëson aftësitë e një ose më shumë aktorëve shtetërorë ose joushtetërorë ndaj përdorimit të një përzierjeje veprimesh konvencionale dhe jokonvencionale për të arritur objektivat e synuara.

- **Konflikti hibrid**, që është përdorimi i njëkohshëm i mjeteve konvencionale dhe jokonvencionale gjatë luftës dhe përshtatja e përhershme e tyre me veprime joushtarake (politike, ushtarake, ekonomike, sociale, informative ose diplomatike), në mënyrë që të arrihen qëllimet politiko-ushtarake.

- **Lufta hibride**, do të thotë angazhim i njëkohshëm i mjeteve të luftimit konvencional e jokonvencional dhe përshtatja e tyre me ato joushtarake (politike, ushtarake, ekonomike,

⁶ Qasja e integruar - një domosdoshmëri për t'iu kundërvënë veprimeve të përshkruara nga lufta hibride, f. 44

⁷ Silviu-Stelian Borşa, Zbatueshmëria e strategjive konvencionale në menaxhimin e konflikteve hibride.

sociale, informative ose diplomatike), në mënyrë që të arrihen qëllimet e propozuara politiko-ushtarake.

Mënyra hibride e veprimit e përdorur nga Federata Ruse kundër Ukrainës nuk mund të përdoret në të njëjtën mënyrë për një shtet tjetër. Në mënyrë që të kuptojmë veçoritë e konflikteve hibride, rreziqet dhe kërcënimet që paraqesin, ato janë të pranishëm në strategjitë e reja (hibride) në faza të ndryshme të konfrontimit që duhet të studiohen dhe deshifrohen.

Në fazën e parë të konfrontimit, veprime jo-kinetike (politik, ekonomik ose diplomatik), inteligjencë (mbledhje dhe keqinformim) operacionet psikologjike (për të ndikuar dhe dekurajuar kundërshtarin), aktiv (përdorimi i aftësive të tyre në hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të kontrolluar nga kundërshtari) dhe pasive (duke nënvizuar rrezikun e ndërhyrjes ushtarake ose goditjeve paraprake) kryhet parandalimi ushtarak.

Më pas, në fazën aktive të konfrontimit, forca ushtarake fillon të përdoret në dimensionin fizik të luftës, përveç masave të fazës së parë që mbeten aktive. Kjo fazë mund të përfshijë, rast pas rasti, imponimin e zonave të ndalimit të fluturimit ose bllokada detare, bombardime me sisteme me precizion të lartë, mbështetje për veprimin e forcave të opozitës, të fshehta etj.

Në një mjedis operativ, ku disa aktorë shtetërorë ose joshtetërorë bashkëjetojnë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet modelit (identifikimit dhe më pas kundërveprimit) të kërcënimeve që secili mund të gjenerojë dhe, së fundi, të atyre që zbatojnë objektivin e marrë.

4. Mënyrat e identifikimit të kërcënimeve hibride

Mënyra më e mirë për të identifikuar dhe analizuar kërcënimet, rreziqet dhe dobësitë mund të jetë në faza, siç janë:

Identifikimi i kërcënimeve (përfshi rreziqet dhe dobësitë) dhe i aktorëve (objektivi i synuar i agresionit) duke analizuar mjedisin operacional dhe të sigurisë; kjo mund të rezultojë në një tabelë të kërcënimeve, rreziqeve dhe dobësive të rregulluara (p.sh. PMESII - Politike, Ushtarake, Ekonomike, Informative, Infrastruktura) ose karakteristika të tjera specifike (të tilla si: efektet, rreziku, ndikimi në objektiv, probabiliteti ose frekuenca e ndodhjes); mënyra më e përshtatshme do të ishte që një listë standarde të ekzistojë e të kompletohet / përshtatet në përputhje me evolucionin e situatës; gjithashtu, lista do të finalizohet pas identifikimit dhe analizimit të të aftësive dhe dobësive të tyre.

Analizimi i aftësive të aktorëve dhe agresioneve të mundshme, nga perspektiva e instrumenteve, burimeve, trajnimit, doktrinës dhe veprimeve të mëparshme, duke rezultuar grup i agresioneve që secili aktor mund të tregojë synimin (mund të jetë një listë e bërë më parë dhe i vlerësuar). Analiza SWOT⁸ mund të përdoret për të identifikuar dobësitë e synuara, të cilat bëhen objektiva për agresorin. Nuk duhet harruar se agresioni hibrid është i përbërë nga përzierje veprimesh me mundësi të ndryshme manifestimi, nga të cilat është e nevojshme të gjesh të gjitha kombinimet e mundshme, për të cilin mund të përdoren

⁸ SWOT, Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet.

aplikacione kompjuterike.

Vlerësimi i agresionit hibrid dhe planifikimi i masave përfshin përcaktimin e proporcioneve, burimeve, vendit, trashëgimisë dhe momenteve kur agresionet hibride, si shfaqje e kërcënimeve hibride, zbatohen në mënyrë plotësuese, në mënyrë që të prodhohet efekti maksimal në objektiv. Qëllimi i këtij procesi do të jetë një plan masash dhe veprimesh për t'iu kundërvënë agresionit hibrid; natyrisht, kompjuter me aplikacionet të ndryshme mund të përdoren gjithashtu në këtë fazë.

Interpretimi i rezultateve të marra: pas vendosjes së konfigurimeve të agresionit, efektet e tyre në një objektiv janë mjaft të paparashikueshme, jo gjithmonë metodat i zgjidhin problemet. Megjithatë, duke përdorur metodat e analizave, mund të përcaktohet harta e efekteve që krahasohen me veprimet e nevojshme; rezultatet e kësaj faze të analizës çojnë në përfundime që mund të përdoren për të identifikuar komponentët më të mundshmet e agresionit të tipit hibrid për të zbuluar se si ato shpalosen me kalimin e kohës, përgjithmonë).

Kërcënimet, rreziqet dhe dobësitë hibride ndaj vendit tonë, ndaj vendeve të rajonit dhe vendeve euroatlantike i nënshtrohen disa rreziqeve dhe kërcënimeve, përfshirë politikën dhe kriza ushtarake, korrupsion institucional, krim i organizuar ndërkuftar, terrorizëm, mjedis degradimi, mungesa e burimeve, zhvillimi i rrjeteve kompjuterike që favorizojnë qasjen në informacionin e grupeve terroriste ose shteteve armiqësore, ksenofobia, fundamentalizmi dhe varfëria.⁹

Rreziqet kryesore për rajonin tonë dhe perëndimin konsiderohen terrorizmi, migrimi i paligjshëm, qeverisja e keqe dhe korrupsioni, ndërsa kërcënimet e reja, të tilla si: tensionet etnike, shfaqja e sferave të reja, krimi i organizuar, veçanërisht krimi ndërkuftar, trafikimi i substancave të rrezikshme (droga, armë, substanca radioaktive) dhe qeniet njerëzore, paraqet një gamë të gjerë mundësitë e manifestimit.

Në përgjithësi, kërcënimet, rreziqet dhe dobësitë ndaj vendit tonë janë në varësi të rrezikut me të cilat përballen të gjitha shtetet anëtare të NATO-s dhe BE-së.

Nga ky këndvështrim, ne mund të identifikojmë disa lloje kërcënimesh, ndër të cilat janë:

- **Tensione ndëretnike në vite:** gjatë gjithë historisë, rajoni i Ballkanit i përket disa perandoritë, maqedonase (shekujt III-II para erës sonë), romake (I para Krishtit - V pas Krishtit), bizantine (V-XIV pas Krishtit) dhe Osmane (XIV-XIX), megjithëse secila përballej me popullsinë autoktone (trakët, Maqedonas, bullgarë, serbë, malazezë, boshnjak etj.), ende mbanin ndarjet administrative bazuar në provincat historike (Iliri, Maqedoni, Bullgaria, Trakia / Rumelia, Greqi); duke filluar me shekullin XIX (Epoka e Kombeve), kufijtë e shteteve të sapothemeluara e bënë të mos ndjekin linjat tradicionale të demarkacionit historik dhe kështu problemet ndëretnike lindën që nuk u zgjidhën as sot; si rezultat, popullata të shumta etnike u vendosën në shtetet e tjera të Ballkanit: kroatët dhe serbët në Bosnjë dhe Hercegovinë (B&H), serbët në Kosovë, shqiptarët në veri të Maqedonisë së Veriut (ish-IRJM), turqit në Bullgari dhe Greqi.

- **Konfliktet midis shteteve dhe enteve shtetërore:** megjithëse Serbia ka treguar qëndrim provokues ndaj Kroacisë, B&H, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës në të kaluarën, tani

⁹ D.A., Analiza e efekteve të luftës hibride në sigurinë euroatlantike, f. 29-30.

nuk ka gjasa të përsëritet, veçanërisht për shkak të aspiratave të Serbisë për integrim në BE.

- **Sulmet kibernetike:** Interneti, si një infrastrukturë kritike për të gjithë sektorët e veprimtarisë publike dhe private dhe për shkak të ndërlikimeve dhe ndërvarësive në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe shoqërore (energji, mbrojtja, transporti, financat, uji, ushqimi, etj.), ofron mundësitë për zhvillimin e shoqërisë, por edhe rreziqet dhe kërcënimet ndaj individëve dhe shoqërive (shtetet) në tërësi, të cilat nuk mbrohen më nga kufijtë fizikë.

- **Krimi i organizuar:** përfaqëson një kërcënim për shoqërinë si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë krize dhe lufte. Aktivitetet e krimit të organizuar që kontribuojnë në financimin e luftës, duke krijuar kaos dhe anarki, veçanërisht në rastin e konflikteve hibride, sjellin cenueshmërinë e institucioneve. Lufta kundër krimit të organizuar kryhet globalisht, me implikime në fusha të ndryshme të veprimtarisë, të tilla si: trafikimi i qenieve njerëzore, droga, armë dhe municione.

Përveç kërcënimeve të renditura më sipër, ne vlerësojmë se ka disa nga ato specifike, veçanërisht për shkak të pozitës gjeopolitike të Shqipërisë. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është një garanci jetike për sigurinë e saj dhe evolucioni i mjedisit të sigurisë në Evropë në vitet e fundit e dëshmon këtë, por NATO ashtu edhe BE mund të jenë shënjestra të një agresioni hibrid jokonvencional. Në këtë kuadër, vendi ynë merr masa në fushën e mbrojtjes e të sigurisë për të qenë i besueshëm dhe të dekurajojë çdo agresor që synon të shkaktojë konflikt hibrid kundër Shqipërisë. Për të ditur se cilat zona të shoqërisë shqiptare mund të jenë shënjestra kërcënimin hibrid, ne duhet të dimë se nga çka përbëhet ky lloj konfrontimi dhe cilat dobësi ka vendi ynë në procesin e planifikimit të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit. Ndjeshmëria tjetër përfaqësohet nga evolucioni i burimeve njerëzore, të cilat zvogëlohen si për shkak të ritmit negativ të rritjes së popullsisë, ashtu edhe për shkak të masivitetit të emigracionit, sidomos të rinjtë. Me fjalë të tjera, ka premisa për rritjen e pakënaqësisë së disa kategorive të qytetarëve, situatë që mund të shfrytëzohet nga një agresor i mundshëm që përdor metodat hibride të veprimit kundër Shqipërisë. Biden nënkroi urdhër ekzekutiv¹⁰ që parashikon ngrirjen e pasurive dhe ndalimin e hyrjes në SHBA për ata që destabilizojnë Ballkanin Perëndimor, kryejnë korrupsion e minojnë institucionet demokratike. Ndër ata që kërcënojnë stabilitetin e Ballkanit Perëndimor përfshihen edhe ata që punojnë kundër Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Urdhri është vazhdim i një urdhri fillestar të vitit 2001, që parashikon sanksione për individë nga Ballkani Perëndimor që shihen si rrezik për sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Tani ai është zgjeruar duket përfshirë edhe sanksione ndaj personave që kryejnë korrupsion dhe minojnë institucionet demokratike.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, korrupsioni në shoqërinë tonë është bërë objekt i një rëndësie të veçantë edhe nga partnerët tanë strategjikë. Për këtë temë, sipas Shtëpisë së Bardhë korrupsioni dëmton drejtpërdrejt politikën e jashtme dhe sigurinë kombëtare.

Si përfundim, dobësitë ndaj sigurisë së Shqipërisë janë të ndryshme, të larmishme dhe të mundshme të shfrytëzohen nga një agresor i mundshëm hibrid, i cili do të përpiqet të

¹⁰ Presidenti i SHBA, urdhër ekzekutiv nr. 14033 qershor 8, 2021; Bllokimi i pronës dhe pezullimi i hyrjes në Shtetet e Bashkuara të personave të caktuar që kontribuojnë në destabilizimin e situatës në Ballkanin Perëndimor.

destabilizojë shoqërinë shqiptare, të zvogëlojë besimin e investitorëve të huaj në ekonomi dhe kështu të ndalojë hyrjen e kapitalit të huaj në Shqipëri, si dhe përdorimin e personave të përfshirë në veprimtari të paligjshme si kolona e pestë në një përballje të mundshme.

Gjithashtu, ne mund të vlerësojmë se shmangia e agresionit hibrid është e mundur duke rritur përgjegjësia e të gjithë qytetarëve, para së gjithash e vendimmarrësve politiko-ushtarake, të cilat duhet të kuptojë se interesi kombëtar përfshin bashkëpunimin e të gjithë përbërësve të Sistemi Kombëtar i Mbrojtjes, Rendit Publik dhe Sigurisë Kombëtare për përmbushjen e objektivat e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

5. Përfundime

Megjithëse në literaturën përkatëse, ideja që veprimet hibride kryhen nga të dy shtetet dhe entitetet joshitetore ose një kombinim i tyre, midis kërcënimeve të mundshme hibride vektorët - shtetet dhe aktorët joshitetorë ka dallime të konsiderueshme për shkak të TTP të përdorur.

Veprimet hibride me një shkallë të lartë të ndërlikueshmërisë janë domeni i gjendjeve që kanë një fushë të gjerë të mjeteve reale të energjisë ose kanë potencial real për të gjeneruar efekte në zgjerim të hapësirave të konfrontimit (në nivel rajonal ose global).

Ky model veprimi me shumë qëllime mund të përdoret vetëm pjesërisht nga entitetet joshitetore (të tilla si grupe terroriste), pasi ato janë të kufizuara në mënyrë operacionale në zonat specifike të shtetit (politik, ekonomik dhe ushtarake), por ato mund të rrisin aftësitë e tyre informuese duke propaganduar islamizmin dhe përmes rekrutimit të pasuesve për qëllimin e përdorimit të tyre në veprimet pasuese për të arritur synimin e kërkuar.

Kur aktorët joshitetorë arrijnë një nivel organizimi të krahasueshëm me një shtet, referencat për luftën hibride në hapësira evropiane synojnë kryesisht anën e kërcënimeve hibride, me theksin në kërcënimet informative dhe kibernetike të gjeneruara kryesisht nga shtetet, si dhe mjetet duke iu kundërpërgjigjur.

Ne e vlerësojmë se planifikimi duke marrë në konsideratë kërcënimet hibride, reagimi ndaj tyre, si një aspekt më pak i debatuar në literaturën dhe doktrinën ushtarake, duhet të vlerësohet nga mjedisi akademik ushtarak dhe të zbatohet me përgjegjësi nga institucionet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit tonë.

Si përfundim, për t'iu kundërvënë kërcënimeve hibride, është e nevojshme të identifikohen dhe menaxhojmë edhe dobësitë tona, me theks të veçantë ato që manifestohen në politikë, fushat sociale dhe informuese/mediatik për të rritur nivelin e njohurive në lidhje me opsionet e kundërshtarit.

Pra, kjo tablo e krijuar nga njohuritë e plota për sfidat që ndeshim në mjedisin e sigurisë, kërcënimet hibride përbëjnë aspekt të rëndësishëm të objektit të strukturave të sigurisë dhe në mënyrë të veçantë vlerësimi të Procesit Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes, sipas standardeve të përafërta me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, (NDPP).

Bibliografia:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare RSH-2014, kreu II “Domosdoshmëritë Strategjike”, pika 7 “Forcimi i rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë”; kreu III “Zbatimi dhe Përgjegjësitë”.
- Strategjia Ushtarake, botimi i vitit 2015, kreu II, “Mjedisi Strategjik i Sigurisë”.
- Presidenti i SHBA, Urdhër ekzekutiv nr. 14033 Qershor 8, 2021; Bllokimi i pronës dhe pezullimi i hyrjes në të Shtetet e Bashkuara të personave të caktuar që kontribuojnë në destabilizimin e situatës në Ballkanin Perëndimor.
- Ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Direktiva e Mbrojtjes 2021.
- Përfundime dhe Relacioni i Konferencës Shkencore për sfidat e planifikimit të mbrojtjes dhe përputhshmëria me procesin e planifikimit të NATO- s (NDPP).
- Udhëzimet e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm FA për arsimimin dhe stërvitjen, 2019.
- Doktrina e Përbashkët e FA, 2017.
- Kolegji Mbrojtjes NATO- Romë, botimi: Prezantimi politik; 13 qershor 2019, “Përse baltikët kanë rëndësi. Mbrojtja e kufirit veri-lindor të NATO-s”, PDF. Burimi elektronik në: www.ndc.nato.int
- Kolegji Mbrojtjes NATO- Romë, botimi: Prezantimi politik, Karl-Heinz Kamp, 6 mars 2019 “Sfida ekzistenciale e NATO-s”: PDF. Burimi elektronik në: www.ndc.nato.int
- AJP-1 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës, 2017; Seksioni 2 - Sistemi i Përgjigjes së Krizave të NATO-s 3-3 dhe Procesi i menaxhimit të krizave të NATO-s 3-5

INTELIGJENCA USHTARAKE NË OPERACION DHE ROLI NË VENDIMMARRJE

Kolonel Hysni Gjergji
Shef i Grupit i Kërkimit RSM, IKSHU

*“Nëse njuh armikun dhe vetveten, kurrë nuk do të frikësohesh nga qindra beteja”
Sun Tzu*

Trajtesë e shkurtuar.

Strategët ushtarakë në shekuj e kanë vlerësuar inteligjencën si faktor kyç për njohjen e armikut e për rrjedhjet, në rrugën drejt fitores. Armiku apo kërcënimi kanë marrë përmasa, trajta, perceptime dhe tipare të ndryshme në dekadat e fundit dhe për rrjedhim, cenimet ndaj sigurisë nuk janë më vetëm ato tradicionale, por kanë ndryshuar dhe po ndryshojnë. Ato përpiqen të bëhen të padukshme, të papercptueshme dhe të paparashikueshme çdo ditë “Më mirë të kesh një armik të njohur se sa një aleancë të fortë”¹. Po përballemi me shumë kërcënime të sigurisë në jetën tonë dhe jo të gjithë këta “armiq” janë “të veshur me uniformë” apo dukshëm “mbajnë një armë”. Në epokën e sotme të luftës asimetrike është detyrë e inteligjencës që të gjejë vendin ku ndodhen, aktorët që janë përfshirë, mënyrën se si pritet të veprojnë si dhe kohën kur ky kërcënim mund të ndodhë. Kërcënimi më i ri i sigurisë globale i jetës së individit, COVID-19, nxori në pah përparësinë e një disipline të zbulimit jo të vlerësuar sa duhet deri në vitin 2020, atë të MEDICAL Intelligence. Dimensi biologjik i luftës, u shfaq, është prezent dhe mund të evoluojë në të ardhmen. MEDINT mori një rëndësi më të veçantë këto dy vitet e fundit duke dalë në krye të disiplinave të zbulimit dhe shumë shpejt do të kërkojë një qasje dhe doktrinë të kësaj “luftë në dimension të ri”.

Fjalët kyçe: Inteligjencë, zbulim, kundërzbulim, kërcënim, spiunazh, sabotazh, subversion, OMP, OZK, HUMINT, OSINT, SININT, MEDINT

¹ Napoleon Bonaparte - “Viktor Hugo- “Dita e fatit”

1. Hyrje

Në epokën e informacionit pa kufij, të cilën po përjetojmë, sfida e shërbimeve të inteligjencës nuk është më mungesa e informacionit por teprica e tij. “Mbytja” me informacion nga të gjitha anët dhe burimet e tij kanë bërë të vështirë vlerësimin dhe analizimin e produktit të dobishëm si për vendimmarrësit politikë, po kështu edhe për komandantët ushtarakë.

Përzgjedhja dhe përdorimi i burimeve të informacionit, të hapura e të klasifikuara, si në rrafshin kombëtar, ashtu dhe në operacionet paqeruajtëse dhe të zgjidhjes së krizës, bëhet nga struktura, organizata dhe individë që duhet të njohin shumë mirë kundërshtarin, kërcënimin dhe natyrën e tij të ndryshueshme.

Kërcënuesit asimetricë të sigurisë si spiuni, terroristi apo sabotatori i kanë kamufluar më tej dhe i kanë fshehur qëllimet, teknikat dhe taktikat e tyre duke qenë të padukshëm. Një i dyshuar i tillë mund të jetë “*gjithkush*” apo “*askush*”, si dhe duke u shfaqur “*askund*” dhe “*kudo*”. Këto kamuflime e bëjnë rolin e shërbimeve inteligjente në luftën asimetricë mjaft të vështirë dhe krijuese. Për më tepër në operacione ushtarake me NATO-n, nga ana e inteligjencës ushtarake, kërkohet një tjetër stil dhe tjetër mënyrë e grumbulimit dhe shpërndarjes së produktit informativ krahasuar me operacionet e mëparëshme.

2. Objektivat dhe burimet e shërbimeve inteligjente ushtarake në operacione me NATO-n

Në momentin që trupat pjesëmarrëse në një mision jashtë territorit të RSH do të futen në zonën e operacionit, veçanërisht gjatë një operacioni OMP¹ dhe OZK², misioni i zbulimit do të jetë:

- Të mbrojnë personelin, pajisjet dhe teknologjinë luftarake, burimet kritike të FARSH, informacionit të klasifikuar, operacionit, forcave të koalicionit në teatër si dhe të aleatëve në vendin pritës.
- Të reduktojë rrezikun e paraqitur nga një zbulim kundërshtar në operacione, për të mundësuar zhvillimin e operacioneve dhe aktiviteteve.

¹ Operacioni i Mbështetjes së Paqes, që kryhet në një zonë për të mbështetur paqen, e cila është e vendosur, por është e cenuar.

² Operacioni i zgjidhjes së krizës.

- Të eliminojë pasigurinë që vjen nga një zbulim kundërshtar dhe të rrenjosë ndjenjën e të qenit mirë, të sigurisë e të besimit të ushtarakëve shqiptarë që shërbejnë në këto operacione.

Kundërzbulimi³ dhe informacioni për sigurinë janë “*paralajmëruese*” për planifikimin dhe drejtimin e mjeteve mbrojtëse aktive dhe pasive, të cilat duhet të ekzekutohen kryesisht nga komandantët, elementë të stafit të zbulimit si dhe struktura të tjera të mbrojtjes së Forcave, të cilat në këto operacione janë MIX dhe trupat shqiptare të inteligjencës veprojnë duke bashkëpunuar.

SALUTE⁴ përfaqëson gjithçka që duhet të bëjë inteligjenca në operacion për të grumbulluar të dhëna mbi numrin, veprimet luftarake që ajo kryen, vendin ku ndodhet i dislokuar, uniformën dalluese dhe pajisjet luftarake që dispononin.

Informacioni i vlefshëm për mbrojtjen e Forcave Shqiptare në OMP dhe OZK merret nga një rreze e gjerë burimesh dhe veçanërisht nga:

- Burime njerëzore në teatër të krijuara nga oficerët tanë, me burimet e tyre të Inteligjencës, ose të NATO-s. Këto janë asetë HUMINT⁵ me përbërje (Zbulimi, kundërzbulimi (KZ) dhe MP⁶).
- COMINT⁷.
- Burime të Hapura Vendore (OSINT).
- Zbulimi Kombëtar dhe agjenci KZ kombëtare dhe aleate që veprojnë në teatër.
- Qendra Kombëtare e Inteligjencës Shqiptare që vepron në rajon (NIC)⁸.
- MEDINT9 - informacion lidhur me sëmundjet, epidemitë, pandemitë, klimën, nivelin shëndetësor dhe vaksinimin mbrojtës të rajonit të operacionit etj.

Bashkimi dhe analizimi i informacionit në lidhje me mbrojtjen e Forcave duhet të ndodhë në teatër; preferohet në një “*celulë informative gjithëburimëshe*” në NATO-SHB¹⁰ përgjegjës, që duhet të jetë në kontakt të ngushtë me CKI¹¹, të cilat mund të konfigurohen edhe si celula informative gjithëburimëshe. Në përgjithësi, nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor ndërmjet shpërndarjes së informacionit ose raportit të kundërzbulimit. Faktori *kohë* është një aspekt kritik i shpërndarjes së të gjitha llojeve të informacionit, por vlera e KZ dhe informacionit

³ Kundërzbulimi është tërësia e masave që merren dhe e veprimeve që kryhen me qëllim parandalimin, ndërprerjen dhe goditjen e veprimtarisë së zbulimit të kundërshtarit, që lidhet me spiunazhin, subversionin, sabotazhin dhe terrorizmin.

⁴ *Size, Activity, Location, Uniform, Equipment*

⁵ *Human Intelligence* - zbulimi i cili përdor njeriun si burim të informacionit.

⁶ Policia Ushtarake.

⁷ Informacioni që përftohet nga interceptimi i komunikimeve të kundërshtarit.

⁸ *National Intelligence cell* - Qendra Kombëtare e Zbulimit.

⁹ MEDINT, është inteligjenca që përftohet nga të dhëna mbi; nivelin e mjekësisë, të bioshencës, epidemiologjisë, mjedisit si dhe çdo e dhënë tjetër rreth shëndetit të popullsisë dhe kafshëve të kundërshtarit.

¹⁰ Shtabe të bashkuara.

¹¹ Celulat kombëtare informative.

të sigurisë mund të degradojë seriozisht ose madje të bëhet i padobishëm nëse arrin vonë.

3. Parimet e sigurisë dhe raporti i kundërzbulimit

Për sa i takon mbrojtjes së Forcave, raportet parajlmëruese të KZ duhet të shpërndahen në mënyrë që të arrijnë te çdo njësi/ushtar shqiptar ose i koalicionit që mund të preket në kohën e duhur sipas parimit “*më mirë kurrë se sa vonë*”.

KZ dhe stafi i sigurisë është përgjegjës për të siguruar që i gjithë informacioni iu kalua atyre që u nevojitet, përfshi stafet KZ dhe të sigurisë në formacionet fqinje dhe ato afër (rrethuese).

Metodat e shpërndarjes së raporteve dhe të dhënave janë të përcaktuara nga vetë klasifikimi i informacionit¹². Por edhe informacioni i paklasifikuar duhet të shpërndahet vetëm në linjë të besueshme komunikimi, për t’u siguruar që mbërrin i sigurt tek i adresuari. Shpejtësia e shpërndarjes së informacionit është jetike.

Këto rregulla janë të përmbledhura në dokumente kryesore, të cilat shërbejnë si bazë për funksionimin e këtyre strukturave. Qëllimi i kundërzbulimit në OMP dhe OZK është:

- *Të parandalojë* shërbimet armike¹³ të zbulimit ose organizata, grupe apo individë që të sigurojnë informacion, që shkakton përçarje ose dëmtim të personelit shqiptar ushtarak ose civil.
- *Të sigurojë* standardet minimale të përgjithshme të sigurisë që mund të zbatohen në të gjitha formacionet dhe njësitë shqiptare që operojnë në një OPV ose OZK.
- *Të pamundësojë* aksesin e paautorizuar në informacionin dixhital dhe shkatërrimin ose ndryshimin e informacionit në rrjetet e punës ose në kompjuterët personalë.

Të asistojë në hetimin për prishjen e sigurisë dhe rastet e kundërzbulimit.

Në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, zbatimi i masave të sigurisë mbrojtëse në mision, është kryesisht një përgjegjësi kombëtare. Grupe dhe forca të shpërndara në vende të tjera zbatojnë masa sigurie brenda zonës së tyre të përgjegjësisë.

Operacionet informative janë përkufizuar si aksione të ndërmarra nga shërbimet e inteligjencës së NATO-s në OMP dhe OZK për të ndikuar vendimmarrësit në mbështetje të objektivave politikë dhe ushtarakë.¹⁴ Ka dy kategori operacionesh informative:

Operacionet Informative Mbrojtëse, të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e informacioneve, ruajtjen fizike të tyre, si dhe të sistemeve të komunikimit të sigurtë.

Operacionet Informative Sulmuese, të cilat kanë si qëllim sulmimin e informacionit dhe të sistemeve të informacionit të palës kundërshtarë.

Gjatë një OZK, mënyra e mbledhjes së informacionit varet nga ecuria e operacionit, gjendja e kundërshtarëve dhe situata politiko-ushtarake në zonën e operacionit dhe në shtetin ose shtetet e forcave OZK.

¹² Klasifikimi i informacionit, pavarësisht atij kombëtar, në këtë rast, i nënshtrohet mënyrës së klasifikimit nga NATO.

¹³ Shërbime inteligjente armike janë të gjitha shërbimet e shteteve që mbajnë qëndrim jo miqësor me NATO-n dhe me Republikën e Shqipërisë.

¹⁴ *NATO Doctrine for Intelligence and Security services AJP 2.0.*

Zgjedhja e mjeteve të grumbullimit të informacionit të dobishëm do të varet nga ndjeshmëria e situatës, e cila mund të ndryshojë nga dita në ditë ose nga ora në orë. Prandaj, stafi i inteligjencës duhet të jetë shumë fleksibël gjatë menaxhimit të inteligjencës.

KPI¹⁵ e një komandanti të përfshirë në një OZK do të jetë më e gjerë dhe politikisht më komplekse se ato që lindin gjatë veprimeve luftarake. Informacioni dhe inteligjenca e grumbulluar do të kenë disa fokusime dhe stafi grumbullues dhe përpunues i inteligjencës do të duhet të bëjë vlerësime mbi forcat në OZK dhe mbi një numër grupimesh kundërshtarë. Prandaj kërkesat e inteligjencës do të jenë komplekse dhe stafi i inteligjencës dhe ai i OZK duhet të ketë aftësi të konsiderueshme për të bërë të mundur interpretimin dhe shndërrimin e KPI në detyrat e duhura dhe konkrete.

Komandanti i OZK do të kërkojë vazhdimisht informacion dhe inteligjencë mbi një gamë të gjerë çështjesh plotësuese, përveç atyre që i kërkojnë normalisht inteligjencës, duke përfshirë:

- Situatën gjeopolitike të zonës së operacionit.
- Bazën historike, etnike dhe kulturore të vendit, rajonit dhe zonës së konfliktit, si dhe influencën e mundshme të këtyre faktorëve në operacion.
- Vlerësimin e qëllimeve, sjelljeve dhe objektivave afatmesëm dhe afatgjatë të të gjitha grupeve, nëngrupimeve të brendshme të përfshira në OZK dhe ndikimin e tyre në OZK dhe te njeri-tjetri.
- Vlerësimin e grupimeve të jashtme politike, financiare, fetare dhe territoriale që kanë një interes apo ndikim në OZK.
- Qëndrimin e mediave.
- Influenat strategjike.
- Çështjet civile.
- Ekonominë e shtetit apo shteteve në zonën e operacionit.
- Çështjet të rëndësishme shëndetësore.¹⁶

Zbatimi i procesit të inteligjencës në OZK i parashtron stafit të inteligjencës një mori problemesh, të ndryshme nga ato që hasen gjatë skenarit të betejave. Rëndësia e madhe e HUMINT, kërkesat e shumta kundrejt inteligjencës dhe situata e paparashikueshme dhe e ndryshueshme e operacioneve brenda dimensioneve gjeopolitike, sociale dhe ekonomike të zonës në fjalë, ofrojnë një mjedis sfidues për zbatimin e procesit të mbështetjes së komandantit me inteligjencë.

Duhet të kuptohet qartë se inteligjenca e planit përgatitor të OZK ka të njëjtën rëndësi, ndoshta më të madhe se ajo e betejave. Në OZK ndodh gati gjithnjë e paparashikuara dhe inteligjenca duhet të ketë kapacitetin dhe fleksibilitetin që të parashikojë se *kur* dhe *çfarë* do të ndodhë.

¹⁵ Kërkesa Prioritare Informative.

¹⁶ COVID-19 tregoi se sa aktual dhe i rëndësishëm është informacioni lidhur me situatën shëndetësore të rajonit, (sëmundjeve, higjienës, burimeve ujore, nivelin e mbrojtjes) dhe sistemin shëndetësor rajonal dhe vendor i njerëzve dhe kafshëve.

4. Kërcënimi ndaj sigurisë - “Spiunazhi”

Spiunazhi përshkruhet si një metodë e maskuar e përdorur nga shërbimet informative armike për të përfutuar informacion të klasifikuar, që prek sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë në përgjithësi, të Forcave të Armatosura apo edhe të një operacioni në veçanti¹⁷. Informacion i vlefshëm mund të merret dhe nga libraritë publike, media, nga një vëzhgim i zakonshëm, mjete të tjera të dukshme, apo dhe nga faqja zyrtare e internetit e Ministrisë së Mbrojtjes, FARSH apo të institucioneve të tjera të rëndësishme të sigurisë kombëtare të RSH. Vëzhgimi i zakonshëm dhe përfutimi i informacionit nga mjete të hapura publikimi është një kërcënim i përhershëm ndaj sigurisë, i kryer si nga organizata, ashtu edhe nga individë.¹⁸ Por një shërbim informativ armik do t’ia kushtojë aktivitetet e tij të spiunazhit marrjes së informacionit, i cili është i klasifikuar¹⁹, pra jo i lehtë për t’u përfutuar. Sidoqoftë, duhet të kihet parasysh se edhe pjesë informacioni, në dukje të parëndësishme, mund të kenë kuptim të veçantë kur futen në vlerësimin informativ dhe analizohen nga oficerë të aftë dhe me përvojë. Po kështu, edhe disa nga informacionet e marra nga mjete të dukshme do të marrin konfirmim kur ato vërtetohen nga burime të tjera.

Kërcënimet e sigurisë, objekt i inteligjencës përmes spiunazhit, vijnë kryesisht nga:

- Shërbime Informative Armike (SHIA).
- Organizata subversive, grupe ose individë.
- Organizata terroriste, grupe ose individë.
- Njësi specialistësh (kundërshtarë) siç janë Forcat e Qëllimeve të Veçanta (FQV)²⁰.
- Survejimi i zbulimit ajror, detar dhe tokësor nga asetet informative interceptuese të sinjaleve dhe pamjeve, përfshi satelitët.
- Organizata dhe grupe kriminale.
- Individë pa qëllime të përcaktuara qartë.

Në mënyrë të vazhdueshme, *Shërbimet Inteligjente Armike (SHIA) janë në kërkim të personave me akses ose me akses të mundshëm në perspektivën e karrierës së tyre në informacionin e klasifikuar ose materiale të tjera, të cilët mund të rekrutohen si agjentë*²¹.

SHIA-t sot janë shumë herë më të interesuar për persona me akses nga trupat shqiptare, pasi nëpërmjet aksesit të tyre mund të përfitojnë informacion të klasifikuar të NATO-s. Ushtarakët tanë pas 4 prillit 2009 kanë të njëjtin akses në informacion me ushtarakët e vendeve të tjera të NATO-s, që shërbejnë në të njëjtin mision. Kjo i bën ata vulnerabël dhe

¹⁷ I njëjti përkufizim për spiunazhin është edhe për NATO-n si organizatë politiko-ushtarake dhe për 29 vendet anëtare.

¹⁸ Individë (mercenarë) pa përkatësi kombëtare apo shtetore në shërbim e një shteti të caktuar, të cilët veprojnë për llogari të një pale, grupi apo personi, për qëllime përfitimi ekonomik, financiar dhe shantazhi.

¹⁹ Informacion i klasifikuar cilësohet informacioni, aksesit në të cilin është kufizuar vetëm për një grup të caktuar personash. *NATO definition of classified information*, publication of 2007.

²⁰ Janë kryesisht aktorë pa përkatësi të shprehur shtetërore dhe që punojnë për një qëllim të veçantë, para, influencë, burime etj.

²¹ Agjent quhet individi, që në mënyrë të paligjshme, përvetëson informacion sekret kombëtar dhe ia dorëzon një shërbimi inteligjent armik.

target të vazhdueshëm.

Nëse nuk ka armik brenda, armiqtë e jashtëm nuk mund të të lëndojnë²². Është thënë, pranuar dhe vërtetuar në luftëra botërore roli i spiunëve në luftë, ku dëmi apo dobia, në vartësi të palës për të cilën punon, ka qenë e jashtëzakonshme. Aktualisht, spiunazhi rus kërkon të jetë në veprim si në shtetet e dobëta e të trazuara të “Evropës së Re”, ashtu edhe në shtetet e pasura të “Evropës së Vjetër”. Dobësia më e madhe e qasjes perëndimore është se e trajton kapjen e spiunëve, drejtësinë, mbikëqyrjen financiare, si zona të ndara të vendimmarrjes. Rusia i shfrytëzon të gjitha këto, të pandara me operacione që kalojnë nga njëra te tjetra. Duke pasur parasysh aspektet e shumta të kërcënimit me të cilin përballen autoritetet perëndimore, agjencitë e përfshira në këto fusha duhet të punojnë në unison, jo veç e veç²³. Shembulli i Herman Simm²⁴ në vitin 2009 dhe i të tjerëve më pas, e tregoi qartë rrezikun. Më së shumti të preferuarit e spiunazhit rus janë operatorë, oficerë të IT, programues, drejtues të gradave të larta, përkthyes vendas ose oficerë stafi të inteligjencës. Njerëzit mund të bëhen agjentë të shërbimeve të huaja për arsye të ndryshme dhe kryesoret janë përmbledhur në (MICE)²⁵: për para, dhurata, përfitime, karrierë, ego, hakmarrje e të tjera përparësi të ndonjë lloji. Spiunazhi nuk njihet aleancë të përhershme por vetëm interesa, pasi aleatët ushtarakë dhe ekonomikë shpesh herë nuk janë aleatë në inteligjencë. Mjaftojnë dy rastet e muajit të fundit:

1. Më datë 31 maj 2021, mediat raportojnë për një skandal përgjimi mes aleatëve amerikanë nga njëra anë dhe Francës e Gjermanisë nga ana tjetër. Përgjimi raportohet të jetë kryer nga territori danez. Ne duhet të kuptojmë sistemin e shërbimeve inteligjente. Ky është biznesi i tyre. Këtu nuk kemi të bëjmë me aleancë, miqësi apo me pretendime morale ose etike. Kemi të bëjmë vetëm me përmbushjen e interesave amerikane.²⁶

2. Shërbimi serb i sigurisë vërtetoi se në Zemun, një anëtar në pension i ushtrisë serbe më 24 dhjetor 2018, rreth orës 18, u takua me *Georgy Kleban*, oficer i GRU Ruse, duke i dorëzuar atij dokumente sekrete dhe shkëmbyer ato me para. Ishte e pamendueshme që mes aleatëve të ngushtë të kishte një aferë të pastër spiunazhi. Pyetja ime është “*Pse*” - deklaroi Vuçiç, në një notë dërguar Moskës.²⁷

5. Sabotazhi

Një operacion i suksesshëm sabotimi është shumë pak i kushtueshëm për organizatorët. Duke përdorur eksploziv ose material të fuqishëm shpërthyes, pak njerëz ose madje vetëm

²² Winston Churchill “*Triumph and Tragedy*”.

²³ Edward Lucas senior editor, “*The Economist*”.

²⁴ Herman Simm, ish-drejtori i Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar të Estonisë, i cili ishte rekrutuar nga FSB ruse dhe kishte spiunuar te rusët për 16 vjet nga viti 1992 -2008.

²⁵ MICE (*money, ideology, coercion, ego*).

²⁶ Deklaratë e Thomas Wegener Friis, ekspert danez për shërbimet sekrete pas skandalit të përgjimeve nga NASA në drejtim të Danimarkës më 1 qershor 2021.

²⁷ Deklarata e Aleksandër Vucic më 21 nëntor 2019 për incizimet që janë bërë nga Agjencia e Sigurisë së Ushtrisë Serbe, por se shërbimi ishte në dijeni të incidentit, sipas Vuçiç.

një njeri mund të krijojë impakt shumë të madh, në krahasim me përgatitjet që duhen për ta shkaktuar atë.

Sabotazhi ndodh kryesisht në kohë fushatash ndërkombëtare, arritjesh politike, në kohë paqe, krize ose lufte. Veprime të bashkërenduara dhe të shtrira mund të priten menjëherë pas shpërthimit të armiqësive, xhelozive për arritje politike, kur efekti i sabotimit do të jetë më i madh. Objektivi i veprimeve të sabotazhit nuk është domosdoshmërisht shkatërrimi; por ndërprerja e përdorimit të *objekteve* që po sabotohen dhe impakti negativ që përcillet. Koha e planifikimit të një sabotimi është shumë më e madhe se koha e kryerjes dhe e kamuflimit të saj. Ata zgjedhin vetëm shënjestrat më jetësore, të cilat kanë impaktin më të madh ndërkombëtar, kombëtar dhe mediatik. Media, shpeshherë, për të përcjellë lajmin, bën edhe përcjelljen e mesazhit që sabotatori kërkon të bëjë.

Shkatërrimi i përpjekjeve dhe arritjeve politike të të gjitha vendeve të ish-traktatit të Varshavës për t'u anëtarësuar në NATO si: në Letoni, Lituani, Estoni, Çeki, Sllovaki, Rumani, Bullgari, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi ka qenë objekt i sabotazhit rus. Kjo ka ndodhur dhe është denoncuar që nga viti 2000 e në vazhdim.

“Ekzistojnë dëshmi të qarta në lidhje me përfshirjen e oficerëve të shërbimit inteligjent rus të GRU-së me shpërthimin në depon e municioneve të nëntorit 2014²⁸”. Në prill 2015 u helmua në Sofje tregtari bullgar i armëve Emilian Gebrev, me të njëjtën substancë që u përdor për helmimin e Skribal-it në Londër. Duke përdorur informacione të gjurmimit të fluturimit, të dhënave në *database* dhe të dhënave të telefonave celularë, rezultoi se deri në tetë oficerë të GRU-së nga e njëjta njësi – Njësia 29155²⁹ – mund të kenë udhëtuar në Bullgari në javët kur ndodhi helmimi³⁰. Shërbimi inteligjent bullgar gjurmoi udhëtimet e disa prej oficerëve të njohur të GRU-së brenda dhe jashtë Bullgarisë dhe zbuloi se në kohën e vizitave të tyre, në vitin 2014 dhe 2015, kanë ndodhur 6 shpërthime deponash armatimi, nga muaji shkurt 2014 deri në prill 2015. Njësia speciale 29155 është lidhur me të paktën një përpjekje për ndërhyrje kibernetike pasi në tetor 2018, zyrtarët holandezë të sigurisë deklaruan se agentët e GRU-së u përpoqën që të sulmonin kompjuterët e Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, me seli në Hagë. Tor Dikovall³¹ deklaroi se zbulime të bëra nga Çekia, edhe pse nuk janë të plota, japin detaje, që sugjerojnë se sa agresive ishte GRU-ja për krijimin e kësaj njësie. Ky demonstrim tregon gatishmërinë e Ruisë që të përfshihet në kësaj misionesh dhe të shkojë në shtete të tjera – dhe të kryejë operacione të tilla – kjo e vërtetë është e frikshme³².

²⁸ Deklaratë e kryeministrit çek, Andrej Babis, gjatë një konference për media më 17 prill 2021 te *Radio Evropa e Lirë*.

²⁹ Repart special rus, në vartësi të GRU (shërbimit të zbulimit ushtarak rus) i krijuar më 2008, me mision spiunazh, sabotazh, eliminim fizik, helmim, kibernetik në vendet kundërshtarë të Ruisë.

³⁰ Deklaratë e ish-ministrit të Mbrojtjes, Todor Tagarev në një raport të përbashkët me *Der Spiegel* dhe *The Insider*.

³¹ Deklaratë e Tor Bukkvoll, hulumtues i specializuar në sigurinë ruse në Institucionin për Kërkime të Mbrojtjes të Ministrisë Norvegjeze të Mbrojtjes, datë 22 prill 2021.

³² Deklaratë e Tor Bukkvoll, hulumtues i ministrisë norvegjeze të Mbrojtjes, datë 23 prill 2021 në *The Insider*.

Reparti special i zbulimit rus planifikoi në 2016 të vriste kryeministrin malazez Gjukanoviq, si dhe të dominonte skenën politike serbe përmes elementit pro rus, me qëllim pengimin e anëtarësimit të Malit të zi në NATO.³³ Po të analizojmë profesionalisht faktorët: kohë, vend, objektiv, mënyrë, aktorët ndërkombëtarë, kombëtarë, politikë, ekonomikë, nga njëra anë; bashkë me paralajmërimin që NOS (NATO Office of Security) i bën Shqipërisë dhe vendeve të tjera kandidate në janar 2008; del qartë se shpërthimi i Gërdecit më 15 mars 2008 është një rast i pastër sabotazhi. Kjo ka ndodhur me të gjithë vendet që ishin në prag anëtarësimi në NATO siç i përshkruam më lart. Ky sabotim i dyshuar duhet hetuar në bashkëpunim me policinë dhe shërbimet inteligjente homologe të aleancës që kanë grumbulluar përvojë për raste të ngjashme .

6. Subversioni

Subversioni³⁴ përkufizohet si një veprim i organizuar për të dobësuar fuqinë ushtarake, ekonomike ose politike të një kombi duke minuar moralin, besnikërinë ose sigurinë e qytetarëve të tij. Në një OMP dhe OZK subversioni synon minimin dhe dështimin e këtij misioni. Një organizatë subversive përdor metoda joligjore dhe jokushtetuese, me qëllim që të shkaktojë një ndryshim të qeverisë për avantazhet e saj. Gjithashtu, individët që subvertohen, besnikëria e tyre do të ndryshojë dhe ata do të bëhen të përshtatshëm për përdorim të mëtejshëm nga agjenci inteligjente armike ose organizata subversive. Ka shumë teknika të subversionit dhe me metodat moderne të komunikimit – gazeta, radio dhe televizion – një audiencë shumë e gjerë mund të arrihet nga organizatat, grupet dhe individët subversivë. Metodatat e tyre të subversionit përfshijnë:

- Propagandë, demonstrata dhe trazira, shpërndarje fletëpalosjesh, përdorim i mediave.
- Përdorim i “*organizatave mbulimi*”³⁵ ose sabotazhi, për të fshehur veprimtarinë e tyre të vërtetë. Asnjëherë nuk i gjejmë të ndara; ato ndërthuren.
- Rekrutimi i “*mbështetësve*” që me ndërgjegje ose jo veprojnë në emër të tyre.
- Krijimi i një klime mosbesimi dhe zhgënjimi, duke përdorur të gjitha plagët e shoqërisë shqiptare, që çojnë në diskreditimin e qeverisë dhe individëve. Këto plagë janë kryesisht ,korrupsioni, nepotizmi, lufta politike pa princip, etj.
- Përhapja e fjalëve të rreme ose e të vërtetave të shtrembëruara (dezinformacion), me qëllim shkatërrimin e besimit tek udhëheqësit ose aleatët.

Subversioni është kërcënimi më i përhapur dhe i vazhdueshëm ndaj sigurisë në kohë paqeje. Në kohë krize dhe reformash, subversioni mund të rritet. Ai nuk mund të jetë vetëm ashtu siç u përshkrua më lart. *Në disa raste, organizata dhe shërbime, shtete dhe individë përdorin fakte dhe të vërteta të vogla e të besueshme, për të fshehur një mashtrim të madh.*

³³ Deklaratë e Gjeneral Curtis Scaparrotti, Komandanti Suprem i Forcave Aleate të NATO-s në Europë, 23 mars 2017.

³⁴ *NATO Doctrine for Intelligence and Security Services* AJP 20, p. 31.

³⁵ NGO apo çdo organizatë tjetër qeveritare apo humanitare që financon, mbështet ose kamuflon veprimtarinë subversive.

7. Terrorizmi dhe krimi i organizuar

Terrorizmi përshkruhet si një përdorim i paligjshëm ose përdorim kërcënues i dhunës kundër individëve kryesisht civilë ose pasurisë në përpjekje për të shtrënguar ose frikësuar qeveritë ose shoqëritë, si një mënyrë për të arritur objektivat politikë, etnikë, fetarë ose ideologjikë. Në operacione por edhe në situata paqësore, elementet e subversionit, sabotazhit e të terrorizmit ndërthuren dhe disa herë janë të njëjta.

Megjithëse efektivisht një shtojcë e subversionit, terrorizmi është bërë kaq i përhapur, sa që tani është e përshtatshme ta konsiderojmë atë si një kërcënim edhe të një operacioni OMP dhe OZK. Detyra e inteligjencës në këtë luftë është të gjejë kush, ku dhe çfarë planifikojnë të bëjnë këta terroristë, të cilët në taktikat dhe mënyrat e veprimit, i afrohen shërbimeve inteligjente. Ata janë të padukshëm, përdorin agjenturë për grumbullim informacioni si dhe ruajnë sekretin e komunikimit.

Krimi i organizuar është një lloj aktiviteti i paligjshëm i organizatave me natyrë kriminale, të strukturuar si një rrjet pune, me një ose më shumë drejtues dhe njësi të ndryshme vartëse të shpërndara në një territor të gjerë. Qëllimi i krimit të organizuar është të fitojë pushtet jo ligjërish nëpërmjet influencës ose parasë, duke mospërfilluar ligjet demokratike, të cilat qeverisin vendin ku vepron krimi i organizuar.

Organizatata kriminale mund të kryejnë aktivitetet kriminal të ngjashëm me ato të përshkuara në paragrafët e mëparshëm dhe për më shumë ata mund të kryejnë operacione kontrabande në një shkallë të tillë, sa që mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare dhe ushtarake brenda një vendi.

Në OMP dhe OZK trupat shqiptare mund të ndeshen me aspekte të KO kështu që, njohja e teorisë dhe e praktikës së punës të krimit të organizuar në teatër, të ndërthurur me forma të tjera, është e domosdoshme.

8. Përfundime

1. Kërcënimet e sigurisë nga shërbimet inteligjente kundërshtare po ndodhin, ato nuk janë më histori “*Fiction*”.
2. Ushtarakët shqiptarë në përgjithësi dhe ata në mision në veçanti, duhet të trajnohen lidhur me kërcënimet që paraqesin shërbimet inteligjente kundërshtare ndaj jetës së tyre në veçanti dhe sigurisë kombëtare në përgjithësi.
3. Parimi i sigurisë së informacionit të klasifikuar të NATO-s është: “*Zinxhiri është aq i fortë, sa hallka e tij më e dobët*”. Pra, nëse një informacion rrjedh nga një vend, nuk ka rëndësi siguria në vendet e tjera anëtare të cilat kanë të njëjtin akses.
4. Informacioni i cili është jetësor për mbrojtjen e Forcave, nuk duhet të kalojë ekskluzivisht nëpërmjet kanaleve rutinë, por menjëherë te stafi përgjegjës i sigurisë në operacion.
5. Informacioni, veçanërisht kur ka kërcënim ndaj jetës së ushtarëve, ka përparësi ndaj të gjitha masave paraprake rutinë të sigurisë.
6. Bashkëpunimi mes shërbimeve inteligjente vendase, partnere dhe aleate është kyç në realizimin e misionit të tyre.

Bibliografia:

1. *NATO doctrine for Intelligence, counterintelligence and security, AJP2-0 12 February 2016.*
2. *NATO Intelligence, surveillance, (ISR) Volume I.*
3. *NATO Intelligence Interoperability Architecture (NIIA) Volume II. Management Guidance.*
4. *Karl Von Clausewitz "On War".*
5. *Herman Simm, spiuni në NATO "NOS 2009".*
6. *"Power of intelligence in peace and war", NATO publication, 2009.*
7. *The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) 2016 publication,*
8. *Michael Warner "Wanted a definition of intelligence" 2019.*
9. *Dr Marc Goleoti "Ekspert i shërbimeve të sigurisë në Britaninë e Madhe"*
10. *Edward Lucas "Dark Soldiers of the New Order".*
11. *Marko Cepic "Inteligjenca dhe Demokracia".*

NDËRHYRJET HUMANITARE KUR FORCA ËSHTË E JUSTIFIKUAR!

Kolonel Mehmet Metko

Shef i Departamentit të Publikimeve Doktrinare, IKSHU

Dr. Urim Qinami

Specialist në Grupin e Publikimeve Doktrinare të Mbështetjes, IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Në këtë artikull do të përshkruhet realiteti ndërkombëtar në vitin 1999 në aspektet e ndërhyrjes humanitare, me rastin e 50-vjetorit të NATO-s në Kosovë. Qëllimi nuk është diskutimi i literaturës rreth legjitimitetit të ndërhyrjes, të humanitarizmit të ri apo i doktrinës sipas të cilës Forca Ajrore është në gjendje të fitojë luftën e vetme.

Materiali në vijim synon të identifikojë disa trende që kanë kushtëzuar dhe vazhdojnë të kushtëzojnë ndërhyrjet ndërkombëtare në raste specifike. Gjithashtu shkrimi trajton ndërhyrjet humanitare nga këndvështrimi politik, etik, moral si dhe doktrinar.

Për shkak të hapësirës së limituar, argumenti i trajtuar në këtë material, në mënyrë të pashmangshme, nuk synon, nuk mund dhe nuk është shterues dhe i plotë.

Fjalët kyçe: ndërhyrje humanitare, Ballkan, spastrim etnik, Kosovë, gjenocid, NATO

1. Hyrje

Shumica e personave që kanë drejtuar një barkë bien dakord me faktin se, sa më e madhe është barka aq më e vështirë është të ndryshojë drejtimin e saj (Sindroma e Titanikut). E njëjta gjë është e vlefshme për pothuajse të gjitha gjërat në univers. Bazuar në këtë analogji, është e lehtë të thuhet se Aleanca e Atlantikut të Veriut, si organizata më e madhe ushtarake që historia e njerëzimit ka njohur, pas rënies së Bashkimit Sovjetik, ballafaqohet me vështirësi serioze në ndryshimin e objektivave dhe të politikës së saj, duke u bërë kështu më statike, më hermetike, më e ngurtë dhe më e matur në përqaftimin e rrjedhës natyrale të politikës së ndryshimit.

Periodha pas Luftës së Ftohtë dukshëm rezultoi më pak e qëndrueshme dhe më pak dashamirëse se sa shumica kishte shpresuar. Konfliktet në Haiti, Afganistan, Ballkan dhe në rajone të ndryshme të Afrikës subsahariane treguan se luftërat civile dhe urrejtja etnike dhe fetare zëvendësuan tensionet ideologjike mes Lindjes dhe Perëndimit. Këto konflikte shpesh çuan në verifikimin e dhunës, mizorive njerëzore dhe të emergjencave humanitare. Në dritën e këtyre shqetësimeve të reja, ideja e ndërhyrjes humanitare u shfaq si burimi kryesor i shpresës. Përkrahësit e ndërhyrjeve argumentonin se një aksion i armatosur mund të zbuste efektet e konflikteve lokale dhe të ndihmonte në parandalimin e tyre në të ardhmen. Kjo, pasi demonstrimi i forcës do të shkurajonte aventurierët autoritarë të ndërmerrnin nisma, të cilat do të kishin kosto të mëdha për ta dhe për institucionet që ata drejtonin. Doktrina e ndërhyrjeve humanitare është aplikuar në një sërë rastesh por, vetëm në sajë të pozicionit gjeografik dhe mbulimit mediatik që iu kushtua, rastet më të rëndësishme të ndërhyrjes humanitare janë verifikuar në ish-Jugosllavi dhe veçanërisht në Kosovë.

2. Lufta III Ballkanike: përshtatu ose vdis

Të gjitha mosmarrëveshjet territoriale në Ballkan kanë mitologjitë e tyre. Çështja kosovare ishte ndër më komplekset në një gadishull shumë kompleks. Në fakt, Ballkani është i lidhur fort me fanatizmin, prapambetjen, me dhunën dhe me luftëra të pandërprera. Shkrimet më të lexuara dhe më me ndikim mbi rajonin, të shkruara në vitin 1990, e portretizojnë atë si një depozitë sadizmi dhe dhune e obsesionar nga fantazmat e armiqësive të paepura. Këto tipare janë të lidhura ngushtë me historinë e rajonit, si karakteristikë kryesore e këtyre shoqërive dhe si kornizë kryesore shpjeguese përmes së cilës e kaluara dhe e tashmja janë trashëguar, sikur të mos kishte asgjë pozitive për të ofruar. Një qëndrim i atillë vërehet në

raste të ndryshme por të përsëritshme në kohë dhe hapësirë. Kështu, diplomatë të acaruar nga dështimi i paqes në Bosnje-Hercegovinë flisnin me shpërfillje si “një kulturë dhune brenda një udhëkryqi qytetërimesh”. Winston Churchill shprehej se Ballkani prodhon më shumë histori nga sa konsumon, ndërsa Karl Marks konsideronte rajonin si “mbetje etnike”. Edhe novelisti turk Nedim Gursel, një mik i rajonit, ankohet për faktin se urrejtja mes popujve, të detyruar të jetojnë së bashku, është “fati i Ballkanit”. Kështu, edhe pse janë të detyruar të jetojnë bashkë, vazhdon Gursel, maqedonasit urrejné bullgarët, bullgarët urrejné turqit, turqit grekët, grekët shqiptarët, shqiptarët serbët, serbët boshnjakët, boshnjakët kroatët, kroatët vllahët, vllahët romët dhe romët janë të urreyer nga të gjithë. Me fjalë të tjera, mund të thuhet se ky është fati i Ballkanit.

Këta tregues negativë mund të injorohen si shprehje të pabaza apo produkte të imagjinatës, krijimtarisë individuale apo kolektive, po të mos ishte për dy fakte jo komode. **Së pari**, perceptimi i Ballkanit si një rajon prodhues i dhunës dhe konflikteve të armatosura ka një bazë objektive. Nga lindja e të parave lëvizje të çlirimit kombëtar, kundër Perandorisë Osmane në shekullin e XIX, Evropa Juglindore ka qenë një rajon kronikash i paqëndrueshëm. Përleshjet me osmanët u kulmuan në Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913 dhe në të dy Luftërat Botërore, rajoni ishte një teatër i rëndësishëm. Qetësia e Luftës së Ftohtë përfundoi pas rënies së Murit të Berlinit dhe në vitin 1991, Ballkani risolli luftën në Evropë, të parën nga viti 1945. **Së dyti**, edhe kur perceptimet janë të ekzagjeruara ose të pasakta, fakti se Ballkani konsiderohet si një zonë e urrejtjeve antike, pavarësisht në është e vërtetë apo jo, ka pllakosur dhe vazhdon të pllakosë qasjen e bashkësisë ndërkombëtare ndaj rajonit dhe problemeve të tij. Për rrjedhojë, terma si: fuçi baruti, dhunë, sadizëm, ksenofobi, mizori, barbari, spastrime etnike, bërje dhe shpërbërje të dhunshme janë terma të cilët, me kalimin e kohës, janë mishëruar në një të vetëm: “ballkanizim”¹. Për komunitetin ndërkombëtar ka të bëjë me kulturën e rajonit e ndryshme nga pjesa tjetër e kontinentit.

Por, Ballkani është më shumë se një zgjerim i thjeshtë i Evropës, një *alter ego* i saj. Është gjithashtu një zonë e veçantë fizike dhe kulturore nën atë që Maria Todorova (*Ballkani Imagjinar*) e quan “realitet historik dhe gjeografik” dhe të gjitha epitetet denigrative janë produkt i pozicionit gjeografik dhe i një sërë rrethanash historike që e kanë karakterizuar. Kështu, pozita gjeografike e ka bërë rajonin një pikë kalimi të detyrueshëm për emigrantët, pushtuesit dhe pushuesit që lëviznin mes Azisë dhe Evropës. Shekujt e baticë-zbaticës e kanë bërë rajonin një nga më të ndryshmit në botë, një mozaik i jashtëzakonshëm etnik, gjuhësor, kulturor dhe fetar, që jetojnë të përzier, në afërsi ose të ndarë. Ndryshe nga Gadishulli Iberik apo Apenin, të ndarë respektivisht nga zemra e Evropës nga malet Pirenej dhe Alpet, gadishulli i Ballkanit nuk ka një kufi të qartë, të natyrshëm dhe fizik me pjesën tokësore me kontinentin. Zonat bregdetare dhe grupet e ishujve në afërsi kanë një sfond më kozmopolite dhe me klimë mesdhetare, të cilët ndryshojnë nga territori i brendshëm

¹ Termi për herë të parë është përmendur në një artikull, në New York Times më 20 dhjetor 1918. Sipas enciklopedisë britanike termi përdoret për të përshkruar fragmentimin etnik dhe politik që pasoi shpërbërjen e perandorisë osmane, por i referohet edhe ndarjes së një shteti multi-etnik në subjekte më të vogla etnike homogjene.

që janë kryesisht malor, relativisht të izoluar dhe i nënshtrohen fenomeneve më të rënda meteorologjike kontinentale. Mungesa e fushave të mëdha dhe pjellore, të përshtatshme për bujqësi intensive, ka qenë pengesë e rritjes demografike. Barrierat e maleve paralele me bregdetin dhe mungesa e lumenjve të mëdhenj të lundrueshëm, kanë shkëputur pjesën e brendshme të Ballkanit me detin. Terreni malor ka inkurajuar dallimet kulturore dhe kontribuar në dështimin e përpjekjeve integruese dhe për pasojë në përcaktimin e një identiteti izolues. Si rezultat janë formuar “geto” kulturore, sociale, etnike, fetare dhe kombëtare. Anëtarësia në një grup të veçantë është përcaktuar me përjashtim. Është me ne sepse nuk është me ata.

Këto karakteristika, me kalimin e kohës, janë konsoliduar. Si pasojë, kulturat e ndryshme që jetonin aty, janë rritur të ndara dhe të shkëputura nga njëra-tjetra duke prodhuar një identitet izolues dhe përjashtues, gjë që pasqyrohet edhe sot. Në këto rrethana, edhe pas fundit të Luftës së Ftohtë, rajoni i Ballkanit ka paraqitur sfida të mëdha sigurie për kontinentin e vjetër. Paqëndrueshmëria sociale dhe qeverisja e dobët kanë qenë dhe mbeten një shqetësim i rëndësishëm. Interpretimi dominant i tensioneve, që degjeneruan në konflikte të armatosura, minimizon rolin e ndërhyrjeve të jashtme, duke ia adresuar të gjithë përgjegjësinë vetëm faktorëve të brendshëm. Kjo tezë është e vërtetë pasi fuqitë ndërkombëtare qëndruan larg vatrave të zjarrit. Fillimisht, bashkësia ndërkombëtare bëri disa përpjekje për të parandaluar luftën, por edhe kur ka vepruar, ka vepruar për të mbrojtur personelin e saj në terren.

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, ishte e natyrshme dhe e pashmangshme se NATO do të duhej të ndryshonte. Aleanca ishte krijuar për të penguar, dekurajuar dhe - nëse do të ishte e nevojshme - t'i kundërpërgjigjej një sulmi sovjetik në Evropën Perëndimore. Po ashtu, e krijuar në 1949 pas dy ngjarjeve të rëndësishme ndërkombëtare (pranimi i Republikës Popullore të Kinës në OKB dhe thyerja e monopolit nuklear amerikan nga Bashkimi Sovjetik), NATO ka qenë edhe një instrument i rëndësishëm influence nga ana e SHBA-ve mbi politikën e kontinentit të vjetër. Ironia e fatit e deshi që me largimin e tij, Bashkimi Sovjetik i dha NATO-s goditjen më të rëndë: e privoi nga armiku. Në fakt, “Perandoria e së Keqes” nuk ekzistonte më dhe bashkë me të edhe arsyeja e ekzistencës së NATO-s. Në mungesë të kërcënimit sovjetik, Aleanca rrezikonte të mbetej pa punë, pa mision, pa objektiva dhe pa një arsye se përse duhej të mbahej akoma në jetë. Në vitet '90 ekzistenca e Aleancës, ishte një anomali dhe në përvjetorin e saj të pesëdhjetë, Aleanca më e madhe ushtarake ishte në pikën e vdekjes, jo vetëm ushtarake por edhe politike. Ishin shtuar zërat në korridoret e kancelarive evropiane, sidomos në rangjet e politikës franceze, të cilët besonin se Aleanca kishte humbur arsyen e saj për të ekzistuar. Nga njëra anë, BE-ja donte të zvogëlonte praninë ushtarake amerikane në kontinentin e vjetër dhe - nga ana tjetër - taksapaguesit amerikanë ishin më se të lumtur që mos të kontribuonin më me xhepat e tyre për sigurinë e kontinentit të vjetër. Pavarësisht forcës së saj ushtarake dhe dislokimit të trupave të armatosura, uniteti politik i NATO-s në këtë periudhë pësoi një “arrest kardiak”. Charls Darwin, në teorinë e tij të evolucionit, shprehet se qenia njerëzore ka mbijetuar dhe përparuar falë aftësisë së saj për tu përshtatur. Në këtë kontekst, NATO e pas-Luftës së

Ftohtë u desh të përballet më këtë sfidë ekzistenciale: të përshtatej ose të vdiste.

3. Anatomia e një përshkallëzimi: 78 ditët e Kosovës

Arsyeja e parë e ekzistencës së NATO-s u bë e nevojshme me rastin e konflikteve që paraprindë shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Në atë rast, shtetet evropiane në përgjithësi panë shfaqjen e një pas-Lufte të Ftohtë. Në fakt, nuk ishte vetëm problemi i Jugosllavisë, e tërë bota po ndryshonte. Perspektivat e vjetra ishin të dala mode, aleancat të vjetruara, angazhimet të panevojshme. Shumë regjime u rrëzuan dhe ideologjitë politike u tjetërsuan. Nga mesi i viteve '90, u pa qartë se objektivat e NATO-s duhej të ndryshonin, ajo duhej të përshtatej me rendin e ri ndërkombëtar. Si e tillë, Aleanca duhej të ishte e përfshirë edhe jashtë zonës së saj të ndikimit. Në këtë kontekst, Kosova u bë një provë e rëndësishme për besueshmërinë e NATO-s. Në fakt, mungesa e aksionit do të sillte një kosto të lartë në këto terma, sidomos në atë moment historik me përafrimin e *summit*-it për celebrimin e përvjetorit të pesëdhjetë të Aleancës. Të qëndronte pasive në një moment kaq delikat, do të kishte shkatërruar besueshmërinë e NATO-s. Mos veprimi siç duhet i saj në Bosnje rezultoi fatal dhe nëse kjo gjë do të përsëritej në Kosovë, atëherë po që Aleanca do të kishte humbur shumë në reputacionin e saj. Për këtë arsye, si nevojë për të shpëtuar fytyrën e saj e vetmja zgjidhje ishte të bombardonte dhe - ndryshe nga Bosnja - për shkak të impaktit mediatic që kishte Kosova, kësaj here më shumë. Interesant është fakti se ndërhyrja në Kosovë i dha një tjetër dimension luftërave. Në atë rast, lufta ishte edhe “spektakël”² dhe NATO duhej të bënte një luftë të dyfishtë: të luftonte luftën “etike” për të evituar atë “etnike”.

Në vazhden e këtyre diskutimeve, si pasojë e ngjarjeve në Kosovë, të dështimit të diplomacisë për të bindur lidërshtipin serb, me qëllim evitim të katastrofave humanitare, për të mos toleruar spastrimin etnik dhe për të afirmuar besueshmërinë e NATO-s, më 24 mars 1999, Javier Solana firmoste urdhrin ekzekutiv për të ndërmarrë operacionin e famshëm *Allied Force*, i cili u konkretizua me bombardime në Serbi, Kosovë, Vojvodinë dhe Mal të Zi. Për herë të parë në historinë e sajë 50 vjeçare, NATO hyri në luftë dhe nga ky moment, Forcat Ajrore të Aleancës filluan rënien e republikës federale, sigurisht të asaj që kishte mbetur. Prioriteti i gjeneralit Clark ishte të nxirrte jashtë loje sistemin e komunikimit ushtarak dhe të mbrojtjes ajrore serbe. Katër ditë pas fillimit të bombardimeve (27 mars) filloi faza e dytë e luftës ajrore. Tashmë, përpos urave, autostradave dhe hekurudhave, NATO filloi të bombardonte infrastrukturën industriale të Serbisë, impiantet elektrike, rrjetin e shpërndarjes së naftës së bashku me rafineritë, duke goditur më fortë ekonominë e vendit. Më 3 prill, qytetarët serbë manifestuan mbështetjen e tyre për Milosheviçin dhe sfiduan përndimin me anë të një koncerti rok në Beograd.

Milosheviç ishte i bindur se një luftë me NATO-n nuk mund të fitohej por sulmi i aleancës i mundësonte konsolidimin e lidërshtipit të tij politik të brendshëm. Për më shumë, ai deri në momentin e fundit shpresonte në një krisje të madhe brenda aleancës, duke besuar në pozicionin e presionit të Rusisë dhe pozicionin luhatës të Francës. Sipas tij, këto dy vende nuk do të lejonin një sulm të mundshëm mbi Serbi ose të paktën që këto sulme

² Balabanova Ekaterina, *Media, Wars and Politics*. Hampshire, Ashgate, 2007, f 49.

nuk do të zgjasnin shumë, me qëllim të dilte politikisht më i fortë dhe fitimtar nga nja sulm i perëndimit³. Por, në më pak se një muaj nga bomba e parë, efektet e *Allied Force* filluan të ndiheshin në ekonominë e përgjithshme edhe pse pjesa më e madhe e qytetarëve akoma nuk vuanin për energji elektrike apo nga mungesa e ujit të pijshëm. Ndryshimi i madh erdhi kur standardi i jetesës së përditshme të popullit serb u godit. Nga këtu e në vazhdim, morali i popullatës civile filloi të binte dhe për pasojë demonstratat kundër luftës filluan të zëvendësonin koncertet *rock*. “Të vdekurve nuk iu duhet Kosova” ishte parulla e demonstruesve serbë në Krusevac. Nga ky moment, një valë dezertimesh përfshin ushtrinë e Serbisë me shifra që flasin për rreth 500-1000 ushtarake serbë që braktisin Kosovën.⁴

Një muaj pas operacionit (24 prill) NATO mori në konsideratë serioze opsionin e ndërhyrjes me forca tokësore. Në këto kushte, ndërhyrja e Ruisë, me anë të kryeministrit Victor Chernomyrdin, kërcënimi i NATO-s për të përshkallëzuar konfliktin, rënia e popullaritetit të qeverisë në vend dhe paaftësia e saj për të kontrolluar trupat ushtarake, bindën Milosheviçin se mundësitë e tij për të mbajtur pushtetin ishin më të mëdha nëse do t’i dorëzohej kërkesave të NATO-s për t’i dhënë fund luftës. Pas pothuajse tre muajsh bombardime, amerikanët (me anë të zv/sekretarit të shtetit Strobe Talbott) dhe rusët (Victor Chernomyrdin) takohen në Romë për t’i dhënë fund luftës. Më 3 qershor presidenti finlandez Martti Ahtisari, Talbott dhe Chernomyrdin shkuan në Beograd për t’i paraqitur Milosheviçit planin e paqes. Ishte një propozim merre ose lëre! Nëse do të optohej për opsionin e dytë, NATO do të vazhdonte të bombardonte, me opsion ndërhyrjen tokësore dhe se kushtet e një plani paqeje të ardhshëm do të ishin shumë më të rënda. Po ashtu i ofruan një marrëveshje ushtarake teknike, e cila detajonte tërheqjen graduale dhe sipas fashave të ushtrisë serbe nga Kosova. Milosheviç pranoi planin e paqes i cili në të njëjtën ditë u ratifikua formalisht nga parlamenti serb. Përdorimi i forcës kishte dhënë frytet e saj.

4. Luftërat e reja, shumë të reja, gati antike

Asnjë shtet nuk e do luftën, të gjitha shtetet duan paqen, por shtetet duan paqen e tyre dhe për të arritur këtë, bëjnë luftën. Sigurisht disa regjime (kryesisht autoritare dhe totalitare) janë më të prirura të bëjnë luftën ndryshe nga regjimet liberale demokratike të cilat dy gjëra i bëjnë me shumë vështirësi: të fillojnë luftën dhe ta përfundojnë atë. Fakti se regjimet në fjalë hasin vështirësi në fillimin e luftës kjo nuk do të thotë se nuk e bëjnë: regjimet demokratike

³ Për kronikë vlen të përmendet një takim ndërmjet ministrave të jashtëm të BM, të ShBA-ve, të Gjermanisë dhe Ruisë në sallën VIP të aeroportit të Heathrow në Londër. Në një moment kritik dhe të tensionuar, Igor Ivanov, ministri i jashtëm rus i thotë homologut gjerman Klaus Kinkel: “nëse doni ta kaloni në OKB, ne do të vendosim veton. Kinkel i përgjigjet se preferon ta kalojë nga Këshilli i Sigurimit, mirë thotë Ivanov por ne do vendosim veton. Kinkel pyet të njëjtën gjë por kësaj here më i vendosur atëherë Ivanov përgjigjet, -të thashë Kinkel, -ne do vendosim veton por reagimi ynë do të limitohet në gazeta. Kjo dritë jeshile e rusëve dhe dështimi i takimit të fundit të Richard Holbrooke më 22 mars 1999 në zyrën e Milosheviçit (Duhet të pranoni të negocioni. Kupton çfarë do t’iu ndodhë nëse lë këtë zyrë dhe nuk keni ndryshuar pozicion. Milosheviç përgjigjet: po, do të na bombardoni.” Një ide udhëheqësi serb e kishte krijuar) i dha Solanës elementët e nevojshëm për të autorizuar sulmin. Vasquez John A. *The Kosovo War: Causes and Justification*.

⁴ Kirkpatrick Jeane J., *Making War to keep Peace*, HarperCollins e-books, 2007, f. 260.

nuk bëjnë luftë me njëra-tjetrën por jo që nuk bëjnë luftë! Disa etologë e konsiderojnë luftën një fenomen natyror. Kjo hipotezë është sugjeruese por jo shteruese. Sigurisht e thënë me Aristotelin, njeriu është kafshë politike. Të gjitha veprimet e tij janë politike dhe lufta është një prej tyre. Lufta mund të përkufizohet si bashkësi e koordinuar e akteve të dhunës e vënë në praktikë për të detyruar dikë që t'i bindet vullnetit tonë (Clausewitz). Në këtë kontekst, lufta është një instrument i politikës. Por njeriu është përkufizuar edhe si një kafshë racionale. Fakti se njeriu është një kafshë çdo gjë përveçse racionale rrjedh nga fakti se lufta është – ende sot – gjëja që njeriu bën më mirë se të tjerat, më të organizuar, më të zhvilluar, më të avancuar dhe me impakte tmerrësisht më të mëdha.

Ky artikulum ishte i vlefshëm deri në fillim të viteve '90, kur forca ishte monopol i shtetit. Nëse në të kaluarën lufta ishte konvencionale dhe ndërshtetërore e cila mund të degjeneronte në konflikte civile, sot lufta nis si konflikt civil dhe degjeron në luftë ndërshtetërore. Edhe konfliktet që u verifikuan në Ballkan nuk janë totalisht konform traditës të luftimit. Pjesa dërrmuese e tyre nuk ishin ndërshtetërore por brenda territoreve shtetërore. Ky model dhune konfirmohet edhe nga statistikat e luftërave të reja. Në fillim të shekullit XX, raporti ndërmjet viktimave ushtarake dhe civile në luftë ishte 8:1. Në rastin e konflikteve në Ballkan ky raport u bë 1:8.⁵ Efektet anësore të luftërave të reja, dikur të konsideruara të padëshirueshme, të evitueshme, jo etike dhe joligjore, tashmë përbënin një pjesë thelbësore të mënyrës së re të të bërit luftë. Civilët nuk ishin më vetëm pasoja, dëme anësore por qëllimi në vetvete.

Luftërat e reja karakterizohen nga një varietet i shumtë i aktorëve të përfshirë; publik dhe privat, shtetëror dhe joshtetëror, duke braktisur kështu njësitë tradicionale hierarkike vertikale që aplikonin “luftën e vjetër”. Luftërat e reja mund të kryhen nga njësi parashtarake, figura karizmatike lokale, banda kriminale, grupe të armatosur, forcat policore, grupe mercenarësh por edhe nga ushtri të rregullta konvencionale. Ardhja në dritë e këtyre aktorëve të ndryshëm mund të interpretohet si një funksion i kompozimit apo rikompozimit të monopolit shtetëror të përdorimit të forcës. Po ashtu, ekziston një motiv tjetër, ekzistenca e njësisive para shtetërore që hyjnë në aksion kundër forcave që veprojnë kundër shtetit, brenda shtetit apo në vend të shtetit. Karakteristika e fundit e luftërave të reja përshkruhet dhe lidhet me ekonominë e re të globalizuar. Sipas Kaldor⁶ luftërat e reja zhvillohen në një kontekst të qartë të përkufizuar si një version ekstrem i globalizimit. Lufta moderne është të lëshosh një raketë që kushton 100.000\$, nga një avion që kushton 100 milion \$ dhe që harxhon 50.000\$ për orë fluturimi për të vlarë një person që fiton më pak se një dollar në ditë. Në këtë aspekt, lufta ka humbur tradicionalitetin përfitues të saj; nuk është më e leverdishme në termat ekonomikë.

Kosova u bë kështu një shembull tipik i luftërave të reja. Ishte një konflikt i armatosur i brendshëm që shkaktoi raste makabre të spastrimit etnik, vrasjeve në masë, krimeve kundër njerëzimit, genocidit, shkatërrimit të fshatrave të tërë, të qendrave ekonomike, monumenteve historike dhe fetare dhe në fund të ndërkombëtarizmit të konfliktit duke

⁵ Balabanova Ekaterina, *Media, Wars and Politics*, vep. cit., f. 25.

⁶ I cituar në *Media, War and Politics*, f. 28.

përfshirë të gjithë Aleancën e Atlantikut të Veriut. Ishte një luftë e ndërmarrë për objektiva të rinj; mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Çfarë ndodhi në Kosovë bën plotësisht pjesë në hapësirën e luftërave të reja pasi posedon disa karakteristika specifike që e dallon nga konfliktet tradicionale. Konfliktet në fjalë mbijnë pas erozionit të funksioneve shtetërore dhe në disa raste të shpërbërjes së tij. Kanë objektiva politike, si p.sh., mobilizimi mbi bazë të identitetit kombëtar, fetar, gjuhësor apo komunitar lokal. Strategjia ushtarake e aplikuar për të arritur qëllimet është spostimi i popullatës civile dhe destabilizimi i rendit me qëllim provokimin dhe krijimin e frikës dhe urrejtjes. Luftërat e reja janë të drejtuara ndaj civilëve dhe shoqërisë civile në përgjithësi.

Mbështetësi e ndërhyrjeve humanitare mund të kundërshtojnë faktin se ajo, për sa e përgjakur mund të jetë, mund të jetë e keqja më e vogël. Në këtë kontekst, lufta humanitare mund të përkufizohet si një luftë e drejtë (*Luigi Bonante, Guerra*). Gjithsesi, si do të jetë puna, problemi qëndron i pazgjidhur pasi, a mund të qëndrojmë pasivë përballë disa krimesh kundër civilëve të pafajshëm? Edhe pse të vetëdijshëm për kritikën rreth argumentit për luftërat e reja në Kosovë dhe në Ballkanin e pas '90, është i vështirë kontestimi që këto konflikte nuk mund të përkufizohen si "luftëra të reja". Kjo për disa arsye; bëhej fjalë për shqiptarët në betejë për një autonomi politike apo për pavarësi të plotë; së dyti pretendimi territorial i Serbisë mbi Kosovën u bazuan në argumente që rridhnin nga manifestime të veçanta politike identitare; së treti, procesi i spastrimit etnik në Kosovë si pjesë e një strategjie më të gjerë për të kontrolluar territorin.

5. Përfundime

Aksioni ushtarak ndërkombëtar kundër ish-Jugosllavisë është proklamuar me të madhe si ndërhyrja e parë ndërkombëtare ushtarake kundër një shteti sovran për qëllime pastërtish humanitare. Ky veprim përfaqësonte një precedent të rëndësishëm në politikën ndërkombëtare që, jo vetëm ilustroi ndryshimet konceptuale të sigurisë ndërkombëtare por, gjëja më e rëndësishme, ofroi një instrument të humanitarizmit të ri ushtarak. Qëndrimi në pasivitet do të thoshte një kthim në të kaluarën, në kujtimet më të egra të atij shekulli, do të minonte të gjithë sistemin e vlerave mbi të cilat ishin ndërtuar politikat e sigurisë perëndimore, do të kishte minuar besueshmërinë në institucionet ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë raportin transatlantik.

Kështu, katër arsye kryesore u sollën në jetë për të justifikuar sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë: evitimi i katastrofave humanitare; besueshmëri dhe ekzistenca e NATO-s; spastrimi etnik nuk mund të tolerohej në civilizimin evropian; përdorimi i forcës, edhe pse nuk mori aprovimin e Këshillit të Sigurimit, ishte konform rezolutave të tij. Këto argumente janë të aplikueshëm për sa i përket kritereve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe transformoi axhendën e politikës ndërkombëtare. Nga Kosova e më pas, dhunimet e rënda të të drejtave të njeriut apo opresimi i grupeve të tëra për shkak të racës, fesë, kulturës apo etnisë është bërë motiv i mjaftueshëm për të aktivizuar aksionin ushtarak nga ana e komunitetit ndërkombëtar edhe pse mund të jetë në kundërshtim me parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti sovran.

Mund të diskutojmë pafundësisht rreth legjitimitetit të ndërhyrjes, por fakti është se në Kosovë ishin verifikuar raste të tmerrshme të vrasjeve masive dhe të spastrimit etnik. Nuk ishte akoma gjendja boshnjake por, për shkak se lidershpi serb ishte i njëjti që kishte shkaktuar mizoritë në Bosnje dhe fakti se për Beogradin, Kosova ishte shumë më e rëndësishme se Bosnja, probabiliteti që të njëjtat krime do të ndodhnin edhe në Kosovë ishte i lartë. Bashkësia ndërkombëtare, duke pasur parasysh pasivitetin e saj në Bosnjë duhej - herët a vonë - të mësonte nga “gabimet e saj” pasi, sa ishte e vërtetë se jo të gjithë serbët kanë bërë masakra, aq e vërtetë është se të gjitha masakrat i kanë bërë serbët. Kosova për serbët nuk është çështje racionale! Lufta për serbët, ashtu si për Ballkanin në përgjithësi, nuk është çështje racionale! Në Ballkan lufta bëhet jo sepse janë të bindur se mund ta fitojnë, jo në bazë të një plani të detajuar optimist, por i nënshtrohen efekteve të theksuara emotive dhe aventuriere! Në Ballkan lufta bëhet dhe pikë.

Machiavelli dënon neutralitetin për shpresën e rremë që ofron. Duhet marrë pozicion dhe duhet të jesh prezent. Në fakt kjo gjë vlen për pothuajse çdo gjë, vlen edhe për problemet të cilat nëse nuk i godet në kokë dhe në kohë, do të përhapen si kanceri. Në këto kushte, çmimi i indiferencës ishte me të vërtetë i lartë! Siç shprehet Thomas Addison (*Violent Politics*): “*nëse politika është një mjet për të zgjidhur mosmarrëveshjet, lufta është një tjetër*”. Kështu, më 24 mars 1999, bombat e NATO-s filluan rënien e Federatës së Jugosllavisë, sigurisht të asaj çfarë kish mbetur. Me 9 qershor, pas 78 ditë bombardimesh, përfaqësuesit e NATO-s dhe ato të Serbisë firmosën në Kumanovë marrëveshjen teknike ushtarake, e cila ishte ekuivalent i kapitullimit të Serbisë dhe humbjes së kontrollit efektiv të Beogradit mbi Kosovë. Ironia e deshi që pikërisht në betejën e Kumanovës në vitin 1912 që Serbia, në luftë kundër Perandorisë Osmane, pushtoi Kosovën, po në atë vend, pas pothuajse një shekulli, humbi kontrollin efektiv mbi të.

Në të vërtetë, konflikti në Kosovë rezultoi “fatlum” për Aleancën, pasi vendimi për bombardime u arrit për dy arsye: për të ndaluar spastrimin e dhunshëm etnik dhe për të afirmuar “kredibilitetin e NATO-s”. Përsa i përket të parës, duhet thënë se ishte fundshekull dhe udhëheqësit e botës së civilizuar donin të hynin në shekullin e ri me fytyrë të pastër, pasi krimet kundër njerëzimit, gjenocidi dhe spastrimet etnike ishin krime që i përkisnin shekullit XX dhe në agimin e shekullit XXI, këto krime nuk duhet të kishin vend. Ndërhyrja u pa edhe si një instrument për të dërguar një mesazh të fortë ndaj të gjithë aventurierëve autoritarë se krime të tilla nuk do të tolerohen më.

Përsa i përket të dytës: mosveprimi do të kishte rezultuar fatal për Aleancën dhe për besueshmërinë e saj, veçanërisht në atë kohë (1999), me afrimin e samitit për kretiminin e përvjetorit të pesëdhjetë të NATO-s. E vetmja mundësi që NATO kishte për të siguruar kredibilitetin e saj ishte të bombardonte dhe - ndryshe nga Bosnja - këtë herë shumë pasi, sytë e botës ishin të drejtuar nga Kosova. Në fakt, ishte e nevojshme të llogaritej edhe efekti mediatik, sepse për herë të parë, makina luftarake e Atlantikut të Veriut ishte vënë në veprim dhe për këtë duhej të bënte një përshtypje të mirë. Në këto kushte, mund të theksojmë guximshëm se, nëse është i vërtetë fakti se NATO i bëri punë Kosovës, nuk është më reduktiv fakti se edhe Kosova i bëri punë NATO-s.

Bibliografia:

- Babac Bahador, *The CNN effect in action. How the news media pushed the west toward war in Kosovo*, Palgrave Macmillan, New York, 2007.
- Bacevich Andrew J. e Cohen Eliot A., *War over Kosovo. Politics and strategy in a Global Age*, New York, Columbia University Press, 2001.
- Balabanova Ekaterina, *Media, Wars and Politics. Comparing the Incomparable in Western and Eastern Europe*, Hampshire, Ashgate Publishing Limited, 2007.
- Bozzo Luciano, a cura di, *Le guerre umanitarie. Dalla Somalia al Kosovo*, Quaderni Forum, Anno XIV n.1, 2000.
- Cordesman Anthony H., *The Lessons and Non-Lessons of the Air and Missile Campaign in Kosovo*, Westport, Praeger Publisher, 2001.
- Chomsky Noam, *Il nuovo umanesimo militare: lezioni dal Kosovo*, Trieste, Asterios, 2000.
- Gibbs, David N. *First do no Harm. Humanitarian intervention and the destruction of Yugoslavia*, Nashville, Vanderbilt University Press, 2009.
- Helton Arthur C., *The price of indifference. Refugees and humanitarian Action in the new Century*, Oxford, Oxford University Press, 2002.
- Holzgrefe Jeffrey L. e Keohane Robert O., *Humanitarian intervention. Ethical, legal, and political dilemmas*, New York, Cambridge University Press, 2003.
- Kirkpatrick Jeane J., *Making war to keep peace*, HarperCollins e-books, 2007.
- Nardulli Bruce R., *Disjointed war. Military operation in Kosovo, 1999*, California, RAND Arroy Center, 2002.
- Mayer Marco, *Interventi umanitari e missioni di pace. Una guida non retorica*, Roma, Carocci, 2005.
- Scotto Giovanni e Arielli Emanuele, *La guerra del Kosovo. Anatomia di un'escalation*, Roma, Editori Riuniti, 1999.

FATKEQËSITË NATYRORE DHE SIGURIA NJERËZORE – PËRFSHIRJA E FATKEQËSIVE NATYRORE NË AXHENDËN E SIGURISË NJERËZORE

Kolonel Irela Nebiaj

Shef i Grupit Kërkimor për Analizë Strategjike
për SS/SSK/PM/SU, IKSHU

Nënkolonel (R) Alqi Nikolla

Oficer shtabi/specialist për Politikat e Mbrojtjes
dhe SU, IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Siguria njerëzore është një qasje që hedh poshtë përparësinë tradicionale të sigurisë shtetërore dhe identifikon individin si referent kryesor të sigurisë. Ajo ofron një mënyrë për të zgjeruar perspektivën tonë, duke pranuar që kërcënimet më të ngutshme ndaj individëve nuk vijnë nga lufta ndërshtetërore, por nga emergjencat që prekin njerëzit çdo ditë, siç janë uria, sëmundja, zhvendosja, konflikti civil, fatkeqësitë natyrore, degradimi i mjedisit etj.

Fokusi kryesor i këtij punimi përqendrohet në analizën dhe ndikimin e krizave apo fatkeqësive natyrore mbi dobësitë e grupeve sociale, jetesën e tyre, në eksplorimin e çështjeve të sigurisë njerëzore në kontekstin e procesit të menaxhimit të krizave apo fatkeqësive natyrore. Duke e vlerësuar sigurinë njerëzore si më kategorike në përpjekjet tona për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, ne do të jemi në gjendje të kemi strategji të përmirësuara, planifikim e përgatitje më të mirë për shmangien nga fatkeqësitë natyrore pa lënë pas dore pjesët më të rrezikuara të komuniteteve.

Si një teori relativisht e re, siguria njerëzore ende po zbulohet dhe diskutohet nga studiuesit dhe ekspertët. Aplikimi i saj në fatkeqësitë natyrore është një fazë e rëndësishme e evolucionit të mëtejshëm të konceptit të sigurisë njerëzore.

Fjalët kyçe: siguri njerëzore, fatkeqësi natyrore, mbrojtja civile

1. Hyrje

Siguria njerëzore është një qasje që hedh poshtë përparësinë tradicionale të sigurisë shtetërore dhe e identifikon individin si referent kryesor të sigurisë. Ajo ofron një mënyrë për të zgjeruar perspektivën tonë, duke pranuar që kërcënimet më të ngutshme ndaj individëve nuk vijnë nga lufta ndërshtetërore, por nga krizat dhe emergjencat që prekin njerëzit çdo ditë, të tilla si: uria, sëmundja, zhvendosja, konflikti civil, emigrimi, degradimi i mjedisit, fatkeqësitë natyrore, etj. Siguria njerëzore ka të bëjë me njerëzit, të cilët jetojnë jetën e tyre me dinjitet, duke qenë të lirë nga “frika” dhe “dëshirat”. Deri më tani, ka pasur një tendencë të fortë për t’u përqendruar në pasigurinë e shkaktuar nga konflikti civil, me më pak vëmendje në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë mjedisore nga fatkeqësitë natyrore.

Krizat dhe fatkeqësitë natyrore janë prirur të anashkalohe nga axhenda e sigurisë njerëzore, edhe pse ato shkaktojnë të njëjtat probleme: vdekje, shkatërrim masiv, zhvendosje të popullsisë dhe ndjeshmëri më të madhe për njerëzit.

Le të përmendim disa shembuj konkretë: tsunami i Oqeanit Indian në vitin 2004 rezultoi me 226,408 vdekje; cikloni Nargis në Myanmar në 2008 shkaktoi 138,366 vdekje; tërmeti në Haiti në vitin 2010 pati më shumë se 316,000 vdekje; tërmeti i Sichuan i vitit 2008 zhvendosi mbi 15 milion njerëz; 11 milion njerëz u zhvendosën gjatë përmblytjeve në Pakistan në 2010¹. Po kështu, nga tërmeti 6.3 ballë i 26 nëntorit 2019 në vendin tonë humbën jetën 51 persona, u prekën 202,291 të tjerë dhe 17 mijë u zhvendosën.² Ndërsa në rastin e pandemisë COVID-19, e cila po vazhdon ende, humbjet njerëzore janë shumë të mëdha pa përmendur ato ekonomike.

Fatkeqësitë natyrore nuk prekin në mënyrë të barabartë vendet dhe njerëzit, por ato paraqesin një kërcënim gjithnjë e më të madh të sigurisë njerëzore në çdo vend. Kështu, një doktrinë e sigurisë njerëzore që nuk përfshin fatkeqësitë natyrore do të ketë një vlerë të kufizuar në menaxhimin e kërcënimeve me të cilat përballemi.

Njëzet e shtatë vjet pasi u shfaq për herë të parë në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të

¹ https://en.wikipedia.org/wiki/2010_Haiti_earthquake; [https://www.worldvision.org/disaster-relief-news-stories/2004-indian-ocean-tsunami-facts;](https://www.worldvision.org/disaster-relief-news-stories/2004-indian-ocean-tsunami-facts) https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/14116/myanmar_cyclonenargis_case_study.pdf?sequence=1&isAllowed=y

² Raport: Shqipëria, vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë. <https://www.balkanweb.com/raporti-i-plote-per-termetin-e-26-nentorit-mbi-200-mije-persona-te-prekur-ja-sektoret-me-te-goditur/>

UNDP-së, siguria njerëzore ka siguruar një vend në axhendën e bashkësisë ndërkombëtare. Gjithashtu, Raporti i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së në vitin 1994 dhe Komisioni për Sigurinë Njerëzore në mënyrë të qartë identifikuan fatkeqësitë natyrore si një kërcënim për sigurinë njerëzore³. Veçanërisht, Ban Ki-Moon⁴, ish-Sekretari i Përgjithshëm i KB, ka luajtur një rol kryesor në integrimin e plotë të sigurisë njerëzore në sistemin e Kombeve të Bashkuara. Kjo qasje duhet të vazhdojë të avancohet dhe një theks shumë më i madh duhet t'i kushtohet kërcënimit të paraqitur nga fatkeqësitë natyrore dhe ndikimin e tyre në sigurinë njerëzore. Siguria njerëzore adreson gamën e plotë të pasigurive njerëzore, me të cilat përballen komunitetet, përfshirë, por pa u kufizuar në konflikte të dhunshme, varfërim ekstrem, fatkeqësitë natyrore, pandemitë shëndetësore, etj., si dhe ndërvarësitë e tyre. Në veçanti, si një qasje operative, siguria njerëzore identifikon shkaqet thelbësore të kërcënimeve brenda dhe përtej kufijve dhe me përparësi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

2. Kuptimi i sigurisë njerëzore dhe lidhja me sigurinë kombëtare

Qasja e sigurisë njerëzore, bazohet në një kuptim të zgjeruar të sigurisë ku mbrojtja dhe fuqizimi i njerëzve formojnë bazën dhe qëllimin e sigurisë. Zhvillimi i kornizës së sigurisë njerëzore nga Raporti Global i Zhvillimit Njerëzor i vitit 1994 (HDR) i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) ishte një hapi i parë në këtë drejtim.

Kjo qasje u ndikua thellësisht nga konteksti politik dhe i sigurisë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ishin një sërë faktorësh që krijuan hapësirën e nevojshme për zhvillimin e saj, si:

- ulja e kërcënimit global të luftës bërthamore;
- mbizotërimi i kërcënimeve jotradicionale dhe joushtarake; demokratizimi;
- forcimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e jetës njerëzore dhe mirëqenies;
- globalizimi dhe pasojat e lidhura me të;
- rritja e varfërisë;
- rritja e numrit të konflikteve të brendshme të armatosura e të dhunshme;
- përhapja e armëve të vogla dhe të lehta;
- ndryshimet klimaterike, katastrofat/fatkeqësitë natyrore.

Kërcënimet më të mëdha për njerëzit normalisht nuk vijnë nga lufta ndërshtetërore, por nga llojet e tjera të emergjencës, siç janë: krizat, fatkeqësitë natyrore, uria, sëmundjet, zhvendosja, konflikti civil dhe degradimi i mjedisit. Në këtë kuptim, siguria njerëzore nënkupton “mbrojtjen nga problemet e papritura dhe të dëmshme në modelin e jetës sonë të përditshme”⁵. Duke u bazuar tek kjo, përpjekjet për të adresuar pasiguritë duhet të

³ *United Nations Development Programme, Human Development Report, fq. 29.*

⁴ *Ban Ki-moon is a South Korean politician and diplomat who served as the eighth Secretary-General of the United Nations from January 2007 to December 2016. Before becoming Secretary-General, Ban was a career diplomat in South Korea's Ministry of Foreign Affairs and in the United Nations.*

⁵ *United Nations Development Programme, Human Development Report 1994, f. 3.*

ndërmerren si pjesë e politikës normale, të përditshme.

Sipas *Oscar Arias*, “Siguria njerëzore përfaqëson shkallën e mbrojtjes së qenieve njerëzore nga injoranca, sëmundjet, uria, shpërfillja dhe keqtrajtimi. Standardi i jep dinjitet jetës njerëzore”; kurse në një trajtim më njerëzor, ajo “është një fëmijë që shpëtohet, një sëmundje që kurohet, një tension etnik që zbutet, një disident i cili arrin të flasë lirshëm, një shpirt njerëzor që ka shpresë”⁶. Siguria njerëzore është një qasje gjithëpërfshirëse, e cila vendos peshë të barabartë ndaj kërcënimeve për mirëqenien e njerëzve të shkakuar nga dhuna fizike dhe ato të shkaktuara nga faktorë të tjerë, siç janë varfëria, mos zhvillimi, sëmundja ose fatkeqësitë natyrore. Ndjeshmëria e shkakuar nga uria, sëmundja ose dëmtimi i mjedisit mund të jetë po aq e dëmshme për sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve, ashtu si edhe dhuna fizike e drejtpërdrejtë. Në rastin e fatkeqësive natyrore, në shumë mënyra, pasojat njerëzore nuk janë aq të ndryshme me ato të shkaktuara nga lufta: vdekja e përhapur, shkatërrimi masiv, zhvendosja e gjerë dhe cenueshmëria /ndjeshmëria e shtuar.

Komisioni për Sigurinë Njerëzore 2003 (Commission on Human Security) shpjegon: “Pak shoqëri mbrojnë sigurinë njerëzore me forcën dhe efektin e përgjigjeve të tyre ndaj kërcënimeve të shumta për sigurinë e shtetit. Por, qëllimi i sigurisë njerëzore është të bëjë pikërisht atë - të ndërtojë një infrastrukturë mbrojtëse që mbron jetën e të gjithë njerëzve nga kërcënimet kritike dhe të përhapura”⁷.

Raporti i UNDP për zhvillimin njerëzor i vitit 1994, raporti i Komisionit për Sigurinë Njerëzore 2003 dhe raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të KB në vitin 2010 dhe 2012, përcaktojnë në mënyrë të qartë krizat dhe fatkeqësitë natyrore si një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë njerëzore. Për më tepër, Komisioni për Sigurinë Njerëzore ka vënë në dukje se “fatkeqësitë natyrore, së bashku me krizat ekonomike dhe konfliktet, janë burimi i tronditjeve më të mëdha në një shoqëri dhe i sigurisë njerëzore të popujve”⁸. Pra, në fund të fundit, siguria njerëzore ka të bëjë me njerëzit që jetojnë jetën e tyre me dinjitet, që nënkupton “lirinë nga frika”⁹ dhe ‘lirinë nga dëshira’¹⁰.

Por, siguria njerëzore është e lidhur ngushtë me sigurinë kombëtare. Ndërsa siguria kombëtare tradicionale përcakton përparësitë për sigurimin/arritjen e sigurisë kombëtare, siguria njerëzore përcakton përparësitë për sigurimin e nevojave themelore të individëve përtej kufijve kombëtarë.

Siguria njerëzore bën të mundur prioritizimin e nevojave të përshtatshme njerëzore. Në secilën marrëdhënie këto dy koncepte të dallueshme kanë të bëjnë me njëra-tjetrën dhe

⁶ *Globalization and the Challenges of Human Security* Speech by Oscar Arias University of San Diego, September 28, 1998).

⁷ *Commission on Human Security Report 2003* faqe 85

⁸ *Commission on Human Security Report 2003*, p. 73

⁹ *Liria nga frika, nënkupton një ulje të armatimeve në të gjithë botën në një pikë të tillë dhe në një mënyrë kaq të plotë sa që asnjë komb nuk do të jetë në gjendje të kryejë një akt agresioni fizik kundër cilitdo fqinj, kudo në botë.*

¹⁰ *Liria nga dëshira, nënkupton mirëkuptim ekonomik që do t'i sigurojnë secilit komb një jetë të shëndetshme paqeje për banorët e saj - kudo në botë.*

mungesa e njerës çon në mungesën e tjetrës. Siguria kombëtare mund të forcojë sigurinë njerëzore dhe kjo e fundit nuk kundërshton sigurinë kombëtare, por zgjeron fushën e strategjive për sigurinë e përgjithshme. Siguria njerëzore është një qasje individuale dhe e orientuar drejt sigurisë, e cila pranon se stabiliteti i qëndrueshëm, jo vetëm i shteteve por edhe i shoqërive që ata përfaqësojnë, është i pamundur derisa të garantohet siguria njerëzore. Siguria njerëzore i referohet të drejtave të qytetarëve për të jetuar në një mjedis të sigurt dhe ekzistencës së veprimtarisë politike, sociale, fetare dhe ekonomike brenda secilës shoqëri pa dhunë të organizuar.

Ajo përfshin një gamë të gjerë të kërcënimeve të mundshme, të tilla si ekonomike, mjedisore etj., dhe kufizimi i saj vetëm në dhunën fizike minon jo vetëm qëllimin origjinal të qasjes, por nënvlerëson seriozisht rëndësinë e kërcënimeve të tjera. Nga ky këndvështrim, fatkeqësitë natyrore përfshihen qartë në sigurinë njerëzore pasi janë ndër kërcënimet më të rëndësishme për sigurinë njerëzore, dhe ndikojnë gjerësisht e thellësisht në mirëqenien e njerëzve.

Vetëm në vitin 2020 janë regjistruar 389 ngjarje të fatkeqësive natyrore me 15,080 vdekje, mbi 98.4 milion njerëz të prekur, dhe 171.3 miliardë dollarë humbje ekonomike në të gjithë botën¹¹. Barra nuk u nda në mënyrë të barabartë pasi Azia përjetoj 41% të ngjarjeve të fatkeqësive dhe 64% të njerëzve të prekur. Zjarret në Australi, uragani Eta në Amerikën Qendrore, përmbytjet në Afganistan, tërmeti dhe cunami në Greqi dhe Turqi, cikloni Amfan në Bangladesh dhe Indi, uragani Laura në Luiziana dhe Teksas, Republika Dominikane dhe Haiti, përmbytjet në Indonezi, tërmeti në Turqi, shpërthimi i vullkanit apo tajfuni në Filipine janë katastrofat natyrore më vdekjeprurëse të vitit 2020¹².

Duke parë drejt së ardhmes, pritet që ngjarjet ekstreme të motit të ndodhin gjithnjë e më shpesh dhe ekspozimi ndaj rrezikut të tyre do të vazhdojë të rritet. Fatkeqësitë natyrore do të jenë një nga rreziqet më të mëdha për sigurinë njerëzore në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara, në dekadat e ardhshme. Siguria njerëzore thekson jo vetëm se si njerëzit në mënyrë individuale dhe kolektive e përjetojnë fatkeqësitë natyrore, por edhe se si i perceptojnë përgjegjësitë e tyre ndaj brezave të ardhshëm, duke përfshirë aftësinë e tyre për të krijuar rezultate që mund të ndërtojnë një të ardhme më të qëndrueshme. Një avantazh i veçantë i qasjes së sigurisë njerëzore për të kuptuar fatkeqësitë natyrore, krizat dhe konfliktet, është theksi i tij në rolin e drejtpërdrejtë e të menjëhershëm të njerëzve në krijimin, përkeqësimin ose zvogëlimin e cënueshmërisë dhe rrezikut.

Fatkeqësitë natyrore nuk janë kurrë plotësisht të natyrshme: sjelljet njerëzore dhe strukturat shoqërore formojnë mënyrën e shfaqjes së tyre. Pra, kur merret në konsideratë një fatkeqësi, ka një tendencë për të bërë një dallim midis fatkeqësisë natyrore (tërmetit, përmbytjes, etj.) dhe asaj të krijuar nga njeriu (ndërtimi, shpyllëzimi, etj.). Kështu,

¹¹ *Natural Disasters – 2020. Cred Crunch 62 - 2020 Annual Report Centre for Research on the Epidemiology of Disasters (CRED) pdf. www.emdat.be Cred Crunch 62 - 2020 Annual Report and “2020 Non-COVID Year in Disasters”*

¹² <https://www.usnews.com/news/best-countries/slideshows/here-are-10-of-the-deadliest-natural-disasters-in-2020?slide=12>

përmbytjet apo tërmetet janë ngjarje natyrore, të cilat, duke bashkëvepruar me veprimet shkatërruese të njeriut, përgatitjen e papërshtatshme dhe vendimmarrjen e dobët, mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme.

Faktorë të tillë si: vetëkënaqësia ndaj rreziqeve të paraqitura nga fatkeqësitë, besimi i gabuar në infrastrukturën mbrojtëse, trajnimi i pamjaftueshëm dhe shkalla e ulët e gatishmërisë (personelit, teknikës, pajisjeve) kontribuojnë në numrin e madh të vdekjeve në njerëz dhe dëmet ekonomike. Në këtë drejtim, një perspektivë e sigurisë njerëzore pranon se mund të jetë e pamundur të parandalohen plotësisht rreziqet natyrore, krizat apo konfliktet, por, përgatitja dhe planifikimi i duhur mund të ndihmojë në kufizimin e dëmeve.

Siguria njerëzore identifikon shkaqet thelbësore të krizave e fatkeqësive natyrore dhe ndikimin e tyre në pasiguritë njerëzore. Ajo thekson parandalimin e hershëm sesa ndërhyrjen e vonë. Inkurajon strategjitë që merren me zhvillimin e mekanizmave për parandalimin, me zbutjen e efekteve të dëmshme kur ndodhin dëmet dhe në fund të fundit, në ndihmën e komuniteteve për të përballuar fatkeqësitë. Ndërsa ne nuk mund të shmangim të gjitha fatkeqësitë natyrore, përgatitja jonë dhe përgjigjet ndaj ndikimeve të tyre njerëzore mund dhe duhet të përmirësohen. Qasja e sigurisë njerëzore ka shumë për të ofruar duke lehtësuar një përqendrim në dobësitë njerëzore, duke zvogëluar kështu pasojat e rënda të fatkeqësive natyrore për sigurinë dhe mirëqenien e njeriut.

3. Elementet kryesore të qasjes së sigurisë njerëzore në fatkeqësitë natyrore

Raporti i zhvillimit të UNDP i vitit 1994 identifikon katër elemente kryesore të qasjes së sigurisë njerëzore¹³, si një mënyrë për të ilustruar se si fatkeqësitë natyrore krijojnë probleme të mëdha nga një perspektivë e sigurisë njerëzore.

3.1. Siguria njerëzore është një shqetësim universal. Siguria njerëzore është e lidhur me njerëzit kudo, në kombe të pasura, të industrializuara, të zhvilluar ekonomikisht dhe të varfra. Pasiguritë serioze mund të ekzistojnë në të gjitha vendet. Ka shumë kërcënime që janë të zakonshme për të gjithë njerëzit, të tilla si: papunësia, droga, krimi, ndotja, epidemitë, fatkeqësitë natyrore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Intensiteti i tyre mund të ndryshojë nga një pjesë e botës në tjetrën, por të gjitha këto kërcënime janë reale dhe në rritje për sigurinë njerëzore.

Faktorët socialë, politikë dhe ekonomikë - duke bashkëvepruar veçmas, në kombinim me njëri-tjetrin dhe me mjedisin fizik, krijojnë një mozaik rreziqesh që prekin njerëzit dhe vendet ku ata banojnë. Kjo është veçanërisht e dukshme në fatkeqësitë natyrore, që përfshijnë vende me të ardhura të ulëta (Haiti), të ardhura të mesme (Kinë, Indonezi) dhe vende me të ardhura të larta (Japoni, SHBA), siç u demonstrua me uraganin Katrina në SHBA apo tërmetin në Japoni në vitin 2011. Pra, në të vërtetë, një qasje e sigurisë njerëzore lëviz përtej një dallimi të thjeshtë midis vendeve duke e bërë atë universale.

3.2. Siguria njerëzore është më e lehtë për t'u arritur përmes parandalimit të hershëm sesa ndërhyrjes së mëvonshme. Qasja e sigurisë njerëzore shkon përtej përgjigjeve të shpejta dhe është e orientuar drejt parandalimit, duke promovuar zhvillimin e mekanizmave

¹³ Human Development Report - UNDP report 1994, f. 22-23

të paralajmërimit të hershëm, që ndihmojnë në zbutjen e ndikimit të kërcënimeve aktuale dhe, kur është e mundur, të parandalojnë shfaqjen e sfidave në të ardhmen.

Siguria njerëzore është më e lehtë dhe më pak e kushtueshme për t'u siguruar përmes parandalimit të hershëm sesa ndërhyrjes së mëvonshme. Ndihma humanitare afatshkurtër nuk mund të zëvendësojë kurrë mbështetjen e zhvillimit afatgjatë. Mund të jetë e pamundur të parandalohen plotësisht këto ndodhi por, përmes përgatitjes së duhur, dëmi i shkaktuar dhe ndikimi i qëndrueshëm në komunitet mund të zvogëlohen në mënyrë të konsiderueshme. Kjo theksohet fuqimisht edhe në “Hyogo Framework for Action”, një dokument që ilustron se si duhet të duket një qasje e sigurisë njerëzore në veprim: “...promovimi i një kulture të parandalimit, dhe mobilizimi i burimeve të përshtatshme për uljen e rrezikut nga fatkeqësitë, është një investim për të ardhmen...”¹⁴

Duke reflektuar këtë shqetësim me cenueshmërinë dhe rrezikun, një qëllim kryesor i qasjes së sigurisë njerëzore është ndërtimi dhe mirëmbajtja e një infrastrukture mbrojtëse që mbron jetën e njerëzve nga kërcënimet kritike dhe të përhapura. Kjo nënkupton jo vetëm trajtimin e simptomave, por identifikimin dhe përgjigjen ndaj shkaqeve themelore të pasigurisë njerëzore. “Fatkeqësitë natyrore nuk janë thjesht dilema shkencore që kanë nevojë për një zgjidhje teknike. Përkundrazi, ata janë produkt i mjediseve të veçanta sociale dhe politike¹⁵”. Qasja e sigurisë njerëzore thekson mënyrën se si cenueshmëria ndaj fatkeqësive natyrore nuk është e paracaktuar, por formohet nga forcat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore.

Duke reflektuar rolin kryesor të parandalimit në sigurinë njerëzore, vlen të kujtojmë analogjinë e Machiavelit mbi rolin që ka fati në çështjet e sigurisë njerëzore. “..... unë mendoj se është e vërtetë se dora e fatit është arbitri i gjysmës së veprimeve tona, por, ajo na lë të drejtojmë gjysmën tjetër”....., fati tregon fuqinë e tij ku guximi nuk është përgatitur t'i rezistojë atij, dhe ai i kthen forcat e tij, aty ku e di se barrierat dhe mbrojtjet nuk janë ngritur për ta kufizuar atë”¹⁶.

Ajo që Machiaveli e identifikon si “gjysmën tjetër” është vendi në të cilin operon qasja e sigurisë njerëzore; kjo është aty ku ekzistojnë mundësi për të ndërmarrë veprime për të zvogëluar cenueshmërinë dhe për të kufizuar llojin e kërcënimeve me të cilat përballen njerëzit. Veprimet e përcaktuara kombëtare dhe ndërkombëtare - përfshirë zhvillimin parandalues dhe rindërtues - janë të nevojshme për të mbështetur proceset e integritimit shoqëror. Fuqizimi i njerëzve dhe komuniteteve të tyre për artikullimin dhe përgjigjen ndaj nevojave të tyre dhe të të tjerëve është thelbësore.

Pandemia COVID 19 tregoi edhe njëherë më qartë se kurrë rëndësinë e parandalimit lidhur kjo me hulumtimin e qëndrueshëm. Pandemia e tanishme është një thirrje e fuqishme zgjimi, duke iu rikthyer paralajmërimit të Mary Lasker se: “Nëse mendoni se kërkimi (shkenca) është i shtrenjtë, provoni sëmundjet”¹⁷. Fjalët e saj tingëllojnë fuqishëm ndërsa vërejmë humbjet

¹⁴ *Hyogo Framework for Action 2005-2015: - UNISDR, fq.5.*

¹⁵ *Steinberg, Ted. 2000. Acts of God -- The Unnatural History of Natural Disaster in America, fq.25.*

¹⁶ *The Prince - Nicolo Machiavelli, fq. 45-46.*

¹⁷ <https://www.researchamerica.org/blog/weekly-advocacy-message-mary-woolley-if-you-think-research->

tragjike të jetës dhe shkatërrimin e ekonomisë globale të bërë nga një virus “një herë në 100 vjet”, të cilin ekspertët e kishin parashikuar vazhdimisht¹⁸.

Qasja e sigurisë njerëzore kërkon përgjigje të përqendruara te njerëzit, gjithëpërfshirëse, kontekst specifik dhe të orientuar drejt parandalimit për të forcuar mbrojtjen dhe fuqizimin e atyre që janë më të pambrojtur.

3.3. Siguria njerëzore vendos njerëzit në qendër. Problemi kryesor që përqendrohet siguria njerëzore është zhvendosja e përqendrimit nga shteti te njerëzit e tij. Ajo ka të bëjë me mënyrën se si njerëzit jetojnë në një shoqëri, sa lirisht ushtrojnë zgjedhjet e tyre të shumta, mundësitë shoqërore dhe nëse ata jetojnë në konflikt ose në paqe. Duke theksuar mënyrën se si jetohet në të vërtetë jeta e njerëzve, siguria njerëzore është e interesuar për njerëzit identiteti i të cilëve është i formuar nga marrëdhëniet e tyre me të tjerët dhe duke qenë pjesë e një shoqërie. Në këtë drejtim, Raporti i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së i vitit 1994 me vetëdije përdori termin “njerëz” dhe jo “individë”. Duke i vendosur njerëzit në qendër të analizës dhe veprimit, siguria njerëzore: Atribuon një rëndësi të barabartë për të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të individëve dhe komuniteteve.

Siguria e individit është formuar nga marrëdhëniet e tij me të tjerët dhe komunitetin ku bën pjesë. Në kontekstin e fatkeqësive natyrore, kjo nënkupton marrjen në konsideratë se si lidhjet dhe marrëdhëniet shoqërore ndërveprojnë me cenueshmërinë. Nëse komunitetet qëndrojnë së bashku ose janë të ndara pas një fatkeqësie tregon se sa ata janë në gjendje të përballen dhe të rikuperohen. Sipas Anthony Lake, ish-drejtor ekzekutiv i UNICEF: “Kombet nuk janë thjesht blloqe druri në një lojë tavoline. Në realitet, kombet janë koleksione të qenieve njerëzore dhe siguria e atyre përcakton nëse një komb është i sigurt apo jo¹⁹”. Siguria njerëzore i vendos nevojat dhe dobësitë e personave të prekur në qendër të kësaj analize.

4. Aplikimi i qasjes së sigurisë njerëzore ndaj fatkeqësive natyrore

Fatkeqësitë natyrore i ekspozojnë njerëzit rregullisht e në numër të madh ndaj një rreziku ekstrem dhe krijojnë sfida masive të sigurisë njerëzore. Ajo që i bën këto ngjarje veçanërisht problematike është se ato tentojnë të bashkëveprojnë me dobësitë ekzistuese. Fatkeqësitë nuk prekin njerëzit në mënyrë të barabartë, pjesa më e prekshme dhe më e pafavorshme e shoqërisë pothuajse gjithmonë vuajnë në mënyrë disproporcionale. Siguria njerëzore mund të jetë universale në kuptimin që të gjithë njerëzit janë të prekshëm nga dëmtimi, por shkalla e pasigurisë ndryshon masivisht në, dhe midis shoqërive. Sidoqoftë, këto dobësi nuk janë të pashmangshme ose të paracaktuara.

Fatkeqësitë natyrore paraqiten rregullisht si “veprime të perëndisë” ose dukuri natyrore

expensive- try-disease

¹⁸ *If You Think Preparedness Is Expensive, the Pandemic Puts Things in Perspective* By Claire Pomeroy on April 30, 2020

¹⁹ *Anthony Lake, UNICEF Executive Director TICAD V: Tokyo International Conference on African Development High Level Human Security Symposium Human Security: Stronger People, Brighter Future Tokyo, Japan June 2, 2013.* https://www.mofa.go.jp/policy/oda/sector/security/pdfs/sympo1306_unicef.pdf, fq. 1

të çuditshme që zakonisht nuk mund të parashikohen. Por përveç kësaj ato janë ngjarje “produkt i mjedisëve të veçanta sociale dhe politike”. Proceset e ndryshme politike, sociale dhe ekonomike luajnë role themelore në formësimin e shpalosjes së këtyre ngjarjeve. Kjo është veçanërisht e dukshme në mënyrën sesi këto fatkeqësi ndikojnë në mënyrë disproporcionale në pjesët më të rrezikuara të shoqërisë. Padyshim që nuk është rast i fatit të keq, por rezultat i rreziqeve mjedisore duke u kombinuar me pabarazitë para-ekzistuese dhe format e përjashtimit/dëbimit. “Në parim, një fatkeqësi është një ngjarje me mundësi të barabarta. Një stuhi nuk zgjedh viktimat e saj. Por, viktimat tipike të fatkeqësisë civile janë pjesa më e pafavorshme nga ana sociale, ekonomike dhe politike.”²⁰

Për të adresuar cenueshmërinë e tyre, është e nevojshme të vlerësojmë plotësisht rolin e njerëzve në krijimin e fatkeqësive natyrore, duke lëvizur përtej ngjarjeve specifike dhe duke marrë parasysh mënyrën e përfshirjes së tyre brenda praktikave të përditshme dhe strukturave shoqërore.

Në kontekstin e një fatkeqësie natyrore, qasja e sigurisë njerëzore fillon me një përqendrim në llojet e pasigurisë që ndikojnë drejtpërdrejt te njerëzit dhe konsideron se si këto kërcënime janë të qëndrueshme, përkeqësohen ose, në mënyrë ideale, zvogëlohen. Ajo tregon një vetëdije për mënyrën se si kriza e menjëhershme është e lidhur me strukturat më të thella shoqërore që formojnë cenueshmërinë.

Fatkeqësitë natyrore nuk ndodhin në një vakum. Ato ndodhin brenda konteksteve specifike social-ekonomike që janë pas ngjarjeve dhe formojnë llojin e pasigurive njerëzore që ekzistojnë. Po kështu, në fatkeqësitë natyrore, gratë, fëmijët, të moshuarit, të varfrit, emigrantët, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat racore kanë disavantazhe paraprake, disa të vetëdukshme për sa i përket aftësive fizike dhe qëndrueshmërisë, disa të mprehta/delikate për sa i përket paragjykimëve shoqërore.

Kuadri i sigurisë njerëzore është i rëndësishëm për të gjitha fazat e ciklit të fatkeqësisë. Ndihma nga fatkeqësitë që nuk përfshin një vetëdije për nevojat dhe aftësitë e ndryshme të personave të prekur, rrezikon të forcojë dhe thellojë dobësitë ekzistuese. Për shembull, akti në dukje neutral për të siguruar lehtësim pas një fatkeqësie në të vërtetë mund të rrisë ndjeshmërinë e disa grupeve të prekura, nëse nuk shpërndahe në mënyrë të kujdesshme. Kur fatkeqësia godet në kontekstin e konfliktit ekzistues, shpërndarja e ndihmës mund të formohet nga këto ndarje dhe të përdoret si një mënyrë për të shpërblyer ose ndëshkuar pjesë të caktuara të popullatës.

Kjo lidhet me fazën e rimëkëmbjes, ku qasja e sigurisë njerëzore inkurajon një vetëdije se si prekshmëria ndërvepron me fatkeqësitë dhe se si kjo ul nivelet e rezistencës ndaj goditjeve të ardhshme. Në procesin e rindërtimit nuk është e mjaftueshme thjesht për të gjetur, por ne gjithashtu duhet t'i përgjigjemi shkaqeve themelore social-ekonomike që i bëjnë disa grupe më shumë të rrezikuar se të tjerët. Vlerësimi i rolit që luan zgjedhja dhe sjellja e njeriut është një hap i domosdoshëm në krijimin e shoqërive të përgatitura më mirë për llojin e sfidave që toka dhe klima do të vazhdojnë të ‘hedhin tek ne’.

²⁰ *Ethics for Disaster Naomi Zack. Series: Studies in social, political, and legal philosophy. Publisher: Rowman & Littlefield Publishers, Year: 2009, fq.119.*

Fatkeqësitë natyrore paraqesin probleme në shoqëri e këto, janë kriza që mund të shkaktojnë humbje dhe dëmtime të mëdha. Këto ngjarje ekspozojnë pabarazitë e mëdha në shoqëritë dhe mënyrën sesi strukturat social-ekonomike përkeqësojnë shumë nivelin e pasigurisë me individë dhe grupe të ndryshme. Megjithatë, këto ngjarje të tmerrshme mbajnë brenda tyre mundësitë për ndryshime të dobishme dhe një qasje e sigurisë njerëzore ndaj fatkeqësive natyrore duhet të identifikojë dhe theksojë përbërësit më pozitivë.

Siguria njerëzore vendos rëndësinë ndaj cenueshmërisë me të cilën përballen individët dhe grupet, por e balancon këtë me një vlerësim të forcës dhe rezistencës së tyre dhe një vetëdije për mundësitë që mbesin për fuqizimin. Qasja e sigurisë njerëzore është një kornizë për të identifikuar mënyrën e kufizimit dhe heqjes së mundësive njerëzore - por edhe të krijuara - kur rreziqet natyrore ndërveprojnë me strukturat shoqërore. Sado të jenë të sigurt apo jo njerëzit, do të formohet nga një sërë karakteristikash dhe faktorësh shoqërorë. E rëndësishme është për të kuptuar nevojat e ndryshme të grave, vajzave, burrave dhe djemve në një krizë dhe për të siguruar që planifikimi i plotëson këto nevoja në mënyrë të barabartë. Aplikimi i qasjes së sigurisë njerëzore duhet të bëhet në mënyrë aktive, e diferencuar midis individëve dhe grupeve, duke vlerësuar natyrën e ndërlikuar dhe të ndërlikur të kërcënimeve dhe dobësive. Një qasje e sigurisë njerëzore ndaj fatkeqësive natyrore sugjeron një vetëdije mbi mënyrën se si faktorët e rëndësishëm biologjikë dhe sociologjikë ndikojnë në mënyrën se si njerëzit janë të sigurt dhe në çfarë lloj rreziku ekspozohen. Kategoritë përkatëse për t'u marrë parasysh përfshijnë: gjininë, moshën, shëndetin, aftësinë fizike, pozicionimin social-ekonomik dhe përkatësinë etnike.

Një qasje e sigurisë njerëzore përqendrohet jo vetëm në mënyrën se si kategoritë e ndryshme sociale dhe biologjike formojnë cenueshmërinë/ndjeshmërinë dhe sigurinë, por edhe natyrën e ndërlikur të kërcënimeve. Është e dobishme të merren parasysh lidhjet e pasigurisë njerëzore, duke u mbështetur në shtatë kategoritë themelore të kërcënimit: “ekonomike, ushqimore, shëndetësore, mjedisore, personale, komunitetit dhe politike”²¹. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve më të rënda, si dhe sugjerimin e zgjidhjeve më efektive dhe efikase. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fatkeqësitë natyrore, ku burimet janë të pamjaftueshme dhe koha është thelbësore.

Siguria njerëzore sigurisht që nuk do të jetë një zgjidhje, por nëse përdoret si një mënyrë për të identifikuar lidhjet midis pasigurive të ndryshme, mund të jetë në gjendje të tregojë rrugën drejt formave më efektive të përgjigjes. Për shembull, gjatë fazës së përgjigjes, mënyra e shpërndarjes së ndihmës shpesh mund të lërë pjesë të komunitetit të pafavorizuara, veçanërisht kur ekziston një kundërshtim fizik për furnizime. Pasiguria ushqimore më pas mund të çojë në kërcënime personale - dhe të lidhura me shëndetin. Në këtë shembull, zhvillimi i mekanizmave më efektivë të shpërndarjes së ushqimit mund të punojë potencialisht për të kufizuar ose zvogëluar një numër pasigurish të tjera në komunitetin e prekur.

Vlera e të menduarit për sa i përket natyrës së ndërlikur të kërcënimeve mund të identifikohet përmes reflektimit të një numri të rasteve të tjera. Një shembull është një lidhje

²¹ (Raporti - UNDP 1994, fq. 23–44)

e pasigurisë njerëzore e përbërë nga siguria personale dhe komunitetit. Ndërsa komunitetet merren me detyrën e vështirë të rindërtimit, duhet të llogaritet rreziku i rëndësishëm i abuzimeve të ndryshme. Një pjesë e kësaj ka të bëjë me mbrojtjen e sigurisë individuale të grave, fëmijëve të moshuarve por, është gjithashtu e nevojshme që ajo të adresohet në një nivel shoqëror: të njihet dhe të sfidohet mënyra se si identitetet dhe marrëdhëniet e ndërhuara shoqërore kontribuojnë që këto shtresa të jenë më të prekshme.

Shqetësimi për mënyrën se si ndërveprojnë dhe shumohen kërcënimet është një komponent i rëndësishëm për sigurinë njerëzore, por duhet të ekuilibrohet me një vetëdije për mundësitë që ekzistojnë për njerëzit - individualisht dhe kolektivisht - për t'u përgjigjur pozitivisht. Fatkeqësitë natyrore mund t'i lënë njerëzit të ndjehen plotësisht të pafuqishëm, kështu që çdo gjë që mund të bëhet për të ndihmuar mundësitë e mbështetjes, për të fuqizuar njerëzit, është thelbësore.

Të prekurit nuk janë viktima pasive: strukturat shtetërore duhet të njihen me ta dhe duhet të mbështeten tek ata, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi të ndodhë një fatkeqësi. Për shembull, gratë, shpesh të paraqitura si të dobëta e të pafuqishme, kanë treguar se kanë një qëndrueshmëri të konsiderueshme pas ngjarjeve të tilla. Aftësitë që gratë tregojnë si kujdestare në rritjen e fëmijëve dhe kujdesin për familjet janë shumë të dobishme gjatë fazës së reagimit të menjëhershëm dhe gjithashtu gjatë procesit më të gjatë të rindërtimit. Kjo sugjeron që planet e reagimit dhe rimëkëmbjes që janë të ndjeshme ndaj çështjeve të tilla si: gjinia, mosha etj., mund të ndihmojnë në fuqizimin e njerëzve shpesh të lënë pas dore në shoqëri dhe të kenë pasoja pozitive në drejtim të rikuperimit të fatkeqësive. Fatkeqësitë prishin funksionimin themelor të shoqërisë, por, pa minimizuar dëmin e madh që ato sjellin, ato krijojnë gjithashtu mundësi të rëndësishme për të fuqizuar njerëzit dhe potencialisht të sjellin ndryshime më të thella në një shoqëri.

Një aspekt i rëndësishëm, kur zbatohet siguria njerëzore në fatkeqësitë natyrore, është roli i FA-ve dhe natyra e marrëdhënieve civilo-ushtarake. Në konfliktet civile, FA-të ndonjëherë mund të jenë një kërcënim për sigurinë njerëzore, por në rastin e fatkeqësive natyrore, FA-të, me kapacitetet e tyre të rëndësishme operationale dhe përvojën në terren, janë një ofrues kryesor i sigurisë njerëzore.

Kjo shprehet qartë edhe në Komunikatën e Samitit të fundit të NATO-s ku theksohet se: NATO ka njohur prej kohësh rëndësinë e sigurisë njerëzore, e cila përqendrohet në rreziqet dhe kërcënimet ndaj popullatave në zonat e konfliktit ose krizës dhe se ajo është e përkushtuar për të shmangur, minimizuar dhe zbutur çdo efekt të mundshëm negativ mbi civilët që vijnë nga misionet ose aktivitetet ushtarake.

NATO mbështet politikën saj të re për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës seksuale të lidhur me konfliktet, luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe fëmijët, si dhe mbrojtjen e pronës kulturore. NATO do të vazhdojë të punojë me partnerët e saj, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile për të çuar përpara axhendën tonë të sigurisë njerëzore, e cila përfshin politika të forta dhe udhëzime të qarta operationale, në mbështetje të paqes, të sigurisë së qëndrueshme dhe mbrojtjes së përbashkët të popullatave tona²².

²² "Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in

5. Koncepti i elasticitetit në sigurinë njerëzore

Përdorimi i konceptit të elasticitetit është duke u bërë më i zakonshëm dhe përdoret gjithnjë e më shumë në studimet akademike si një aftësi për t'u rikuperuar ose përshtatur lehtë në ngjarje/fatkeqësi të ndryshme. Gjatë dhe pas krizave dhe fatkeqësive natyrore, “ndërtimi i elasticitetit” mund të jetë shumë i rëndësishme pasi këto ngjarje prekin si burimet njerëzore ashtu edhe ato materiale. Ne nuk mund të parandalojmë të gjitha kërcënimet që vijnë nga krizat ose fatkeqësitë natyrore, kështu që përqendrimi ynë duhet të jetë në ndërtimin e elasticitetit të komuniteteve ndaj kërcënimeve të tilla ekzistuese dhe të mundshme në mënyrë që ndikimi negativ në jetën e tyre të zvogëlohet.

Në një nivel më praktik, mund të vërejmë se disa vende dhe komunitete janë në gjendje të kufizojnë me sukses numrin e vdekjeve dhe vuajtjet njerëzore të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe krizat e tjera, ndërsa të tjerët - madje edhe ato me kushte shumë të ngjashme social-ekonomike dhe gjeografike - nuk janë. Pse janë ato vende më elastike ndaj fatkeqësive? Një shpjegim është se zonat që kanë qenë më të suksesshme janë ato ku komunitetet e të cilëve janë mobilizuar tashmë dhe janë të angazhuar në mbrojtjen e tyre. Në këtë drejtim është e rëndësishme që të kuptohen nevojat në komunitet si dhe mundësitë për mobilizim përmes bashkëpunimeve lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Për më tepër, shumë e rëndësishme është besimi i komuniteteve. Po kështu ka rëndësi edhe arsimimi dhe përvoja e fëmijëve në shkollë. Gjithkush ka potencialin të ndërtojë elasticitet ndaj kërcënimeve me të cilat përballen, madje edhe popullsitë më të rrezikuara.

Tërmeti i fuqishëm që goditi Japoninë në vitin 2011 shkaktoi një cunam dhe fatkeqësinë e centralit bërthamor, duke vrarë afërsisht 16,000 njerëz dhe 4.000 të zhdukur²³. Edhe pse goditi Japoninë verilindore, ai ka pasur ndikim të rëndësishëm ekonomik dhe psikologjik në tërë Japoninë. Gjatë dhe pas fatkeqësisë në Japoni, fëmijët ndërmorën veprime për të mbrojtur veten dhe të tjerët. Ndërsa shumë të rritur ishin të pavendosur për evakuimin pas tërmetit, shumë fëmijë u evakuuan menjëherë pas dridhjes, duke ndjekur me besnikëri ato që kishin mësuar në shkollë²⁴. Edhe pse rreth 60% e fëmijëve humbën disa nga anëtarët e familjes së tyre në qytetin Kamaishi, pothuajse 100% e tyre mbijetuan dhe shumë prej tyre ndihmuan fëmijët më të vegjël dhe të moshuarit të evakuohen.²⁵ Fëmijët e shkollës gjithashtu ndërmorën veprime për të kapërcyer ndikimin emocional të humbjes masive të jetës dhe pronës.

Pas një jave që jetonte në një zonë strehimi me çadra - një vajzë shtatë vjeçare filloi të botojë një gazetë unike. Ideja e saj ishte “Unë dua të kënaqen të gjithë në çadra, sepse

Brussels 14 June 2021” https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_185000.htm

²³ Great East Japan Earthquake—A message from Japan I. Human Security Approaches for Disaster Recovery and Resilience. JMAJ 54(5): 338–341, 2011. Masamine JIMBA, Susan HUBBARD, Eriko SASE, Tomoko SUZUKI, Keiko OTSUKA - fq.338.

²⁴ Great East Japan Earthquake—A message from Japan I. Human Security Approaches for Disaster Recovery and Resilience. JMAJ 54(5): 338–341, 2011. Masamine JIMBA, Susan HUBBARD, Eriko SASE, Tomoko SUZUKI, Keiko OTSUKA - fq.340.

²⁵ Po aty.

njerëzit duket se dekurajohen këtu”. Ndryshe nga gazetat e vërteta të mbushura me histori të trishtuara serioze, ajo vendosi të shkruante vetëm histori të lumtura dhe ta botonte si një gazetë të përditshme muri me emrin “Lufto”, me miqtë e rinj që kishte bërë në kamp/çadra. Në numrin e parë, fëmijët shkruan “Ju (të rriturit) tani po jetoni në rrethana jo të favorshme, por le të luftojmë për të ardhmen!”²⁶

Për sa më sipër mund të themi se ato demonstrojnë rëndësinë e elementeve të sigurisë njerëzore të përshkruara më lart në ndërtimin e aftësive fizike dhe emocionale përballë fatkeqësive natyrore. Rëndësia kritike e një elementi shpesh të anashkaluar - të qenit i përqendruar te njerëzit - ilustron nga aktivitetet për të ndërtuar elasticitet. Fëmijët e shkollës janë njerëz që janë të vetëdijshëm për vlerën e sigurisë njerëzore, megjithëse mund të mos dinë shumë për tre liritë: lirinë nga frika dhe dëshira dhe të jetuarit në dinjitet. Ekzistenca e njerëzve të tillë me nivel të lartë të ndërgjegjësimit (ose vetëdije kritike), i shtyu ata të motivojnë njerëzit përreth tyre për të krijuar komunitete elastike.

Frekuenca dhe intensiteti i fatkeqësive natyrore është rritur vitet e fundit, me rritje të mëtejshme të parashikuara për të ardhmen. Në kontekstin e menaxhimit të fatkeqësive, është e përshtatshme t’i referohemi elasticitetit si: “Aftësia e një sistemi ose komuniteti për t’u akomoduar dhe rikuperuar me shpejtësi nga ndikimet e rreziqeve; rivendosja e strukturave thelbësore dhe funksionalitetit të dëshiruar dhe përshtatja me rrethanat e reja”.

Komunitetet elastike ndaj fatkeqësisë natyrore janë ato që punojnë së bashku për të kuptuar dhe menaxhuar rreziqet e tyre. Elasticiteti ndaj fatkeqësive është një përgjegjësi e përbashkët për të gjithë sektorët, përfshirë të gjitha nivelet e ekzekutivit (edhe FA), biznesit, OJF-ve dhe individëve. Strategjia për elasticitetin ndaj fatkeqësive është instrumenti udhëzues për realizimin e vizionit, për të bërë strukturat përgjegjëse dhe komunitetin më elastik duke u mbështetur nga katër fusha prioritare:

Prioriteti 1: Kuptimi i rrezikut nga fatkeqësitë.

Politikat dhe praktikat për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore duhet të bazohen në të kuptuarit e rrezikut nga to në të gjitha dimensionet e cenueshmërisë, kapacitetit, ekspozimit të personave dhe pasurive, karakteristikave të rrezikut dhe mjedisit. Njohuri të tilla mund të shfrytëzohen për qëllime të vlerësimit të rrezikut para fatkeqësive, për parandalimin dhe zbutjen, si dhe për zhvillimin dhe zbatimin e gatishmërisë së duhur dhe reagimit efektiv ndaj tyre.

Në Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive 2015-2030, theksohet se të kuptuarit e rrezikut nga fatkeqësitë është përparësia e parë drejt zvogëlimit të rrezikut. Identifikimi i rrezikut, analiza e ekspozimit dhe e cenueshmërisë dhe identifikimi pasues i rrezikut përmes këtij procesi është gur-themeli i të kuptuarit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe formon bazën për një planifikim efektiv të bazuar në rrezik.

Prioriteti 2: Përmirësimi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Menaxhimi e rrezikut nga fatkeqësitë në nivelin kombëtar, rajonal dhe global ka një rëndësi

²⁶ Great East Japan Earthquake—A message from Japan I. Human Security Approaches for Disaster Recovery and Resilience. JMAJ 54(5): 338–341, 2011. Masamine JIMBA, Susan HUBBARD, Eriko SASE, Tomoko SUZUKI, Keiko OTSUKA - fq.348

të madhe për një menaxhim efektiv dhe efikas të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore. Vizion i qartë, plane, kompetencë, udhëzime dhe koordinim brenda / dhe në të gjithë sektorët, si dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara përkatëse, janë të nevojshme dhe shumë të rëndësishme. Forcimi i menaxhimit së rrezikut nga fatkeqësitë për parandalimin, zbutjen, gatishmërinë, reagimin, rikuperimin dhe rehabilitimin është i domosdoshëm dhe nxit bashkëpunimin dhe partneritetin midis mekanizmave dhe institucioneve për zbatimin e masave të rëndësishme për uljen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Prioriteti 3: Investimi në uljen e rrezikut nga fatkeqësitë.

Investimet publike dhe private në parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore përmes masave strukturore dhe jo strukturore janë thelbësore për të forcuar aftësinë ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të personave, komuniteteve, vendeve dhe pasurive të tyre, si dhe mjedisit. Këto mund të jenë shtytësit e inovacionit, rritjes dhe krijimit të vendeve të punës. Masat të tilla janë me kosto efektive dhe të dobishme për të shpëtuar jetën, parandalimin dhe zvogëlimin e humbjeve dhe sigurimin e rimëkëmbjes dhe rehabilitimit efektiv.

Prioriteti 4: Përmirësimi i vazhdueshëm i gatishmërisë/përgatitjes për reagim efektiv ndaj fatkeqësive për rimëkëmbjen, rehabilitimin dhe rindërtimin.

Rritja e qëndrueshme e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, përfshirë rritjen e ekspozimit të njerëzve dhe pasurive, të kombinuara me mësimet e nxjerra nga fatkeqësitë e kaluara, tregojnë nevojën për të forcuar më tej gatishmërinë për përgjigje ndaj fatkeqësive, për të ndërmarrë veprime në pritje të ngjarjeve, për të integruar uljen e rrezikut nga fatkeqësitë në gatishmërinë e përgjigjes dhe të sigurohet që ekzistojnë kapacitete për reagim efektiv dhe rehabilitim/shërim në të gjitha nivelet. Fuqizimi i grave dhe personave me aftësi të kufizuara, udhëheqja dhe promovimi i çështjeve të barazisë gjinore dhe të pranueshme në mënyrë universale, qasja e rigjenerimit, rehabilitimit dhe rindërtimit është thelbësore. Fatkeqësitë kanë demonstruar që faza e rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit, e cila duhet të përgatitet përpara një fatkeqësie, është një mundësi kritike për të “ndërtuar më mirë”, duke përfshirë integrimin e zvogëlimin të rrezikut të fatkeqësive në masat e zhvillimit, duke i bërë komunitetet elastike ndaj fatkeqësive.

Kur ndodh një krizë ose fatkeqësi natyrore edhe pse përpjekjet humanitare janë në lëvizje të plotë, reagimi i shpejtë që përqendrohet në shërimin e hershëm dhe kufizimin e dëmtimit të mundshëm të tyre mund të ndihmojë një komunitet të shërohet më shpejt dhe të kthehet në rrugën drejt zhvillimit. Edhe para se të kalojë një krizë, funksionimi i sistemeve dhe institucioneve që promovojnë sigurinë, drejtësinë dhe një kalim të qetë drejt normalitetit - inkurajojnë jetesën e qëndrueshme dhe riparojnë dëmin afatgjatë fizik dhe psikologjik të shkaktuar nga kriza, rindërtojnë shoqëritë e dëmtuara dhe ri-integrojnë ata që preken duke ulur rrezikun afatgjatë të një përsëritje të krizës dhe lejojnë rritjen ekonomike dhe zhvillimin njerëzor.

Krizat dhe fatkeqësitë rrallë mund të shmangen plotësisht, por masat parandaluese dhe planifikimi i kujdesshëm para një krize ndikon në sigurinë njerëzore duke lehtësuar vuajtjet dhe humbjet ekonomike dhe i bëjnë komunitetet më elastike ndaj fatkeqësive. Kur të gjithë

këta elementë të parandalimit dhe shërimit të krizës bëhen së bashku, komunitetet bëhen më elastike ndaj goditjeve që përndryshe do të kërkonin jetë, të shkaktonin vuajtje dhe shkatërrojnë arritjet e zhvillimit.

6. Siguria njerëzore dhe axhenda e rindërtimit

Në kontekstin pas katastrofës, autoritetet kombëtare së bashku me lojtarët e tjerë përballen me sfidën e vështirë të rindërtimit të asaj që është dëmtuar. Autoritetet kombëtare duhet të vlerësojnë nevojat dhe pritjet e njerëzve dhe komuniteteve në mënyrë që të fillojnë rrugën e gjatë të rindërtimit. Në këtë drejtim, siguria njerëzore mund të luajë një rol vendimtar në krijimin e axhendës ose duke u bërë pjesë e tij. Parimet e sigurisë njerëzore ofrojnë një kornizë udhëzuese për zhvillimin e strategjisë apo mjeteve. “Në shumë raste, një qasje e sigurisë njerëzore jo domosdoshmërisht prezanton mjete të reja, por përkundrazi udhëzon modifikimin e mjeteve ekzistuese ose kombinimin e mjeteve në mënyrë që të rrisë parimet dhe objektivat e sigurisë njerëzore”²⁷.

Procesi i rindërtimit në rastin e një tërmeti ka kaq shumë për të fituar nëse siguria njerëzore konsiderohet në rendin e ditës. Nën sigurinë njerëzore, axhenda e rindërtimit do të kërkojë të identifikojë, zvogëlojë dhe/ose eliminojë të gjitha dobësitë dhe kërcënimet e prekshme që rrezikojnë dinjitetin, jetesën, mbijetesën dhe sigurinë e njerëzve dhe komuniteteve në këto vende. Duke bërë këtë, korniza e sigurisë njerëzore do të kontribuojë për të hedhur themelet për fillimin e procesit të zhvillimit njerëzor. Miratimi i sigurisë njerëzore si mjet qendror i formësimit të axhendës do të ketë disa implikime, por të rëndësishme.

Nën prizmin e sigurisë njerëzore, mbrojtja dhe fuqizimi i njerëzve dhe komuniteteve duhet të jetë objektivi kryesor i rendit të ditës. Një fokus i veçantë kërkohet për komunitetet dhe grupet më të prekshme si: gratë, fëmijët, të moshuarit, të varfrit, të zhvendosurit etj., në mënyrë që t’u sigurohet atyre një mbijetesë me dinjitet. Sa i përket përparësive në axhendë, siguria njerëzore gjithashtu mund të jetë e dobishme pasi së pari do të marrë parasysh dobësitë dhe nevojat e menjëhershme të njerëzve dhe komuniteteve. Në këtë kuptim, është kritike që njerëzit dhe komunitetet, kryesisht ata që kanë më shumë nevojë, të mund të kenë qasje në mallrat bazë për të përmbushur nevojat e tyre.

Është gjithashtu thelbësore që të krijohen kushte që njerëzit dhe komunitetet të rivendosin jetesën e tyre nëse dëmtohen ose të sigurojnë jetesën përmes punësimit ose veprimtarive të krijimit të të ardhurave, në mënyrë që ata të kenë sigurinë ekonomike. Si një mjet i dobishëm për të identifikuar përparësitë, siguria njerëzore tërheq vëmendjen për nevojën e krijimit të kushteve për të pasur një qeverisje në shumë nivele, me qëllim sigurimin e mallrave bazë dhe shërbimeve sociale dhe forcimin e institucioneve kombëtare, në mënyrë që njerëzit dhe komunitetet të mund të rifillojnë rutinën e tyre të përditshme. Sipas perspektivës së sigurisë njerëzore, thelbësore është që të gjenden shkaqet e fatkeqësisë në mënyrë që të marrim zgjidhje të përshtatshme për të.

²⁷ *Towards a post-2015 framework for disaster risk reduction, UNISDR, Geneva.*

UNSG 2010, ‘Human security, report of the secretary-general’, UNSG A/64/701, 8 March, viewed 8 August 2013, http://hdr.undp.org/en/media/SG_Human_Security_Report_12_04_10.pdf

Për rastin e tërmetit në Shqipëri, më 26 nëntor 2019, kur vlerësojmë shkaqet e fatkeqësisë, axhenda duhet të shkojë përtej vetë fatkeqësisë. Kjo kërkon që axhenda të shikojë për problemet strukturore para-ekzistuese, të cilat edhe pse mund të mos jenë shkaku, ato shërbejnë për të përkeqësuar madhësinë e fatkeqësisë. Nëse nuk vlerësojmë problemet strukturore, cilësinë e dobët të punimeve, korrupsionin, problemet ligjore, ne do të vazhdojmë të sjellim zgjidhje jo të sakta apo të përpikta për problemin. Po kështu, madhësia e tërmetit nuk mund të ndahet nga niveli i lartë i varfërisë dhe nga planifikimi i pakontrolluar urban dhe rural që i lë njerëzit dhe komunitetet të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme.

Një tjetër parim i sigurisë njerëzore që është i përshtatshëm për rastin është parandalimi i hershëm, se sa reagimi i vonë. Përgjigja më e mirë ndaj tërmetit nuk është përgjigja humanitare (kjo është shumë e rëndësishme pasi të ketë goditur një fatkeqësi), por përkundrazi eliminimi i varfërisë strukturore, përmirësimi i kushteve sanitare e të higjienës në këto vende, me qëllim për të zbutur ndikimin e fatkeqësive mbi njerëzit dhe komunitetet.

Më në fund, korniza e sigurisë njerëzore mund të sigurojë udhëzime të mira në lidhje me aktorët në procesin e rindërtimit. Tradicionalisht, detyra e rindërtimit të vendit i përket ekskluzivisht shtetit. Për më tepër, në ditët e sotme, lojtarët e tjerë, shpesh nën koordinimin e shtetit, marrin pjesë në procesin e rindërtimit. Në përputhje me parimet e sigurisë njerëzore, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, OJF-të, sektori privat dhe vetë njerëzit dhe komunitetet mund të luajnë një rol të rëndësishëm në rindërtimin e vendit. Njerëzit dhe komunitetet duhet të kenë një zë në procesin e rindërtimit pasi të jenë të vetëdijshëm për nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Siguria e komunitetit, formimi i një komuniteti funksional, është çelësi për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë në të gjitha fazat e procesit pas katastrofës, së pari në qendrat e evakuimit, pastaj në komunitetet e strehimit të përkohshëm në periudhën afatmesme dhe, së fundmi, në procesin e rindërtimit.

Si përmbledhje, një axhendë rindërtimi nën lentet e sigurisë njerëzore duhet të ketë një qëllim parandalues në vetvete, si dhe identifikimin dhe zvogëlimin e ndikimit të fatkeqësive të ardhshme në sigurinë dhe mbijetesën e njerëzve dhe komuniteteve. Në këtë kuptim, axhenda e rindërtimit do të synojë më në fund në krijimin e rezistencës/elasticitetit njerëzor dhe të zvogëlojë mundësinë e fatkeqësive natyrore. Kjo axhendë do të përqendrohet në sigurimin e burimeve themelore për njerëzit dhe komunitetet për të përballur problemet me mjedisin pas katastrofës. Zhvillimi do të konsiderohet si mjeti kryesor për arritjen e sigurisë njerëzore. Kështu, procesi i rindërtimit do të përqendrohet në përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve dhe komuniteteve.

7. Përfundime/Rekomandime

1. Për shkak të ndikimit të tyre të madh në jetesën dhe mbijetesën e njerëzve dhe komuniteteve, fatkeqësitë natyrore apo krizat e ndryshme paraqesin sot një faktor kryesor të pasigurisë njerëzore. Fatkeqësitë natyrore kontribuojnë në krijimin e dobësive të reja ose në përkeqësimin e atyre ekzistuese. Prandaj në kornizën e sigurisë njerëzore, fatkeqësitë natyrore janë konceptuar si forca që mund të shkaktojnë pasiguri

- ekstreme të njeriut. Duke marrë parasysh këtë realitet, qëllimi kryesor i sigurisë njerëzore është mbrojtja e njerëzve dhe komuniteteve nga ndikimi i fatkeqësive natyrore apo krizave të ndryshme.
2. Siguria njerëzore mund të përcaktohet si një nga kushtet themelore e të qenit njerëzor, duke përfshirë mbrojtjen e qëndrueshme dhe sigurimin e kushteve materiale për plotësimin e nevojave të njerëzve si dhe mbrojtjen e kushteve ekzistuese të ndryshueshme për të mbajtur një jetë dinjitoze.
 3. Siguria njerëzore është koncept i duhur për sistemin që jetojmë, ku ndërveprimet ndodhin përgjatë sistemeve gjeologjike, gjeografike, klimatike, biologjike dhe sociale në nivelin global dhe ku veprimet e njëanshme nga shtetet e vetme janë të pamjaftueshme për t'u marrë me kërcënimet që shfaqen nga një bashkëveprim i tillë. Çështjet e sigurisë njerëzore nuk mund të trajtohen në nivelin e një vendi të vetëm. Në kontekstin e sigurisë njerëzore kërkohet një koordinim dhe komunikim më efektiv midis aktorëve të ndryshëm në ofrimin e ndihmës, promovimin e vetë ndihmës dhe fuqizimin e njerëzve/popullatës.
 4. Shqipëria duhet të adaptojë sistemin e saj aktual për menaxhimin e fatkeqësive me tendencat dhe rrethanat e reja. Mbrojtja civile duhet të njohë prirjet e reja dhe të përpiqet të përshtatet me mjedisin e ri për të realizuar misionin dhe objektivat e saj.
 5. Llojet e reja të krizave në të gjithë botën tregojnë se stili tradicional i menaxhimit të emergjencave civile nga lart-poshtë nuk funksionon në mënyrë efektive. Perspektiva e re në menaxhimin e krizave kërkon menaxhim linear dhe jolinear. Rrjetet horizontale po tërheqin më shumë vëmendje sepse u jep mundësi qeverive të organizohen në nivelin kombëtar dhe vendor, ndërkohë që konsiderojnë pjesëmarrjen e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe OJF. Sa më shumë kontroll të ketë pushteti lokal mbi menaxhimin e fatkeqësive, aq më efektiv do të jetë rezultati.
 6. Për të rritur gatishmërinë dhe efektivitetin e MC në nivelin qendror dhe lokal duhet të zgjerohet bashkëpunimin rajonal, pasi fatkeqësitë nuk njohin kufijtë kombëtar dhe për këtë arsye ne jemi të detyruar të bashkëpunojmë.
 7. Zbatimi i detyrave në fushën e mbrojtjes civile duhet të përfshijë: ruajtjen e jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit nëpërmjet, monitorimit, parandalimit, informimit dhe paralajmërimit dhe ofrimin e ndihmës urgjente humanitare dhe ristabilizimit.
 8. Një rol kryesor për krijimin e një sjelljeje të përshtatshme në lidhje me sigurinë njerëzore ka familja, shkolla, por edhe perceptimet dhe sjelljet individuale përmes pajtueshmërisë së duhur me rregullat e sjelljes dhe legjislacionit.
 9. Sot është koha për të kuptuar se ndikimi i fatkeqësive natyrore jo vetëm që lidhet drejtpërdrejt me sigurinë njerëzore, por gjithashtu me strukturën politike, ekonomike dhe sociale me efekte afatgjata. Siguria njerëzore ka një rol të rëndësishëm në Shqipëri, në adresimin e menaxhimit të krizave/fatkeqësive dhe për stabilitetin dhe lirinë e qytetarëve të saj në një botë plot divergjenca dhe përçarje. Ofrimi i sigurisë njerëzore, sigurisë së brendshme, stabilitetit dhe sigurisë përgjatë kufijve tanë është një objektiv i rëndësishëm i vendit tonë.

10. Investimi në fushën e mbrojtjes civile është një e mirë publike: Tërmeti kaloi po kështu edhe COVID-19 po kalon, por ato shkaktuan vuajtje të jashtëzakonshme njerëzore dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë për ca kohë. Ndërsa bashkohemi kundër fatkeqësive apo krizave të ndryshme, shohim qartë se investimet në zona që përmirësojnë sigurinë e njeriut janë të paçmueshme. Shteti duhet të sigurojë investime serioze e thelbësore në mbrojtjen civile, në mënyrë që të jetë në gjendje t'i përgjigjet fatkeqësive apo krizave të ardhshme.
 11. Mbështetja e burimeve njerëzore është thelbësore: teknologjia nuk është një ilaç. Shteti duhet të mbështesë njerëzit që punojnë për mbrojtjen e jetëve. Rëndësia e zhvillimit të një strukture speciale të fortë dhe efikase për MC (brenda FA) është bërë jashtëzakonisht e qartë dhe urgjente nga tërmeti i 26 nëntorit dhe COVID-19.
- Nëse kemi një forcë të përgatitur për emergjencat civile dhe nuk do të kemi nevojë për të, mund të humbasim vetëm paratë – por, në qoftë se nuk kemi një forcë të përgatitur për emergjencat civile dhe do të kemi nevojë për të, mund të humbasin jetë njerëzish.**

Bibliografia

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH – 2014.
- Ligji Nr. 45/2019 për Mbrojtjen Civile.
- Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i miratuar me VKM nr. 835 datë. 3.12.2005.
- Manuali për Emergjencat Civile, (MP 3-28), botim i vitit 2013.
- National Strategy for Disaster Risk Reduction and Civil Protection 2014-2018 - Republic of Albania.
- Japan: Earthquake and Tsunami. Period covered by this report: 11 March 2011 – 31 March 2013, pdf.
- United Nations Development Programme, Human Development Report, 1994.
- Commission on Human Security Report 2003.
- Natural Disasters – 2021. Centre for Research on the Epidemiology of Disasters (CRED) pdf.
- Hyogo Framework for Action 2005-2015: - UNISDR.
- Steinberg, Ted. 2000. Acts of God -- The Unnatural History of Natural Disaster in America, pdf.
- The Haiti case study - JALLC – NATO, pdf.
- Human Security Unit Strategic Plan 2014 – 2017, United Nations, 2014.
- Human Security Approaches and Challenges, UNESCO, pdf.
- International Scientific Conference Strategies XXI National Defense University “CAROL I” Bucharest, Romania, April 14-15, 2016, pdf.
- Human Security Handbook - An integrated approach for the realization of the Sustainable Development Goals and the priority areas of the international community and the United Nations system - Human Security Unit · United Nations · January 2016, pdf.
- Human Security Approaches for Disaster Recovery and Resilience, 2011 - Masamine JIMBA, Susan HUBBARD, Eriko SASE, Tomoko SUZUKI, Keiko OTSUKA.
- Gary Cecchine, Forrest E. Morgan, Michael A. Wermuth, Timothy Jackson, Agnes Gereben Schaefer, Matthew Stafford The U.S., “Military Response to the 2010 Haiti Earthquake”.
- Hyogo Framework for Action 2005-2015: Building the Resilience of Nations and Communities to Disasters *Extract from the final report of the World Conference on Disaster Reduction (A/CONF.206/6)*.
- Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015 – 2030 pdf.

RUBRIKA E DYTË

PUNIME TË AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

Në këtë rubrikë, autorë të ndryshëm trajtojnë dhe analizojnë problematika të ndryshme që lidhen me sistemin e arsimimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura, me qëllim realizimin me sukses të misionit e detyrave themelore të tyre, kryerjen e spektrit të plotë të operacioneve ushtarake në kuadër të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zhvillimet kurrikulare në shekullin e 21-të në arsimin ushtarak janë në thelb të shkrimit të Dr. Etleva Smaçi. Argumenti përse ato duhet të reformohen, duke synuar përafrimin me kurrikulat e universiteteve publike dhe private, ka për qëllim të shpjegojë se akademitë ushtarake duhet të krijojnë modelin e ushtarakut qytetar që ndërvepron me mjedisin civil lehtësisht, me efektivitet dhe si i barabartë mes të barabartëve. Për këtë, njohja e modeleve kurrikulare në fushën e pedagogjisë dhe ndërthurja me interesat kombëtarë në fushën e mbrojtjes e të sigurisë janë kyç i suksesit të krijimit të profesionistëve jo me spektër të ngushtë veprimi vetëm në Forcat e Armatosura por edhe më gjerë, qoftë në tregun kombëtar të punës, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Në shkrimin “*Emocionet dhe Lidshipi*” Dr. Edmond Braneshi dhe Dr. Valbona Zeka kanë vënë theksin në ndikimin e emocioneve në jetën tonë të përditshme, duke vërtetuar se qëndrimet themelore etike në jetën e njeriut kushtëzohen nga aftësitë emocionale.

Nëse ne do të jemi të aftë të kuptojmë emocionet tona dhe të dimë si t’i menaxhojmë ato, rrjedhimisht do të jemi të aftë të shprehim se si ndjehemi dhe të kuptojmë se si ndjehen të tjerët gjithashtu. Kështu, mund të komunikojmë në mënyrë efektive dhe të krijojmë marrëdhënie të forta si në organizatë, ashtu dhe në aspektin personal. Kontrolli i emocioneve ndihmon në krijimin, përmirësimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me grupin dhe individët

në organizatë. Marrëdhënia përmirësohet me komunikim efektiv, të qartë dhe korrekt, me menaxhimin e konflikteve edhe kur na kanë pushtuar emocionet negative. Drejtuesi është ai që ruan ekuilibrin e artë të marrëdhënive me vartësit e tij që janë të natyrave e karaktereve të ndryshëm.

Komunikimi është elementi kryesor në veprimtarinë drejtuese ushtarake. Ai duhet të jetë gjithmonë në funksion të misionit dhe zbatimit të detyrave. Në shkrimin e tij *“Komunikimi i drejtuesve ushtarakë – element i rëndësishëm për realizimin e objektivave dhe rritjen e kohezionit”* Kolonel Editson Zarka e trajton komunikimin si një mjet i fuqishëm i drejtuesve të çdo niveli. Ndër të tjera, ai thekson se për një drejtues nuk mjaftojnë vetëm aftësitë analitike e vendimmarrëse, por kërkohen dhe aftësi për të shprehur e komunikuar qartë synimet e tij, me qëllim që vartësit të veprojnë në përputhje me to.

Në shkrimin *“Zhvillimi i profesionit ushtarak dhe sfidat bashkëkohore”* major Edval Zoto paraqet një historik të shkurtër të zhvillimit të profesionit ushtarak, duke evidentuar faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e tij, si dhe diskutuar sfidat bashkëkohore ndaj unikalitetit të tij në një plan të përgjithshëm, por dhe në rastin e Shqipërisë.

Studimi dhe shtjellimi i çështjeve të mësipërme ka rëndësi themelore për njohjen e profesionit dhe profesionistëve ushtarakë në Shqipëri dhe do të lejonte krijimin e një baze të shëndoshë dijesh për zhvillimin e mëtejshëm, jo vetëm të studimeve sociologjike ushtarake, por dhe në zhvillimin tërësor të profesionit e profesionistëve ushtarakë shqiptarë. Një ushtri dhe një trupë ushtarakësh që njeh vetveten, zhvillimet, karakteristikat pozitive, por sidomos problemet që qëndrojnë në bazë të profesionit ushtarak, është një ushtri që zhvillohet në mënyrë të shëndetshme e të qëndrueshme.

ZHVILLIMET E KURRIKULËS NË ARSIMIN USHTARAK NË SHEKULLIN E 21-të¹

Dr. Etleva Smaçi
Zëvendësdekan i Fakultetit
të Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Akademitë ushtarake gjithmonë janë dalluar për veçoritë e tyre jo vetëm në raport me universitetet publike dhe private, por edhe me akademitë dhe kolegjet profesionale me të cilat mund të kenë ngjashmëri strukturore. Si domen unik i Forcave të Armatosura ato ofrojnë një edukim profesional për gjatë gjithë jetës që nuk mund ta zhvillojë askush tjetër. Ato ngelen ndër shtyllat më të forta të arsimit publik dhe deri më tash përvoja botërore ka treguar se bazat e këtij arsimimi janë pjesë e rëndësishme e politikave të mbrojtjes e të sigurisë në botë.

Pavarësisht këtij individualiteti, shekulli i 21-të çdo ditë edhe më shumë po vërteton se qasjet ndaj arsimit duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe jo përjashtuese. Gjithëpërfshirja është “shtylla kurrizore” e çdo reforme arsimore, prandaj edhe arsimimi ushtarak nuk mund të ngelet jashtë kësaj kornize për faktin se është domen i Forcave të Armatosura.

Objekt i këtij punimi është analiza e zhvillimeve kurrikulare në shek. e 21-të në arsimin ushtarak. Argumenti përse ato duhet të reformohen, duke synuar përafrimin me kurrikulat e universiteteve publike dhe private, ka për qëllim të shpjegojë se akademitë ushtarake duhet të heqin dorë nga prodhimi i modelit të oficerit prusian dhe të krijojnë modelin e ushtarakut qytetar që ndërvepron me mjedisin civil lehtësisht, me efektivitet dhe si i barabartë mes të barabartëve.

Artikulli gërsheton disa topikë/tema/ çështje/ përmes shtjellimit të të cilëve do të tentohet t'u jepet përgjigje pyetjeve si: Në ç'raport qëndrojnë zhvillimet dhe implementimi i

¹ Pikëpamjet e shprehura në këtë artikull shprehin qëndrimin personal të autores; ato nuk janë qëndrimet zyrtare të institucionit ku autorja punon dhe nuk janë të lidhura me situatën apo marrëdhëniet e AFA.

doktrinave ushtarake me zhvillimet e kurrikulës? Çfarë mësohet nga zhvillimet doktrinare që është e dobishme për rishikimet kurrikulare? A janë ndryshimet kurrikulare një nevojë e brendshme për edukimin e profesionistëve të fushës apo një input që pasqyrohet në politikat shtetërore? Cili është qëllimi i arsimit ushtarak dhe si duhet të ofrohet ai?

Për këtë, njohja e modeleve kurrikulare në fushën e pedagogjisë dhe ndërthurja me interesat kombëtarë në fushën e mbrojtjes e të sigurisë janë kyç i suksesit të krijimit të profesionistëve jo me spektër të ngushtë veprimi vetëm në Forcat e Armatosura por edhe më gjerë, qoftë në tregun kombëtar të punës, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Sfida më e madhe mbetet që zhvillimet kurrikulare të shekullit të 21-të në arsimimin ushtarak t'i përgjigjen me fleksibilitet mjedisit të sigurisë, i cili është krejt i ndryshëm dhe i paparashikueshëm nga ai tradicional. Shkathtësia intelektuale dhe inovacioni janë thelbësore për të siguruar që forcat e armatosura të mbeten konkurruese jo vetëm në fushën e luftimi por edhe në fushë akademike.

Fjalë kyçe: reformë kurrikulare, arsimim ushtarak, shekulli i 21-të, mjedis sigurie, pedagogji hibride, aftësi konjitive.

1. Hyrje

Termi “kurrikul” ka një përdorim të gjerë dhe po kështu ka një numër po kaq të madh përkufizimesh. Të gjitha përkufizimet kanë ngjashmëri mes tyre duke dalluar tek cili element e vënë theksin. Kjo na shtyn që në këtë punim t’i referohemi kurrikulës si një koncept i përgjithshëm që nënkupton një sistem të përbërë nga disa elemente me synime arsimore që, në bashkërendim me njëra-tjetrën, krijojnë mundësi të funksionimit të sistemit arsimor. Vetë kurrikula është një koncept ciklik në ndryshim të vazhdueshëm, pasi ajo është e kushtëzuar drejtpërdrejt nga konteksti shoqëror, politik, ekonomik dhe së fundmi teknologjik i mjedisit arsimor në të cilin prodhohet dhe konsumohet. Në këto kushte, nevoja për ndryshime kurrikulare që synojnë kompetencat, rishfaqet gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore, ndaj përbën thelbin e reformave në edukim në përgjithësi dhe atyre kurrikulare, në veçanti.

Ashtu si është e vështirë të japësh një përkufizim të vetëm për kurrikulën, edhe kur vjen puna në kategorizimin e saj, autorë të ndryshëm përshkruajnë tipe të ndryshme kurrikulash. Në këtë punim do t’i referohemi kategorizimit të bërë nga Allan Glatthorn që përshkruan 7 tipe kurrikulash:

- Kurrikula e rekomanduar, e cila hartohet nga ekspertët apo institucionet përgjegjëse arsimore.
- Kurrikula zyrtare, e cila ka formën e një dokumenti të shkruar dhe të aprovuar zyrtarisht.
- Kurrikula e implementuar, e cila zakonisht zbatohet nga mësimmshënësit gjatë procesit mësimor në klasë.
- Kurrikula mbështetëse, ku bëjnë pjesë burimet që mbështesin implementimin e kurrikulës.
- Kurrikula e arritjeve që teston njohuritë në procesin e mësimmshënies.
- Kurrikula e zbatuar, ajo çfarë realisht studentët aftësohen.
- Kurrikula e fshehur, e cila prek dhe ndikon praktika specifike të mësimmshënies.¹

Reforma kurrikulare nga pikëpamja e dokumentacionit bazohet në një sërë dokumentesh shtetërore, të cilat pasqyrojnë politikat dhe strategjitë arsimore për të ardhmen. Ndër to, në të gjitha vendet e zhvilluara, dokumenti më i rëndësishëm është Korniza Kurrikulare Kombëtare. Ajo është dokument kyç për organizimin e sistemit arsimor që orienton aktorët dhe palët e interesuara për aspektet kryesore të kurrikulës, si bazë për të siguruar në mënyrë

¹ Allan A. Glatthorn, *The Principal as Curriculum Leader*, California: 2000 Thousand Oaks, ICAN Home, Modules, Social interventions: Hidden Curriculum.

efektive arsimim cilësor. Pjesë e kësaj kornize është edhe arsimit ushtarak, por nisur nga natyra e tij unike ndryshimet e kurrikulës në këtë fushë harmonizojnë jo vetëm strategjitë arsimore por edhe strategjitë kombëtare të sigurisë. Andaj dhe qasja ndaj kurrikulës së arsimit ushtarak mbetet një domen paksa i ngurtë në raport me kurrikulat e arsimore në përgjithësi.

2. Kurrikula në arsimimin ushtarak

Në arsimimin ushtarak përveç çfarë thamë më lart, kurrikula është një ndër shtyllat kryesore dhe pjesë integrale e ndërtimit të ushtrisë si një institucion me mision shumë të rëndësishëm dhe unik, siç është siguria kombëtare. Nga ana tjetër, fakti që ushtarakët (këtu përfshihen edhe ushtarakët shqiptarë) i ushtrojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre në një mjedis sigurie kompleks kërkon që qasja ndaj arsimit të jetë multidisiplinare. Kjo do të thotë që aftësimi profesional është vetëm një shtyllë e kurrikulës. Shtylla tjetër shumë e rëndësishme është aftësimi i tyre me kompetenca që zhvillon një qytetar me bindje demokratike dhe integritet në publik.

Nisur nga dy shtyllat e lartpërmendura që në fillim të këtij punimi do të parashtroja qartë se zhvillimet e kurrikulës në arsimimin ushtarak nuk synojnë aspak të ndryshojnë thelbin e vlerave të ushtrisë. Patriotizmi, uniteti, kuraja apo edhe vlerat drejtuese do të mbeten po ato që kanë qenë qindra vjet më parë. Por ato duhet të mbajnë të njëjtin hap me zhvillimet teknologjike të shpejta.² Për ta ilustruar në mënyrë figurative do t'i referohemi Jimmy Doolittle, i cili thoshte se “nëse do të duhet të luftojmë, duhet të përgatitemi ta bëjmë atë nga qafa e sipër dhe jo nga qafa e poshtë”.

Në hartimin e kurrikulave të shkollave ushtarake përgjithësisht kanë luajtur rol parësor konceptet dhe doktrinat që bazoheshin në luftën e fundit. Por, a është aktual ky model? Pothuajse në të gjitha akademitë ushtarake perëndimore kurrikula përfshin lëndë akademike që përqendrohen në politikën moderne dhe zhvillimet ushtarake, në lidhjen e ngushtë midis qëllimeve politike dhe përdorimit të mjeteve ushtarake. Integrimi arsimor i historisë, i kulturave të huaja, ndërkombëtare, marrëdhëniet, shkenca operacionale ushtarake dhe e drejta humanitare i shërbejnë një objektivi të thjeshtë: për të prodhuar një klasë të mirinformuar ushtarake. Por për rrethet ushtarake është e njohur paradigma se ushtritë moderne ndeshen sot me një mjedis të paparashikueshëm sigurie. Në dallim të dukshëm nga Lufta e Ftohtë, faktorët e rinj siç është inteligjenca artificiale, kanë sjellë edhe ndryshimin e natyrës së luftës. Por inteligjenca artificiale nuk është i vetmi faktor që ka ndikuar në tjetërsimin e natyrës së luftës. Në dhjetëvjeçarën e parë të shekullit të 21-të u duk se natyra e luftës dhe mjedisi i sigurisë patën si qendër rëndese terrorizmin. Ndryshimet klimaterike gjithashtu së bashku me ndryshimet demografike kanë qenë një faktor me peshë për lindjen e teorive të reja të luftës. Së fundmi, pandemia ishte sfida e radhës që ngriti pyetjen si duhet të trajnohet dhe arsimohet një ushtarak për t'u përballur me të ardhmen e paparashikueshme ku armiku është i padukshëm?!

² Pk. Mallick, *Challenges of 21st century military leadership – how do we train?*
<https://www.researchgate.net/publication/344507100>

Nga të gjitha çfarë përmendëm më lart padyshim mund të pohojmë pa frikë se ushtarakët duhet të aftësohen gjatë edukimit të tyre me kompetenca që i bëjnë të aftë të përballen me pasigurinë jo më në modelin klasik të saj. Mirëpo kjo kërkon një qasje të re në kurrikula, jo atë qasjen e përgjithshme që është arsyeja kryesore përse, sipas Paula Thornhill, ish-dekane e *US National War College*, është e destinuar të dështojë në pajisjen e ushtarakëve me aftësitë e nevojshme. Ndërhurja e taktikave të luftimit me procesin e të menduarit kritik duhet të jenë komplementare në ndërtimin e kurrikulave të reja dhe jo të rivalizojnë njëra-tjetrën. Kjo do të thotë që sfidat intelektuale dhe kulturore janë ato që do të përcaktojnë ndryshimet kurrikulare, krahas vizionit politik për kompetencat e ushtarakut të shekullit të 21-të.

Fleksibiliteti mendor që buron nga një natyrë e hapur (që shkon në kundërshtim me rigorozitetin akademik që shoqëron kurrikulat klasike ushtarake) është një qasje kulturore që duhet të ofrohet përmes një kurrikulë të re. Ai do të ndihmojë ushtarakët të kenë kompetencat jo vetëm taktike por edhe në nivelet e tjera për të kaluar nga njëra formë e luftimit te tjetra edhe duke improvizuar. Referuar gjeneralit Carl E Vuno, një ndër prioritetet e arsimit ushtarak krahas trajnimit institucional dhe arritjeve operacionale është vetëzhvillimi, që do të thotë rritje e tij intelektuale krahas rritjes profesionale. Pra, ajo që kërkohet nga kurrikula e shekullit të 21-të është formimi i ushtarakëve që mendojnë me një spektër të gjerë duke iu ofruar zgjedhje multidisiplinare në vend të kontekstit ushtarak të fushëbetejës.

Kërkesa që buron natyrshëm nga epoka digjitale ku po jetojmë e bën të pavlefshme një kurrikulë të përgjithshme tradicionale në edukim në përgjithësi, por veçanërisht në arsimimin ushtarak në veçanti. Kompleksiteti i detyrave të një ushtaraku lidhet me domosdoshmërinë për aftësi dhe njohuri të shumta për të realizuar me sukses kryerjen e operacioneve të reja ushtarake të ndryshme nga ato tradicionale (operacione të tjera përveç luftës, “operacione stabilizimi” dhe të ngjashme).³ Në teatrin e luftimit, ushtaraku i shekullit të 21-të është sa luftëtar aq edhe specialist teknikien, madje në situata të caktuara i duhet të kryejë detyra burokratike të një rëndësie tepër të lartë (përgatitje urdhri, raport etj.) nga të cilat mund të varen fatet operacionale për zgjidhjen e detyrave strategjike më shumë sesa nga veprimet e tij luftarake.

Një faktor tjetër që e bën të domosdoshme një kurrikulë të prirë më shumë nga zhvillimet teknologjike edhe në shkollat ushtarake është fakti që spektri i kërcënimeve në ditët e sotme është shumë i gjerë. Sidomos kërcënimet hibride janë ato që i kanë vënë vendet e zhvilluara përpara përgjegjësive që të gjejnë balancën mes kurrikulës tradicionale ku pjesën e luanit e zënë padyshim taktika, zjarri, operacionet dhe moduleve të reja të luftës hibride, inteligjencës artificiale, cyber etj. Kjo ka çuar në formulimin nga disa autorë të konceptit *pedagogji hibride për luftërat hibride*.⁴ Theksi vihet në zhvillimin e aftësive konjitive

³ Tomislav Smeric, *Military Profession, Comparative Orientations and Transformation of the Civil-Military Relations*, 2002, Social Research 1(57): 67-88.

⁴ Mihail Anton, “Hybrid Pedagogies for Hybrid War,” Proceedings of Scientific Research and Education in the Air Force, AFASES 2016, 18, no. 2 (2016), 509- 516, <https://doi.org/10.19062/2247-3173.2016.18.2.3>

(njohëse) të nevojshme në kornizën e luftërave hibride. Supozimi themelor i funksionimit të kësaj qasjeje është sepse mendja shihet si faktori kryesor në luftën hibride. Mendja përmes shpërqendrimit, mashtrimit, parandalimit ose bindjes, prish vullnetin e kundërshtarit. Edukimi efektiv në këtë drejtim duhet të anashkalojë pasuritë materiale dhe të përqendrohet në proceset mendore, emocionet, ndjenjat, perceptimet, sjelljet dhe vendimet.⁵ Pra, kurrikula duhet të synojë që akademitë ushtarake jo thjesht të prodhojnë oficerë të cilët janë mjaft të trajnuar, por që janë të aftë të mendojnë dhe janë inovativë në ide.

Hoffman në studimin e tij mbi luftërat hibride nuk përjashton luftërat konvencionale përkundrazi sipas tij në këtë kuadër luftërat hibride do e bëjnë edhe më të vështirë planifikimin e luftërave në ta ardhmen. Në këtë pikë kur vijmë tek arsimimi ushtarak i shekullit të 21 –të edhe qasjet pedagogjike që kërkohen duhet të jenë më kreative për të stimuluar mendimin strategjik.⁶ Kështu që reformimi i kurrikulave ushtarake duke vënë ballë për ballë edukimin tradicional përmes bindjes, konformitetit dhe pajtueshmërisë, me iniciativën, kreativitetin dhe mendimin kritik është vërtetë jo vetëm sfidë arsimore por në tërësi e modelit të ushtrisë.

Në mbështetje të ideve të Hofmanit vjen edhe David Betz⁷. Sipas tij, aftësitë e evokuara nga luftërat e parregullta ndajnë disa karakteristika interesante: ato nuk janë rreptësisht ushtarake (ose me të vërtetë kryesisht ushtarake në shumicën e rasteve); ato mësohen më mirë jashtë një institucioni ushtarak. Ato varen nga sinteza e thellë e njohurive nëpër fusha të ndryshme, përmes një programi të integruar studimi, përfshirë aspektet e historisë politike dhe ushtarake, strategjisë etj. E thënë ndryshe, ushtarakët që do të përballen me luftërat hibride, krahas aftësive taktike dhe vendimmarrëse, është koha të pajisen me aftësi nga fusha e mbrojtjes kibernetike, diplomacisë publike si dhe inteligjenca kulturore.

Hapi më i rëndësishëm mbetet ngulitja e frymës se duhet ndryshuar mënyra e të mësuarit dhe jo thjesht ajo çfarë është mësuar më parë të hiqet nga kurrikula si e “vjetër”. Si shembull do të sillja një aksiomë të njohur për rrethet ushtarake “Ne stërvitemi për siguri dhe edukohemi për pasiguri”. Kjo bën që arsimi të ketë një peshë kryesore në raport me trajnimin në të gjitha nivelet, nga ushtari i thjeshtë deri te lidershipi. Trajnimi shihet si procesi i të mësuarit i përqendruar në aftësitë teknike dhe procedurale ose zgjidhjet standarde i aplikuar nga personeli në rrethana të parashikueshme, një problem i njohur ose në kontekstin e njohur. Arsimimi plotësues shihet si proces në të cilin njohuritë teorike të ushtarakut shndërrohen në aftësi njohëse si p.sh., të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi dhe kompetenca ndër-kulturore, aftësitë ndër-personale dhe fleksibiliteti kulturor, toleranca për paqartësinë, vetërregullimi dhe iniciativa sociale.

Pra, modelet e kurrikulave të hartuara në kohën e një armiku të caktuar e të parashikueshëm, rolet e udhëheqjes dhe metodat e luftimit duhet të sillen në një format bashkëkohor.⁸

⁵ Frank G. Hoffman, “Hybrid Warfare and Challenges,” Joint Force Quarterly 52 (1st Quarter, 2009): 34-48.

⁶ Shih Mihal Anton, ... artikull i përmendur.

⁷ Dr David Betz, profesor në King’s College London, Departamenti i Studimeve të Luftës

⁸ Joseph J. Thomas, Leadership in the Long War: Developing 21st Century Warriors, in Conference Proceedings Pedagogy for the Long War: Teaching Irregular Warfare, Quantico, VA, USA, 2008, page 50.

Faktorët që përcaktojnë gatishmërinë konjitive (njohëse) shoqërohen jo vetëm me faktorët tradicionalë njohës (të të menduarit), por edhe me personalitetin dhe prirjet, motivimin dhe emocionet, si dhe besimet dhe qëndrimet. Kështu që, për të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemit, qasja të zhvillimi i aftësive dhe gatishmërisë njohëse do të jetë pika kyçe në transformimin e kurrikulave në fushën e mbrojtjes e të sigurisë.

Për ta përmbledhur, për sa thamë më lart, një ndër përfundimet e arritura nga mbështetësit e tezës së reformimit të kurrikulave në shkollat ushtarake është se pa e kuptuar qartë rolin e trajnimit dhe arsimit - për të rregulluar kompetencat që lidhen me luftën e parregullt - të gjitha përpjekjet për të transformuar Arsimin Profesional Ushtarak për të përmbushur sfidat e reja mund të dështojnë.⁹ Së fundmi, specialistëve të kurrikulave të arsimit ushtarak për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm në fushën e mbrojtjes e të sigurisë do t'iu duhet të pranojnë se kompetencat ndërkulturore, ndërpersonale, aftësitë dhe fleksibiliteti kulturor përballë të panjohurës do të dominojnë bindjen dhe pajtueshmërinë tradicionale.

3. Përfundime

Edhe në vendet e zhvilluara ku qasja ndaj kurrikulës është progresive vazhdimisht ndihet nevoja për reflektim. Është pikërisht praktika arsimore ajo që ju jep përgjigje pyetjeve dhe dilemave. Ndryshimet e mentalitetit janë të vështira por jo të pamundura. Roli i vendimmarrësve ushtarakë është tepër i rëndësishëm, pasi ata janë njohës më të mirë të fushave kurrikulare dhe kroskurrikulare/ ndërkurrikulare që lidhen me pedagogjinë e luftës e të luftimit. Lufta do të mbetet domeni i tyre, për të cilën ata duhet të përgatiten për të ofruar siguri. Po kështu, duhet të bëhet e qartë se qëllimi i rishikimeve të kurrikulës në mjedisin akademik ushtarak është për t'u bërë aktor i rëndësishëm për nevojat e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Pjesa më e madhe e edukimit të ushtarakëve (duke përjashtuar arsimin e lartë në të gjitha nivelet e tij) bëhet përmes kurseve institucionale. Distanca kohore mes këtyre kurseve pasqyrohet shpesh në nivelin e njohurive që ushtarakët reflektojnë jo në anën profesionale për në kulturën e përgjithshme. Kështu që një arsimim vetëm ushtarak nëpër kolegje duket sot i pamjaftueshëm. Debati që ushtarakët (të paktën disa prej tyre) duhet të marrin arsimimin dhe trajnimin jashtë organizatës së tyre është sot thembra e Akilit të ushtrive moderne. Një zgjidhje do të ishte që arsimit pasuniversitar i këtyre oficerëve të bëhej "larg" akademike ushtarake. Kjo për arsye sepse institucione të tilla krijojnë kulturën e tyre stereotip që pengon të menduarit ndryshe.

Disa nga karakteristikat e aftësive që u përmendën më lart për luftën hibride që nga pikëpamja pedagogjike nuk janë vetëm ushtarake, gjykoj se mund të mësohen më mirë jashtë një institucioni ushtarak. Bashkërendimi civilo-ushtarak në jetën akademike duhet të mbështetet në dy shtylla: teknologjia dhe sistemet e informacionit dhe shkencat shoqërore psikologji, histori, marrëdhënie ndërkombëtare etj.).

Të gjithë jemi dëshmitarë se kemi kaluar nga një ushtri e epokës industriale në ushtrinë e epokës së informacionit. Kjo e bën urgjente nevojën për të rifreskuar mendësinë e edukimit

⁹ Po aty.

të profesionistëve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë. Bërja bashkë e njeriut dhe teknologjisë do të jetë prova më e madhe për të gjithë edukimin e këtij shekulli. Për ushtarakët, kërkesat do të jenë komplekse, të pashembullta në historinë e mëparshme. Ata do të merren me një mori skenarësh jotradicionale që do të kërkojnë zgjidhje inovative. Pra, kurrikula e ofruar duhet t'i edukojë ata gjerësisht në mënyrë që të jenë në gjendje të parashikojnë dhe t'i përgjigjen në mënyrë efektive sfidave politike, ekonomike, ushtarake dhe teknologjike.

Zhvillimi dhe ndërthurja e aftësive ushtarake me ato teknologjike do të jetë çelësi i suksesit. Ato kërkojnë një ekuilibër mes trajnimit ushtarak, që do të thotë përvetësim i disa aftësive taktike që e bëjnë atë të ndihet i sigurtë dhe zhvillim i aftësive të të menduarit, që promovojnë shfrytëzimin jo të forcës fizike, por të forcës intelektuale për të qenë i sigurtë në situata të pasigurta. Reformimi kurrikular duhet t'i japë zgjidhje dikotomisë që ekziston sot në arsimin profesional ushtarak mes shkollës klasike ushtarake dhe institucionit të lartë të arsimit publik. Harmonizimi ngelet më i rëndësishëm sesa uniformiteti. Praktikave dhe përkufizimeve të suksesshme nga mjedisi i mësimdhënies ju nevojiten mekanizma që lehtësojnë politikat dhe doktrinën arsimore të përqafojnë ndryshimin duke gjeneruar sukses të mëtejshëm. Në përfundim, përgjigjja nuk duhet kërkuar domosdoshmërisht te kualifikimi akademik profesional por tek investimi në një edukim, me qasje nga mendimi kritik që kultivon zgjidhjen e problemit.

Bibliografia

- Abbe, Allison, Lisa M.V. Gulick, and Jeffrey L. Herman, "Cross Cultural Competence in Army Leaders: A Conceptual and Empirical Foundation US Army" Research Institute for the Behavioral and Social Sciences, Study Report 2008-01. October 2007.
- Anton, Mihail, "Hybrid Pedagogies for Hybrid War", Proceedings of Scientific Research and Education in the Air Force, AFASES 2016, 18, no. 2 (2016), 509- 516
- Caforio G., (2000). The European Officers: A Comparative View on Selection and Education, Edizioni ETS, Pisa.
- Franke V., (1999). Preparing for Peace: Military Identity, Value, Orientations and Professional Military Education, Praeger Publishers, Connecticut.
- Glatthorn, Allan A. "The Principal as Curriculum Leader", California: 2000 Thousand Oaks, ICAN Home, Modules, Social interventions: Hidden Curriculum.
- Hartmann U., (2002). Military Pedagogy in a Changing World – A German View, In H. Florian (ed.), Military Pedagogy – An International Survey, Peter Lang, Frankfurt 69-82.
- Hoffman, Frank G. "Hybrid Warfare and Challenges", Joint Force Quarterly 52 (1st Quarter, 2009): 34-48.
- Huntington, Samuel P. "The Soldier and the State. The Theory and Politics of Civil-Military Relations". Cambridge MA: Belknap, 1957.
- Paile, S. (2013). Towards a European Understanding of Academic Education of the Military Officers, In H. Annen, C. Nakkas and J. Makinen Paile, S. (2013). Towards a European Understanding of Academic Education of the Military Officers, In H. Annen, C. Nakkas and J. Makinen (eds.), Thinking and Acting in Military Pedagogy, Peter Lang, Frankfurt 279-290. (eds.), Thinking and Acting in Military Pedagogy, Peter Lang, Frankfurt 279-290.
- Thomas, Joseph J. Leadership in the Long War: Developing 21st Century Warriors, in Conference Proceedings Pedagogy for the Long War: Teaching Irregular Warfare, Quantico, VA, USA, 2008.

EMOCIONET DHE LIDERSHIPI

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi

Pedagog për Udhëheqjen Ushtarake, AFA

Dr. Valbona Zeka

Shef i Grupit i Përgatitjes Fizike, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të kaluar, kemi qenë dëshmitarë të shtimit të përnjëhershëm të studimeve shkencore në fushën e emocioneve. Ato më të spikaturat janë imazhet e trurit gjatë punës, të mundësuar nga teknologjia e re e imazherisë së trurit. Tashmë, shkencën është në gjendje të flasë me autoritet për ndjenjat, emocionet, shëndetin mendor, si dhe të studiojë me njëfarë saktësie zemrën e njeriut. Për të gjithë ata që kanë mbështetur këndvështrimin e ngushtë sipas të cilit zgjuarsia ose e thënë ndryshe Koeficienti i Inteligjencës (IQ) është një tipar gjenetik që nuk ndryshon në varësi të përvojës jetësore dhe se ai e përcakton gjerësisht fatin e jetës sonë, nuk qëndron më, pasi ky argument anashkalon pyetje shumë të rëndësishme si: Çfarë mund të ndryshojmë ne në mënyrë që të përmirësojmë jetën tonë apo të fëmijëve tanë? Cilët faktorë ndikojnë kur njerëz me IQ të lartë dështojnë në jetë dhe ata me IQ të ulët ecin përpara? Kësaj dileme i jep përgjigje Daniel Goleman në librin e tij “Inteligjenca Emocionale”. Ai shprehet se ndryshimi ka të bëjë pikërisht me atë që ai e quan Inteligjenca Emocionale, e cila përfshin vetëpërmbytjen, zellin, këmbënguljen dhe vetëmotivimin. Rëndësia e inteligjencës emocionale mbështetet në lidhjen midis ndjenjave, karakterit dhe instinkteve morale. Po gjenden gjithnjë e më shumë prova që vërtetojnë se qëndrimet themelore etike në jetën e njeriut kushtëzohen nga aftësitë emocionale. Si fillim, mjeti i emocionit është impulsi. Aftësia për ta kontrolluar impulsin është baza e vullnetit dhe e moralit. Në aktualitetin e sotëm virtytet morale të vetëpërmbytjes dhe mëshirës nuk janë më të nevojshme.

Fjalë kyçe: koeficienti i inteligjencës, lidhshipi, inteligjenca emocionale, ndjenjë, emocion, aftësi, vetëbesim, vetëpërmbytje, marrëdhënie.

1. Përse shërbejnë emocionet?

Sociobiologët sjellin vazhdimisht shembuj ku vendimet tejet të vështira merren më Stepër me zemër se me mendje. Ata madje kanë edhe një teori se pse evolucioni u ka lënë emocioneve një vend kaq vendimtar në psikikën njerëzore. Sipas tyre, me anë të emocioneve ne mund të marrim vendime që janë shumë të rëndësishme për t'ia besuar vetëm intelektit. Vendime të tilla kanë të bëjnë me rrezikun, humbjen e dhimbshme, këmbënguljen në arritjen e një qëllimi, pavarësisht dështimeve, gjetjen e një partneri, krijimin e një familjeje etj. Çdo **emocion** përmban në vetvete **një shkallë gatishmërie për të vepruar**.¹ Secili prej tyre na nxit drejt një zgjidhjeje e cila ka rezultuar e suksesshme në sfidat e shumta të jetës njerëzore. Dallimi mes emocionale dhe racionale është i përafërt me ndarjen popullore mes “mendjes” dhe “zemrës”. Kur jeni të bindur për diçka “me zemër”, kjo lloj bindjeje është shumë më e thellë dhe jep një siguri më të plotë se të të menduarit. Në këtë kuadër, themi që ne kemi **dy mendje**. Me njërin **mendojmë**, ndërsa me tjetrën **ndjejmë**. Sipas P. Smith, një nga njëzet kërkesat themelore që formojnë bazën e filozofisë së udhëheqjes është që “drejtuesi **duhet t'i besojë intuitës së tij**”, pasi ai nuk do të ishte i suksesshëm po të mos kishte intuitë të mirë. Në arsyetimin e tij, *nëse intuita të jep shenja jo të mira, gjë që tregon se organizata mund të shkojë në rrugë të gabuar, atëherë shqyrtoje më tej çështjen, shtyji vendimet e rëndësishme derisa ato të bëhen plotësisht të arsyeshme dhe çdo gjë të ecë në rrugë të mbarë*.²

Masa në të cilën emocionet tona pengojnë apo ndihmojnë aftësinë tonë për të menduar dhe për të planifikuar, për t'u ushtruar për arritjen e një objekti të caktuar, për të zgjidhur probleme të tjera si këto, përcakton kufijtë e aftësisë sonë për t'i përdorur aftësitë tona mendore të lindura. Në këtë mënyrë përcaktohet edhe suksesi që do të arrijmë në jetë. Ndjenja e kënaqësisë dhe entuziazmit në punën që bëjmë na nxit të përpiqemi më fort dhe na shtyn drejt arritjeve të mëdha. Për këtë arsye, mendoj se inteligjenca emocionale është **aftësi mjeshtërore** që vendos nëse çdo aftësi tjetër do të **lulëzojë** apo do të **vyskjet**.³

Drejtimi i emocioneve në funksion të të qenit produktiv është një nga aftësitë kyçe të inteligjencës emocionale. Për çfarëdo që të bëhet fjalë për ta kontrolluar impulsin apo për ta vonuar marrjen e kënaqësisë, rregullimi i gjendjes emocionale në mënyrë që ajo të na lehtësojë të menduarit në vend që të na e pengojë dhe motivimi i vazhdueshëm për të ngulur këmbë dhe për të mos hequr dorë para vështirësive, apo gjetja e mënyrave për të hyrë në gjendjen përkatëse, të gjitha dëshmojnë fuqinë e emocioneve për të bërë që përpjekjet tona të jenë të frytshme.

¹ Daniel GOLEMAN, “Inteligjenca emocionale”, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, f. 20.

² Perri SMITH, “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, f. 24.

³ Daniel GOLEMAN, “Inteligjenca emocionale”, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, f. 106.

2. Inteligjenca emocionale dhe natyra e saj

Daniel Goleman, në librin e tij “Inteligjenca Emocionale”, trajton raste, ku persona me inteligjencë të lartë kanë dështime në veprimtarinë e tyre. Kjo tregon se inteligjenca akademike nuk ka të bëjë shumë me jetën emocionale. Edhe ata më të zgjuarit mund të fundosen në shtjellën e pasionit dhe të impulseve të pakontrolluara. Njerëzit me IQ⁴ të lartë mund të jenë krejtësisht të paaftë për t’i drejtuar jetët e tyre.

Kemi plot përjashtime nga rregulli që IQ-ja parashikon suksesin. Sipas studimeve të bëra dhe rezultateve përkatëse, ky rregull ka shumë më tepër përjashtime se konfirmime. Në rastin më të mirë, ***IQ-ja është përgjegjëse për njëzet përqind të faktorëve që përcaktojnë suksesin në jetë.*** Tetëdhjetë përqind e kanë në dorë forca të tjera.⁵ Siç vëren një studiues, “në pjesën më të madhe, vendi që zë dikush në shoqëri përcaktohet nga faktorë që nuk kanë të bëjnë me IQ-në, duke filluar nga këmbëngulja, zotërimi i vetes, klasi i sjelljes, klasa shoqërore deri te fati”. Pikërisht këtu hyn në lojë ajo që quhet Inteligjenca Emocionale ose EQ⁶ (Koeficienti Emocional). EQ nuk është e kundërta e IQ-së. Inteligjenca emocionale është një lloj tjetër zgjuarsie. Disa janë të bekuar më shumë nga të dyja, të tjerë nuk kanë mjaftueshëm nga asnjëra.

Sa i zoti është një person në aftësitë që përmendëm më sipër, është shumë e rëndësishme për t’u kuptuar pse dikush ecën përpara në jetë, ndërsa një tjetër që ka të njëjtin potencial intelektual mbetet vend-numëro. Shkathtësia emocionale është vetëm një gjysmë-aftësi, për të përcaktuar sa jemi në gjendje t’i përdorim aftësitë e tjera që kemi, përfshirë edhe intelektin.

Po dalin gjithnjë e më shumë të dhëna që vërtetojnë se njerëzit që janë të mprehtë nga ana emocionale, që i njohin mirë dhe dinë të kontrollojnë ndjenjat e veta, që dinë t’i kuptojnë ndjenjat dhe t’u shkojnë për shtat ndjenjave të të tjerëve, janë më të suksesshëm në shumë fusha të jetës. Dëshiroj të bëj të ditur një letër, shkruar nga Isokrati, një nga mentorët dhe oratorët më të njohur të Athinës, në vitet 374 para erës sonë, drejtuar një të riu të quajtur Domenikus, duke e paralajmëruar që të mos e lejonte veten të dërmohej nga “nervozizmi, kënaqësia dhe dhimbja”: “*Asnjë stoli nuk vlen sa modestia, drejtësia dhe vetëpërmbytja; sepse këto janë virtyte, përmes të cilave karakteri i të rinjve mbahet nën kontroll. “Praktiko vetëkontrollin!”*”⁷ Njerëzit që i kanë zhvilluar mirë aftësitë emocionale, ka më shumë gjasa të gjejnë lumturinë dhe qetësinë në jetën e tyre. Ata dinë të përqendrohen në ato gjendje mendore ku japin maksimumin. Njerëzit që nuk e vënë dot jetën emocionale kalojnë vazhdimisht beteja të brendshme që e dëmtojnë aftësinë e tyre për t’u përqendruar në punë

⁴ Intelligence Quotient (IQ) - Koeficienti i Inteligjencës është një rezultat total i nxjerrë nga një sërë testesh ose nëntestesh të standardizuara, të përcaktuara për të vlerësuar Inteligjencën Njerëzore.

⁵ Daniel GOLEMAN, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, f. 52.

⁶ Emotional Quotient (EQ) - Koeficienti Emocional (ose Inteligjenca Emocionale) përcaktohet më shpesh si aftësia për të perceptuar, përdorur, kuptuar dhe menaxhuar emocionet.

⁷ Ryan HOLIDAY, “Egoja është armiku”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-15-9, f. 17-18.

dhe për të menduar kthjellët.

Jack Block, psikolog pranë Universitetit të Kalifornisë në Berkli ka bërë një krahasim mes dy inteligjencave në gjendjen e tyre të pastër. Ai ka krahasuar njerëzit me IQ të lartë me ata që zotërojnë një numër të madh aftësish emocionale. Ndryshimet janë interesante: *“Tipi i inteligjencës së pastër IQ (pa llogaritur këtu inteligjencë emocionale) është pothuajse një karikaturë e intelektualit. Shumë i zoti në punët e mendjes, por me vështirësi në marrëdhëniet e jetës së përditshme”*⁸.

Pra, është inteligjenca emocionale ajo që na përkufizon më shumë si njerëz. Ajo është diçka që të gjithë e zotërojmë deri diku, por thjesht nuk mund të përcaktohet. Ajo ndikon në mënyrën se si sillemi, si përshtatemi me situatat komplekse shoqërore, apo si marrim vendime për të arritur rezultatin e nevojshëm. Inteligjenca emocionale përbëhet nga elementet bazë të aftësive tona që kombinohen me dy faktorë: kompetenca personale (aftësi për të njohur, kuptuar dhe menaxhuar emocionet tona) dhe ato shoqërore (aftësi për të njohur, kuptuar dhe ndikuar emocionet e të tjerëve). Pra, inteligjenca emocionale është aftësia e individëve për të identifikuar, njohur dhe përdorur emocionet e tyre dhe të të tjerëve dhe të kuptojë e përdorë informacionin emocional për të drejtuar të menduarit dhe sjelljen. Inteligjenca emocionale ndikon në aspekte të ndryshme të jetës së përditshme siç është sjellja dhe ndërveprimi me të tjerët.

Është me vend të përmendet një rrëfenjë të vjetër japoneze⁹ që flet për një samuraj gjaknxehetë, i cili i kërkoi një mjeshtri të filozofisë t’i shpjegonte konceptet e **parajsës** dhe **ferrit**. Plaku i urtë iu kthye me përçmim: “E kotë të ta them. Pse të harxhoj frymë me një kokëgdhe si puna jote?” I prekur në sedër, samuraji, duke shkumëzuar nga inati, nxori shpatën nga mllefi dhe iu hakërrye: “A e di se mund të ta marr shpirtin për këtë fyerje?”.

“Ky – iu përgjigj murgu qetësisht, - është ferri”. I shtangur, kur kuptoi se murgu kishte të drejtë për mërinë që ia erri sytë, samuraji u qetësua, futi shpatën në brez, iu përkul me nderim para plakut dhe e falënderoi për urtinë.

“Ndërsa kjo, - vazhdoi murgu, - është parajsa”.

Ndërgjegjësimi i papritur i samurajit se tërbimi ia kishte errur arsyen na ilustron më së miri ndryshimin mes gjendjes se të qenët i përfshirë nga një ndjenjë dhe të kuptuarit se ajo po na rrëmben plotësisht. Shprehja e Sokratit **“Njihe veten”** ka të bëjë pikërisht me këtë gur themeli të inteligjencës emocionale: të jemi të ndërgjegjshëm për ndjenjat tona ndërkohë që ato na kanë mbërthyer.

3. Drejtuesi dhe inteligjenca emocionale

*“Nuk mjafton të kemi cilësi të jashtëzakonshme,
duhet të jemi gjithashtu në gjendje për t’i administruar ato”*¹⁰

La Rochefoucauld

⁸ Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, f. 65.

⁹ Po aty, faqe 67.

¹⁰ Ryan Holiday, “Egoja është armiku”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-15-9, f. 143.

Për të qenë një drejtues i suksesshëm dhe për të arritur rezultate të kënaqshme, në radhë të parë, ai duhet të njohë dhe zbatojë me korrektësi parimet e drejtimit, të cilat kanë të bëjnë me kompetencat drejtuese, njohjen e vetvetes, kujdesin për vartësit, udhëheqjen me shembullin vetjak, aftësitë komunikuese, bashkëpunuese, motivuese, krijuese, vetëzhvilluese, marrjen e përgjegjësive etj. Sapo të keni arritur sukses në karrierën tuaj, përgjegjësitë mund të fillojnë të ndryshojnë. Në hierarkinë e zinxhirit të komandimit, sa më lart të ngjiteni, do të merreni gjithnjë e më pak me të bërit dhe gjithnjë e më shumë me vendimmarrjen. E tillë është natyra e lidershipit. Ky tranzicion kërkon që të rivlerësoni dhe të përditësoni identitetin tuaj. Është e rëndësishme të kuptoni se **aftësia drejtuese nuk është sinonim me autoritetin**. Në një masë të konsiderueshme ajo është një vlerë e veçantë e barabartë me **besimin e vartësve** ndaj eprorit. Ajo mishëron një investim emocional shpirtëror, virtytin e besimit. Në këtë raport është vartësi ai që përcakton kushtet për dhënien e besimit. Ai i di dhe i percepton ato cilësi, karakteristika dhe vlera, që duhet të zotërojë eprori i tij për të qenë e për t'u pranuar si drejtues. Por sidoqoftë, është drejtues me të vërtetë i zgjuar ai, që kupton e vlerëson, që ushqen e mban të gjallë lidhjen midis tij si epror dhe vartësve¹¹. Gjithashtu, është e rëndësishme që ju të mësoni të menaxhoni veten dhe të tjerët përpara se puna t'ju konsumojë. Ata që duan të kontrollojnë gjithçka janë egoistë, të cilët nuk mund të menaxhojnë të tjerët dhe, në një kohë të shkurtër, janë gjithnjë të mbingarkuar. Kështu bëjnë dhe vizionarët karizmatikë, të cilët humbin gjithë interesin, kur vjen momenti për të kryer punën.¹² Akoma më keq janë ata që rrethohen nga servilë dhe lajkatarë, të cilët u zgjidhin ndonjë problem të çastit dhe krijojnë fluska, nga të cilat nuk arrijnë të shohin se sa të shkëputur janë nga realiteti.

Dav Sidman autor i librit me titull “Si: Pse mënyra SI bëjmë diçka nënkupton gjithçka... në biznes (dhe në jetë)” thekson: *“Në një botë që përparon me shpejtësi, fitojnë individët dhe organizatat të cilat krijojnë lidhjet më të forta... Sot na dallon mënyra se si sillemi dhe ndërveprojmë me të tjerët. Cilësitë që dikur dukeshin si të “buta” – integriteti, pasioni, përlulesia dhe e vërteta – janë bërë etaloni i suksesit të sipërmarrjes dhe shtysat më të fuqishme drejt emrit të mirë të organizatës dhe fitimit”*¹³.

Punonjësit që mendojnë se organizatat e tyre kanë etikë shfaqin nivel më të lartë kënaqësie në punë dhe ndihen më të vlerësuar.

Inteligjenca emocionale e një drejtuesi është thelbësore në krijimin e një mjedisi të këndshëm për vartësit e tij. Është e njohur thënia e Aristotelit: *“Të gjithë mund të zemërohemi. Kjo nuk është e vështirë. E vështirë është të zemërohesh me njeriun e duhur, në masën e duhur, në kohën e duhur, për qëllimin e duhur dhe në mënyrën e duhur”*¹⁴. Në këtë kuadër, nëse është e lehtë të zemërohesh, nuk është e lehtë të zemërohesh në mënyrën e duhur. Shpesh, ka raste

¹¹ Perri Smith “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, f. 166.

¹² Ryan HOLIDAY, “Egoja është armiku”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-15-9, f. 149.

¹³ Dale CARNEGIE, “Arti për t'u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia botuese “Pegi”, Viti 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0, f. 54

¹⁴ Daniel GOLEMAN, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, faqe 9.

që për hiç gjë drejtuesit dalin nga vetja dhe në vend që të zgjidhin problemet, hapin probleme me vartësit. Prandaj, nëse drejtuesi arrin të zemërohet në mënyrën e duhur, atëherë ndikimi i sjelljes së tij në ekipin që drejton do të ketë vetëm nota pozitive.

Në këtë kuadër, **vetëpërbajtja**, aftësia për të mos u përkulur nga stuhitë e ndjenjave dhe për t'u bërë ballë goditjeve të fatit, në vend që t'i jepesh dobësisë, duke u bërë "rob i pasionit", është çmuar si **virtut** që nga koha e Platonit. Gjithsesi, synimi nuk është ndrydhja e plotë e emocioneve, por shfaqja e tyre në masën e duhur. Të gjitha ndjenjat kanë vlerën dhe domethënien e tyre. Qëllimi ynë duhet të jetë përshtatja e reagimit emocional me rrethanën në të cilën ndodhemi. Kur emocionet ndrydhen së tepërmi, ato krijojnë ftohje dhe largësi. Kur dalin jashtë kontrollit dhe bëhen shumë ekstreme dhe ngulmuese, ato mund të kthehen në sëmundje si depresioni, ankthi, zemërimi i verbër dhe nervozizmi maniak. **Ekulibri i emocioneve negative dhe pozitive përcaktojnë mirëqenien shpirtërore.** Njerëzit nuk duhet t'i shmangin emocionet dhe ndjesitë e pakëndshme për të qenë të lumtur, por duhet t'i kontrollojnë ato. Sipas Publius Sirius¹⁵: "*Kërkoni të zotëroni një perandori të madhe? Sundoni më parë veten tuaj*"¹⁶. Në rast paniku, njerëzit bëjnë gabime. Shpërfillin funksionimin e sistemeve. Nuk zbatojnë procedurat dhe rregullat. Devijojnë nga plani origjinal. Bëhen indiferentë dhe nuk mendojnë qartë. Pengesat na bëjnë emocionale, por mënyra e vetme për të mbijetuar apo për t'i kapërcyer është aftësia për të kontrolluar emocionet tona¹⁷. Ç'është e vërteta, mbajtja e emocioneve të këqija nën kontroll është **çelësi** i mirëqenies emocionale. Nëse nuk arrijmë të shkëpusim mendjen për një kohë të gjatë nga një gjendje emocionale e pakëndshme, atëherë vëmë në rrezik qëndrueshmërinë.¹⁸ Mirëqenia emocionale përcaktohet nga raportit mes emocioneve pozitive dhe atyre negative.

Goleman argumenton se inteligjenca emocionale është treguesi kryesor i suksesit, e cila përfshin vetëdijen, altruizmin, motivimin, ndjeshmërinë dhe aftësinë për të dashur dhe për t'u dashur nga miqtë, partnerët dhe familjarët. Njerëzit apo drejtuesit me inteligjencë të lartë emocionale janë të suksesshëm në punë dhe jashtë saj ndërtojnë karriera të ndritura dhe marrëdhënie të qëndrueshme dhe kuptimplota. Inteligjenca emocionale nuk është e lindur por kultivohet. Ajo është kritike për mjedisin e punës, pasi njohja e emocioneve iu mundëson drejtuesve të reagojnë në mënyrën e përshtatshme dhe në funksion të krijimit të një klime efektive drejtimi. Njerëzit me vetëvlerësim të lartë besojnë se ata kanë më shumë gjasa për t'ia dalë në shumicën e gjërave që bëjnë. Ata kanë respekt për veten dhe e dinë se të tjerët e respektojnë¹⁹. Për këtë arsye, konkludojmë se kyçi për arritjen e suksesit mundësohet nga

¹⁵ Publilius Syrus, ishte një shkrimtar latin, i njohur më shumë për ndjenjat e tij. Ai ishte një Sirian nga Antiokia që u soll si skllav i Italisë Romake.

¹⁶ Ryan HOLIDAY, "Pengesa është rrugëdalja", Shtëpia Botuese "Minerva", Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-13-5, f. 33.

¹⁷ Po aty, faqe 35.

¹⁸ Daniel GOLEMAN, "Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese "Pema", Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, f. 78.

¹⁹ Dale CARNEGIE "Si të mposhtësh shqetësimet dhe stresin", Shtëpia Botuese "Pema", Tiranë 2019, ISBN: 978-9951-721-73-8, faqe 71-72.

besimi te vetja. Drejtuesi duhet të jetë pasionant dhe i aftë për të përjetuar emocione, të njohë veten dhe të dijë të kontrollojë ndjeshmërinë emocionale.

Dianne M. Tice zbuloi se shkrimi i zemërimit është një ndër mënyrat më të këqija për t'u qetësuar. Shpërthimet e zemërimit zakonisht stimulojnë trurin emocional dhe, si rezultat do të ndihemi dhe më të zemëruar në vend që të qetësohemi. Shuarja e zemërimit vjen nëse ai menaxhohet.

Tice zbuloi se kur njerëzit i folën për rastet kur e kishin shfryrë zemërimin ndaj atij që ua kishte shkaktuar, nuk kishin arritur të çliroheshin nga ajo gjendje për një kohë të gjatë. Shumë më mirë kishin rrjedhur gjërat kur **njerëzit kishin pritur sa ishin qetësuar**, pastaj ishin përballur me mendje të kthjellët me shkaktarin e zemërimit të tyre. Chagyam Trungpa, një mësues nga Tibeti, dha këtë përgjigje kur e pyetën cila ishte mënyra më e mirë për t'u përballur me zemërimin: *“Nuk duhet në asnjë mënyrë ta ndrydhni, por nuk duhet as të veproni nën ndikimin e tij”*.²⁰

Kontrolli i emocioneve ndihmon në krijimin, përmirësimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me grupin dhe individët në organizatë. Marrëdhënia përmirësohet me komunikim efektiv, të qartë dhe korrekt, me menaxhimin e konflikteve edhe kur na kanë pushtuar emocionet negative. Drejtuesi që kontrollon të tjerët duhet të kontrollojë veten pasi, siç thoshte Gjenerali i shquar amerikan Robert E. Lee *“Unë nuk mund t'i besoj një njeriu të kontrollojë të tjerët kur ky nuk ka forca të kontrollojë veten”*.²¹ Pse vetëbesimi është kaq i rëndësishëm?

Në fakt, kur nuk ke besim te vetja, njerëzit e tjerë mund ta pikasin fare lehtësisht. Kjo është shumë e arsyeshme, andaj, nëse nuk ndiheni mirë me veten, ndoshta as ata nuk do të ndihen mirë me ju. Por, për të njëjtën arsye, kur ju tregoni vetëbesim dhe vetësiguri, të tjerët do të përfitojnë. Asnjëherë mos harroni se njerëzit që keni afër vetes duan të ndihen mirë me ju, duan të marrin mendimin tuaj si profesionist, ndoshta dhe si një mik. Puna është ta bëni këtë sa më të lehtë të jetë e mundur.²² Drejtuesit duhet të jenë të qëndrueshëm, sa të mos drejtohen nga emocionet dhe ndjenjat por të kontrollojnë jetën e tyre emocionale.

Nuk duhet harruar që drejtimi i njerëzve apo puna me njerëzit është sa e vështirë aq dhe e bukur. Dhe roli i drejtuesit në këto marrëdhënie është vendimtar.

Gjenerali amerikan Xhorxh Marshall thoshte: *“Ushtari është njeri, ai pret të trajtohet si i rritur dhe jo si shkollar. Ai ka të drejta, të cilat duhet t'i bëhen të njohura dhe pastaj t'i respektohen. Ai ka sedër dhe ajo i duhet nxitur. Ai ka besim në një mision të drejtë, prandaj duhet qëndrim i ndershëm ndaj tij. Ai ka nevojë për shoqëri dhe kjo duhet t'i jepet. Ai ka imagjinatë, e cila duhet t'i stimulohet. Ai ka ndjenjën e dinjitetit personal dhe kjo i duhet mbrojtur. Ai ka krenari e cila mund të nxitet dhe të bëhet baza e karakterit të tij në qoftë se ai sigurohet se kryen një detyrë të dobishme dhe të respektueshme. Në këtë mënyrë ushtari bëhet*

²⁰ Daniel GOLEMAN, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, f. 87.

²¹ L.A. Pennington, Romeyn, B. Hought, H. W. Case, “Psikologjia e drejtimit në ushtri”, SHBU, Tiranë 1993, f. 128.

²² Dale CARNEGIE, “Arti për t'u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia botuese “Pegi”, Viti 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0, f. 65

*besnik, sepse ndaj tij tregohet besnikëri*²³. Të drejtosh njerëzit do të thotë t'i respektosh ata, mendimin e punën e tyre, t'u lësh hapësirat e nevojshme, duke i zhveshur nga tutela dhe t'i mbështesësh në çdo çast kur është e nevojshme, duke i konsideruar gjithmonë si partnerë të domosdoshëm.

Drejtuesi është ai që ruan ekuilibrin e artë të marrëdhënieve me vartësit e tij që janë të natyrave e karaktereve të ndryshëm. Drejtuesit nuk i lejohet as hakmarrja dhe as justifikimi ndërkohë që zemërimi është ndjenja më e vështirë për t'u kontrolluar dhe që krijon shumë emocione negative. Vartësit tuaj duhet t'ju pranojnë siç jeni: padyshim aspak i përkryer, por gjithnjë duke bërë më të mirën tuaj. E vetmja sjellje që vartësit e aftë rrallëherë e durojnë për një kohë të gjatë, është *mungesa e respektit*. Nëse dëshironi që t'i mbani vartësit tuaj, është absolutisht shumë e rëndësishme që të vlerësoni cilësitë e veçanta të gjithsecilit prej tyre. Shfaqni respektin tuaj në mënyra të ndryshme dhe vazhdimisht.²⁴

Do të dëshiroja ta mbyllja me thënien e Xhon Shofild, administrator në West-Piont (1879): *...kadetët duhet ta memorizojnë edhe këtë, se të njëjtat komanda mund të jepen në një mënyrë që inspiron besnikëri ose në një mënyrë që nxit pakënaqësi. Ndryshimi vjen nga një vlerë themelore: Respekti. Respekti i vartësve për komandantin? Jo, thotë Shofildi. Zanafilla e lidhshpimit të vërtetë buron nga respekti i komandantit për vartësit.*²⁵

4. Përfundime

Në ditët e sotme, organizatat e shohin inteligjencën emocionale po aq të rëndësishme sa dhe aftësitë profesionale. Inteligjenca emocionale ndikon bindshëm në marrëdhëniet e shëndetshme me të tjerët. Nëse ne do të jemi të aftë të kuptojmë emocionet tona dhe të dimë si t'i menaxhojmë ato, rrjedhimisht do të jemi të aftë të shprehim se si ndjehemi dhe të kuptojmë se si ndjehen të tjerët gjithashtu. Kështu, mund të komunikojmë në mënyrë efektive dhe të krijojmë marrëdhënie të forta si në organizatë ashtu dhe në aspektin personal.

Një inteligjencë emocionale e lartë na ndihmon të kemi performancë më të mirë në drejtim, të jemi më të motivuar dhe të mund të motivojmë edhe të tjerët.

Sfida më e madhe është përfshirja e inteligjencës në jetën tonë emocionale. Kur pasionet tona i ushtrojmë në mënyrën e duhur, ato përmbajnë në vetvete urti. Ato na udhëheqin të menduarit, vlerat dhe mbijetesën. Problemi nuk qëndron tek emocionet, por në mënyrën dhe në masën e shprehjes së tyre. Çështja është: si mund ta bëjmë inteligjencën pjesë të emocioneve? Çfarë duhet të bëjmë që në rrugë dhe në jetën e përbashkët të mbizotërojnë mirësjellja dhe qytetaria?

Mendoni përfitimet që mund të kemi në punë nëse i zotërojmë aftësitë themelore të inteligjencës emocionale, si të arrijmë të përshtatemi me ndjenjat e bashkëpunëtorëve, të dimë të përballemi me mosmarrëveshjet në mënyrë që të mos përshkallëzohen dhe të hyjmë

²³ John G. MEYER, "Komandimi i kompanisë", Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 32.

²⁴ Beverly KAYE, Sharon Jordan-EVANS, "Duajini punonjësit, që të mos i humbisni" botimet "Max", Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3, faqe 67-68.

²⁵ Angela DUCKWORTH, "Forca e karakterit, fuqia e pasionit dhe këmbënguljes", Shtëpia Botuese "Minerva", Viti 2019, ISBN: 978-9928-265-20-3, faqe 266.

në gjendjen e rrjedhës teksa punojmë.

Aftësia për të drejtuar nuk do të thotë të sundosh të tjerët, por t'i bindesh të përpiqen për arritjen e qëllimit të përbashkët.

Të diktosh atmosferën emocionale në një marrëdhënie është një shenjë dominimi në një nivel shumë të thellë dhe intim. Drejtuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për reagimin e tij sipas intensitetit dhe kohëzgjatjes së emocioneve si dhe për mënyrën e kontrollit të tyre. Themeli i klimës së shëndetshme të drejtimit është kontrolli i emocioneve të pakëndshme.

Bibliografia:

- Dale Carnegie, “Arti për t’u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia botuese “Pegi”, Viti 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0.
- Dale Carnegie, “Si të mposhtësh shqetësimet dhe stresin”, Shtëpia Botuese “Pema”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9951-721-73-8.
- Angela Duckworth, “Forca e karakterit, fuqia e pasionit dhe këmbënguljes”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2019, ISBN: 978-9928-265-20-3.
- Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7.
- Ryan Holiday, “Egoja është armiku”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-15-9.
- Ryan Holiday, “Pengesa është rrugëdalja”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-13-5.
- Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni”, botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3.
- John G. Meyer, “Komandimi i kompanisë”, SHBU, Tiranë 1995.
- L.A. Pennington, Romeyn, B. Hought, H.W. Case “Psikologjia e drejtimit në ushtri”, SHBU, Tiranë 1993.
- Perri Smith, “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994

KOMUNIKIMI I DREJTUESVE USHTARAKË – ELEMENT I RËNDËSISHËM PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE DHE RRIJTJEN E KOHEZIONIT

Kolonel Msc. Editson Zarka
Shef i Departamentit të Leadershipit
dhe Shkencave Shoqërore, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Komunikimi është një mjet i fuqishëm i drejtuesve të çdo niveli. Ai është pa dyshim i rëndësishëm në jetën e përditshme të çdo drejtuesi në përgjithësi, ndërsa për drejtuesin ushtarak, ajo është shpeshherë edhe vendimtare. Aftësia e komunikimit të qartë me gojë e me shkrim të urdhrave, direktivave, udhëzimeve është një veti e domosdoshme e komandantëve për të ushtuar komandim-kontrollin në mënyrë të efektshme me njësitë dhe repartet vartëse. Duke qenë se drejtuesi ushtarak konsumon rreth 80% të kohës së tij drejtpërdrejt me eprrorët, vartësit, bashkëpunëtorët etj., atëherë komunikimi mbetet një element shumë i rëndësishëm për përballimin e volumit të punës, problematikave dhe situatave komplekse.

Komunikimi është elementi kryesor në veprimtarinë drejtuese ushtarake. Ai duhet të jetë gjithmonë në funksion të misionit dhe zbatimit të detyrave. Ky komunikim mund të jetë faktori kyç për jetën e vetë oficerit, personelit që ai drejton, si dhe aftësisë së tyre për të pasur sukses në operacionet e një rëndësie të madhe¹. Drejtuesi në çdo moment është nën vëzhgimin e vartësve dhe çdo veprim apo lëvizje e tij lë gjurmë pozitive ose negative tek ata. Drejtuesi vazhdimisht ndodhet përballë një presioni vertikal, midis detyrës së marrë nga lart nga eprori dhe zbatimit të saj nga vartësit. Nëse ai nuk arrin të kryejë si duhet rolin e tij për të neutralizuar këtë presion, për të bindur vartësit për domosdoshmërinë e detyrës, ai është i pirur të dështojë. Përkundrazi, nëse ai di të komunikojë me vartësit, di t'i transmetojë idetë, mesazhet, di t'i shtrojë drejt problemet, di t'i orientojë interesat e tyre për realizimin e detyrave, ai do të jetë i suksesshëm. Pra, për një drejtues nuk mjaftojnë vetëm aftësitë analitike e vendimmarrëse, por kërkohen dhe aftësi për të shprehur e komunikuar qartë synimet e tij, me qëllim që vartësit të veprojnë në përputhje me to. Angazhimi i Forcave të Armatosura në misionet brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimi me vendet e tjera, aleate dhe partnere, kompleksiteti i mjedisit të sigurisë, shumëllojshmëria e mjeteve të komunikimit, dezinformimi etj., rrisin rolin e drejtuesit të nivelit strategjik për të komunikuar. Në thelb mbetet realizimi i misionit të strukturës që ata drejtojnë, ndërsa format e këtij komunikimi zhvillohen përditë e me tepër krahas zhvillimit të formave të komunikimit dhe teknologjisë.

Fjalët kyçe: komunikimi, leadershipi, udhëheqje ushtarake etj.

¹ Torill Holth and Ole Boe, "Enhancing the Leadership Communication Skills of Norwegian Military Officers", Department of Military Leadership and Management, Norwegian Defence Staff and Command College, Norwegian Defence University College

1. Lidershipi dhe aftësitë e komunikimit

John S. Kem ka theksuar se lidershipi nuk është një proces i lehtë dhe se nuk ka një recetë magjike për një lidership të suksesshëm. Kjo është arsyeja pse ka qaq shumë libra rreth liderëve dhe karakteristikave të tyre¹. Në doktrinën e ushtrisë amerikane, lidershipi përkufizohet si *“procesi i ndikimit të njerëzimit për të arritur qëllimin, drejtimin dhe motivimin për përmbushjen e misionit dhe përmirësimin të organizimit.”*²

Lidershipi zhvillohet si proces gjatë gjithë jetës, prandaj edhe komunikimi është një proces i tillë. Lideri ushtarak, i cili promovohet në gradë dhe karrierë, me marrjen e detyrave të një shkalle më të lartë, kërkon përsosjen e aftësive të drejtimit dhe udhëheqjes ushtarake për të qenë sa më i efektshëm në punën e tij dhe për t’iu përgjigjur sa më mirë sfidave të kohës. Këto aftësi përfitohen dhe zhvillohen gradualisht, duke filluar nga nivelet e ulëta, ku komunikimi është më i drejtpërdrejtë (komandant toge, kompanie etj.), kalojnë në nivel organizate (batalion, regjiment, repart autonom etj.) dhe arrijnë deri në nivelet më të larta të komandimit si: komandant brigade, force apo strategjik (Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Përfaqësi Ushtarake etj.).

Tri niveleve të strukturës së komandim-kontrollit të Forcave të Armatosura iu përgjigjen tri nivele të aftësive të komunikimit të drejtuesve. Ato ndahen në aftësitë bazë të komunikimit, aftësitë e komunikimit në nivel organizate dhe aftësitë e komunikimit në nivel të lartë/strategjik. Udhëheqja strategjike ndryshon nga udhëheqja e niveleve të tjera, si rrjedhojë ndryshon edhe mënyra dhe forma e komunikimit. Kërkimet në këtë fushë tregojnë se kalimi i drejtuesve nga niveli më i ulët në nivelet më të larta nuk u heqin atyre kompetencat që kanë fituar më parë³. Përkundrazi, mbi bazën e aftësive të komunikimit të fituara ata avancojnë me kompetenca të reja.

2. Aftësitë bazë të komunikimit

Aftësitë bazë të komunikimit shpeshherë karakterizohen nga një term më i gjerë, të njohur si *aftësitë ndër-personale ose aftësitë e njerëzve*. Aftësitë ndër-personale janë aftësitë e

¹ John S. Kem, US Army War College, “Strategic Leadership - Premier for Senior Leaders” 4th Edition, page 6

² Army Doctrine Publication (ADP) 6-22, *Army Leadership* (Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office 1 August 2012), 1.

³ “Strategic Leadership – Primer for senior leaders” forth edition, Department of Command, Leadership, and Management School of Strategic Landpower U.S. Army War College, Carlisle, PA, page 9.

nevojshme për të ndërvepruar me njerëzit e tjerë. Në këto lloj aftësish futen disa elemente të rëndësishme, të cilat shtjellohen më poshtë:

- *Komunikimi me gojë dhe me shkrim.* Liderët i përdorin këto lloj komunikimesh për t'u lidhur më tepër me njerëzit, prandaj teknikat dhe pozicionet që ai mban e përdor gjatë komunikimit janë të rëndësishme. Praktika konsiderohet si mjeti më i mirë për t'u përmirësuar gjatë prezantimeve zyrtare apo fjalimeve publike.
- *Komunikimi joverbal.* Kërkimet e bëra në këtë fushë theksojnë se pothuajse 90% e brendësisë së një komunikimi kapet nga mënyra joverbale e të shprehurit. Kjo kërkon që liderët ta mbajnë parasysh këtë fakt si një mjet të rëndësishëm komunikimi dhe si pjesë e aftësive të tyre ndër-personale.
- *Dëgjimi në mënyrë aktive.* Lideri duhet të jetë një dëgjues shumë i vëmendshëm dhe procesi i dëgjimit duhet të bëhet në mënyrë sa më aktive, për të marrë të gjithë përmbajtjen e asaj që thuhet nga bashkëbiseduesi.
- *Dhënia dhe marrja e mendimeve.* Dhënia dhe marrja e mendimeve lidhur me performancën në punë është pjesë integrale e lidhshpimit të suksesshëm. Edhe pse kjo gjë mund të mos jetë e përshtatshme për një pjesë të drejtuesve, ajo duhet të jetë pjesë e aktivitetit të tyre të përditshëm.
- *Inteligjenca Emocionale.* Goleman (2004) futi konceptin e Inteligjencës Emocionale, i cili i referohet kapacitetit të liderit për t'u marrë efektivisht si me emocionet e veta, ashtu edhe me emocionet e të tjerëve. Kjo ka të bëjë me të menduarit në mënyrë inteligjente lidhur me emocionet, mënyrën e perceptimit, shprehjes, kuptimit dhe menaxhimit të tyre në mënyrë sa më profesionale dhe efektive. Inteligjenca emocionale mund të matet për çdo lider dhe mund të rritet me kalimin e kohës.
- *Zgjidhja e konfliktit dhe aftësitë negociuese.* Drejtuesit i kushtojnë vëmendjen e duhur negociimit të rezultateve apo zgjidhjes së konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të mundshme. Negocimi dhe zgjidhja e konfliktit përbëjnë një element të vështirë, prej të cilit drejtuesit nuk mund të shmangen. Ata duhet t'i kushtojnë kohën dhe vëmendjen e duhur.

Drejtuesit i mbajnë vartësit të informuar në lidhje me synimin, besimin, duke lehtësuar stresin dhe eliminuar thashethemet⁴. Pa bërë këto informime, vartësit mund të mbushin boshllëkun me supozime dhe ide të cilat janë kundër asaj që synohet. Drejtuesit duhet të dëgjojnë trupat e tyre, të mësojnë nëse informacioni, mesazhi që iu dërgohet është kuptuar nga ata.

Drejtuesit e këtij niveli përdorin teknikat formale dhe informale të komunikimit me vartësit e tyre. Në teknikat formale futen urdhrat, brifingu, tranazhet për konceptet operacionale, adresimet (fjalimet), takimet ballazi, njoftimet e ndryshme, si dhe praktikimi i mbajtjes së “*dyerve hapur*” për të bërë të mundur lehtësinë e komunikimit. Në teknikat informale futen takimet sociale, pushimet e ndryshme, dëgjimi aktiv, takimet personale, transparenca e treguar etj.

⁴ Defense Forces Irland, “Defense Forces Leadership Doctrine”, page 54.

3. Aftësitë e komunikimit në nivel organizate

Komunikimi i liderëve në këtë nivel është më i gjerë sesa në nivelin bazë. Spektri i funksioneve që mbulon drejtuesi i një organizate përfshin më tepër funksione, disiplina, fusha e projekte për t'u ndjekur. Një komunikim i dobët mund të çojë në pasoja negative. Shkëmbimi i hapur i informacionit (duke ruajtur rregullat e sigurisë) forcon vlerat organizative dhe jep sinjale pozitive konstruktive. Komunikimi i hapur si me vartësit, ashtu edhe me eprorët është i rëndësishëm. Kuptimi sa më mirë i udhëzimeve dhe direktivave që vijnë nga komanda eprorë redukton masat korrektuese që mund të duhen në nivelet më të ulëta. Kjo e bën më të lehtë parashikimin e planëzimit për të ardhmen, minimizon fërkimet, ruan tempin dhe klimën e organizatës.

Drejtuesit e këtij niveli duhet të njohin vetveten, misionin, mesazhet, mjedisin, metodat më të mira të komunikimit dhe duhet t'i ndajnë këto me vartësit⁵. Më poshtë trajtohen në mënyrë të përmbledhur këto kompetenca e aftësi.

- *Njohja e vetvetes.* Kjo, pikë së pari, ka të bëjë me njohjen e anëve të forta dhe të dobëta. Kërkohej që drejtuesi të zhytet në filozofinë e lidërshiptit dhe ta komunikojë atë. Drejtuesi duhet të njohë mirë paragjykimet e veta, zhgënjimet e hasura dhe dëshirat që ka për të ardhmen. Komunikimi në mënyrë verbale dhe joverbale, në mënyrë sa më të kujdesshme, duke përforcuar mesazhet që përcillen me veprime konkrete.
- *Njohja e misionit.* Misioni që ka organizata apo struktura që drejton duhet njohur shumë mirë nga drejtuesi, duke e ndarë atë me vartësit nëpërmjet mesazheve të qarta. Kërkohej që të forcohen vlerat e grupit, krijimi i besimit dhe qenia i hapur ndaj ideve të vartësve. Drejtuesi i aftë inkurajon dialogun, dëgjon me vëmendje dhe sigurohet që vartësit të kenë mundësi, hapësirë dhe të shprehën pa frikë.
- *Njohja e mjedisit.* Kjo njohje fillon duke bërë vlerësimin e rrethanave, njerëzve, sistemeve dhe mbi këtë bazë drejtuesit përshtatin mesazhet dhe komunikimin ndaj audiencës.
- *Njohja e metodës më të mirë të komunikimit.* Komunikimi më i mirë arrihet përmes prezencës, shfaqjes dhe shpalosjes së personalitetit të liderit. Kjo gjë arrihet me anë të zhvillimit të vizitave pranë strukturave vartëse, ku drejtuesi bën sqarimin e urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna. Për drejtuesin ka rëndësi të komunikojë “mesazhin e duhur”, për “audiencën e duhur”, në “kohën e duhur”.

Detyrat organizative duhet të përputhen me qëllimin dhe objektivat e organizatës. Liderët tregohen të kujdesshëm për të zhvilluar funksionet e nevojshme detyruese për të realizuar qëllimet organizative. Ata identifikojnë atë që është e rëndësishme dhe më pas matin progresin e bërë, duke komunikuar vazhdimisht me vartësit lidhur me prioritetet.

Drejtuesit e aftë nuk kanë nevojë t'i detyrojnë trupat e tyre, por i frymëzojnë ata⁶, duke i motivuar që të përmbushin misionin me dëshirë.

⁵ Po aty”, faqe 70.

⁶ Stewart Welch, “On Joint Leadership: The importance of Communication”, 7 April 2016, page 2

Komandimi me mision kërkon që komunikimi të mos jetë thjesht një proces i shkëmbimit të informacionit. Komandantët përdorin komunikimin për të forcuar lidhjet brenda strukturës që ata drejtojnë. Komunikimi krijon besim, bashkëpunim, kohezion dhe mirëkuptim të përbashkët. Komandimi me mision kërkon që komunikimi të jetë ndërveprues, të karakterizohet nga reagime të vazhdueshme vertikale dhe horizontale. Procesi i reagimit shërben për të marrë mesazhet dhe përmirësuar komunikimin.

Drejtnesit, menaxherët e organizatës i kalojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre në komunikim. Ata zakonisht i kushtojnë afërsisht 6 orë në ditë komunikimit⁷. Ky komunikim bëhet në të dyja drejtimet, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Në këtë komunikim përfshihen kolegët, eprorët, vartësit, kompanitë kontraktore, strukturat ushtarake e civile në zonë etj. Përveç komunikimit verbal, ata përdorin gjerësisht edhe komunikimin me shkrim në formën e letrave, raporteve, informacioneve e relacioneve. Ky lloj komunikimi kërkon përfshirjen e stafëve për të bërë pasqyrimin sa më qartë të situatës, problematikave, opsioneve dhe rrugëve të mundshme për zgjidhje.

Drejtnesit e efektshëm të organizatës bëjnë pyetje, të cilat ndihmojnë për njohjen më mirë të situatës dhe gjetjen e rrugë zgjidhjes për strukturën që drejtojnë. Ata inkurajojnë stafet e tyre të bëjnë të njëjtën gjë dhe nuk merren me aspekte të vogla, apo detaje të parëndësishme. Drejtnesit i përcaktojnë mirë problemet para se të vrapojnë për t'i zgjidhur ato. Ata i mirëpresin reagimet dhe pranojnë rishikimin e ideve të tyre. Për më tepër, ata mbështesin vendimmarrësit të cilët duhet të dinë dhe rivlerësojnë vazhdimisht supozimet e planifikimit. Meqenëse në botën e sotme komplekse kushtet ndryshojnë me shpejtësi, ata duhet të rishikojnë herë pas here si supozimet ashtu edhe rrezikun, pasi këto janë pjesët më të dobëta të çdo plani. Duke menduar e vepruar në këtë mënyrë ata i shërbejnë liderëve të një niveli më të lartë në hierarkinë e komandim-kontrollit.

4. Aftësitë e komunikimit në nivele të larta/strategjike

Kalimi i lidershipit nga niveli taktik në atë operacional është shumë më i lehtë sesa kalimi nga niveli operacional në atë strategjik⁸. Prandaj, drejtnes të shumtë të këtij niveli kanë dështuar të ecin më tej dhe të shohin progresin. Kjo për vetë faktin se problematikat dhe sfidat janë më të mëdha dhe komplekse, shumëdimensionale dhe që kërkojnë njohuri e profesionalizëm më të lartë. Shpeshherë liderët e këtij niveli mbeten rob të përvojave të mëparshme dhe pak përpjekje bëjnë për të kaluar në një stad më të lartë.

Udhëheqja strategjike ndryshon nga udhëheqja e njësisë. Për të pasur sukses në nivelin strategjik, udhëheqësit duhet të kuptojnë gjerësinë, fushën dhe kompleksitetin e mjedisit në të cilin veprojnë; të vlerësojnë madhësinë e kostove të mundshme të vendimeve të tyre; përdorin me efektivitet ekipet e nivelit të lartë të udhëheqjes dhe të veprojnë si kujdestarë të profesionit⁹.

⁷ ManagementStudyGuide.com, "Importance of Communication in an Organization" page 1.

⁸ "Strategic Leadership – Primer for senior leaders" fourth edition, Department of Command, Leadership, and Management School of Strategic Landpower U.S. Army War College, Carlisle, PA, page 6.

⁹ Po aty, faqe 15.

Aftësia për të artikuluar dhe komunikuar në mënyrë efektive vizionin dhe strategjinë, rrit aftësinë e liderit strategjik për të ndikuar direkt dhe indirekt te të tjerët. Krijimi i lidhjeve të shumanshme është një mjet i rëndësishëm i komunikimit, kështu që drejtuesi strategjik duhet të identifikojë, kërkojë dhe vendosë marrëdhënie kyçe si brenda, ashtu edhe jashtë institucionit në mënyrë që të ndikojë në realizimin e misionit dhe objektivave të marra. Informacioni, ndërjegjësimi për rolin e medias dhe shfrytëzimi i saj sa më mirë janë faktorë të rëndësishëm që kërkon menaxhim të kujdesshëm në këtë nivel.

Mike Myatt ka theksuar se “*Është thjesht e pamundur të bëhesh udhëheqës i madh pa qenë një komunikues i madh*¹⁰”. Në analizën e tij ai thekson se për t’u bërë lider i madh nuk duhet të mbështetesh në atë që do të arrish për vete, por tek ajo që duhet të bësh për të tjerët. Vetëm në këtë mënyrë ata do të mbështesin dhe ndjekin.

Drejtuesit strategjikë formulojnë vizione që përshkruajnë atë që duhet të arrijnë institucionet apo struktura që ata drejtojnë. Shpalojsja e vizionit është një element shumë i rëndësishëm për drejtuesit e nivelit strategjik, pasi me anë të saj ata artikulojnë aspiratat për të ardhmen. Vizioni duhet të jetë real dhe t’i bindë vartësit se ai është i arritshëm. Vizioni duhet të jetë i besueshëm, tërheqës dhe frymëzues, që njerëzit ta ndjejnë vetën pjesë të së ardhmes.

Drejtuesit strategjikë komunikojnë përmes një serë mjetesh të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta¹¹ brenda institucionit. Kjo është mjaft e rëndësishme si për realizimin e ndryshimit, ashtu edhe për mbështetjen dhe mbrojtjen e një politike, apo mënyre të caktuar drejtimi. Kur drejtuesit përpiqen të ndryshojnë përmes politikës, rregullimit apo vizionit, komunikimet e tyre duhet të interpretohen në çdo nivel strukturor. Prandaj, kujdesi në zgjedhjen e fjalëve është thelbësore për të siguruar pranimin e mesazhit të dhënë.

Drejtuesit strategjikë komunikojnë në rrethana apo situata të caktuara me struktura jashtë institucionit të tilla si: kuvendin, institucionet e ndryshme shtetërore, drejtuesit e politikës, organizatat joqeveritare etj. Ky lloj komunikimi kërkon qartësi mendimi, drejtimi e veprimi. Zotërimi i këtyre vetive, shoqëruar me një shkallë të lartë të aftësive bindëse, i ofron drejtuesve të nivelit të lartë mjetet e nevojshme për të pasur mbështetje, konsensus dhe për të negociuar me sukses.

5. Përfundime

Lidershipi zhvillohet si proces gjatë gjithë jetës, duke filluar nga fazat e hershme deri në majat më të larta të drejtimit. Lideri ushtarak, i cili promovohet në gradë dhe karriere, me marrjen e detyrave të një shkalle më të lartë kërkon përsosjen e aftësive të drejtimit dhe udhëheqjes ushtarake për të qenë sa më të efektshëm në punën e tyre dhe për t’iu përgjigjur sa më mirë sfidave të kohës. Këto aftësi përfitohen dhe zhvillohen gradualisht nga niveli bazë deri te niveli strategjik.

Komunikimi është elementi kryesor në veprimtarinë drejtuese. Ai duhet të jetë gjithmonë

¹⁰ Mike Myatt “10 Communication Secrets of Great Leaders”, www.forbes.com

¹¹ “Strategic Leadership – Primer for senior leaders” fourth edition, Department of Command, Leadership, and Management School of Strategic Landpower U.S. Army War College, Carlisle, PA, page 83

në funksion të misionit dhe zbatimit të detyrave. Angazhimi i Forcave të Armatosura në misionet brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimi me vendet e tjera, aleate dhe partnere, kompleksiteti i mjedisit të sigurisë, shumëllojshmëria e mjeteve të komunikimit, dezinformimi etj., rrisin rolin e drejtuesit të nivelit strategjik për të komunikuar.

Komandimi me mision kërkon që komunikimi të mos jetë thjesht një proces i shkëmbimit të informacionit. Komandantët përdorin komunikimin për të forcuar lidhjet brenda strukturës që ata drejojnë. Komunikimi krijon besim, bashkëpunim, kohezion dhe mirëkuptim të përbashkët. Komandimi me mision kërkon që komunikimi ndërveprues të karakterizohet nga reagime të vazhdueshme vertikale dhe horizontale. Procesi i reagimit shërben për të marrë mesazhet dhe përmirësuar komunikimin.

Sistemet e komunikimit janë elemente të rëndësishëm për komunikimin në nivel strategjik. Institucionet, strukturat organizative që kanë sisteme efektive të komunikimit janë shumë më të efektshme sesa institucionet apo organizatat me sisteme të dobëta komunikimi. Drejtuesit e aftë harmonizojnë dhe koordinojnë veprimet për të bërë përshtatjen e njerëzve, sistemeve dhe burimeve që kanë në dispozicion. Komunikimi efektiv është një komponent i rëndësishëm i suksesit profesional qoftë kjo në nivelin e komunikimit ndër personal, brenda apo jashtë grupit, në nivele organizate apo jashtë saj. Aftësitë dhe njohuritë e komunikimit të marra nga drejtuesit e lartë bëhen të vlefshme vetëm kur ato zbatohen praktikisht kur është e nevojshme.

Drejtuesit e lartë duhet të përcaktojnë standardet për një komunikim efektiv. Ata duhet të jenë model për llojet dhe tonin e komunikimit, duke synuar vendosjen e një klime sa më pozitive në institucionin që drejojnë. Drejtuesit strategjikë duhet të ndërmarrin veprime të caktuara për të krijuar një kulturë të përshtatshme dhe krijuese.

Zhvillimi dhe ruajtja e një imazhi pozitiv publik është një detyrë me përparësi të lartë për të gjithë drejtuesit e një institucioni, organizate apo strukture ushtarake. Komunikimi efektiv është një komponent i rëndësishëm i suksesit profesional qoftë kjo në nivelin e komunikimit ndër personal, brenda apo jashtë grupit, në nivele organizate apo jashtë saj.

Komunikimi në nivel strategjik kërkon aftësi të veçanta. Pak njerëz i posedojnë të gjitha këto aftësi, prandaj drejtuesit e suksesshëm janë të rrallë. Përfshirja e udhëheqjes ushtarake në komunikimin strategjik është kushti kryesor për arritjen e efektit të dëshiruar, rezultateve të kërkuara, ndikimit në audiencat specifike dhe përcjelljen e informacionit të saktë te publiku.

Bibliografia:

- “Strategic Leadership – Primer for senior leaders” fourth edition, Department of Command, Leadership, and Management School of Strategic Landpower U.S. Army War College, Carlisle, PA
- “Leadership communication: the three levels”, Peter Miller, South Cross University, January 2012, at <https://www.researchgate.net/publication>.
- Laury Berk, M. Lee Williams, Laury Berk, M. Lee Williams, “Leaders as Strategic Communicators”, May / June 2002, <https://iveybusinessjournal.com/publication/leaders-as-strategic-communicators/>

- Peter Miller, “Leadership communication: the three levels”, South Cross University, January 2012, at <https://www.researchgate.net/publication>.
- Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikn”, SHBU, Tiranë 1999.
- NATO, “NATO Strategic Communication Handbook v.1.0” 20 September 2017
- Kacala, Tomasz, “The role of military leadership in Strategic Communication (StratCom)”, Journal of Positive Management; Torun Vol. 7, Iss. 1, (2016): 32-44
- Torill Holth and Ole Boe, “Enhancing the Leadership Communication Skills of Norwegian Military Officers”, Arts and Social Science Journal, Department of Military Leadership and Management, Norwegian Defence Staff and Command College, Norwegian Defence University College, 2017.
- Robert Clifton, “*Reforma dhe Psikologjia e Totalizmit: Një Studim i ‘Brainwashing’ në Kinë*”, New York, Norton, 1961
- Maj. Christopher M. Ford, U.S. Army “Army Leadership and the Communication Paradox”, Military Review, July-August 2015
- Army Doctrine Publication (ADP) 6-22, Army Leadership 1 August 2012
- Stewart Welch, “On Joint Leadership: The importance of Communication”, 7 April 2016, <https://thestrategybridge.org/the-bridge/2016/4/7/on-joint-leadership-the-importance-of-communication>
- Mike Myatt, “10 Communication Secrets of Great Leaders”, <https://www.forbes.com/sites/mikemyatt/2012/04/04>
- Defense Forces Irland, “Defense Forces Leadership Doctrine”

ZHVILLIMI I PROFESIONIT USHTARAK DHE SFIDAT BASHKËKOHORE

Major Edval Zoto

Oficer Ekzekutiv në Departamentin për
Simulim dhe Eksperimentim, IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Profesioni ushtarak përbën një objekt të rëndësishëm dhe themelor të sociologjisë ushtarake dhe shkencës ushtarake në përgjithësi. Në këtë punim trajtohet debati mbi profesionin ushtarak i klasikëve të sociologjisë ushtarake, si Huntington e Janowitz, si dhe sillen në vëmendje aspekte më specifike të këtij objekti studimi nga autorë të mëvonshëm, me qëllimin për të paraqitur një historik të shkurtër të zhvillimit të profesionit ushtarak, për të evidentuar faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e tij, si dhe diskutuar sfidat bashkëkohore ndaj unikalitetit të tij në një plan të përgjithshëm, por dhe në rastin e Shqipërisë.

Fjalë kyçe: profesion ushtarak, sociologji ushtarake, udhëheqje, sfidat

1. Profesionit ushtarak në studimet sociologjike

Profesionit ushtarak në aspektin sociologjik ka tërhequr mjaft vëmendje sidomos pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Nismëtari i debatit sociologjik mbi profesionin ushtarak ishte Samuel Huntington, me veprën e tij *The Soldier and the State (Ushtaraku dhe Shteti, përkth. i aut.)* (1957, në Moten, 2011). Sipas përcaktimit të tij, “trupa moderne e oficerëve është një organizëm profesional dhe oficeri ushtarak, një profesionist”. Huntington e lidh profesionin ushtarak me trupën e oficerëve dhe profesionalizmin në këtë drejtim e karakterizon me tre attribute: përgjegjësinë – forcat ushtarake janë një krah i armatosur i shtetit dhe të vendosura në mënyrë strikte nën kontrollin civil dhe oficerët profesionistë e përdorin ekspertizën e tyre vetëm në dobi të shoqërisë; korporatizmin (*corporateness*, në origjinal – shën i autor.), sipas të cilit profesionit është i kufizuar dhe ka një sistem promovimi të kontrolluar, nënkultura autonome krijohen si pasojë e profesionale komplekse, si dhe revistat, shoqatat, shkolla, ritet, traditat, uniformat dhe shenjat dalluese i përforcojnë ato; dhe ekspertizën, e cila në mënyrë profesionale arrihet pas një periudhe relativisht të gjatë edukimi dhe dija intelektuale ushtarake e përfutur krijon mundësi ruajtjeje nëpërmjet trashëgimive të shkruara. Sipas Huntington, zhvillimi i profesionit ushtarak duhet të karakterizohet nga një konservatorizëm i detyruar. Libri i tij “Ushtaraku dhe Shteti” jo vetëm që do të shenjojë veprën e parë serioze mbi sociologjinë e profesionit ushtarak, por edhe do të përbëjë bazën e studimeve të tjera plotësuese si dhe ngritjen e debatit mbi profesionin ushtarak dhe karakteristikat sociologjike të tij.

Në vijim emra të rëndësishëm të sociologjisë do të trajtonin në studimet e tyre profesionin ushtarak, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e sociologjisë në këtë drejtim, por edhe duke hedhur themele të qëndrueshme shkencore. Kështu, Martin Janowitz botoi “*The Professional Soldier*” (Ushtaraku profesionist, përkth. i autorit) në vitin 1960; Bengt Abrahamsson “*Military Professionalisation and Political Power*” (Profesionalizmi ushtarak dhe fuqia politike, përkth. i autorit) në 1972; dhe Charles Moskos “*From Institution to Occupation – Trends in Military Organization*” (Nga themelimi të punësimi - Trende në organizimin ushtarak, përkth. i autorit) në vitin 1977. Siç e përmbledh Bolin (2008), Janowitz dhe Abrahamsson kritikuan tezën e Huntington se arsimimi ose profesionalizmi i ngurtë e konservator ushtarak do të ishte në dobi të ushtarakëve dhe mbronin tezën se profesionalizmi ushtarak duhet të zgjerohet dhe pasurohet me modele alternative të karakteristikave të oficerëve, e sidomos në diversifikimin e aftësive të tyre.

Sipas përmbledhjes së shkurtër që Baucom (1985) i bën veprës së Janowitz dhe që është e

vlefshme të paraqitet për këtë studim, trupa e oficerëve është e përbërë nga disa “tipe/karakterë” oficerësh. Së pari, lideri heroik, i cili përfaqëson traditën luftarake në shërbimin ushtarak, është mishërimi i shpirtit marcial dhe vlerave e vetive personale luftarake. Së dyti, oficeri menaxher, është ai i cili është më i shqetësuar me aspektet praktike e konkrete të luftimit, si dhe me mënyrat e mobilizimit të burimeve kombëtare për luftë. Ndërsa së treti, oficeri teknologjist/teknolog (*military technologist*, origj.) është ai i cili ka ngjashmëri me oficerin menaxher, por që ka njohuri të gjera teknike dhe nevojë për progres teknologjik të vazhdueshëm në organizimin ushtarak. Moskos gjithashtu ofronte një model tjetër të vetin sipas të cilit profesionalizmi ushtarak bëhej më i dobishëm si për vetë organizatën ushtarake, ashtu edhe për shtetin.

Kritika ndaj Huntington¹, si vepra e parë në llojin e vet, pavarësisht se ka shkaktuar e vijon të ushqejë debatin kritik në sociologjinë ushtarake, gjithsesi, nuk ka prekur konceptet themelore të tij të shtruar në përkufizimin dhe identifikimin e elementeve social-kulturore në profesionin ushtarak. Për efekte të objektit të studimit të kësaj eseje, Huntington (1957, në Heinecken, 1997) përcakton se besnikëria dhe devotshmëria ndaj shërbimit dhe ndaj kombit janë kualitetet më të dëshiruara në individët që rekrutohen për t’u bërë pjesë e trupës ushtarake të oficerëve. Për shkak të funksionit unik të ushtarakut, që është përdorimi i dhunës në mënyrë të organizuar, shoqëria dhe ushtria si organizatë, kërkojnë tek individët që bëhen pjesë e profesionit ushtarak një devotshmëri të lartë ndaj shërbimit. Ushtarakët kërkojnë të demonstrojnë standarde të larta patriotizmi, disipline, kuraje dhe vetëmohimi përgjatë kryerjes së detyrave të tyre, si dhe të demonstrojnë përgjegjësi në përdorimin e aftësive të tyre në interes të shoqërisë. Për këtë arsye dhe rrjedhimisht, konsiderohet e përkundërt me etikën dhe standardet profesionale që ushtarakët profesionistë të organizohen në grupe interesi (sindikata, unione, etj.), për të kërkuar përfitime financiare ose të përdorin aftësitë e tyre kundër shtetit në interes të fuqizimit të ‘establishmentit ushtarak’ (Heinecken, 1997). Përcaktimet bazë që bën Huntington, por edhe sociologët e tjerë pavarësisht kohës së kaluar, janë në thelb të institutit të profesionit ushtarak dhe në ditët e sotme.

Në një periudhë të mëvonshme Dutu, Mostoflei, Sarcinschi (2003, në Macovei, 2014) duke shqyrtuar e studiuar rastin e profesionit ushtarak në Rumani shprehen se “profesionisti ushtarak është një person tejet i kualifikuar, i karakterizuar nga kompetenca, përgjegjësia dhe *esprit de corps*. Ai është një ekspert me njohuri të specializuara dhe aftësi mbi një fushë të gjerë të

¹ Për Huntington, ushtria duhej të punonte si një institucion konservator dhe të zhvillonte vlera profesionale që ishin të njëtrajtshme me misionin tradicional të saj: luftimi dhe fitimi i luftërave për kombin, nën drejtimin e qeverisë dhe legjisllacionit në fuqi. Profesionisti ushtarak nuk duhej të shqetësohej për çështje sociale ose politike, por të fokusohet vetëm në çështje që i takonin menaxhimit dhe zhvillimit të luftërave. Profesionin ushtarak duhej të zhvillohej nga brenda dhe në këtë mënyrë të maksimalizonte efektivitetin dhe suksesin në arritjen e misionit ushtarak. Në këtë mënyrë, sipas Huntington, do të ruhej legjitimiteti dhe kontrolli civil mbi forcat e armatosura dhe profesionin ushtarak do të mbetej një entitet i pastër profesional, korporativ dhe ekspert në drejtimin luftarak. Gjithashtu, pjesëtarët e profesionit do të do të ndryshonin thellësisht nga popullsia për nga vlerat, besimet dhe sjellja.

Për Janowitz, nga ana tjetër, sistemi ushtarak do të duhej të ishte i hapur për të përthithur vlerat e shoqërisë ku vepronte dhe nga e cila, domosdoshmërisht ishte i varur për mbijetesë dhe sukses. Aty ku Huntington e shihte profesionin ushtarak si një sistem të pavarur dhe të lidhur me shoqërinë veç nëpërmjet drejtimit politik, Janowitz e shihte si një sistem dinamik, të ndërvarur, të integruar, të kontrolluar dhe të legjitimuar nëpërmjet aftësisë së tij për t’iu përshatur shoqërisë të cilës i shërben.

aktivitetit njerëzor. Aftësitë e tij vijnë si rezultat i një ekspertize të përshtatshme teorike në institucione të ndryshme të specializuara dhe një përvojë të gjatë në fushën përkatëse”. Macovei, një sociologe rumune, vijon duke argumentuar se kompetenca e profesionistit ushtarak arrihet nëpërmjet ushtrimeve teorike dhe praktike në institucione të specializuara e të plotësuara me përvojën e fituar gjatë ushtrimit të këtij profesioni. Përgjegjësia e profesionistit ushtarak provohet nëpërmjet ushtrimit të përshtatshëm e realizimit të detyrave dhe misionit në nivelin më të lartë të zotëruar të aftësive dhe njohurive të tij. *Esprit de corps* që e karakterizon profesionistin ushtarak është specifik për grupin përkatës profesional (profesioni ushtarak) dhe kërkon një pranim të brendshëm të vlerave si: nderi, besnikëria, besimi, ndershmëria, dinjiteti, krenaria, disiplina, devotshmëria, solidariteti, etj., të gjitha ato vlera që formojnë etosin ushtarak.

Karakteristikat e profesionit ushtarak, të cilat janë të trashëguara e të zhvilluara përgjatë kohës gjenden të shprehura në formën e kërkesave dhe detyrimeve themeltare në dokumentet përkatëse të brendshme ushtarake, të cilat trajtojnë veçantinë e profesionit ushtarak. Një shembull i këtillë është Doktrina referenciale e ushtrisë² amerikane mbi profesionin ushtarak (ADRP-1, 2013) ku shprehet se profesioni ushtarak (në ushtrinë e SHBA) është një vokacion unik i ekspertëve të certifikuar në hartimin, gjenerimin, mbështetjen dhe aplikimin etik të forcës tokësore, e që shërben autoritetin civil dhe që i është besuar mbrojtja e Kushtetutës, dhe e të drejtave dhe interesave të popullit amerikan. ‘Profesionisti i ushtrisë’ është një anëtar i profesionit ushtarak i cili përmbush kriteret e kompetencës, karakterit dhe angazhimit. Karakteristikat kryesore të profesionit ushtarak në ushtri janë: besimi, ekspertiza ushtarake, shërbimi me nder, *esprit de corps*, dhe kujdestaria ndaj profesionit. (Po aty, p. 6-8)

2. Zhvillimi i profesionit ushtarak përgjatë historisë moderne

Zhvillimi i profesionit ushtarak është i pandarë nga zhvillimi i shtetit dhe rrethanave e karakteristikave identifikuese të shtetit në momente të caktuara historike. Traktati i Vestfalisë në 1648, i cili bëri të mundur vendosjen e një paqeje të gjerë në Europë, dhe mundësoi fillimin e krijimit të shteteve-kombe, u bë kësaj dhe shkas për nisjen e zhvillimit të profesionit ushtarak në kuadër të karakteristikës kryesore të tij, që qëndron e vlefshme dhe në ditët e sotme – profesioni ushtarak në shërbim ekskluziv të shtetit dhe interesave të tij.

Një ndarje kohore në vija të gjera e japin Dandeker dhe Watts (në Kuhlman dhe Dandeker, 1991), të cilët evidentojnë tre periudha madhore të zhvillimit të profesionit ushtarak, në raport me zhvillimin e shtetit, të cilat fillojnë nga shekulli i 17-të: periudha e kapitalizmit liberal, periudha e kapitalizmit të organizuar, dhe periudha e kapitalizmit neo-liberal. Sipas tyre kalimi në profesionin ushtarak me karakteristika moderne (ushtritë në shërbim të shteteve përkatëse) u bë i mundur pikërisht nga nënshtrimi i ushtarakëve ndaj një burokracie shtetërore, e cila e shkëputi profesionin ushtarak nga mercenarizmi. Ky kalim u bë gradualisht nga shek. 16-të deri në fund të shek. 19-të, kur industrializimi i shpejtë bëri të mundur shfaqjen e kapitalizmit liberal. Në këtë periudhë, në kapërcimin ndërmjet shek 19-20, profesioni ushtarak u instalua

² Ushtria, në kuptimin e forcës tokësore. Forca të tjera të armatosura në SHBA janë Forca Detare, Forca Ajrore, Forcat Desantuese Marinare (Marines) dhe Roja Bregdetare. Ushtria është forca e armatosur më e vjetër e SHBA, e krijuar që në vitin 1775.

përfundimisht si një përbërës i domosdoshëm dhe u racionalizua në brendësi të sektorit publik.

Në periudhën e kapitalizmit të organizuar, profesioni ushtarak pati një rritje të privilegjeve dhe të rëndësisë për shkak të rolit të ushtrisë në mbështetjen dhe sigurimit të prodhimit në aspektin politiko-ekonomik, por sidomos në garantimin e vijimit të këtij modeli të shtetit (kjo është periudha e dy luftërave Botërore dhe përvijimi i Luftës së Ftohtë).

Në fazën e kapitalizmit neoliberal profesioni ushtarak është bërë pjesë dhe ndikohet nga ndërkombëtarizmi dhe globalizmi, siç ndikohet dhe vetë shteti. Në këtë fazë Dandeker dhe Watts vënë re se profesioni ushtarak fillon të zbehë karakteristikat e tij të natyrës konservatore si pasojë e humbjes së monopolit të ushtrisë në sigurimin e shoqërisë, rritjen dramatike të fuqisë së qeverisë civile kundrejt ushtrisë, rënien e rëndësisë së kulturës ushtarak si pasojë e zbehjes së etikës ushtarake, si dhe zhvlerësimit në rritje të profesionit ushtarak si pasojë e zhvlerësimit të statusit të ushtarakut në tërësi.

Këto periudha gjithsesi kanë një karakter të përgjithshëm dhe trajtojnë profesionin ushtarak në një këndvështrim të gjerë. Në brendësi të tyre ka nën-periudha të shumta në të cilat vërehen re ndryshime të rëndësishme të profesionit ushtarak. Këto nën-periudha jo domosdoshmërisht janë të njëkohshme për ushtri të ndryshme. Për qëllimin e këtij studimi do të merret në studim dhe do të silllet si shembull zhvillimi i profesionit ushtarak në SHBA përgjatë shekullit të 20-të deri në kapërcimin e Luftës së Ftohtë.

Duke shqyrtuar historinë e zhvillimit të profesionit ushtarak në SHBA në kuadrin konceptual të Janowitz, Moten (2011) shprehet se profesioni ushtarak në Amerikë në gjysmën e parë të shek. të 20-të karakterizohet nga konkurrenca midis ushtarakut në trajtën e liderit heroik, me atë në trajtën e oficerit menaxher. Periudha e Luftës së Ftohtë do të ndikonte që në profesionin ushtarak të zhvillohej një model hibrid ushtaraku, diçka e mesme midis liderit heroik dhe atij menaxher. Në vijim, Moten do të arrijë në përfundimin se kjo balancë e arritur, me “shtendosjen” dhe fundin e Luftës së Ftohtë do të sillte zbehjen e liderit heroik, kapërcimin përtej liderit menaxher, dhe do ta kthente modelin e profesionistit ushtarak drejt trajtës së liderit teknologjik. Duke shqyrtuar zhvillimet konkrete historike, rreth zhvillimit të ushtrisë dhe profesionit ushtarak në Amerikë, mund të provohet dhe se qasja konservatore e Huntington mbi modelin e zhvillimit të profesionit ushtarak nuk rezulton e saktë. Sipas Huntington, ushtria amerikane, ose më saktë trupa e oficerëve (Huntington e përzgjedh këtë trupë si etalon për trajtimin e profesionit ushtarak, shën. i autorit) u profesionalizua në gjysmën e dytë të shek. 19-të si pasojë e izolimit nga shoqëria civile. Baucom (1985) e hedh poshtë këtë qasje duke argumentuar se profesionalizmi i ushtrisë amerikane filloi rreth vitit 1820 dhe u përvijua përgjatë gjithë shekullit të 19-të, dhe kjo jo për shkak të izolimit të ushtrisë në garnizone të mëdha e historike jashtë qendrave të banuara por në përputhje me trendet sociale, të cilat inkurajuan profesionalizimin në terma ligjore, akademike dhe mjekësore. Zhvillime të rëndësishme në këtë aspekt vihen re dhe tek forca detare amerikane duke nisur nga viti 1830.

Në fillim të shek. të 20-të, Ushtria, Marina dhe Forcat Desantuese Marinse (US Marines) të SHBA ishin në një nivel profesionalizmi, duke pasur shtabe të përgjithshme në kontroll të ekspertizës në nivelet strategjike dhe operacionale; juridiksione të ndara për ekspertizën në nivel force tokësore dhe force detare; një sistem arsimimi hierarkik, ku ishin të përfshira Kolegjet e

Luftës; rregulla strikte rekrutimi dhe promovimi të mbështetura në vjetërsi dhe meritë; etikë shërbimi e cila vlerësonte nënshtrimin ndaj kontrollit civil; si dhe nën-kultura profesionale të pasura me elementë si uniformat, terminologjinë, sjelljet, dhe traditat përkatëse që e dallonin secilën nën-kulturë nga tjetra, si dhe nga shoqëria civile. Si shembull të profesionalizmit në profesionin ushtarak që ishte arritur si pasojë e ndërveprimit ushtarakë-shoqëri civile Baucom sjell zhdërvjelltësinë e mobilizimit, fitoren e luftërave botërore dhe çmobilizimit të shpejtë ushtarak pas luftërave nga ana e forcave ushtarake amerikane. Ai duke trajtuar periudhën e pasluftës dhe ndikimin në profesionin ushtarak merr rastin e zhvillimit të një nën-kulture, ose nën-profesioni të ri brenda profesionit ushtarak, trupën e nënoficerëve. Në periudhën e pasluftës në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të trupa e nënoficerëve në SHBA mori një rol të rëndësishëm në brendësi të të gjitha forcave ushtarake amerikane dhe jo vetëm u rrit në numër por edhe roli i nënoficerit u fuqizua në mënyrë të rëndësishme në aspektin e ushtrimit të lidërshiptit në brendësi të profesionit ushtarak.

Duke vijuar në kronologjinë historike, fundi i shek. XX dhe përfundimi i Luftës së Ftohtë do të sillte dukuri që do të shënjonin ndryshime domethënëse në sociologjinë e profesionit ushtarak dhe në profesionin ushtarak në vetvete, si: ridimensionimi i ushtrive (sidomos në vendet e Lindjes), kalimi nga një rekrutim i detyruar në rekrutim vullnetar, si dhe rritja e vëmendjes së ushtarakëve ndaj aspekteve të përkujdesjes civile ndaj tyre. Zhbërja e ndarjeve ideologjike Perëndim-Lindje, në fundin e viteve '80 e fillimvitet '90, solli një ndryshim të qenësishëm sidomos në sasinë e fuqisë ushtarake të të gjitha vendeve. Të gjitha vendet, e sidomos ato të Lindjes "politike", në pamundësi për të përballuan koston financiare të mbajtjes së një trupë të madhe ushtarake, por dhe në mungesë të arsyeve ushtarake, ndërmorën reforma të mëdha duke zvogëluar numrin e ushtarakëve aktivë. Në planin e zhvillimit të profesionit ushtarak, tashmë presioni i rritjes së profesionalizmit të ushtarakëve ishte i lartë si asnjëherë më parë. Lilo (2008) duke marrë parasysh zhvillimin e profesionit ushtarak në Shqipëri pas ndryshimeve politike të fillimviteve '90, shprehet se transformimi dhe reformimi i FARSH në fillimvitet '90 e zvogëloi forcën ushtarake, pasi tashmë nevojitej një trupë e vogël oficerësh të mirëtrajnuar, të përshtatshëm me kërkesat e kohës dhe fleksibël. Edukimi i tyre mori një rëndësi të madhe pasi jo vetëm do i aftësonte për marrjen e detyrës së parë, në rastin e oficerëve të sapodalë nga akademitë e formimit por edhe për t'i mësuar atyre të jenë fleksibël ose lehtësisht të përshtatshëm në përballimin e situatave të ndryshme, karakteristikë e mjedisit modern operacional.

Ndryshimi i mënyrave se si qytetarët lidhen me profesionin ushtarak të nivelit bazë - pra shërbimin në nivel trupe, në mënyrë të detyrueshme ose në bazë të vullnetit të lirë, ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e profesionit ushtarak në tërësi në këtë periudhë. Eksperienca e një vendi fqinj me Shqipërinë është e vlefshme për t'u përmendur në këtë ese. Duke studiuar rastin e Rumanisë, pas heqjes së shërbimit të detyruar ushtarak (e kryer në vitin 2007) dhe kalimit në shërbim ushtarak vullnetar, Dutu (2007, në Macovei, 2014) sjell disa aspekte të ndikimit të këtij ndryshimi sipas niveleve të ndryshme të organizmit të Forcave të Armatosura rumune:

- Në nivelin institucional, të gjitha aspektet rreth burimeve njerëzore ndryshuan (rekrutimi, menaxhimi i karrieres, ruajtja e ekspertizës, etj.)
- Në nivelin organizativ, karakteristikat themelore të njësisve ushtarake dhe organizimi

i mbrojtjes së territorit kombëtar ndryshoi dhe tashmë vëmendja u përqendrua në modularitetin e njësive ushtarake, fleksibilitetin dhe ndërveprueshmërinë e tyre.

- Në nivelin identitar, në karakteristikat e profesionit ushtarak, natyra dhe misioni i ushtrisë, si dhe vendi që ajo mbante në shtetin rumun u ripërcaktua. Krahas misionit historik (ruajtja e sovranitetit, pavarësisë, unitetit dhe integritetit të territorit shtetëror dhe të qytetarëve) u shtuan dhe misione të reja, misionet paqeruajtëse, misionet kundër terrorizmit ndërkombëtar, misionet në kuadër të organizatave ndërkombëtare, etj.
- Në nivelin operacional, pjesëmarrja e gjerë në misione ndërkombëtare si dhe realizimi i detyrave tradicionale në mënyrë të njëkohshme, solli një rritje të operacionalitetit të forcave ushtarake.

Duka marrë parasysh këto zhvillime, Macovei (2014) shton se ushtria rumune ndërmori fushata të shumta reformuese të cilat ishin të vështira dhe delikate, të cilat zhvilloheshin në kushtet e mungesave të theksuara buxhetore si dhe nën presionin e madh të brendshëm kundër ndryshimeve, sidomos në fillimin e ndryshimit.

Ndryshimet e fundshekullit të 20-të e të fillim-shekullit të 21-të, vetvetiu, qoftë prej rritjes së konkurrencës profesionale, por dhe trendeve të përbashkimit të elementëve ushtarakë me ato civilë, sollën dhe tronditjen e disa aspekteve konservatore të profesionit ushtarak, siç janë motivimi e devotshmëria ndaj shërbimit, të cilat janë zbehur tashmë. Zbehja e motivimit të devotshmërisë ndaj shërbimit dhe rritja e vëmendjes ndaj elementëve të “punësimit” siç janë: rroga, siguria e punësimit, kushtet e përgjithshme të punës, etj. është vënë re në trupën e oficerëve që në vitet ‘70 të shekullit të shkuar (Segal dhe Lengermann 1980, në Heinecken, 1997). Moskos (1986, në Heinecken, 1997) e shpreh këtë ndryshim nëpërmjet dallimit të legjitimitetit të “vlerave të tregut” kundrejt vlerave “normative” nga ana e ushtarakëve të kohës. (në vitet 70-80 të shek. të 20-të). Të njëjtat karakteristika vihen re dhe nga Heinecken në vitet ‘90 në rastin e kandidatëve për oficerë në Afrikën e Jugut, dhe Heinecken e shpreh këtë ndryshim duke klasifikuar në ‘profesionistë ushtarakë’ dhe në ‘profesionistë me uniformë’.

3. Faktorë përcaktues të trendeve të zhvillimit të profesionit ushtarak dhe sfidat aktuale

Profesioni ushtarak dhe profesionistët ushtarakë janë elementë përbërës të shtetit, i cili është organizimi më i lartë e më kompleks shoqëror njerëzor. Kësisoj trendet e zhvillimit të profesionit ushtarak do të ndjekin në një vijë të gjerë zhvillimin e shtetit. Gjithsesi, disa faktorë për ndryshim kanë një efekt më të madh transformues te profesioni ushtarak se tek të tjerë. Heinecken (1997) përzgjedh si faktorë ndikues në zhvillimin e profesionit ushtarak mungesën e kërcënimeve të qarta ndaj shtetit dhe shoqërisë së tij si dhe perceptimin³ popullor ndaj tyre; kalimin nga shërbimi ushtarak i detyruar te shërbimi vullnetar; ndryshimin e profilit

³ Perceptimi i kërcënimit nga qytetarët e BE, si metrikë, nuk u përfshi në sondazhet e zhvilluara nga EuroBarometer (seri sondazhesh të zhvilluara nga Komisioni Evropian që nga viti 1973 e që vijojnë dhe aktualisht, ku qytetarët e vendeve të BE pyeten për aspekte me tematikë të gjerë) nga viti 1989 në vitin 2002. Përfshirja e kësaj metrike u bë vetëm si pasojë e sulmeve terroriste në vitin 2001.

të kandidatëve për oficerë (heqja e kufizimeve klasore për kandidatët për oficerë dhe hapja e konkurseve gjithëpërfshirëse); reduktimin e numrit të ushtarakëve; ndryshimet në benefite ekonomike e sociale të ushtarakëve në krahasim me sektorin civil. Sipas Battistelli-t (në Kuhlman dhe Dandeker, 1991), profesioni ushtarak përballet me katër dilema kundërshtuese në raport midis tyre: centralizimin/ decentralizimin; integrimin/ diferencimin; konservatorizmin/ inovacionin; dhe, formalizimin/ informalizimin. Snider (2008) duke trajtuar rastin e SHBA, përzgjedh katër faktorë përcaktues për formësimin e rolit të ushtarakëve: shoqërinë, klimën botërore, teknologjinë dhe sfidat profesionale të vetë profesionit ushtarak. Në të njëjtin mjedis, Box (2012) futet më në thellësi dhe shqyrton fenomenin e liderit “toksik” që ai e përkufizon si “lider që manifeston sjellje destruktive dhe shfaq karakteristika personale jofunksionale, të cilat dëmtojnë profesionistët nëpërmjet helmimit të entuziazmit, kreativitetit, autonomisë dhe shprehjes së inovacionit.”

Rëndësia e lidërshiptit brenda profesionit ushtarak është themeltare dhe prania e liderëve toksikë shkatërron besimin tek institucionet ushtarake si dhe i dëmton ato, prandaj dhe ky fenomen, i cili gjendet i pranishëm në masë të papërcaktuar në organizmat ushtarakë, është një nga faktorët me ndikim në profesionin ushtarak, sidomos kur liderë të tillë gjenden të vendosur në katet e sipërme të hierarkisë ushtarake. Bolin (2008) duke shqyrtuar rastin e profesionit ushtarak në Suedi, përmend faktorë si: zhvillimet në politikën ndërkombëtare, duke filluar nga fundi i Luftës së Ftohtë; evolucioni teknologjik; reduktimet e gjithanshme në Forcat e Armatosura dhe tendenca për uljen e shpenzimeve për mbrojtjen; zgjerimi i juridiksionit të veprimit të forcave ushtarake, që në rastin e Forcave të Armatosura suedeze ka ndjekur tre drejtime: në zgjerimin e përgjegjësisë të ushtarakëve me rol jo vetëm në kohë luftë por edhe në kohë paqeje, me zgjerimin e territorit të veprimit të tyre duke dalë jashtë territorit shtetëror suedez, si dhe me zgjerimin e objektit të veprimit të forcave të armatosura jo vetëm në terrenin gjeografik dhe kundër një agresori shtetëror por në mjedise të ndryshme duke përfshirë terrorizmin dhe veprimin kundër aktorëve të ndryshëm joushtarakë e joshtetërorë. Sipas Caforio (2008) arsyt kryesore të ndryshimeve në profesionin ushtarak nga vitet ‘90 ishin: angazhimi gjithnjë e më rritje i ushtarakëve në operacione të ndryshme nga ato luftarake, pjesëmarrja në operacione gjithnjë e më shumë me karakter ndërkombëtar, si dhe marrja e roleve diplomatike nga ushtarakët që merrnin pjesë në këto misione. Ndërsa Winslow (2010), një sociologe e njohur sidomos në fushën e sociologjisë së gjinive në profesionin ushtarak, evidenton dhe studion rolin e femrave në profesion, duke e përfshirë dhe pjesëmarrjen gjithnjë e më aktive të femrave në profesionin ushtarak pa asnjë kufizim, si një nga faktorët e zhvillimit të profesionit ushtarak. Bolin (2008), duke identifikuar trendin në rritje të angazhimit të femrës në profesionin ushtarak, gjithashtu mbështet argumentin se prania e seksit femër në profesionin ushtarak është jo vetëm një e drejtë njerëzore që nuk ka përse t’u mohohet femrave, por edhe pasi zhvillimet kanë treguar se Forcat e Armatosura kanë nevojë për ekspertizën femërore, dhe në përgjithësi kanë më shumë nevojë për aftësitë intelektuale e sociale se sa për muskuj.

Duke pasur parasysh këta faktorë, është e qartë se profesioni ushtarak në ditët e sotme përballet me sfida të rëndësishme të cilat në hapësira të ndryshme sipas shteteve dhe Forcave të Armatosura të tyre shfaqen me peshë dhe efekte të personalizuar. Në rastin rumun, Macovei

(2014) ndër sfidat e profesionit ushtarak dhe komunitetit profesionist ushtarak rendit rënie e nivelit të konkurrueshmërisë së profesionit ushtarak në përballjen me profesionet civile, në tregun e punës. Një sfidë tjetër për ushtrinë gjithashtu është dhe ruajtja e ushtarakëve, e sidomos të oficerëve të cilët janë në kufijtë e periudhave të skadimit të kontratave të shërbimit. Macovei sugjeron se autoritetet vendimmarrëse duhet të marrin parasysh se profesioni ushtarak gjithnjë e më tepër zhvillohet në kushtet e ekonomisë së tregut dhe pavarësisht aspekteve ekonomike, organizatat ushtarake, jo vetëm duhet të angazhohen në sigurimin e pagave konkurruese, ofrimin e karrierave të qarta dhe motivuese, si dhe ofrimin e mundësive për kualifikim civil për ushtarakët pas daljes nga shërbimi, por duhen të veprojnë edhe në kuadër të zvogëlimit të presionit psikologjik ndaj të cilit nënshtrohen ushtarakët, të cilët janë të vetëdijshëm se megjithëse kanë një shkallë shumë më të lartë specializimi se punonjësit në sektorin civil, ata paguhën më pak. Për këtë qëllim Macovei sugjeron se organizatat ushtarake duhet të kundërveprojnë duke marrë masa për të rritur kohezionin, përmirësimin e komunikimit brenda grupit, si dhe përmirësimin e situatës psiko-sociale të ushtarakëve. Në përfundime të ngjashme arrin dhe Heinecken (2008) e cila mbështet pohimin se angazhimi i një individi kundrejt një organizate varet nga shkalla e plotësimin të ndërsjellë të nevojave të të dyja entiteteve. Kjo e vendos organizatën ushtarake në një situatë sfiduese pasi ajo kërkon nga anëtarët e saj (ushtarakët) një angazhim shumë më të lartë se sa mund të kërkojnë organizatat civile nga punonjësit e tyre, ndërkohë që këto të fundit në të shumtën e rasteve ofrojnë dhe benefite më të mëdha. Heinecken duke studiuar motivimin për të përqaftuar profesionin ushtarak të kandidatëve për oficerë në Akademinë Ushtarake të Afrikës së Jugut vërejt se është në rritje tendenca për karakterizimin e profesionit ushtarak si një punë të zakonshme, dhe zbehjen e motivit të devotshmërisë ndaj shërbimit që implikon profesioni ushtarak. Heinecken arsyeton se kjo tendencë vjen si pasojë e rënies së statusit të profesionit ushtarak në shoqëri, si dhe presionit të madh që rrjedh nga ndryshimet e vazhdueshme organizative, dhe që ushtrohet ndaj ushtarakëve.

Një sfidë e rëndësishme për profesionin ushtarak në kushtet aktuale kombëtare e botërore është dhe arsimimi dhe edukimi i tyre. Bolin (2008), në ndjekje të vijës së mendimit të Janowitz thekson se një sistem edukimi i përshtatshëm me kërkesat e kohës dhe në përputhje me sfidat profesionit mund të jetë i tillë veçse nëse është i integruar me edukimin civil.

Duke marrë parasysh trendet e zhvillimit të profesionit ushtarak dhe sfidat me të cilat përballet ky profesion në kohërat e sotme, është tejet e rëndësishme që organet shtetërore civile të vetëdijësohen për efektet që shkakton vendimmarrja dhe kontrolli i tyre mbi profesionin ushtarak me veprimet por dhe mosveprimet e tyre. Profesionisti ushtarak, tashmë nuk është një vegël në trajtën e një çekiçi të rëndë që mund të shkaktojë dyer të trasha, por një çelës i sofistikuar që me lëvizje dhe vendosmërinë e duhur mund të hapë me lehtësi çdo derë bllokuese, dhe aq më pak profesionisti ushtarak nuk është më një ëndërrimtar apo aventurier romantik i drejtuar nga dëshira për lavdi e dekorata në ekspedita ekzotike, por një “përbindësh” i mirë e social, me aftësi intelektuale të nivelit akademik, i prirur drejt automatizimit e teknologjisë, i ndjeshëm ndaj mungesave në mirëqenien personale e familjare, por dhe ndaj klimës profesionale të përditshme.

Profesionisti ushtarak është sidomos një kërkues i paepur i përmirësimin e zhvillimit të

vazhdueshëm të profesionit për të cilin ai është i vetëdijshëm për sakrificat që e shoqërojnë në çdo hap.

4. Sfidat ndaj profesionit ushtarak në Shqipëri: nevoja emergjente për njohjen e karakteristikave të profesionit ushtarak dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij

Studimet e mirëfillta sociologjike rreth profesionit ushtarak në Shqipëri janë të mangëta, e sidomos studimet përsa i përket periudhës së pasviteve '90-të kur Forcat e Armatosura të vendit i janë nënshtuar ndryshimeve thelbësore. Trajtesat rreth profesionit ushtarak në vendin tonë për këtë periudhë kanë karakter përshkrues e historiografik, se sa karakter analitik sociologjik, nëpërmjet të cilit do të kishte qenë e mundur të shpjegoheshin elementët e karakteristikat në ndryshim të profesionit ushtarak por dhe ngjarjet më të rëndësishme të cilat kanë ndikuar marrëdhëniet ndërmjet institucioneve ushtarake dhe atyre civile, por dhe marrëdhëniet ndërmjet profesionistëve ushtarakë e atyre civile, ose ndërmjet vetë ushtarakëve. Në mënyrë empirike mund të evidentohen një sërë ngjarjesh e tematikash të cilat mund të trajtohen më interes në kuadër të zhvillimit të studimeve sociologjike por dhe vetë sociologjisë së profesionit ushtarak në Shqipëri duke nisur që nga krijimi i ushtrisë shqiptare në 4 dhjetorin e vitit 1912 e deri në periudhën bashkëkohore:

- Pavarësia e vendit dhe përvoja luftarake e popullsisë shqiptare në formësimin dhe institucionalizimin e ushtrisë përgjatë viteve të para të pavarësisë.
- Prania dhe ndikimet e këshilltarëve të huaj në formësimin e karakteristikave të profesionit ushtarak në Shqipëri.
- Ndryshimet në qeverisje, dhe ndikimi i përpjekjeve të brendshme politike në vend përgjatë periudhës midis dy luftërave botërore.
- Prania italiane dhe ndikimi i marrëdhënies Shqipëri-Itali përgjatë qeverisjes së Ahmet Zogut.
- Roli i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në ri-organizimin ushtarak të vendit pas Luftës së Dytë botërore, në aspektin e organizimit dhe institucionalizimit ushtarak.
- Ndikimi i aleatëve lindorë përgjatë periudhës së regjimit komunist, e sidomos në planet e formësimin akademik e profesional të ushtarakëve të kohës, prania e traditave dhe zhvillimi i nën-kulturave për shkak të rritjes drastike të kapaciteteve dhe aftësive luftarake në krahasim me periudhat e mëparshme, si dhe elementët demografike e kulturorë të ushtarakëve të kohës.
- Ndikimi i ndryshimeve politike në fillimvitet '90-të në Shqipëri dhe i reformave ushtarake që i pasuan, ku spikasin shkurtimet e mëdha në personel dhe pajisje.
- Ndikimi i ngjarjeve të vitit 1997 aspektin e motivimit dhe disiplinës ushtarake.
- Anëtarësimi në organizmat ndërkombëtarë, e sidomos në NATO, dhe roli i aleatëve perëndimorë në reformimin e ushtrisë shqiptare.
- Ndryshimet e strategjive kombëtare të sigurisë dhe ndikimi në profesionin ushtarak;
- Heqja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe kalimi në ushtri profesioniste.
- Ndikimi i ndryshimeve të shpeshta të praktikës e metodave të arsimit themelor të oficerëve.

Në një aspekt tjetër më pak kronografik, është e domosdoshme kërkimi dhe studimi sociologjik i çështjeve dhe faktorëve të mëposhtëm:

- Ndikimet krahinore dhe rajonale në profesionin ushtarak ose nën-kulturat e tij.
- Roli i gruas në profesionin ushtarak.
- Niveli kulturor dhe arsimor të ushtarakëve të shqyrtuar në mënyrë krahasimtare në periudha kohore dhe sipas llojeve të trupës (oficer, nënoficer, ushtar).
- Ndikimi i shërbimeve jashtë vendit në operacione paqeruajtëse.
- Ndikimi i ushtarakëve shqiptarë të formuar jashtë vendit.
- Përkujdesja sociale e familjes së ushtarakut dhe ndikimi i kushteve ekonomiko-sociale të ushtarakëve në profesionin e tyre.
- Faktorët e motivimit/demotivimit të profesionistëve ushtarakë.
- Niveli i homogjeneizimit të trupës së oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve.
- Ndryshimet në planin e botëkuptimit mbi profesionin ushtarak midis profesionistëve ushtarakë të formuar/titulluar në periudhën përpara viteve '90, pas viteve '90, por përpara anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe atyre pas anëtarësimit, si dhe elementët e "përplasjes".
- Roli i kontrollit civil e demokratik mbi Forcat e Armatosura dhe ndikimi në profesionin ushtarak.
- Ndikimet e papërshtatshme politike, elementët e kriminalizimit dhe nepotizmit.

Studimi dhe shtjellimi i çështjeve të mësipërme ka rëndësi themelore për njohjen e profesionit dhe profesionistëve ushtarak në Shqipëri dhe do të lejonte krijimin e një baze të shëndoshë dijesh për zhvillimin e mëtejshëm, jo vetëm të studimeve sociologjike ushtarake, por dhe në zhvillimin tërësor të profesionit e profesionistëve ushtarakë shqiptarë. Një ushtri dhe një trupë ushtarakësh që njih vetveten, zhvillimet, karakteristikat pozitive, por sidomos problemet që qëndrojnë në bazë të profesionit ushtarak, është një ushtri që zhvillohet në mënyrë të shëndetshme e të qëndrueshme.

Bibliografia:

- Army Doctrine Reference Publication, (2013) 1-The Army Profession, HQ, Department of the Army Washington DC, <http://data.cape.army.mil/web/repository/doctrine/adrp1.pdf>
- Baucom, Donald R., (1985) *The professional Soldier and the Warrior Spirit*. Strategic Review, <http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/au-24/baucom.pdf>
- Bazo, Jeronim, (2006) *Shaping the future – A new profile of the Albanian Military Officer*. USAWC, Carlisle Barracks, Pennsylvania, <http://www.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a449425.pdf>
- Bolin, Anna (2008) *The military profession in change – the case of Sweden*. Lund Political Studies, Nr. 151, <https://lup.lub.lu.se/search/publication/53eef419-d5e1-410d-84f2-3f0104340e7d>
- Box, John E., (2012) *Toxic leadership in the Military profession*. US Army War College, Carlisle Barracks, Pennsylvania, http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/army-usawc/box_toxic_leadership.pdf
- Caforio, Giuseppe, (2008) "The military profession, public trust, and public interest" Connections, The Quarterly Journal, Fall Edition, <http://davidpublishing.academia.edu/giuseppecaforio>
- Qazimi, Pëllumb, (2013) *Histori e ushtrisë shqiptare : 1912-1991 : studim monografik*, Tiranë, Naimi,

- Heinecken, Lindy (1997) *Stress and Change in the Military Profession: Attitudes of Officer Students at the South African Military Academy*, Scientia Militaria, South African Journal of Military Studies 1997:27, <https://core.ac.uk/download/pdf/37351420.pdf>
- Huntington, Samuel (1957) *The Soldier and the State* Cambridge, MA: Harvard University Press
- Janowitz, Morris (1960) *The Professional Soldier: A Social and Political Portrait*, New York, Free Press
- Kuhlmann, Jurgen and Dandeker Christopher, eds. (1991) *Stress and change in the military profession of today*, Munchen, <https://core.ac.uk/download/pdf/37351420.pdf>
- Lilo, Ardian (2008) *Officer candidates education and training in the AAF*, US Army Command and General Staff College, Fort Leavenworth, Kansas, <http://www.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a502166.pdf>
- Macovei, Crenguta Mihaela, (2014), “*Factors that influence the commitment of military students to profession*”, Romanian Land Forces Academy, <http://www.uav.ro/jour/index.php/app/article/view/417>
- Moskos Jr., Charles C. (1977) *The All-Volunteer Military: Calling, Profession, or Occupation?*, Parameters, http://ssi.armywarcollege.edu/pubs/parameters/Articles/2010winter/Moskos_Jr.pdf
- Moten, Matthew, (2011) *Who is a member of the military profession?* JFQ 62:3:2011, <http://www.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a546558.pdf>
- Snider, Don M. (2008) *Dissent and strategic leadership of the military professions*. Strategic Studies Institute, US Army War College, Carlisle Barracks, Pennsylvania, https://www.globalsecurity.org/military/library/report/2008/ssi_snider.pdf
- Winslow, Donna (2010) *Gender and military sociology* Swedish National Defence College, Stockholm, <http://www.worldcat.org/title/gender-and-military-sociology/oclc/878431400>

RUBRIKA E TRETË

Studime historike

Kjo rubrikë sjell në vëmendje të lexuesve shkrime historike me vlera aktuale dhe të trajtuara në një këndvështrim të ri. Autori Dr. Zaho Golemi me shkrimin “*Siguria në hapat e para të shtetit shqiptar*”, nëpërmjet fakteve dhe dokumenteve të autorëve të ndryshëm, na sjell në kujtesë dy ngjarjet më të mëdha historike shqiptare, duke e vënë theksin te çështja e sigurisë kombëtare: pavarësia e parë e vitit 1912 në Vlorë dhe pavarësia e dytë e 1920-ës në Lushnjë.

Siguria kombëtare dhe shqetësimi për ruajtjen e pavarësisë e ka shoqëruar intelektualizmin shqiptar në prag, përgjatë dhe pas ngritjes së flamurit në Vlorë më 1912. Elita intelektuale shqiptare e dinte se ndërtimi i shtetit lidhej me pavarësinë e vonuar, ekzistencën kombëtare, integritetin territorial, sovranitetin dhe sigurinë e qytetarëve. Me kongresin e Lushnjës më 1920 u vunë themelet e shtetit modern shqiptar, duke u fokusuar në mbrojtjen e tërësisë territoriale, rimëkëmbjen e shtetit dhe sigurimin përfundimtar të pavarësisë së vërtetë të shtetit.

Një risi në këtë rubrikë vjen nga autori Dr. Albert Hitoaliaj me shkrimin “*Analizë strategjike: plani italian i pushtimit të Shqipërisë më 1919 dhe situata e brendshme shqiptare*”. Dokumentacioni i riprodhuar në këtë material është përzgjedhur nga Arkivi i Zyrës Historike, të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë italiane. Kjo analizë ushtarake e strategjike e vitit 1919 hedh dritë më shumë mbi ngjarjet që ndodhën më pas: Lufta e Vlorës së 1920-s dhe vendimi i 9 nëntorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris, i cili konfirmoi edhe një herë pavarësinë e shtetit shqiptar dhe kufijtë e tij.

Në thelb, gjeografia shqiptare ishte shkaku kryesor që prodhoi Luftën e Vlorës dhe kërcënimin kryesor për ndryshimin e kufijve e të statusit të Shqipërisë. Kjo gjeografi e ka rrënjën e ndikimit qysh në antikitet dhe do të vijojë që ta ketë edhe në të ardhmen, sepse Vlora do të vijojë të jetë epiqendra e fuqisë kombëtare shqiptare dhe një prej porteve më të vlefshme të Mesdheut, i shoqëruar me Sazanin strategjik dhe prapatokën që shërben si mbështetje për fuqinë detare. Këtë gjë sjell edhe ky dokument strategjik, të cilin autori e sjell në faqet e “Revista Ushtarake” me rastin e 100-vjetorit të vendimit të 1921-shit.

SIGURIA NË HAPAT E PARA TË SHTETIT SHQIPTAR

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi
Shefi i Sektorit të Kërkimit Shkencor
Akademia e Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Shqipëria ishte shteti i fundit në Ballkan që fitoi pavarësinë më 1912. Por pa mbushur dy vjet shpërtheu Lufta Ballkanike e më tej Lufta e Parë Botërore. Vendi u gjend në udhëkryq, i cili pa u konsoliduar si shtet, u pushtua nga lakmitë e fqinjëve dhe e Fuqive të Mëdha. Shqiptarët do të duhet të rizgoheshin, pse jo edhe ta rifitonin sërish pavarësinë për herë të dytë, në kushte e rrethana të reja, pas një lufte të madhe të gjatë e të përgjakshme. Elita intelektuale shqiptare orientoi parësinë drejt një kuvendi mbarëkombëtar, këtë herë jo në Vlorë por në Lushnjë, në “kërthizë” të vendit. Në rrugëtimin historik të ngritjes së shtetit, Kongresi i Lushnjës ishte ngjarje madhore, që krijoi organizma të rinj të sigurisë dhe mbrojtjes, Komandës së Përgjithshme Ushtarake, Ministrisë së Luftës, Shtabit Madhuer e Komandës së Xhandarmërisë, ndërkohë që funksionet e Komandës së Përgjithshme Ushtarake i kryente “Këshilli i Naltë i Shtetit”.

Në Lushnjë u konceptua dhe u zgjidh çështja e Sigurisë e Mbrojtjes shqiptare, u krijuan organizmat e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Komanda e Përgjithshme dhe Komanda e Xhandarmërisë, që ishin organet kyç të sigurisë në vend. Lushnja u kthye në truallin e sigurisë sepse kuvendi i saj ishte dhe mbeti përjetësisht kongresi i shpëtimit të kombit, duke qëndruar me dinjitet krahas Lidhjes së Prizrenit të 1878-ës dhe shpalljes së Pavarësisë në 1912. Kongresi i Lushnjës dhe Lufta kombëtare e Vlorës janë dy ngjarje madhore të 1920-ës që konsiderohen Pavarësia e dytë e Shqipërisë. Mbrojtja dhe siguria kombëtare ishte sfida më e rëndësishme e shekullit ku vendosej e ardhmja e vendit.

Siguria e hapësirës territoriale kishte dalë në plan emergjent. Qysh prej pavarësisë së parë

të 1912-ës deri në pavarësinë e dytë të 1920-ës, vendi kishte kaluar një kalvar sakrificash ku dhe vetë pavarësia ishte vënë në rrezik. Me kongresin e Lushnjës u vunë themelet e shtetit modern shqiptar, duke u fokusuar në mbrojtjen e tërësisë territoriale, rimëkëmbjen e shtetit dhe sigurimin përfundimtar të pavarësisë së vërtetë të shtetit, përmes një akti kushtetues për pavarësinë e plotë si dhe zgjodhi këshillin e lartë të shtetit/Regjencën. “Këshilli i Naltë”, me atributë të kryetarit të shtetit dhe të Komandës së Përgjithshme Ushtarake, solli vlerë dhe garanci sigurie për vijimësinë e shtetit që kishte vuajtur peshën e thundrës së rëndë të tetë ushtrive me 250 mijë ushtarë pushtues. Asnjë rrethanë e LIB nuk mundi ta fshijë Shqipërinë nga harta e historisë së Evropës.

Atdhetarët, intelektualët, kuvendarët morën dhe mbajtën në supet e tyre vendime historike, që brenda një kohe të shkurtër e shndërruan në një Shqipëri të lirë, me Tiranën kryeqytet si dhe anëtare të Lidhjes së Kombeve. Në këtë periudhë në kujtesën e kombit shqiptar është gdhendur shprehja e Presidentit Woodrow Wilson (1856-1924), mik i përhershëm i shqiptarëve, që thoshte “një votë kam dhe atë do t’ia jap Shqipërisë”. Por shqiptarët pas Kuvendit të Lushnjës, pa mbushur gjashtë muaj, zhvilluan një ndër luftërat më fitimtare dhe të parën pas pavarësisë që u shkrua në kujtesë të kombeve si Lufta kombëtare e Vlorës. Kjo fitore në Vlorë më 3 shtator 1920 ishte pavarësi e vërtetë e shtetit, ishte siguri dhe epope e shkruar e mbrojtur me gjak. Vlora u bë sërish fati kombëtar i shqiptarëve, që ndryshe nga diplomacia e 1912-tës, liria, pavarësia dhe siguria e shtetit shqiptar u dekretova dhe u nënshkrua me gjakun e dëshmorëve, si dëshmi dhe tipar i një popull lirishtës, luftarak, “kastës luftëtare me armë në dorë”, që e kishin dhe e kanë ndjenjën e fortë kombëtare të mishëruar ndër shekuj, që dinë jo vetëm “të konsumojnë siguri”, por edhe të prodhojnë siguri e vlera.

Fjalë kyçe: pushtim, luftë, kongres, kapitullim, çlirim, fitore, besëlidhje, delegatë, vendime, komb, kthesë historike, kryeqytet, siguri kombëtare, mbrojtje kombëtare, koncept

1. Hyrje

Siguria kombëtare dhe shqetësimi për ruajtjen e pavarësisë në plan të brendshëm e të jashtëm e ka shoqëruar intelektualizmin shqiptar në prag, përgjatë dhe pas ngritjes së flamurit në Vlorë më 1912. Koncepti “siguri” ishte prioriteti në plan të përgjithshëm, pasi e dinin se ndërtimi i shtetit lidhej me pavarësinë e vonuar, ekzistencën kombëtare, integritetin territorial, sovranitetin, sigurinë e qytetarëve, sigurinë e brendshme e të jashtme. Bashkëshoqëruesit e babait të kombit, Ismail Qemalit, dinin me hollësi strukturën e ndërtimit juridik, publik e social, ndërkohë që, për sigurinë e pavarësinë, u investuan në të katër vilajetet ku ndërgjegjja kombëtare kishte në zemër pavarësinë. Teorikisht dhe praktikisht nuk mund të ndanin trinomin: mëvetësi - integritet territorial – siguri, me qëllim që të hidheshin hapat e mëtejshëm të ndërtimit të shtetit shqiptar.

Shqiptarët u vetëshpallën të pavarur nga 83 delegatët e gjithë trevave shqiptare ku mbizotëronte pasiguria. Sali Xhuka¹ bëri vërtetimin e mandateve të delegatëve, nga 83 delegatë të zgjedhur, 43 prej tyre kishin arritur në kohë dhe ndodheshin në sallën e madhe në shtëpinë e Xhemil Bej Vlorës, ku u lexuan telegramet e disa qyteteve të rrethuara, si: Korça e Shkodra, që në pamundësi të dërgonin delegatë, kishin mandatuar të flisnin dhe të vendosnin në emër të tyre disa nga delegatët që ishin aty. Ismail Qemali u zgjodh njëzëri Kryetar i Kuvendit. Dhimitër Zografi shkruan: “U ngrit Ismail Qemali dhe si përshkrojtë humbjen e Turqisë dhe të vojturat dhe gjendjen e Shqipërisë mbi rrezikun e madh që ndodhet atdheu ynë, tjetër shpëtim, tha, s’ka përveç se të ngrehim flamurin e Shqipërisë dhe të kasnecojmë vetëqeverimin”. Në fund ai propozoi: “Të bëhet Shqipëria më vehte, nën një qeveri të përkohshme; të zgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontroll të qeverisë; të dërgohet një komision në Europë për të mprojtun çashtjen shqiptare përpara mbretërive të mbëdha”. Historiografia shqiptare njihë Luigj Gurakuqin si shkruajtës i parë për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes, që me (pa)dashje, shërbeu edhe si deklaratë e pavarësisë. “Pas fjalëve që tha Ismail Qemali beu, me të cilat tregoi rrezikun e madh në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët në një za, vendosën që Shqipëria të bëhet më vete, e lirë dhe e mosvarme!”

¹ Sali Gjokë Dukagjini është një nga veprimtarët e shquar të arsimit dhe të kulturës kombëtare, përfaqësues nga Kosova dhe delegat i Pejës, Gjakovës, Plavës e Gucisë, i cili mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë.

Pavarësia u shoqërua nga flamuri, si shenjë e simbolikës së identitetit² dhe deklaratës së 40 firmëtarëve. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Asambleja e Vlorës formoi qeverinë e parë shqiptare të drejtuar nga Ismail Qemali.

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë ishte problemi themelor i kohës, ndërkohë që përcaktimi i kufijve të Shqipërisë u bë nga Konferenca e Ambasadorëve. Gjashtë fuqitë e mëdha ngritën Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, të themeluar më 15 tetor 1913, në bazë të vendimeve të Gjashtë Fuqive të Mëdha, më 29 korrik 1913, sipas Traktatit të Londrës. Qëllimi i komisionit ishte “të kujdesej” për qeverisjen e Shqipërisë së brishtë të sapokrijuar, deri sa institucionet e saj politike të merrnin formë. Shpallja e Pavarësisë shqiptare sovrane nga Perandoria Osmane, nën mbikëqyrjen e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe lënia e gjysmës së territoreve të shtetit të porsaformuar jashtë kufijve të tij administrativë, për shkak se kombi shqiptar ishte i rrezikuar nga fqinjët për vlerën e madhe gjeostrategjike. Shqiptarët ishin po aq të interesuar sa edhe popujt e tjerë të shtypur të Ballkanit për t’u çliruar nga sulltanati osman. Përfaqësuesit e tyre bënë përpjekje për t’u lidhur me fqinjët në luftën e përbashkët, por këto përpjekje dështuan për faj të krerëve të Aleancës Ballkanike, të cilët nuk dëshironin t’i kishin shqiptarët si palë me të drejta të barabarta në këtë aleancë, sepse ishin marrë vesh ndërmjet tyre për copëtimin e Shqipërisë. Për këtë arsye, shqiptarët nuk hynë në një aleancë, pa u njohur zyrtarisht më parë me të drejtat e tyre; një qëndrim i mençur i elitës shqiptare të kohës.

2. Fatet e njerëzve të pavarësisë që shkruan historinë dhe sigurinë e kombit

Përpjekjet e shqiptarëve për liri e pavarësi kombëtare kanë vazhduar gjatë gjithë periudhës së sundimit të gjatë osman. Historia ka pasqyruar shumë ngjarje që e dëshmojnë këtë, duke filluar me kuvendet e famshme ndërkrahinore shqiptare apo me kuvendet ndërbalkanike të shekujve XV-XVI. Por shekulli i fundit i sundimit osman, në historiografinë zyrtare shqiptare shënon ngjarjen më madhore historike, dëshmon përpjekjet dhe dëshirën e shqiptarëve për t’u bërë sikurse shtetet fqinj, të lirë dhe të pavarur. Në sa e sa kuvende dhe oda burrash në të gjithë hapësirën shqiptare e donin “Shqipërinë të lirë dhe të mosvarme” dhe se “do të luftonin deri në pikën e fundit të gjakut derisa edhe ushtari i fundit pushtues të largohet nga hapësira shqiptare”. Historia e sigurisë së shqiptarëve përtej vitit kulmor 1912 dhe pas tij është mbushur me gjak, mund e sakrificë, aq sa ka merituar vëmendjen e njerëzve intelektualë të botës së civilizuar, që ishin zëra jashtë qeverive, jashtë konferencave dhe jashtë mendimit “zyrtar” të të mëdhenjve.

Një shekull e nëntë vite pavarësi janë pak për një komb, por është mjaft domethënëse për kombin shqiptar. Fatin e një kombi të tërë e shkruajnë emrat, burrat e kombit, vizionarët, firmëtarët, ata që prodhuan historinë e fillimshkullit të kaluar, ata që shkruan të parët emrin për sigurinë e së ardhmes së kombit shqiptar.

² Sipas gazetës “Liri e Shqipërisë”, nr. 63, që flet për ngritjen e flamurit në Durrës më 26 nëntor 1912. Shumica e shqiptarëve nuk e njihnin atë, ndërkohë që historia e flamurit shqiptar dhe atij të Vlorës është komplekse. Flamuri që rizbuluar dhe botuar së pari nga Faik Konica në Revistën “Albania”, sipas porosisë tek një piktor francez që e vizatoi atë dhe më tej e botoi flamurin në faqen e parë të gazetës dhe që nga ai numër, e quajti atë: “Flamuri i Shqiptarëve”. Në një farë mënyre, është Faik Konica ai që e imponoi atë si Flamuri Kombëtar, simboli që i përfaqëson shqiptarët ende.

Shekulli që lamë pas ka qenë një shekull ngjarjesh dhe përmbysjesh që nuk mund të kuptohen pa historinë e shekujve, pa zbritur në qindra e mijëra vjet të shkuara deri në tabanin pellazgjik e ilirik, por edhe pa hedhur vizionin në të ardhmen. Historia jonë ushtarake dhe e policimit, pse jo dhe e xhandarmërisë së parë kombëtare, është pjesë e tërësisë së historisë sonë kombëtare. Historia ecën në relievet dokumentare të shkencës historike dhe përmes memories së shkruar e të dokumentuar.

Analiza e fakteve historike dhe ç'pluhurosja dokumentare e historisë meriton vëmendje në lidhje me lidhshimin ushtarak shqiptar, që me thirrjen e zërit mëmëdhetar erdhën në Vlorë për flamurin dhe shtetin e parë shqiptar. Nuk është e rastësishme që nga vatrat e kryengritjeve më të mëdha shqiptare dhe vatrat e intelektualizmit të kohës të grumbulloheshin në një kohë të shpejtë rreth figurës qendrore të pavarësisë rreth Ismail Qemalit, Isa Buletinit, Hasan Prishtinës edhe figura të tilla që bënë emër si themelues të lidhshimit, të politikave të sigurisë dhe krijimit të formacioneve të para ushtarake shqiptare që vullnetarisht u vunë në drejtim të Ministrisë së Luftës si dhe Shtatmadhorisë së parë shqiptare si Mehmet Pashë Dërralla (Tetovari) dhe Ali Shefqet Shkupi. Që të dy drejtuesit e parë erdhën nga Tetova dhe Shkupi, aty ku historia është shkruar me pushkë e me penë. Por siguria kombëtare do të ishte e plotë edhe me rendin dhe qetësinë që vendosën në periudhën e pavarësisë, sikurse kanë qenë emrat e njohur.

Fillimshekulli i njëzetë ishte drita dhe aspirate e një plejade të tërë dhe kurorëzim i ëndrës së rilindësve. Barometri i pulsimit të kombit ishte njësh me Stambollin dhe kryeqendrat e tjera të intelektualizmit, aty ku iluminizmi shqiptar ndizte zemrat dhe shpresat e shqiptarëve për liri e pavarësi. Dhe në fakt, pavarësia dhe siguria erdhi pikërisht nga vatrat e intelektualizmit që menduan dhe vepruan në strofullën dhe vatrën e pushtuesit, atje në Stambollin e largët dhe të afërt. Lidhshimi ushtarak dhe i sigurisë së brendshme ishte një prej kolonave vertebrore të qeverisë së Vlorës me shtrirje gjithëkombëtare, me vizion të qartë për rrugën që do të përshkruante. Akademikët ushtarakë, të xhandarmërisë dhe të policimit erdhën në Vlorë nga fushëbetejat, nga akademitë më prestigjioze të kohës me synimin e vetëm që mençurinë e dijenitë t'i përdornin në të mirë të shqiptarëve.

Për këtë arsye, lidhshimi ushtarak, i xhandarmërisë dhe policimit shqiptar nderohet e respektohet për veprën e tyre për aspiratat e shtetit të ardhshëm shqiptar. Prandaj gjykojmë se ka ardhur koha e ringritjes së godinës autentike në qendër të Vlorës, ku u ngrit për herë të parë flamuri për ta rindërtuar “Shtëpinë e Pavarësisë”, selinë e parë të qeverisë së Vlorës, “godinën-themel” të orientimit evropian të atdheut e kombit shqiptar. Në godinën-themel të pavarësisë filloi aktivitetin jo vetëm qeveria, por edhe Ministria e Luftës, e Brendshme e shtetit të ri shqiptar, filloi siguria e brendshme dhe e jashtme, diplomacia, ekonomia, jeta shqiptare në mëvetësi.

Nëse i referohemi Profesor Kristo Frashëri: “Shqipëria u shpall sovranë, e pavarur jo vetëm ndaj zgjedhës otomane por edhe ndaj ëndrrave të fqinjëve. Në vitet e para të shekullit XX politika evropiane dominohej nga Austro-Hungaria, Italia, Franca, Anglia, Gjermania dhe Osmanët në rënie. Rivaliteti kapte shumë sfera të ekonomisë, politikës, diplomacisë dhe po kalohej në përgatitje të ethshme ushtarake. Osmanët edhe pse ishin në dekadencë,

disa shqiptarë e shikonin shpëtimin nën autoritetin e osmanëve”.³ Bota e përparuar dhe jo vetëm ishte tashmë e bindur se pavarësia shqiptare vuri në vend një të drejtë legjitime të kombit shqiptar, të një kombi të formuar në territorin e vet, të banuar gjatë shekujve me gjuhën, kulturën dhe historinë e vet. Pavarësia shqiptare nuk ishte një akt i lehtë, por ajo mbante peshën e shekujve të mbushur me robëri, një e drejtë e fituar nëpër llogoret e një lufte të gjatë e të ashpër, një e drejtë që i takonte edhe për kontributin e vyer që kishte dhënë në procesin çlirimtar ballkanik dhe evropian. Në fakt, pavarësia konfirmonte atë që thoshte dikur Naim Frashëri dhe që jua përcillte shqiptarëve, “amanetin” e Skënderbeut me vargjet “...po të jini të bashkuar./është e bërë Shqipëria”. Bashkimi kombëtar për rilindësit ishte pasion dhe dëshirë e zjarrtë atdhetare, që rridhte nga dijetarë të shquar idealistë. Konceptet për shtetin shqiptar, për rolin e unitetit kombëtar dhe sigurinë e tij ishin plotësisht të mbështetura në argumente historike, etnike, gjuhësore, gjeografike dhe ekonomike, ishin të drejta dhe i përgjigjeshin realitetit shqiptar, të cilin ata e njihnin me hollësi. Dhe në mes të errësirës ata e kishin një dritë, një shembull historik siç ishte epoka e Skënderbeut, heroit kombëtar të shqiptarëve që shërbente si shembull i shkëlqyer që u jepte shqiptarëve shembullin e bashkimit përpara armiqve. Por Ismail Qemali kur kërkonte nga evropianët dyfishin e sipërfaqes për shtetin shqiptar bazohej në të drejtën historike të popujve dhe në fakt mundi të merrte as gjysmën. Por medalja ka dy anë. Atë që evropianët nuk do ta pranonin më 1913, do të detyroheshin ta pranonin me pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe të njohur deri më sot nga 116 shtete, nga 193 shtete anëtare që ka OKB-ja ose 55.95% e tyre.⁴

3. Siguria në pavarësinë e 1912-tës, produkt i intelektualizmit shqiptar

Shqetësimi i Ismail Qemalit për shtetin që po ngrinte për herë të parë për shqiptarët ishte pikërisht për ruajtjen e rendit, qetësisë së brendshme, prandaj dhe porosia e parë e tij ishte: “Përpiquni të siguronit sa më mirë qetësinë e vendit dhe rendin publik...”⁵ Kjo pasqyrohet që në njoftimin e parë telegrafik për prefekturat dhe bashkitë e vendit.⁶ Në fakt, po të hedhim një vështrim të përgjithshëm, tendencat e fillimit të krijimit të policimit në Shqipëri për çështjet e sigurisë ishin të “mbytura” nga fryma ushtarake, veçanërisht forcat e xhandarmërisë, që policinë dhe policimin e shikonin si aneks të Komandës së Xhandarmërisë. Fillimet policore shqiptare gjenden në fund të shek. 18-të dhe në fillim të shek.19-të. Pashallëqet e Janinës dhe të Shkodrës vepruan me tendencat e përparuara të kohës duke krijuar për herë të parë policinë dhe xhandarmërinë, ku në Janinë Ali Pashë Tepelena organizoi një policim të centralizuar e të fortë me disa lloj shërbimesh të policimit

³ Prof. Dr. Kristo Frashëri, Revista Ushtarake “Albanian Armed Forces”, Tiranë, 2012, faqe 37.

⁴ Shumica e vendeve të BE e kanë njohur Kosovën (23 nga 28); BE-ja ka dërguar misionin EULEX për të siguruar paqe, mbikëqyrje të jashtme. Nga 30 vende anëtare të NATO-s 26 anëtarë të saj e kanë njohur Kosovën. Shtetet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, janë të ndara sa i përket pavarësisë së Kosovës. USA, UK dhe Franca, njohën pavarësinë e Kosovës, Rusia e ka kundërshtuar dhe konsideruar ilegal aktin e pavarësisë Kina jo. Më 15 maj 2008, Rusia, Kina dhe India, lëshuan një deklaratë të përbashkët, në të cilën ftojnë për negociata të reja në mes të autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës.

⁵ AQSH, Viti 1912, Fondi dokumentar, Dosja 1, Dokumenti nr. 723/19 Datë 28.11.1912.

⁶ Po aty.

për rend e qetësi, polici portesh pranë doganave, polici burgjesh etj. Shkodra nga viti 1757 deri 1796 forcoi rregullin dhe qetësinë publike mjaftueshëm me përdorim të strukturave policore dhe xhandarë. Por policia shqiptare në kuptimin e plotë të funksionimit lidhet me pavarësinë që krijoi Ismail Qemali pas një udhëtimi të gjatë nga Stambolli në Vlorë në rrugën e vjetër prej 4122 km⁷ dhe krijimit të Ministrisë së Brendshme më 4.12.1912, që përgjigjej për rendin e qetësinë publike, e më tej edhe me krijimin e “Fuqisë Civile”, ku një pjesë e saj kryente rolin e policisë për ruajtjen e ligjshmërisë, zbulimin e shtypjen e krimineleve, ndërkohë pjesa tjetër u angazhua me krijimin e strukturave të xhandarmërisë. Më 13.1.1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, nxori Vendimin për Krijimin e Forcave të Rendit, që përbëheshin nga forca Policore dhe forca xhandare.⁸ Për herë të parë në një qeveri shqiptare nisi të funksiononte Zyra e Sigurimit Publik, që po të shqipërohet ishte “Drejtoria e Policisë shqiptare”. Në pushtetet e prefekturave dhe nënprefekturave vepronin zyrat e komisarëve të policisë dhe mbështeteshin nga struktura të xhandarmërisë të formatuara mbi bazën e batalionit në çdo prefekturë, kompanisë në çdo nënprefekturë, si dhe togës në krahina. Më 4 maj 1913 krijohet shtabi madhnuer nga i cili varej xhandarmëria me tre batalione xhandarmërie në Vlorë, Berat e Elbasan. Milicia shqiptare më 3.6.1913 u bë me rregullore që ishte e modelit Osman dhe e shkruar në osmanllisht. Për herë të parë u vendos uniforma kombëtare shqiptare për policinë dhe xhandarët. Më 20.12.1913 firmoset dekreti i Qeverisë së përkohshme të Vlorës mbi Formimin e Xhandarmerisë në krahinat e jugut, ku misioni holandez i William De Weer-it, i ardhur në nëntor 1913 kontribuoi në formimin e katër reparteve xhandare me treqind vetë secili. Gjatë LIB, policia dhe xhandarmëria shqiptare e humbën funksionin dhe adaptuan modelet e forcave pushtuese austro-hungareze, franceze dhe italiane, ku është fakt se më 10 dhjetor 1916 u krijua Republika “franceze” e Korçës, e drejtuar nga shqiptari Themistokli Gërmenji dhe kapiteni francez Henri Descoins dhe prefektura e policisë. Veprimi i gjeneralit Sarraill u kishte rënë si bombë kancelarive të Fuqive të Mëdha. Ministri i jashtëm francez Ribot autonominë e korçarëve e quajti “veprim të nxituar”, ndërsa gjenerali Sarraill iu përgjigj: “Gjithnjë kam dashur të bëhet vullneti i popullit. Korça deshi të ishte e pavarur dhe ajo u bë. Që nga ajo kohë, qetësia mbretëron në këtë zonë”. Thelbi i Republikës qëndronte në marrëveshjen: “Ne, delegatët e popullit shqiptar, i deklaruaam përfaqësuesit të Francës se kazaja e Korçës dhe zonave që varen prej saj është një provincë autonome e administruar nga funksionarë shqiptarë, nën mbrojtjen franceze”, ku përfshihej Korçë, Bilisht, Kolonjë, Opar, Gorë.⁹ Por ngjarjet në Korçë ishin vetëm një fragment në ngjarjet mbarëkombëtare shqiptare. Fakt është se sigurisë shqiptare, që në vitin 1913 i parapriu veprimi i përbashkuar i Fuqive të mëdha që tashme janë të njohur historikisht dhe kronologjikisht. Është fakt se Fuqitë e Mëdha themeluan Komisionin e Kontrollit të përbërë nga përfaqësuesit e

⁷ Zaho Golemi: Rrugëtimi i pavarësisë shqiptare. Gazeta Telegraf, Tiranë, më 28 nëntor 2012, faqe 1, 6, 7.

⁸ AQSH. Fondi dokumentar nr. 245/II, dosja 69, faqe 1.

⁹ Dhimitër Kolovani: “La question de Koritza”: Çështja e Korçës një çështje nderi për francezët që kanë ngritur flamurin shqiptar në dhjetor 1916, Paris, 1920); Muin Çami, Shqiptarët dhe francezët në Korçë, “Dituria”, 1999.

Fuqive të Mëdha¹⁰ dhe një shqiptar dhe më konkretisht: francezi Leon-Alphonse-Thadee Krajewski (16.10.1913–6.9.1914), britaniku Harry Harling Lamb (16.10.1913–6.9.1914); italianii Alessandro Leoni (16.10.1913–10.8.1914); Carlo Galli (10.8.1914–6.9.1914); rusi Aleksandr Mihajloviç Petrajev (16.10.1913–6.9.1914); austro-hungarezi Aristoteles Petroviç (16.10.1913–25.4.1914); August Kral (25.4.1914–6.9.1914); gjermani Julius Winckel (15.10.1913–25.4.1914), si dhe dy përfaqësuesit shqiptarë Myfid bej Libohova (20.10.1913–17.3.1914) dhe Medi Frashëri (17.3.1914–6.9.1914)¹¹. Kjo është ndër periudhat më të vështira shqiptare, sepse, ndërkohë që popujt ishin të çoroditur, qeveritë e vendeve më të fuqishme të planetit po përgatiteshin për ta hedhur botën në luftën e parë botërore, ku asnjëria shqiptare nuk pati ndonjë rol dominant në këto zhvillime.

4. Firenze - simbol i debatit mbi kufijtë, sigurinë dhe të ardhmen e Shqipërisë

Menjëherë pas caktimit të kufijve shqiptarë me Protokollin e Firences¹², një shekull më parë, fuqitë e mëdha kërkuan nga shteti fqinj jugor, Greqia, të bënte lëshimin e krahinave të Shqipërisë politike “londineze”¹³ brenda një muaji. Kryeministri grek¹⁴ në këtë kohë e kishte peshuar mirë situatën gjeopolitike. Si serbët edhe malazezët nuk mundën të gjenin asnjë lloj mbështetje te Shqipëria dhe shqiptarët e veriut sepse myslimanë e katolikë ishin kundër tyre, ndërsa në jug paraqitej gjendja ndryshe: një pjesë e shqiptarëve ortodoksë ishin grekomanë, të punuar me kohë prej shkollave helene dhe mund t’i shërbenin Greqisë si një bazë për të bërë lodrën e saj. Synimi i fqinjëve tanë ishte që dy krahinat jugore, Korçë e Gjirokastrë, të shpallehin si “shtet autonom” i Vorio-Epirit dhe të veçoheshin nga Shqipëria. Më tej do të ishte e lehtë bashkimi me Greqinë. Firenze është qyteti italian që dy herë është bërë simbol i debatit mbi kufijtë e Shqipërisë. Kufiri që është shënuar në protokollin e 17 dhjetorit 1913 është në fuqi edhe sot me përjashtim të disa ndreqjeve të vogla që u bënë në zonën e Korçës pas Luftës së Parë Botërore.¹⁵ Komisioni i kufirit shqiptarogrek përfundimisht u vendos më 27 janar 1925¹⁶ ndërsa kufiri në veri midis shqiptarëve dhe mbretërisë serbo-kroato-slllovene u hartua më 26 korrik 1926¹⁷. Në këtë periudhë, edhe

¹⁰ Barbara Jelavich: “The end of Ottoman rule in Europe”, History of the Balkans: Twentieth century, Cambridge, United Kingdom: The Press Syndicate of University of Cambridge, 1883, page 101.

¹¹ Arhontology, “International Commission of Control: 1913-1914”.

¹² Protokollin e Firences ishte akti ndërkombëtar me anën e të cilit u caktua kufiri i Shqipërisë. Para një shekulli protokollin u hartua nga një komision i posaçëm me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të gjashtë Fuqive të Mëdha të kohës. U krijua me vendimin e 11 gushtit 1913 të Konferencës së ambasadorëve në Londër, e cila kishte caktuar në parim si pika skajore të kufirit Korçën dhe kepin e Stillos në bregdet përballë Korfuzit. Komisioni që filloi punën në tetor 1913 dhe duhej të mbështetej në parimin etnik dhe gjeografik, gjuha amtare ishte elementi bazë. Vetë komisioni u bë fushë kontradiktash midis dy blloqeve të Fuqive. Në këto kushte u vendos që ai të shkonte në Firence të Italisë, larg “teatrit të armiqtëve lokale” në Ballkan.

¹³ Shqipërisë londineze ishte vendosur në 66 mbledhjet e Konferencës së Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Londër nga 17.12.1912 e deri më 29 korrik 1913; ndërsa vendimi ka dalë më datën 11 gusht 1913.

¹⁴ Kryeministri grek në këtë periudhë ka qenë Lefteris Venizellos.

¹⁵ Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese “Kristalina KH”, Tiranë, 2009, faqe 2117.

¹⁶ Po aty, faqe 2117.

¹⁷ Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese “Kristalina KH”, Tiranë, 2009, faqe 2116.

Komisioni vetë u bë fushë kontradiktash midis dy blloqeve të Fuqive të Mëdha ku interesat e palëve sillnin kontradikta të ashpra diplomatike që më vonë do të shpaloseshin edhe në planet e ballafaqimit ushtarake përgjatë Luftës së Parë Botërore. Vendimet e vitit 1913 patën rëndësi për Shqipërinë, sepse e shënuan atë në hartën e Evropës. Por për të pasur mirë parasysh rëndësinë e vendimit të 29 korrikut 1913 mjafton të përmendim direktivën që u jepte Pashiqi¹⁸ përfaqësuesve të Serbisë në kryeqytetet e Fuqive të Evropës: “ja të shuhet Shqipëria, ja të bëhet sa më e vogël dhe e paaftë për të jetuar”. Mbi bazën e këtij perceptimi dhe në unison me konceptin, “një Shqipëri e paaftë për të jetuar” pas Konferencës së Londrës e deri më sot ka vepruar platform “Naçertanie” duke e përcjellë brez pas brezi dhe duke masakruar shqiptarët e Kosovës për t’i shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre, të cilët gjetën strehë dhe mikpritje pikërisht në atë pjesë Shqipërie të njohur më 29 korrik 1913 në Londër nga përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha. Kosova është shembulli më i mirë i mbijetesës së një populli që ka provuar më shumë padrejtësitë e “kohës së re” që prej 29 korriku 1913 e deri më 17 shkurt 2008¹⁹. Kosova, shqiptarët e ngelur jashtë trojeve etnike në anët veriperëndimore të saj, por dhe Çamëria, si vatra të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare, përfshi këtu dhe kuvendet e kongreset historike të Rilindjes të viteve 1878, 1880, 1909, nuk pajtohen me fatin historik që i servirën përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Londrës më 1913. Gjithë drama shqiptare u laujt jashtë dëshirës dhe vullnetit të shqiptarëve, pa dëgjuar zërin e përfaqësuesve legjitimë të popullit shqiptar. Kryengritja e parë pas vendimeve të të mëdhenjve evropianë, në shtator të vitit 1913 kundër zgjedhës serbe vërtetoi padrejtësinë e vendimeve të Konferencës së Londrës përsa i takon kufijve të shtetit shqiptar. Pretendimet e fqinjëve tanë të pangopur për justifikimin e synimeve të tyre aneksioniste, veç të tjerash kamufluar dhe me “misionin e tyre qytetërues mbi shqiptarët”, të quajtur prej tyre, primitivë e të egër, i rrëzoi koha dhe historia i përmboldhi në koshin e saj. Në rrafsh ballkanik që më 1913 u shpalos pesha e faktorit shqiptar në zhvillimet politike ndërshtetërore dhe ndërnacionale në gadishullin tonë, fill pas vendimeve të Konferencës së Londrës. Këtë faktor, aleatët ballkanikë nuk e kishin marrë në konsideratë dhe e nuk e përfillën gjatë kryengritjeve të mëdha të shqiptarëve në vitet 1909-1912 dhe gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Më pas, është i padyshimtë ndikimi i kryengritjes shqiptare në ecurinë e bisedimeve turko-bullgare që kishin nisur për krijimin e një aleance të re kundër Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Ideatorët e saj e patën të qartë se në kontekstin ballkanik faktori shqiptar, tashmë, nuk do të mund të injorohej në të ardhmen në asnjë projekt të tillë. Kështu, në rrethet politike shqiptare shtypja e egër e kryengritjes së shtatorit 1913 përforcoi bindjen se në rrethanat e krijuara, të brendshme dhe të jashtme, detyra e çlirimit

¹⁸ Pashiqi, ish-kryeministër dhe lider shpirtëror i serbëve në fillim të shekullit XX.

¹⁹ Shpallja përfundimtare dhe e shumë pritur e pavarësisë së Kosovës me të drejtë konsiderohet ndodhia më madhore në rrafshin kombëtar që nga dita e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor të vitit 1912. Ndonëse mund të jetë shumë e pahijshme të bëhet ndonjë krahasim, për shkak të rëndësisë dhe peshës që kanë këto dy ditë në historinë tonë, megjithatë, duke pasur parasysh vuajtjet, sakrificat, angazhimin dhe kohëpritjen, duket sikur dita e 17 shkurtit ka një rëndësi më specifike dhe më të veçantë. Për më tepër që përmes saj po bëhet edhe plotësimi i deri dikurshëm i mozaikut gjeografik kombëtar të paramenduar që nga Lidhja e Prizrenit. Pritja mbi 100 vjeçare e kësaj dite të madhe, lidhja e gjakut dhe gjuhës, sakrifica sublime për shtetin dhe të drejtën ka vlejtur drejt objektivave dhe synimeve strategjike kombëtare. (Sh.a).

dhe e bashkimit të trojeve shqiptare nuk mund të zgjidhej pa siguruar aleatë të jashtëm, pa krijuar miq e strategji të qarta zhvillimi. Kombinimet politike që po projektoheshin midis Perandorisë Osmane dhe Bullgarisë u dhanë atyre një rast të mirë për të vepruar. Por në fakt, intelektualizmi shqiptar kishte mbrojtësin më të mençur dhe më veprues për kohën, kryetarin e qeverisë së Vlorës, Ismail Qemali.

5. Antishqiptarizmi i Protokollit të Korfuzit, “kujdesi” i Fuqive të Mëdha dhe dështimi

Vendi fqinj në jug të Shqipërisë, duke shfrytëzuar pozitat e dobëta të shtetit të sapokrijuar shqiptar dhe duke pasur frikë nga përbashkimi i katër vilajeteve dhe marrja nën mbrojtje të ndonjë nga Fuqive të Mëdha të kohës, nxitoi të armatoste ushtrinë dhe të vinte në veprim diplomacinë për të përfutur sa më shumë në rrëmbimin e kufijve ende të pa stabilizuara. Kështu, pasi mbajti nën presion qeverinë e Vlorës që të mos kishte mundësi të lidhej me botën, veproi dhe u parapriu edhe veprimeve në terren. Mbretërisë fqinje në jug të Shqipërisë i duhej të fitonte kohë, deri sa të përgatiste vënien në zbatim të helenizimit të jugut të Shqipërisë. Më 30.12.1913, Venizelloja u përgjigj se do ta tërhiqte ushtrinë prej krahinave të Shqipërisë jugore pasi të ishte zgjidhur në dobi të Greqisë çështja e ishujve të Egjeut. Ushtria greke organizoi bandat famëkeqe të quajtura “kompani të shenjta” (hierolohitet) me hajdutë dhe kriminelë të lëshuar prej burgjeve dhe i dërgoi në krahinat e Korçës e të Gjirokastrës për ta shkretuar vendin në zjarr e në gjak. Shpalli gjithashtu mobilizimin e përgjithshëm për ortodoksët shqiptarë të cilët i shikonte si “të vetët”. Por atdhetarët nuk pranuan të tradhtonin vendin e tyre. Pati edhe nga ata që u vëllazëruan me kriminelët e Gjiritit dhe u bënë lodër e mbretërisë fqinje si në qarkun e Korçës dhe në Përmet, Delvinë, Gjirokastrë, Himarë etj. Ata formuan banda të rrezikshme kundër popullsisë myslimane dhe dogjën vendin me zjarr. Më 13 shkurt 1914, fuqitë e mëdha, me anën e një note të përbashkët, ia kujtuan edhe njëherë qeverisë greke se duhej t’i lironte tokat e Shqipërisë gjer në fund të marsit 1914 dhe se vetëm atëherë mund të merreshin parasysh kërkesat e saj në lidhje me ishujt e Egjeut. Për të mos ardhur në kundërshtim të hapët me fuqitë e mëdha, u urdhërua që ushtria e rregullt “ta lëshonte” Korçën më 1.3.1914. Më 2 mars 1914 hyri në qytet xhandarmëria shqiptare dhe u vu një administratë e varur prej Komisionit ndërkombëtar të Kontrollit. Ndërkohë vendimi i Konferencës së Londrës fiksoi kufirin midis Greqisë dhe Shqipërisë,²⁰ miratimi i të cilit në Protokollin e Firences është dokumenti bazë edhe sot për kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë.²¹ Por për shqiptarët u zhvillua një situatë tragjike, sepse autoritetet greke, natyrisht, nuk mund t’i kundërviheshin vendimit të Konferencës së Ambasadorëve, por ata inskenuan një “lëvizje popullore” që u vetëquajt “Qeveria autonome vorio-epirote”,²² nën kryesinë J. K. Zografit.²³ Por forcat ushtarake ua

²⁰ Arben Puto: Shqipëria Politike 1912 – 1939, Tiranë: Toena, 2009, faqe 81.

²¹ Valentina Duka: Histori e Shqipërisë 1912 – 2000, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2007, faqe 51.

²² Eqerem Bej Vlora: Kujtime 1885 – 1925, botim i tretë, Tiranë: IDK, 2003, f. 337.

²³ Historia e Popullit Shqiptar, vëllim III, f. 61.

lanë vendin “Legjioneve të Shenjta”,²⁴ “Batalione të Shenjta”²⁵ apo “Kompani të Shenjta” që u bënë tmerri i Shqipërisë së jugut, nga kontingjente “kokëkrisurish” nga Kreta me kriminelë të lëshuar nga burgjet me emigrantë dhe partizanë grekë dhe nga shqiptarë që u detyruan ose u joshën të bashkoheshin me ta”.²⁶

Nga ana tjetër, kish përgatitur shpalljen e “autonomisë së Epirit të Veriut” dhe hedhjen në veprim të “kompanive e batalioneve të shenjta”, që paraqiteshin si “forcë vorio-epirote”. Më 2. Mars 1914 u thirr kongresi vorio-epiriot në Gjirokastrë, ngjarje kjo disa ditë përpara ardhjes së Vidit në Durrës dhe që fqinjët realizimin e synimeve kërkonin ta bënin përmes besueshmërisë dhe ndikimit besimtar. Por fakt është se besimi mysliman dhe ortodoksia atdhetare përbënin shumicën, ndërkohë që fqinjët shfrytëzonin një pakicë ortodokse të paguar por edhe të detyruar me forcë e që shërbente si një mbulesë për të fshehur prapa tyre kriminelët e prurë nga Gjiriti (Kreta) dhe prej viseve të tjera të Greqisë. Qëllimet politike dhe synimet strategjike greke kishin filluar të vinin si një re e zezë mbi Shqipërinë. Zjarrin fillestar nisën ta hidhnin me “autonomitë që synonin në Korçë, në Gjirokastrë dhe në Himarë. Pas dështimit në Korçë, grekët ngarkuan një shqiptar me origjinë nga Qesarati i Lunxhërisë në Gjirokastrë, ish ministër i jashtëm grek si dhe guvernator i Janinës, për të shpallur në Gjirokastrë “Republikën Autonome të Epirit të Veriut të fillimvitit 1914”. Qeveria e “Epirit të Veriut”, jetoi 253 ditë, që ishin ditë tmerri e masakrash për popullsinë e Jugut të Shqipërisë. Në Himarë majori i ushtrisë greke Spiro Spiromilo shpalli autonominë krahinore me shtatë fshatra dhe synonte ta zgjeronte rrethin e fshatrave me autonomi qeveritare më vete në 18 fshatra. Strukturat ushtarake greke më 1913-1914, angazhuan potencialet e resurset më antishqiptare të quajtura “kompani e batalione të Shenjta”, të përbërë nga kriminelë lufte, dezertorë dhe të burgosur nga burgjet greke, të cilët do të njiheshin si “Andartë”, veçanërisht të sjellë nga Kreta dhe Peloponezi. Njësitë e rregullta greke, të ashtuquajturit “epirotë” apo “andartë” zotëronin armë, municione, pushkë, mitraloza dhe madje dhe topa grekë të njëjtë. “Formacionet e shenjta” të dirigjuara nga fqinjët jugorë shqiptarë kanë kryer masakra në të gjithë Jugun e Shqipërisë, duke vlarë gra, pleq e fëmijë për të spastruar zonën nga shqiptarët pasi më parë kishte pastruar Çamërinë dhe Gjirokastrën. Fakt është se ushtarakët me urdhër hoqën uniformat dhe nisën masakrat, djegiet duke argumentuar se nuk pranonin vendimin e Evropës për: “lënien jashtë Greqisë të Korçës dhe Gjirokastrës”. Situata u rëndua pas bisedimeve ndërmjet KNK dhe përfaqësuesve “vorio-epirotë nga 10.5.1914 deri 17.5.1914, përfunduan me “Protokollin e Korfuzit” të 17.5.1914 të nënshkruar në Hotelin “Orea Elvetia”. Protokollin e “udhëheqësve” shqiptarë, grekë e ndërkombëtarë mori vulën si “protokoll i turpit” sepse Shqipërinë e

²⁴ Ferdinando Salleo: Shqipëria: Gjashtë muaj Mbretëri, Tiranë: SHLK, 2000, f. 49.

²⁵ Joseph Swire: Shqipëria: Ngritja e një Mbretërie, Tiranë: Dituria, 2005, f. 146.

²⁶ Valentina Duka: Histori e Shqipërisë 1912 – 2000, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2007, faqe 63.

²⁷ Në “Republikën autonome” të Zografos u përfshi dhe Saranda, Delvina e Përmeti. “Qeveria” e Zografos përbëhej nga Jorgji Kristos Zografi, kryeministër, Vasilios, mitropolit i Gjirokastrës, Germanos mitropolit i Korçës, Spiridon mitropolit i Konicës, Aleksandër Karapanos ministër i Jashtëm, Kolonel Dhimitris Dhulis ministër i Luftës, Jorgos Paramenidhis ministër i Ekonomisë, Jorgos Dhimas zëdhënës i Epirit dhe Athinës.

jugut ia falte mbretërisë greke. Por kush janë arkitektët e Protokollit të Korfuzit? Protokollit i Korfuzit më 17 maj 1914 u firmos nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe: Sir Harry Lamb; Gjermanisë: Bigel; Austro-Hungarisë: Kral Sahtain; Francës: Krazefski; Rusisë: Petrof; Italisë: Lauro; Shqipërisë: Kolonel Tomson, Mehdi Frashëri dhe Greqisë: Zografos, Karapanos.

Më 1919 në Paris u krijuan kufijtë e Evropës së re dhe protokollit i Korfuzit e humbi rëndësinë, por nuk u shfuqizua. Megjithatë 40 mijë ushtarë kryen masakra të pashembullta në qytete e fshatra të Korçës, Përmetit, Gjirokastrës, Sarandës, Labërisë etj. Çetat e armatosura shqiptare me gjithë depërtimin dhe masakrat e andartëve në shumë beteja i ripërsëritën një mësim historie fqinjëve si në Betejën e Skërficës, në Senicë, Bashaj, Vergo, Kopaçez, Palavli, Rusan të Delvinës, në Fushëbardhë, Zhulat, Kapariel, Golem, Shkallë të Zezë, Shtëpëz, në Kodrat e Humelicës, Cepo, Kodrat e Shehe në Çepunë, nën Kolonjë, në grykën e Borshit, në Kallarë, në Lajthizë të Gusmarit etj.²⁸ Lufta vazhdoi dhe në Kurvelesh, Këndrevicë e gjithë zonat labe për mbrojtjen e truallit arbëror.

Protokollit i Korfuzit ishte një marrëveshje turpi që dogji jugun e Shqipërisë dhe që dëshmitë janë tepër tronditëse në gjithë jugun e vendit. Sulmeve andarte të vitit 1914 u paraprinë masakra të shumta si “Masakra e Paramithisë më 27 mars 1913, ku u vranë 72 udhëheqës të krahinës së Çamërisë; masakra e Panaritit në janar 1914 në fshatin Panarit, si hakmarrje për ngritjen e Flamurit Kombëtar Shqiptar u therën mbi 400 burra, gra, fëmijë e pleq. 300 burra nga Panaritit e Grabocka u keqtrajtuat dhunshëm në Karakoll, në krye të Rripës së Melckës dhe u prenë kokat djemve panaritas; më 25 shkurt 1914 në Pacomit e Kuqan dy fshatra afër Kosinës së Përmetit të banuar nga myslimanë, ku gjithë fëmijët që kishin mbetur në fshat u therën 75 vetë; në Hormovë vranë 217 vetë, në mars 1914. Dëmi total i masakrës së andartëve dhe ushtrisë greke në jug të Shqipërisë është katastrofik: 2500 të vrarë, 400 fshatra të djegura e mbi 200 milionë franga ari dëme. Opinioni publik ndërkombëtar sidomos ai britanik u indinjua nga ky veprim i Greqisë dhe protestoi përmes deputetëve britanikë “Miqve të Shqipërisë” Sir Walter Guinness, Aubrey Herbert, Lord Lawington, etj. Ish-ministri i SHBA në Athinë, Fred Williams, që ishte edhe anëtar i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit protestoi në atë kohë me forcë kundër aktit çnjerëzor të qeverisë greke dhe pasi vizitoi Shqipërinë e Jugut, në shenjë proteste, u kthye në SHBA, dhe u bë mbrojtës i hapur i shqiptarëve”. Rreth këtyre ngjarjeve mikja e shqiptarëve Edith Durham shkruan: “Nuk mund t’i besoj ato që kam parë. Më duket sikur jam në një ëndërr të keqe dhe grekët edhe sikur një shekull të tërë, të bëjnë pendesë, ata nuk mund t’i shlyejnë krimet e urryera që kanë bërë ndaj shqiptarëve”. Masakrat, djegiet e shkatërrimet e gjithçkaje, në ngjarjet e vitit të mbrapsht 1914, mund t’iu kujtojnë fqinjëve jugorë të shqiptarëve se në botën e civilizuar reflektohet dhe kërkohet edhe ndjesë.²⁹ Përveç firmës së KNK-së, Fuqitë u bënë garant për zbatimin e Protokollit për shkëputjen e jugut të Shqipërisë nga pushteti i qeverisë së Princit, në kundërshtim me vendimet e Londrës. Në këtë rast binte në sy edhe pozicioni i KNK si pushtet suprem i ndërkombëtarëve, që

²⁸ Revista “Mbrojtja”, Organ i Ministrisë së Mbrojtjes, Tiranë, Nr. 3/mars 2014, faqe 45.

²⁹ Revista “Mbrojtja”, Organ i Ministrisë së Mbrojtjes, Tiranë, Nr.3/mars 2014, faqe 47.

dilte mbi qeverinë e Princit³⁰ kukull. Fakt është se menjëherë pas kësaj tragjikomodie, Zografi bëri të njohur se “as Greqia as fuqitë e mëdha nuk kishin të drejtë të ndërhyjnë në punët e brendshme të “shtetit hije” të “Epirit të Veriut” duke kërkuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit që të mos i lejonte forcat shqiptare të shkelnin “kufijtë e këtij shteti”. Ardhja e princit Wilhelm von Wied ose Vidi më 7 mars 1914 u prit diku me gëzim, diku me shpresë, diku me mosbesim. Por në këtë situatë kaq komplekse nuk mjaftonte që Vidi të quhej “njeri i mirë”. Shqiptarëve u nevojitej zotësia për ta nxjerrë vendin nga gjendje tepër e vështirë e pamjaftueshmërisë së sigurisë dhe të ekonomisë. Kryeqytet u zgjodh Durrësi. Më 17 mars 1914 u formua qeveria shqiptare nën kryesinë e Turhan Pashë Përmetit, një diplomat i vjetër që kishte qenë ambasador i Turqisë në Shën Petërburg. Esad Toptani nuk u vu dot në krye të qeverisë, ai mbeti prapë se prapë njeriu më i fuqishëm sepse mori dy ministritë më të rëndësishme, të Punëve të Brendshme dhe të Luftës. Kjo tregonte se Vidi nuk e njihje fare ambientin shqiptar duke keqpërdorur kështu dy vende kyç në qeveri. Vidi gaboi edhe në kushtin e dytë, kur nuk u garantua nga Fuqitë e Mëdha për çlirimin e krejt tokës shqiptare prej ushtrive greke përpara se ai të vinte në Shqipëri. Dobi fasadë e ardhjes së Vidit në vendin tonë ishte vetëm se ky u njoh si princ i Shqipërisë prej gjithë Fuqive të Mëdha dhe shteteve të tjerë të Evropës e të Ballkanit, duke i dhënë kështu pavarësisë shqiptare një “certifikim” ndërkombëtar. Qeveria që u formua përbëhej prej çifligarësh a bejlerësh të mëdhenj të tokave, të cilët mbështesnin më fort interesat e tyre se sa ato të Shqipërisë. Por sido që të kishte qenë qeveria kombëtare, ata që propozonin dhe vendosnin në punët e Shqipërisë ishin të huajt: Këshilli Ndërkombëtar i Kontrollit dhe këshilltarët e huaj që rrethonin princ Vidin. Në fakt, as këta të huaj nuk ishin në një mendje, sidomos këshilltarët austriakë dhe italianë. Është i njohur rivaliteti i vjetër ndërmjet Italisë dhe Austro-Hungarisë për çështjen e ndikimit e të sundimit të tyre në Shqipëri. Por gjatë Luftës Ballkanike dhe vendimeve të Konferencës së Londrës, këto dy fuqi kishin mbajtur një politikë pak a shumë të përbashkët kundrejt Shqipërisë.

Me mbërritjen e Vilhelm Vidit, Italia e ndryshoi qëndrimin dhe nisi të bënte një politikë të sajën në lidhje me çështjen shqiptare kundër Austro-Hungarisë dhe në dëm të Shqipërisë. Kështu, Vidi nisi të bënte me Greqinë një politikë më vete duke i lëshuar pe në Shqipërinë e jugut. Pas formimit të qeverisë së Durrësit, kundërshtimi i parë ndërmjet fuqive të mëdha u shfaq për çështjen e huasë që do t'i jepej Shqipërisë dhe për krijimin e bankës kombëtare të saj. Austria kërkoi edhe njëherë që banka shqiptare të krijohej me kapitale austro-italiane dhe huaja prej 75 milionë frangash ari, vendosur prej Konferencës së Londrës, t'i jepej Shqipërisë pikërisht prej Austrisë dhe Italisë. Franca ndërhyri energjikisht që banka e Shqipërisë dhe huaja të plotësoheshin me kapitale prej gjashtë Fuqive të Mëdha. Më 10.4.1914 në Vlorë u hartua prej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe u nënshkrua prej tij Statuti Organik i Shqipërisë, që është ndryshe edhe Kushtetuta e parë e Shtetit Shqiptar. Statuti ishte një përmbajtje e vendimeve themelore që Konferenca e Londrës pati marrë për Shqipërinë, më 29.7.1913.

³⁰ Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese “Kristalina KH”, Tiranë, 2009, faqe 2118.

Neni 1 i statutit parashikonte se Shqipëria shpallej principatë kushtetutore, sovrane e trashëgimore, nën garantinë e gjashtë Fuqive të Mëdha. Neni 2, Fuqitë e Mëdha garantonin tërësinë dhe paprekshmërinë e tokës së Shqipërisë me kufijtë që ato patën caktuar. Neni 3 Shteti shqiptar ishte asnjans dhe asnjansia e tij garantohej po prej gjashtë fuqive të mëdha. Në fronin e Shqipërisë njihej me të drejta sovrane Princi Wilhelm von Wied, i cili ishte kryetari i administratës civile e ushtarake dhe emëronte këshillin e ministrave. Gjithashtu Kushtetuta shqiptare parashikonte gjuhën shqipe, organet legjislative, bankat, ushtrinë, arsimin, administratën, pushtetin vendor etj.³¹ Statuti organik i jepte Shqipërisë vendin e një principate të pavarur në radhën e shteteve Evropiane. Një pikë enigmatike e “Kushtetutës” ishte pika e katërt, me anën e së cilës principata shqiptare detyrohej të mbante në fuqi traktatet, konventat dhe rregullimet ndërkombëtare të Perandorisë Otomane në lidhje me koncesionet a privilegjet që ajo iu kishte njohur të huajve në tokat e Shqipërisë.³² Por në Gjirokastër e ashtuquajtura qeveri e “Epirit të Veriut” shtoi përpjekjet për të zotëruar vendin. Dhe jo vetëm kaq sepse fokusi i tyre u drejtua për të bërë miq për të marrë “çdo metër të tokës shqiptare”³³. Koloneli holandez Thomson, i ngarkuar si komisar për krahinat e jugut³⁴, shkoi në Korfuz ku pati një bisedim me Karapanon, përfaqësuesin e “qeverisë së Vorio-Epirit”, për të gjetur një zgjidhje të çështjeve të jugut të Shqipërisë. Thomsoni, duke shprehur mendimet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili s’donte të kishte shumë kokëçarje, iu premtoi grekëve disa “të drejta të veçanta” për popullsinë e “Epirit të Veriut”. Por qeveria e Durrësit fillimisht nuk i pranoi këto lëshime dhe u tregua kundër çdo forme autonomie për krahinat e jugut. Thomsoni shkoi shumë larg në premtime, duke pranuar në të vërtetë autonominë³⁵ e dy krahinave të Korçës dhe të Gjirokastrës, të cilat

³¹ Në bazë të Kushtetutës së parë shqiptare: “Gjuha zyrtare dhe e detyrueshme nëpër shkollat ishte shqipja. Organi legjislativ i principatës së Shqipërisë ishte Asambleja Kombëtare, ku do të zgjidheshin, me anë zgjedhësash të dytë, nga tre deputetë për çdo sanxhak; por në Asamble do të bënin pjesë edhe përfaqësuesit e tri fevet, komisari i lartë shqiptar pranë Bankës Kombëtare, dhe dhjetë antarë të caktuar prej Princit. Nga ana administrative, Shqipëria ndahej në 7 sanxhaqe ose prefektura, që nëndaheshin në kaza ose nënprefektura, dhe këto në nahije ose në komuna. Statuti organik caktohte institutet e larta të shtetit, përbërjen e forcave të armatosura, organizimin e degëve të ndryshme të administratës, të financave, të drejtësisë, të arsimit etj. Garantonte lirinë e nënshtetasvet, lirinë e veprimtarisë së tyre politike, ekonomike e shoqërore”. (Sh.a).

³² Këto nuk mund të hiqeshin as mund të ndryshoheshin veçse me vendimin e të gjashtë Fuqive të Mëdha. Por statuti organik i Principatës Shqiptare nuk pati kohë e mundësi të vihej në zbatim sepse vërshuan grekët në jug dhe kryengritja e rebelëvet, në Shqipërinë e Mesme.

³³ Gazeta Panorama, “Holandezit që dëboi Esadin nga Shqipëria. Historia e deputetit Thomson që formoi xhandarmërinë më 1913”, Tiranë, më 22 korrik 2006, faqe 27.

³⁴ Lodewijk Willem Johan Karel Thomson lindi më 11.6.1869 në Voorschoten pranë Hagës në Holandë, në një familje ushtarakësh dhe u vra në Durrës më 15.6.1914. Babai i tij ishte mjek i marinës ushtarake, e ëma ishte një Pompe van Meerdervoort, një familje e thjeshtë fisnike. Shkollën fillore e kreu në Voorschoten, për t’u shpërngulur më pas në Rotterdam, ku përfundoi shkollën reale. Pasi mbaroi programin trevjeçar të shkollës pasuniversitare, ai u regjistrua në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Breda më 1884, bashkë me të vëllanë. Pas një sërë gradash që mori, më 8.11.1892 u gradua toger dhe fitoi titullin “Kryqi i Nderit”. U martua me date 29.11.1893 me Henrietta Lambertina Slotemaker. Nga martesja lindën 2 vajza, njëra e cila vdiq në foshnjëri. Shërbeu në misionet e Holandës: në Batavia, që sot njihet me emrin Xhakarta, kryeqyteti i Indonezisë, ku punoi për 5 vjet në ushtri, duke iu dhënë një sërë dekoratash për trimëri si “Urdhri i Luanit të Holandës”, “Kalorësi i Urdhrit me Shtatën e Suedisë”. Më vonë shërbeu në Afrikë, në Greqi. Në Shqipëri ka shkuar më 7.11.1912; më 14.2.1913 ndoqi zhvillimet në Serbi e në Mal të Zi.

³⁵ Historia e Popullit shqiptar, Periudha e pavarësisë, 28.11.1912-7.4.1939, Vëll. III, Toena, Tiranë, 2007, faqe 62.

do të mbanin lidhje thjeshtë formale me Shqipërinë.³⁶ Krahas diplomacisë, grekët duke parë qëndrimin e lëkundshëm të Komisionit të Kontrollit dhe mosinteresimin e Fuqive të Mëdha, tentonin të pushtonin përsëri Korçën sikurse ndodhi në befasi natën më 2 prill 1914. Por befasia e grekëve u demaskua dhe shkatërrua nga xhandarmëria shqiptare, nën komandën e majorit holandez G. Snellen, që i thyen forcat armike. Ky guxim iu dha zemër Shqiptarëve të cilët u ngritën me shumicë, të udhëhequr nga Themistokli Gërmënjit dhe të komanduar prej Sali Butkës. Vidi dhe qeveria e Durrësit e Turan Pashë Përmetit shpresuan se erdhi rasti për t'i përzënë pushtuesit nga Shqipëria jugore dhe synonin të përgatitnin një forcë prej 10000 vullnetarësh në ndihmë të luftëtarëve të jugut. Por zbatues i planit do të ishte ministri i Luftës, i cili nuk kishte asnjë dëshirë për të ndihmuar "Toskët", edhe për faktin se kishte miqësi me grekët. Kur panë vendosmërinë e çetave të Sulo Beqirit, Çerçiz Topullit, Halil Sullos, Selam Musait etj, dhe forcat e tyre që arritën gjer në Virua më 22 prill 1914, përpara Gjirokastrës, qeveria greke bashkë me Zografin iu paraqitën Fuqive të Mëdha kërkesa më të zbutura, në dukje, por që në të vërtetë s'e ndryshonin aspak qëllimin dhe planin e Greqisë. Ishte një manovër për të fituar kohë e për ta pushtuar vendin ca nga ca. Nga të dhënat dokumentare del se në rajonin e Tepelenës dhe Përmetit ka qenë dhe i dërguari i Vilhelm Vidit, Kolonel Tomsoni, roli i të cilit mbeti në hije gjatë dhe pas gjithë masakrave që ndodhën në të gjithë jugun e Shqipërisë dhe sidomos pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Korfuzit. Tomsoni në fillim të marsit shkoi në Korfuz dhe i kërkoi guvernatorit Varatas si mik i Zografosit ta ndërmjetësonte për të takuar "ministrat" vorioepiriotë. Guvernatori, sikurse shkruan Dr.G.T.Goslinga, në librin "Holandezët në Shqipëri", mohoi se kishte lidhje me rebelët. Më 13 mars 1914 Karapanos me atributet e ministrit të jashtëm vorioepiriot erdhi në Korfuz dhe u takua me Tomsonin, i cili tejkaloi të drejtat e tij dhe premtoi autonomi qeverisë së Zografosit. Kjo ishte një lajthitje e Tomsonit me kosto të jashtëzakonshme për shqiptarët.

Shteti helen në këtë periudhë ka qenë "kanakari" i përkëdhelur i Antantës dhe Bllokut Qendror, pasi ata lakmonin pozitën e saj strategjike. Më 24 prill 1914, Fuqitë e Mëdha, e njoftuan Venizellosin se do t'u bënin lëshime "vorio-epirotëve" dhe se, "mund të pranonin rishikimin e kufirit greko-shqiptar në favor të Greqisë." Dhjetë ditë më vonë, më 5 maj 1914, qeveria e Turhan Pashë Përmetit, nga presioni i gjithanshëm ia besoi NKN zgjidhjen e konfliktit shqiptaro-grek. Por bisedimet ndërmjet NKN dhe përfaqësuesve "vorio-epirotë u zhvilluan shtatë ditë në Korfuz. Bisedimet filluan më 10 maj dhe përfunduan më 17 maj 1914 me nënshkrimin e një protokolli, që u quajt, "Protokolli i Korfuzit" ose siç quhet ndryshe edhe "Marrëveshja e Korfuzit e 17 majit 1914". Është fakt historik i hidhur se Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit nënshkroi me qeverin greke, në emër të qeverisë 6 mujore të Vidit, që përfaqësonte shqiptarët dhe po u bënte gjëmën shqiptarëve nën firmat e Tomsonit dhe Mehdi Frashërit.³⁷ Tomsoni po u jepte "nga xhepi" vorio-epiroteve disa

³⁶ Po aty faqe 62.

³⁷ Mehdi Frashëri (28.2.1872-25.5.1963) intelektual dhe politikan shqiptar; firmëtar i Protokollit të Korfuzit dhe ish-Komisar i Lartë në Komisionin Ndërkombëtar për caktimin e kufijve shqiptare në të gjitha etapat si, në delegacionet shqiptare në Konferencën e Parisit etj. Mehdi Frashëri kryesoi të gjitha komisionet parlamentare për hartimin e ligjeve (kodeve)

“të drejtave të veçanta” fqinjëve tanë jugorë. Ishte një lëshim që i bëhej, në marrëveshje midis Fuqive, politikës e diplomacisë greke, e cila nëpërmjet të ashtuquajturës “Lëvizja autonomiste vorio-epiriothe” synonte të pengonte tërheqjen e ushtrisë greke nga Shqipëria e jugut të parashikuar në protokollin e Firences të dhjetorit 1913, por edhe të synimeve të mëvonshme aneksioniste. Synohej gjithashtu të njëjhej greqishtja, si gjuhë e vetme fetare e komuniteteve ortodokse, ndërsa në shkolla, në organet shtetërore e gjyqësore gjuha e fqinjëve do të ishte e barabartë me shqipen. Por “Protokolli”, shërbeu për një manifestim të fuqishëm të qëndrësës së popullsisë shqiptare përballë fabrikimeve historike të fqinjëve. Siguria shqiptare sërish ishte në rrezik dhe kjo u vinte këtë herë nga “miqtë”, prandaj me të drejtë misioni i Tomsonit në Korfuz ishte një mit krejtësisht i thyer dhe i paautorizuar që nuk meriton nderim por vetëm përçmim, pse jo edhe ndëshkim.

6. Në vend të përfundimeve

Çështjet e sigurisë shqiptare kanë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Bota ka teori e praktika të shumta klasike dhe bashkëkohore që lidhen me sigurinë. Çdo gjë në shoqëri, shtet apo mes shteteve mund të bëhet çështje e sigurisë gjatë procesit politik e praktik edhe pse çështjet dhe problemet që lidhen me sigurinë nuk presin, sepse brenda vetë sigurisë është e tërësishmja, e qenësishmja dhe thelbësorja, pa të cilën dështon misioni dhe funksioni i vetë shtetit. Në asnjë rast shteti nuk mund të thotë që siguria “të presë”, sepse vetë ekonomia nuk mund të ngrihet pa siguri, shteti nuk mund të ketë themele të sigurta pa qetësinë e njerëzve dhe, nga ana tjetër, edhe prosperiteti vihet në dyshim pa siguruar siguri të qëndrueshme.

Përcaktimi i një çështjeje si çështje e sigurisë në parim arsyeton mundësinë e përdorimit të masave të jashtëzakonshme për t’iu përgjigjur situatës, duke mundësuar që shteti të përdorë autoritetin dhe forcën në mënyrë legjitime. Çështjet e sigurisë dhe rrugët e sigurimit të saj duhet të jenë pronë e publikut dhe jo vetëm e elitave. Kuptueshmëria dhe përgjegjshmëria përballë çdo kërcënimi nënkupton që aktorët dhe faktorët duhet të përfshihen dhe mos të delegojnë përgjegjshmërinë për siguri. Kërcënimet mbi sigurinë e brendshme e më tej, janë ekzistenciale dhe duhen ndarë me publikun, sepse masat e jashtëzakonshme kërkojnë aktorë e faktorë të gjerë, argumente mbi mundësinë e kundërpërgjigjes mbi kërcënimet të çfarëdo lloji qofshin këto. Shqiptarët me problematikën e sigurisë janë marrë që prej themelimit të shtetit dhe në vijimësi edhe në ditët tona. Siguria e brendshme dhe e jashtme shqiptare është shkruar në testamentin e themeluesit të shtetit, Ismail Qemali, i cili, para se të mbyllte sytë më 1919, la një amanet: “Djemtë e mi, nuk bëra pasuri që t’ju lë trashëgimi. Po ju lë një Atdhe amanet.” Dhe djemtë e tij ishin bijtë dhe bijat e të gjithë shqiptarëve që trashëgojnë “një Atdhe amanet”.

Këtu qëndrojnë gjurmët e pashlyeshme të pavarësisë, të mendimit politik, veprimtarisë e të lëvizjes shqiptare, të cilat përbëjnë një trashëgimi të vyer, një stafetë brezash, një mësim dhe testament i madh, që historia e kaluar i la së tashmes dhe të ardhmes së shqiptarëve.

ekonomike dhe ishte i pari që paraqiti nevojën e reformës agrare e themelimin e një Banke në Shqipëri. Nga viti 1923 e deri në vitin 1939, me disa ndërprerje të shkurtra, Mehdi Frashëri ishte në funksionin e deputetit të Parlamentit shqiptar dhe përfaqësuesit të Shqipërisë pranë Lidhjes së Kombeve (sot OKB) në Gjenevë të Zvicrës. (Sh.a)

Bibliografia:

- Historia e Popullit shqiptar, Periudha e pavarësisë, 28.11.1912-7.4.1939, Vëll. III, Toena, Tiranë, 2007.
- Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese “Kristalina KH”, Tiranë, 2009.
- Heatorn Armstrong, Kujtimet e sekretarit të Princ Vedit, “Gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë, 2002.
- Kristo Frashëri, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912). Tiranë: Kristalina – KH, 2008.
- Arben Puto, Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912 – 1914. Tiranë: Mihal Duri, 1978.
- Paskal Milo, Politika e Jashtme e Shqipërisë (1912 – 1939). vëllim i parë, Tiranë: Toena, 2013.
- Gazmend Shpuza: Kuvendime për historinë kombëtare, Tiranë, 2000.
- Buletini Arkivor Ushtarak, Nr.1/Mars 2011 dhe 2./Qershor 2011.
- Mexhit Kokalari, Bijtë e shpatës shqiptare, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2000.
- Zaho Golemi, Gazeta Telegraf, “Idriz Sulli prijësi dhe legjislatori popullor i Labërisë, 17.8.2013.
- Gazeta “Atdheu”, publikuar më Nr. 12 datë 25.5.1913; Gazeta Liria e Shqipërisë, datë 5 gusht 1915, Sofje Bullgari.
- Lumo Skëndo (Mitat Frashëri), “Kalendari Kombiar”, Tiranë, faqe 192.
- Teki Selenica, “Shqipëria në vitin 1927”, Tiranë, 1928.
- Qendra e Stud.albanologjike, Shqipëri-Austri, Reflektim Historiografik, Bot.albanologjike, Tiranë, 2013.
- Ksenofon Krisafi, “Çështja e Kufijve të Shqipërisë në Konf. Ambasadorëve Londër (1912 – 1913)”, Tiranë: 2008.
- Ferdinando Salleo, Shqipëria: Gjashtë muaj Mbretëri. Tiranë: SHLK, 2000.
- Eqerem Bej Vlora, Kujtime 1885 – 1925. botim i tretë, Tiranë: IDK, 2003.
- Tajar Zavalani. Histori e Shqipnis. botim i dytë, Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit, 1998.
- Valter Gjoni, Shqipëria në llogore luftërash, 1912-1922, Shtypshkronja Gent Grafik, Tiranë, 2014.
- Joep Zonne, “Ushtarakët holandezë në folezën shqiptare të grerëzave, 1913-14 - Kronika e një misioni të rrezikshëm paqësor” Holandë, 2014.
- Mehdi Frashëri, Kujtime 1913-1933, Shtëpia botuese: OMSCA-1, Tiranë, 2005.
- Burime gazetareske holandeze “Elsevier” (gazetë e përjavshme), datë 21.05.2014, dhe gazeta “NRC” datë 22.05.2014; gazeta “De Volkskrant”, datë 14.06.2014; Holandë.
- Gazeta “Drita”, publikuar në Gjirokastrë, 25 shtator 1924; Gazeta e Korçës, publikuar në Korçë, 6 shtator 1924.

ANALIZË STRATEGJIKE: PLANI ITALIAN I PUSHTIMIT TË SHQIPËRISË MË 1919 DHE SITUATA E BRENDSHME SHQIPTARE

Dr. Albert Hitoaliaj
Akademia e Sigurisë, Tiranë

Trajtesë e shkurtuar.

Dokumentacioni i riprodhuar në këtë material është përzgjedhur nga ai i ruajturi në Arkivin e Zyrës Historike, të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë italiane. Pamja që sjell ky material arkivor italian pasuron pikëshikimin për kornizën e madhe të ngjarjeve që ndodhën në Shqipëri në '20-'21. Kjo analizë ushtarake e strategjike e vitit 1919 hedh dritë më shumë mbi ngjarjet që ndodhën më pas: Lufta e Vlorës së 1920-s dhe vendimi i 9 nëntorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris, i cili konfirmoi edhe një herë pavarësinë e shtetit shqiptar dhe kufijtë e tij. Në thelb, gjeografia shqiptare ishte shkaku kryesor që prodhoi Luftën e Vlorës dhe kërcënimin kryesor për ndryshimin e kufijve e të statusit të Shqipërisë. Kjo gjeografi e ka rrënjën e ndikimit qysh në antikitetet dhe do të vijojë që ta ketë edhe në të ardhmen, sepse Vlora do të vijojë të jetë epiqendra e fuqisë kombëtare shqiptare dhe një prej porteve më të vlefshme të Mesdheut, i shoqëruar me Sazanin strategjik dhe prapatokën që shërben si mbështetje për fuqinë detare.

Këtë gjë sjell edhe ky dokument strategjik, të cilin e sjellim në faqet e "Revista Ushtarake" me rastin e 100 vjetorit të vendimit të 1921-shit.

Fjalë kyçe: gjeopolitikë, Lufta e Vlorës, Lidhja e Kombeve, siguria.

1. Hyrje

Më 9 nëntor këtij viti bëhen 100 vjet që nga viti 1921, kur Konferenca e Ambasadorëve të Anglisë, Francës, Italisë dhe Japonisë e rikonfirmoi edhe një herë sovranitetin dhe pavarësinë e Shqipërisë, sipas kufijve të vitit 1913. Ky material, duke synuar të rikujtojë këtë ngjarje, përpiket të sjellë një informacion të asaj kohe nëpërmjet një dokumenti i cili lidhet me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, më 1919-n. Rrethanat pas Luftës së Parë Botërore e rrezikuan në mënyrë serioze shtetin e sapokrijuar shqiptar. Pas Kongresit të Lushnjës, i cili ishte një ngjarje me rëndësi të madhe kombëtare, Shqipëria u detyrua që ta mbronte me armë në dorë sovranitetin e saj. Luftime të tilla si ato të Vlorës, Dibrës, Shkodrës etj., tregonin se shqiptarët ishin të vendosur për mbrojtjen e viseve të tyre dhe e të shtetit kombëtar. Lufta e Vlorës dhe marrëveshja shqiptaro-italiane (1920) patën një rëndësi të veçantë në njohjen e sovranitetit shqiptar. Pavarësisht se Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve më 17 dhjetor 1920, u desh më pas Konferenca e Ambasadorëve e 121-shit që të ripohohej sovraniteti i saj dhe tërësia territoriale. Një komision hetimor ndërkombëtar (i pari i këtij lloji) kreu vëzhgimet e tij në Shqipëri më 1921-1922. Raporti përfundimtar i këtij komisioni u dorëzua në vitin 1922 dhe pohonte se te shqiptarët ekzistonte një ndjenjë dhe dëshirë e fortë shtetformimi. Rreth dy vjet para këtyre zhvillimeve, Italia analizonte pozitën strategjike, gjendjen e brendshme të Shqipërisë dhe mundësinë për pushtimin e saj ushtarakisht. Dokumenti arkivor italian i vitit 1919 i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë italiane ndihmon në njëfarë mënyre që të kuptohet panorama e madhe e atyre ditëve.

2. Situata e përgjithshme e Shqipërisë së 1919-s dhe analiza për pushtimin e saj

Komanda e Trupave në Shqipëri, Shtabi i Përgjithshëm, N. 9688 op. – Konfidencial (I rezervuar), 11 nëntor 1919.

Lënda: Situata e përgjithshme e Shqipërisë dhe forcat që kërkohen për pushtimin e saj. Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Luftës, Komandës Superiore, Romë.

Gjenerallejtnant Piaçentini, komandant i trupave në Shqipëri.

Premisë

Sot, kur lufta ka mbaruar, kur paqja me Gjermaninë e Austrinë është firmosur e kur vendimet e Konferencës së Parisit janë vënë e kanë për t'u vënë në jetë, është e nevojshme rihapja e gjithë çështjes shqiptare, duke koordinuar mënyrat me përfundimet, duke

demonstruar situatën aktuale politiko-ushtarake dhe duke kërkuar nxjerrjen e propozimeve konkrete për sistemimin përfundimtar të Shqipërisë.

Në të shkuarën, nevojat e luftës, pavendosmëria nëse Shqipëria do të ishte ose jo nën mandatin e Italisë, dhe probleme të tjera më urgjente e më jetike për vendin tonë, kanë këshilluar një politikë, për ta quajtur, të ditës, duke u përpjekur që të zgjidhim tani njërin e tani tjetrin, në mbrojtje nga çdo goditje që na jepej, duke u përpjekur në fund të fundit që populli shqiptar, nën pushtimin tonë dashamirës, të linte mënjatë mëritë e brendshme e të jashtme dhe të priste në një qetësi relative vendimet për të ardhmen e tij. Vijimi i një politike të tillë sot, do të ishte jo vetëm i vështirë, por i rrezikshëm; nevojitet përbalja me problemin shqiptar e të ndikimit tonë ekonomik e moral në bregun juglindor të Adriatikut, me ballin hapur, vendosmërisht, me ide që tejkalojnë ato të së qenit mirë sot, e të së shpresuarit mirë për të nesërmen. Duhet të konkretizojmë në mënyrë përfundimtare se cilat janë objektivat tona të së ardhmes, të llogarisim nëse kjo urë drejt Lindjes, siç është Shqipëria, mund të na shërbejë, dhe atëbotë që të kemi konkretizuar planin, të ndërmarrim hapat e nevojshme për ta rregulluar, duke paralajmëruar ata që janë të ngarkuar për zhvillimin e çdo gjëje, që edhe sot kushtet e vendit nuk premtojnë veçse një pakicë mjetesh; por ata duhet të punojnë duke pasur gjithnjë parasysh objektivin përfundimtar, që do të përmbushet esencialisht me kalimin e kohës, përmes një linje sjelljeje të qëndrueshme e me një ndërgjegje pune konstante, të frytshme, të interesuar, të çdo italiani që dërgohet në Shqipëri.

Konsideratat, si të natyrës ushtarake dhe të natyrës politike, që duhen bërë mbi Shqipërinë, duhet t'u referohen dy zonave qartësisht të dallueshme që përfaqësojnë karaktere të ndara, që janë “Zona në veri të Shkumbinit” dhe “Zona në jug të Shkumbinit”¹.

Në momentin e parë, pushtimi italian i Shqipërisë qendrore dhe jugore, i kryer në shtator-tetor 1918, iu mbajt në thelb bregut duke u ngjitur në Vlorë-Durrës-Tiranë-Krujë-Lezhë e Shkodër dhe duke përfshirë krahina të tëra si Berati e Elbasani. Sapo trupat sistemuan bazat e tyre të nisjes dhe sapo stina e lejoi, nisi shtyrja në brendësi duke ndjekur linjat natyrale të komunikimit dhe duke përparuar ngadalë, sidomos për shkak të vështirësive logjistike.

Në periudhën mes përparimit tonë përgjatë bregut dhe përparimit pasues në brendësi, Esad Pasha, i financuar nga serbët, që i kishin premtuar rikthimin e një principate të vogël të pavarur në Shqipërinë e Veriut, duke u bërë thirrje bashkimi mbështetësve të tij të shumtë e duke ngritur banda të shumta, po ndizte fushatën esadiste të orientuar thelbësisht dhe vetëm kundër Italisë. Nga ana jonë u morën menjëherë masat e një fushate kundërvepruese (antiesadiste), drejtuar nga kapiten Campi, i cili me një bërthamë të fortë RR.Ç. rekrutoi xhandarët e parë, punësoi informatorë e kërkoi me çdo mënyrë që të bashkonte me ne kryetarët e krahinave të ndryshme. Përparimi i trupave tona deri në Qafë Bulqizë, Qafë Murrë, Orosh, Kukës dhe Hani i Spasit, kompletoi efektet e fushatës antiesadiste dhe në muajt korrik-gusht, mund të thuhej se nga linjat e mbajtura prej trupave tona deri në det,

¹ Fg. 9688 R. in data II, novembre 1919 del Comando Truppe: Albania, avente all'oggetto “Situazione generale dell'Albania e forze che si richiedono per la sua occupazione”, në: *L'esercito italiano nella grande guerra, volume vii, Le operazioni fuori del territorio nazionale Albania, Macedonia, Medio Oriente, tomo 3°bis, Documenti* (Roma: Ufficio Storico, Stato Maggiore Esercito, 1981), 107.

esadizmi ishte zhdukur plotësisht.

Pakësimi i vazhdueshëm i forcave tona, disa mësymje ndaj karvanëve tanë me pasojë vrasjen e ca ushtarëve tanë, të mbetura të pandëshkuara për pamundësi absolute të dhënies së pari një trupe të përshtatshme shoqërimi karvanëve, e mandej të ndërtimit të bërthamave të fuqishme trupash për operacione reprezaljeje, i kanë dhënë mundësi rilindjeje esadizmit, sidoqoftë kurrë si në ditët e para, dhe në të njëjtën kohë e kanë ulur shumë prestigjin tonë në sy të popullsisë shqiptare të egër e krenare, të Veriut, e cila me mentalitetin e vet që nuk kupton gjë tjetër veç forcës e shfarosjes, thotë se ne jemi të mirë, por të dobët.

Ndër të tjera, Shqipëria e Veriut përmban popullsinë më të egër e më të vështirë për t'u nënshtruar, të lidhur me traditat e saj të lashta, duke qenë kësajsoj shumë e vështirë për ta bërë që të pranojë të tjera; të shqyer nga luftërat vdekjeprurëse bajrak me bajrak, familje me familje. Gjakmarrjet shpërthejnë edhe pas një periudhe të gjatë sa jeta e një njeriu dhe kanë egërsi e shtrirje jo gjithnjë të llogaritshme. Popullsia injorante në kuptimin më të gjerë të fjalës, e paprekur kurrë nga ndonjë fije civilizimi, për shkak të mungesës absolute të komunikimit, e përkushtuar vetëm ndaj fanatizmit, në zonën e banuar nga katolikët është e gjitha në dorë të priftërinjve, te të cilët kanë besim të pakufishëm.

Në zona të tjera të Shqipërisë së Veriut, aty ku ekziston, si në mes të mesjetës, feudalizmi më absolut, janë të vazhdueshme luftërat mes bajraktarëve dhe nuk është gjë e lehtë që t'i mbash të gjithë të kontrolluar, të kënaqur dhe t'i lidhim pas nesh, sepse armiqësitë, intrigat, smira fshikullojnë në çastin kulmues edhe muaj të tërë propagande të vazhdueshme politike.

Pushtimi italian dhe sistemimi akoma i papërcaktuar i Shqipërisë u kanë lejuar atyre zonave, deri sot, një qetësi relative. Por është e thjeshtë për t'u parashikuar se ç'ndodh nëse mungon prezenca efektive e trupave tona, nëse integriteti i Shqipërisë do të jetë i cenuar dhe nëse forma e qeverisë që do të drejtojë vendin nuk do të jetë e tillë që, në mos të kënaqë të gjithë, pasi kjo është e pamundur, të kënaqë pjesën më të madhe të prirjeve të ndryshme e të aspiratave të ndryshme të kryetarëve e krahinave më me influencë².

Kjo qetësi e sotme, në dukje, do të turbullohej të nesërmen nga luftime të dhunshme vdekjeprurëse, në të cilat do të luajnë fortë elementët serbë e jugosllavë, kundërshtarët tanë, dhe që do të na detyrojnë të mbetemi spektatorë të ngurtë, duke humbur kësajsoj jo vetëm çdo përfitim të arritur, por duke copëtuar prestigjin tonë të Fuqisë së Madhe, që ka pasur një mandat dhe nuk ka ditur ta konkretizojë; ose, duke na detyruar që të rikthehemi në vend dhe të ndërmarim ne direktivat e qeverisë. E gjitha kjo, me shumë më shumë shpenzime e me shumë më shumë sakrifica nga ato që janë bërë deri më sot.

Më vonë, pas shfaqjes së elementit jugosllav, të përmendur më sipër, në Mal të Zi, i favorizuar dukshëm nga Komanda franceze e Garnizonit të aleatëve në Shkodër, përparimi i trupave italiane u shtri në veri të këtij qyteti, duke e rrethuar e duke u shtyrë deri në Kastrat dhe hyri në luginat e Alpeve Veriore shqiptare.

Për t'u rikthyer, situata politike në veri të Shqipërisë prezantohet sipas aspekteve vijuese:

² Ibid., 109.

garnizone serbe në Drin dhe përgjatë kufirit malazez që nxisin sulme të vazhdueshme bandash të parregullta kundër vendqëndrimeve tona të rojeve; banda të armatosura që shfaqen me intervale në zonën malore, të ashpër dhe të padepërtueshme, duke pasur parasysh vendosjet tona, e jo vetëm kaq, por edhe duke sulmuar kur munden, detashmente të izoluar të trupave tona; popullsi që nuk ndihet plotësisht e mbrojtur e kësodore nuk guxon të hidhet vendosmërisht në anën tonë; luftime vdekjeprurëse mes familjeve që e mbanë zonën në gjendje të vazhdueshme lufte, duke e penguar çdo ekspansion ekonomik e tregtar; ambicie kryetarësh me peshë që nuk duan të njohin mbi ta asnjë autoritet, sidomos nëse është shqiptarësh; pakësim i vazhdueshëm i forcave tona derisa bëhen qesharake krahasuar me nevojat, dhe zvogëlimi i vazhdueshëm i prestigjit, - të gjitha, gjëra që sjellin në mos humbjen e plotë, atë të një pjese të mirë, të asaj që është fituar në të shkuarën.

Situata politike në zonën në jug të Shkumbinit

Është shumë më e mirë se sa në Veri, edhe pse zona është prej një kohe të gjatë nën pushtimin tonë. Sot, kur marrëveshja italo-greke mban larg, për momentin, rrezikun e Greqisë i cili ishte më kërcënuesi në fushën jugore të shahut, nuk kemi kundër nesh veçse partinë nacionaliste që ka si qendër kryesore Gjirokastrën. E përbërë esencialisht nga myslimanë, armiq të hidhur të grekëve, të cilët i kundërshtojnë edhe Italisë çdo pazarllëk në Shqipëri, e quan uzurpim dhe tradhti pushtimin e qëndrueshëm të Vlorës dhe të prapatokës së saj. Kryetari në fuqi i kësaj partie, edhe pse nuk është plotësisht e qartë, është anëtari i Qeverisë së Përkohshme, Mufid bej, person i pabesë ndaj nesh e të cilit i është dhënë, ndoshta për fatalitet të rrethanave, tepër autoritet e tepër rëndësi. Kjo parti nacionaliste, e mashtruar nga kryetarët, i shërben thelbësisht interesave dhe ambicieve të tyre; por nuk mund të thuhet vërtetë se ka një ndikim të madh mbi popullin shqiptar, sepse i mungon fryma e besa, përderisa ideja e Shqipërisë së pavarur nuk është dëgjuar në të vërtetë vetëm prej pakëve, teksa është marrë si flamur nga disa bejlerë lakmitarë për para, nga marifetçinjtë politikë e nga intrigantët. Një politikë e mprehtë jona, që do të eliminonte vërtetë kërcënimin grek, e bashkuar me prurjet përfituese të pushtimit tonë, do të ishte më se e mjaftueshme për t'u çjerrë maskën këtyre mashtruesve dhe për t'i demonstruar popullit shqiptar ndershmërinë dhe sinqeritetin e qëllimeve tona³.

Përveç banditizmit, që lulëzon edhe këtu njësoj si në zonën në veri të Shkumbinit, shkak frike të vazhdueshme për Shqipërinë jugore është edhe ndarja që ekziston ndërmjet elementit ortodoks dhe elementit mysliman, e shpërthyer sot për shkak të tentativës franko-greke për t'ia dhënë Korçën Greqisë, dhe nga marrëveshja italo-greke, që nuk i është sqaruar sa duhet këtij popull mosbesues e dyshues. Origjina e saj është shumë e lashtë dhe rilindi gjatë masakrave të kryera nga grekët në fushatën ballkanike të '13-s dhe gjatë pushtimit të '14-s, masakra që sot gjejnë hakmarrje te përshkallëzimi i krimeve e vrasjeve pa arsye grabitjeje, të kryera nga myslimanët kundër ortodoksëve.

Përderisa një qeveri e qëndrueshme, e sinqertë, nuk u jep garanci dy partive që të mbrojnë njësoj, të dyja, aspiratat dhe besimet e tyre, e që krahas lejimit të çdo lirie fetare, të mos

³ Ibid., 110.

njohë asnjë dallim ndërmjet myslimanëve e ortodoksëve, në jetën civile e politike, Shqipëria jugore do të mundë kurrë që të fitojë stabilitet. Ky i fundit mund të bëhet realitet përderisa të zgjasë pushtimi dhe ndikimi italian; në asnjë mënyrë nuk mund të arrihet kjo gjendje, sikur ky [pushtimi] të zëvendësohet nga ai grek. E vetmja pikë e marrëveshjes italo-greke, është fakti se Korça ishte gati për t'u pushtuar nga grekët, teksa ne nuk kishim mundësi t'i parandalonim për këtë krahinë, me trupat tona, ashtu siç ishte kërkuar nga të gjithë, gjë që dëmtoi prestigjin tonë në Shqipërinë jugore. Sot, kur fati i Korçës nuk është vendosur akoma qartësisht (dhe kur shqiptarët frikohen edhe për atë të Gjirokastrës), është një fakt i qartë për të gjithë që sapo greku të tejkalojë kufirin e Londrës, çetat e parregullta dhe milicia e rregullt shqiptare, që janë në librin tonë të pagës e që na kanë shërbyer gjithnjë me besnikëri, do të dezertonin masivisht, për të themeluar çeta vullnetarësh kundër grekëve. Kundërvënia ndaj një akti të tillë, do të thoshte humbje e të gjithë fryteve të fituara në katër vite të qëndrimit tonë e do ta bënin shumë të pasigurt pushtimin tonë të ardhshëm të Shqipërisë jugore.

Largimi i francezëve nga ajo pjesë e Shqipërisë të cilën e sundojnë akoma, dhe pushtimi i së njëjtës krahinë nga ana e trupave tona do të ishte shumë i vlefshëm për prestigjin tonë, pasi do t'i demonstroi në mënyrë të qenësishme popullsisë shqiptare që, edhe pse ekziston një pakt italo-grek për shumë arsye të tjera, ai nuk ka të bëjë me integritetin e Shqipërisë së njohur nga "Traktati i Londrës".

Nga ana tjetër, mbrojtja dhe respekti i treguar nga ne për "ishujt" e kombësisë greke që gjenden në Shqipërinë jugore, teksa do e bënin besnik ndaj nesh elementin greko-ortodoks, e detyrojnë popullsinë e mbetur që të njohë veprimin e ndershëm dhe qytetarinë e lartë të Italisë.

Kushtet logjistike

Në gjithë Shqipërinë ekzistojnë këto rrugë të kalueshme kamionët:

- 1) Vlorë – Tepelenë – Gjirokastrë – Jorgucat;
- 2) Vlorë – Himarë – Porto Palermo – Sarandë;
- 3) Sarandë – Delvinë – Jorgucat;
- 4) Tepelenë – Këlcyrë;
- 5) Këlcyrë – Përmet – Berat;
- 6) Berat – Leskovik – Ersekë – Korçë;
- 7) Vlorë – Ura e Drisit (sic) – Fier – Kavajë – Durrës (kalimi qendror Fier – Kavajë është i kalueshëm vetëm në kohë të mirë, për shkak të terrenit baltovinë që ka në pjesë të madhe);
- 8) Durrës – Vorë – Lezhë – Shkodër – Kastrat (e shkëlqyer, mungon vetëm ura e Matit);
- 9) dega Vorë – Tiranë;
- 10) dega Ura e Ishmit – Krujë.

Gjithë pjesa e mbetur e komunikimeve kryhet në rrugë mushkash apo shtigje dhe në ndonjë shtrirje të rrallë, në rrugë qerresh e udhë të kalueshme vetëm në ata pak muaj kohe të mirë. Duke parë në hartë rrugët e sipërpërmendura, shihet se ato shtrihen thelbësisht në Shqipërinë jugore, në pjesën e pushtuar nga ne; ato të pakta të Shqipërisë veriore,

gjarpërojnë të gjitha përgjatë bregut, përveç asaj të Tiranës, dhe shihet lehtësisht se sa larg janë ato nga garnizonet që janë më në brendësi. Ndërsa e gjitha kjo krijon një vështirësi të pamat për shërbimet e furnizimit të ushqimeve, duke detyruar formimin e karvanëve të gjatë që duhet të shoqërohen në mënyrë të fuqishme, sjell gjithashtu edhe ngadalësimin e çdo shërbimi korrespondence, arsye kjo që komunikimet e shërbimit duhet të zhvillohen kryesisht përmes telefonit dhe telegrafit, në mënyrë që regjimentet tona më të largëta të mos braktisen në vetvete.

Shërbimet e karakterit publik (telegraf, telefon, postë, furnizim ushqimor) dhe një pjesë e mirë e shërbimeve private, janë kryer përmes mjeteve tona, pasi vetë Shqipëria nuk zotëron asgjë. Pra, rezulton qartësisht se, nëse populli shqiptar lihet në një çast në punë të tij, duke rikthyer trupat tona, ky popull nuk do të mund të jetonte më vete, qoftë për shkak të arsyeve politike, edhe për shkak të atyre logjistike. Ose do të binte në mjerimin më të madh e në mungesë të çdo drite qytetërimi, si më parë, ose do të lëshohej në dorë të ndonjë tjetri që do e ndihmonte.

Shkodra

Mosndëshkimi i ofruar nga regjimi i aleatëve ndërkombëtarë e ndoshta edhe bashkëjetesa e saj, lejon që Shkodra të jetë qendra ku mblidhen fijet e veprimeve esadiste dhe serbe, të drejtuara kundër nesh. Është e ditur mandej, se Shkodra me Vlorën dhe Gjirokastrën, janë tre qendrat më të mëdha të propagandës nacionaliste, të kryer, siç u tha më parë, më shumë nga intrigantë të etur për para e për pushtet e të patolerueshëm ndaj kontrollit, se sa nga vullneti i përbashkuar i popullsisë shqiptare. Atëbotë që të vendoset se mandati për Shqipërinë do i jepet Italisë, mund të bëhet e mundur që Franca do të linte sa më parë Shkodrën, duke i dhënë fund kështu fushatës së hapur armiqësore, të drejtuar nga kjo komandë franceze kundër nesh; një fushatë e cila mbron serbët e jugosllavët duke i vënë nën maska të ndryshme në Shkodër, si pasojë me infiltrimet e emisarëve të tyre në territoret që kemi pushtuar ne, për ta mbajtur gjallë fushatën esadiste, derisa sa të arrestohen e të përzihen nga Shkodra funksionarët e Qeverisë së Përkohshme, vetëm e vetëm se kjo qeveri mbështetet nga Italia. Na duhet të lejojmë kësisoj, një influencë më të fuqishme në këtë qytet që do të ishte pika e nisjes për një politikë tonën të sigurt dhe të vlefshme, drejt mesit të Drinit dhe drejt zonave të Malësisë, të Shalës e të Kastratit⁴.

Situata ushtarake

Në skemën veriore, trupat tona rëndojnë nga njëra anë drejt Bunës, e cila do të përfaqësonte për serbët rrugën më të thjeshtë të pushtimit sepse do të na shkëpuste nga portet, që janë jetikë për ne: nga ana tjetër [trupat tona] janë dislokuar në brendësi, përgjatë maleve të bregut të majtë të Drinit të Zi dhe në Shkumbinin e epërm, në një distancë ajrore nga bregdeti, ndërmjet 40-80-100 kilometrash, të cilët njehsohen për ato zona në 6-8-10 e më shumë, ditë marshimi më mushkë për të arritur në brigjet e garnizoneve tona. Trupat tona, me gjithë urdhrat e pa marrë kurrë një shtesa, kanë një fuqi mesatare prej pak më shumë se

⁴ Ibid., 111.

njëzet pushkë për kompani, sigurisht duke zbritur detyrat speciale dhe njerëzit e duhur të shërbimeve të ndryshme.

Në skemën jugore, duke hequr trupat përqark Vlorës, të cilat janë ato në dispozicion të Komandës së Trupave për çdo ngjarje, dhe që në momentet e fundit duhet të mbanë llogoret e kampit, pushtimi ynë shtrihet, pjesërisht në bregdetin nga Vlora në Sarandë, duke vigjiluar për aq sa është e mundur me trupat e dislokuara në Tepelenë, zonën e Kurveleshit, e cila është më e infektuara me kaçakë, dhe duke mbetur atje, i prezantuar nga bersalierët e 10-të, dislokohet përgjatë gjithë kufirit grek. Pjesa lindore e rrjedhës së Osunit, në kufirin e Londrës, i cili përfshin provincën e Korçës, sot është akoma e pushtuar nga francezët⁵.

Trupat italiane që duhet të qëndrojnë në Shqipëri

Nga sa u tha më sipër përmbledhur, dalin në pah të dhënat faktike si në vijim, të cilat influencojnë në jetën e Shqipërisë:

- 1) shtrirja e territorit shumë e gjerë;
- 2) zonë e papërshkrueshme, pak e populluar dhe e fshehtë;
- 3) rrjete rrugore pothuajse joekzistuese në brendësi;
- 4) popullsia që pjesërisht na beson e pjesërisht jo; veçse kjo e fundit nuk merakoset nëse ne rrimë ose jo, pasi dyshon se nuk kemi forca të mjaftueshme për ta mbrojtur nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm;
- 5) shtete kufitare (Jugosllavia e Serbia) me përbërje jo të stabilizuar dhe kundërshtarë me në; nga Greqia, përderisa ekziston marrëveshja italo-greke, nuk duhet të jemi tërësisht të paimterësuar, sepse ajo me siguri që do të vazhdojë të ketë popullsinë ortodokse në favor të saj;
- 6) propaganda franceze në Shkodër e në Korçë, në favor të serbëve e grekëve, propaganda e Kryqit të Kuq Amerikan në qendrat më të mëdha shqiptare, në favor të vet me qëllim tregtar dhe simpatizues për popujt e ndryshëm që rrethojnë Shqipërinë;
- 7) kusari, gjakmarrje që turren ngado, të cilat mbeten shumicën e herëve të padënuara e që pengojnë çdo siguri transiti e tregtie në brendësi;
- 8) ndarje të thella mes familjeve, mes fshatrave e mes religjioneve, për çështje interesash, politike e të besimit fetar;
- 9) mungesë e një qeverie të qëndrueshme e të respektuar, që të fusë në udhë forcat e ndryshme të kombit, drejt mirëqenies së tij morale e materiale;
- 10) e nevojshme për ne që nga ana e Konferencës së Paqes të sistemohet Shqipëria, sepse na është pakësuar përgjegjësia dhe duhet të afirmohet influenca jonë mbi të⁶.

Duke dhënë në këtë mënyrë situatën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë, mund të merren në konsideratë tre raste, në lidhje me problemin e forcave ushtarake që do të duhet ta pushtojnë, sipas asaj që Qeveria Mbretërore do të synojë të përcaktojë çështjen shqiptare, në një mënyrë a në një tjetër:

⁵ Ibid., 113.

⁶ Ibid., 114-115.

1. – Të pushtojë të gjithë zonën, nga kufiri i Londrës në det

Në këtë rast, nevojiten sot (më vonë me sistemimin politik të përcaktuar, mund të pakësohen) forcat tashmë ekzistuese dhe të përmendura, të grupuara në dy divizione efikase, e që të jenë të drejtuara nga një politikë e kujdesshme dhe e qartë, nga ana e qeverisë sonë. Divizioni i 13-të plus brigadën e përmendur “Udine”, do të pushtonte zonën në veri të Shkumbinit dhe do të përfundonte në garnizonet italiane në Malin e Zi; Divizioni i 36-të bashkë me bersalierët e 10-të, do të pushtonte zonën në jug të Shkumbinit dhe kampin e fortifikuar të Vlorës. Krahas pasjes së fuqisë luftarake, njësitë e përmendura do të kenë nevojë për shërbime të mëdha të çdo lloji, sidomos për mjete transporti bagazhesh dhe kamionë e transmetues (telegrafë dhe radiotelegrafë).

2. – Pushtim i kufizuar vetëm në bregdet

Në këtë rast do të nevojitej një divizion në tre brigada, që do të zinte me një regjiment dhe një batalion, shtrirjen nga Buna në Vjosë, me dy batalionet e tjerë shtrirjen nga Porto Palermo në Sarandë, dhe me dy brigada kampin e fortifikuar të Vlorës. Ky divizion duhet të mbështetet nga shërbimet e një trupe operacionale përtej detit.

3. – Pushtim i kufizuar në kampin e fortifikuar të Vlorës

Izolimi i rajonit të mbetur shqiptar, pasiguria për atë që mund të ndodhë nesër me kufirin e Londrës dhe nevoja për të dhënë siguri absolute nga ana e tokës në bazën e Vlorës, e shtyjnë këtë komandë, që të shohë si të nevojshëm, më sistemimin e kryer, një divizion efikas me shërbimet e një trupe ekspedite të përtej detit. Në Gjirin e Vlorës duhet të jenë të vendosura gjithmonë, një ose dy njësi të Marinës Mbretërore.

Nga tre rastet e lartpërmendura, i dyti dhe i treti, nuk do i përgjigjeshin në mënyrë të plotë qëllimeve që ne ofrojmë për t’u realizuar, me mbajtjen e një force të armatosur në Shqipëri, që d.m.th.: sundim në Adriatik dhe ekspansion ekonomik në Shqipëri dhe Ballkan.

Përkundrazi, nëse pushtimi i brigjeve mund të na lejojë kontrollin për zbarkimet në pjesën juglindore të Adriatikut (Buna, Shëngjini, Durrësi, Vlora, Saranda), do të linte megjithatë, jashtë influencës sonë, rrugëkalimet për në brendësi, drejt Maqedonisë, Greqisë dhe qendrave shqiptare më të rëndësishme, si, Shkodra, Kruja, Tirana, Elbasani, Berati dhe Korça.

Pushtimi mandej, vetëm i kampit të fortifikuar të Vlorës, krahas pengesës së lartpërmendur, do të kishte si tjetër, edhe mosgarantimin në mënyrë të sigurt të sundimit të Adriatikut, sepse edhe pse do sigurohej Kanali i Otrantos, do të mbetej zbuluar Kanali i Korfuzit, sundimi i të cilit do na kërcënonte. Përvoja tregon se sigurimi i neutralitetit në Kanalin e Korfuzit, nuk mund të merret si garanci e mjaftueshme⁷.

2.1. Pasqyra e humbjeve të njërive italiane në operacionet në Shqipëri, 1916-1920

Dokumenti tjetër arkivor: “Pasqyra e humbjeve të njërive italiane në operacionet në territorin e Shqipërisë, 1916-1920”, jep një panoramë të përpjekjeve të vazhdueshme italiane për zotërimin e hapësirës gjeografike shqiptare, e cila do t’u mundësonte atyre një siguri më të lartë dhe një pozicion gjeostrategjik më të favorshëm për Ballkanin dhe

⁷ Ibid., 115-116.

Mesdheun.

Për ato raste ku shënohet “të humbur”, nënkuptohet se janë të vdekur, por që nuk u është tërhequr trupi për shkak pamundësie. Gjithashtu, merren në konsideratë edhe humbjet e shqiptarëve që shërbenin në reparte italiane ose të shtuara. Për shembull, në sulmin e gushtit të vitit 1918, numërohen mes shqiptarëve këto humbje: 26 të vdekur, 75 të plagosur, 14 të humbur.”⁸

PASQYRA E HUMBJEVE TË NJËSIVE ITALIANE NË OPERACIONET NË TERRITORIN E SHQIPËRISË								
Viti dhe cikli operativ	Të vdekur		Të plagosur		Të humbur		Totali	
	Oficerë	Trupa	Oficerë	Trupa	Oficerë	Trupa	Oficerë	Trupa
1916.								
-Pushtimi, mbrojtja dhe boshatisja e Durrësit	-	15	5	94	20	706	25	815
-Operacione më të vogla	1	8	5	50	5	90	11	148
1917.								
-Operacione të ndryshme	3	19	4	48	-	26	7	93
1918.								
-Mësymja në muajin gusht.	20	114	20	512	-	-	40	626
Kundërsulmi austriak dhe avancimi final.	12	106	21	310	-	-	33	416
1920.								
-Periudha e ngjarje të tjera, përfshirë edhe kryengritjen e 1920-s.	19	192	36	390	20	108	75	690
Totali	55	454	91	1404	45	930	191	2788

3. Raporti i parë i një komisioni hetimor për Shqipërinë nga një organizatë ndërkombëtare (Lidhja e Kombeve), nëntor 1921 – prill 1922

Pavarësisht shpresave dhe përpjekjeve të elitës politike shqiptare të fillimit të viteve ‘20-të të shekullit të kaluar, që Fuqitë e Mëdha t’ia kalonin Lidhjes së Kombeve çështjen e përcaktimit të statusit dhe kufijve të shtetit shqiptar pas pranimit të tij në këtë organizatë (17.12.1920), kjo gjë nuk ndodhi. Vendimmarrja për këtë çështje u arrit në Konferencën e Ambasadorëve II të Fuqive të Mëdha, Paris 9 nëntor 1921. Kjo konferencë detyronte Lidhjen e Kombeve të merrej me zbatimin e këtij vendimi në terren.

⁸ “Specchio delle perdite delle Unità italiane nelle operazioni sul territorio di Albania” në: *L’esercito italiano nella grande guerra, volume vii, Le operazioni fuori del territorio nazionale Albania, Macedonia, Medio Oriente, tomo 3°bis, Documenti* (Roma: Ufficio Storico, Stato Maggiore Esercito, 1981), 174.

Për të hetuar situatën në vend, pavarësisht pretendimeve të palës shqiptare, asaj serbo-kroato-slllovene, apo greke, më 19 nëntor 1921 mbërriti në Shqipëri i pari komision hetimor i organizatës së parë ndërkombëtare, siç ishte Lidhja e Kombeve, që përfaqësonte një shpresë të madhe për popujt e vegjël. Në këtë logjike ky komision u prit me entuziazëm nga popullsia lokale, anëtarët e Regjencës dhe qeveria shqiptare e kohës. Komisioni përbehej nga tre anëtarë e një sekretar, që vinin nga Norvegjia, Luksemburgu dhe Finlanda.

Detyra e tyre ishte së pari: të informohej Këshilli i Lidhjes për tërheqjen e trupave serbo-kroato-slllovene dhe ato shqiptare në përputhje me vijën kufitare të vendosur nga Konferenca e Ambasadorëve II 1921, të ndihmohej procesi që kjo të ndodhte pa incidente; së dyti: të vëzhgohej situata e brendshme politike në Shqipëri, duke u përpjekur që të shmangeshin trazirat e brendshme.

Të dhënat e para, por të paformuluara në një raport zyrtar, ky komision i përcolli në Gjenevë një javë pas mbërritjes, 25 nëntor 1921. Ata njoftonin se procesi i tërheqjes së trupave të dy palëve kishte filluar, dhe çfarë ishte më e rëndësishmja për historinë tonë shtetformuese, ata njoftonin se e tërë popullsia, pa asnjë mëdyshje, aspironte fuqishëm për një politike kombëtare të pavarur. Komisioni njoftonte se ishin formuar tre partitë e para politike: Partia Popullore (parti e intelektualëve liberalë që kërkonin reforma të shpejta), Partia Progresiste (parti e bejlerëve dhe pronarëve të tokave, si e tillë më konservative në politikën e saj), dhe Partia Indipendente, e paqëndrueshme në programin e saj dhe lëkundej mes dy partive të mëdha. Komisionin dëshmonte se në vend ekzistonte besimi se një monarki konstitucionale, do ishte forma më e mirë e qeverisjes për kohën (të dalë nga një trashëgimi e gjatë perandorake). Qeveria ishte një qeveri koalicioni, e përbërë nga tre partitë politike dhe nga tre besimet. Sipas tyre ajo përbëhej nga njerëz intelektualë e patriotë, të angazhuar për të kryer përmirësime të rëndësishme në disa fusha, veçanërisht tek punët publike. Vendi kishte pasuri e burime të mëdha natyrore, por të pashfrytëzuara për shkak të gjendjes si vend i pushtuar për një kohë të gjatë⁹.

Raporti i parë i plotë i këtij komisioni për Këshillin e Lidhjes u realizua me 24 prill 1922. Ai ishte i plotë dhe fryt i një pune 5-mujore në terren. Përballë udhëzimeve që i ishin dhënë në fillim në Gjenevë, ai analizonte ndjenjën e shtetformimit të shqiptarët, ndjesitë kombëtare, gjendjen ekonomike, organizimin politik e shoqëror, marrëdhëniet me vendet fqinje, ndërtimin e institucioneve shtetërore, problemet sociale, etj. Vlen të veçojmë një ndër konkluzionet e tij:

“Megjithëse ka tre besime fetare . . . manifestimet fanatike aq të shpeshta në vendet e tjera që janë të ndara në besime fetare, janë krejt të rralla në Shqipëri. Përkundrazi, rregulli i përgjithshëm është një tolerancë e jashtëzakonshme . . . kjo provon që ndjenja e patriotizmit është më e fortë se divergjencat fetare. Vuajtjet e përbashkëta nga të qenit teatër operacionesh ushtarake në luftëra të gjata i kanë dhënë impuls nacionalizmit shqiptar i shtrirë tek të gjitha klasat e shoqërisë. Çdo përpjekje për të penguar këtë ndjenjë legjitime

⁹ Public Record Office, FO 371/5735, C23754/580/90.

Burimi elektronik: <https://punetejashme.gov.al/al/arkiva-e-rubrikes/raporti-i-pare-i-nje-komisioni-hetimor-per-shqiperine-nga-nje-organizate-nderkombetre-lidhja-e-kombeve-nentor-1921-prill-1922>

do ishte e dështuar dhe do të kishte pasoja për paqen në Ballkan . . . Nga ana tjetër, në qoftë se ndjenja kombëtare lejohet të zhvillohet, ka çdo arsye për të besuar që cilësitë e racës shqiptare, traditat e saj, inteligjenca e lartë, dhe shija e saj artistike do t'i jepte mundësi këtij populli të vogël të kontribuonte në një të ardhme të afërt tek kultura botërore”.¹⁰

Lufta e Vlorës e 1920-s, e cila u zhvillua një vit para shkrimit të këtij raporti hetimor ndërkombëtar, vërtetonte më së miri përfundimet e tij lidhur me ndjenjën e fuqishme patriotike kombëtare shqiptare dhe dëshirën për shtetformim. Pjesa ku raporti shprehet: “në qoftë se ndjenja kombëtare lejohet të zhvillohet”, vlen të analizohet me kujdes, pasi lidhet me ndikimin sistemit, gjeografisë, gjeopolitikës dhe interesave të vendeve fqinje e më gjerë të shqiptarët.

4. Përfundime

Lufta e Vlorës e 1920-s ishte një ngjarje me rëndësi të madhe historike për dy arsye themelore: 1) ripërsëriti fuqishëm mesazhin se shqiptarët kishin bindjen dhe dëshirën e patundur për organizimin e shtetit të tyre të pavarur, jashtë ndikimit të fuqive të huaja dhe, 2) qartësoi më shumë idenë, se në planin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve, interesi shtetëror i secilit shtet është boshti i veprimtarisë së tij kombëtare e ndërkombëtare. Këtë të fundit Italia e dëshmoi duke ndjekur realizimin e plotësimit të objektivave të veta strategjike. Sipas dokumenteve të kohës, Lufta e Vlorës pati një mbështetje të gjerë kombëtare, si nga populli, edhe nga qeveria, e cila në hije mbështeste largimin e Italisë dhe synonte krijimin e një Shqipërie pa ndikime të huaja.

Ngjarje të këtij niveli duhen parë në kuadrin e gjerë strategjik dhe gjeopolitik. Hulumtimi i arkivave italiane, greke, serbe, franceze etj., lidhur me këtë ngjarje do të bënte që ngjarja të zbardhte ndikimet dhe interesat e huaja në Shqipëri. Retrospektiva arkivore mundëson që të kuptohet më mirë e tashmja, pasi në kontekstin strategjik e gjeopolitik, Shqipëria nuk e ka humbur rëndësinë e vendndodhjes. Nuk mungojnë as interesat e aktorëve të djeshëm, të para 100 viteve në rajon; të njëjtët aktorë janë prezentë në skemën ballkanike gjeopolitike. Por, kanë ndryshuar mënyrat e qasjet drejt plotësimit të interesit kombëtar të këtyre shteteve. Analiza e gjerë strategjike e Luftës së Vlorës, duhet me doemos të lidhet me një analizë të natyrës gjeopolitike që paraqet Shqipëria dhe të kuptuarit se në ç’pozicion ndodhet ajo, brenda skemës ndërkombëtare. Nuk është rastësi që Vlora të ketë pasur peshë që nga koha e luftërave ilirike e Cezarit, e deri në Luftën e Ftohtë, në synimin e transformimit të saj në bazën më të rëndësishme detare të Traktatit të Varshavës, e madje deri sot, kur ajo paraqet një vlerë strategjike për cilëndo aleancë në të cilën bën pjesë Shqipëria.

Po ç’pozicion zë Vlora në skemën detare mesdhetare? Vlora ndodhet në boshtin Venecia – Otranto – Suez; në boshtin Gjibraltari – Otranto – Selanik – Dardanele; në gjysmëhënën detare Otranto – Ishuj Jonianë – Peloponez – Kretë – Rodos; në fashën që ndan Mesdheun Lindor nga Mesdheu Perëndimor: Otranto – Ngushtica e Mesinës – Kanali i Maltës

¹⁰ Public Record Office, FO371/7329,C6071/735/90.

Burimi elektronik: <https://punetejashme.gov.al/al/arkiva-e-rubrikes/raporti-i-pare-i-nje-komisioni-hetimor-per-shqiperine-nga-nje-organizate-nderkombetre-lidhja-e-kombeve-nentor-1921-prill-1922>

– Kanali i Sicilisë; është në grykën e një prej 12 ngushticave mesdhetare, një prej më të rëndësishmeve pasi mbyll Detin Adriatik, cili është deti që depërton më thellë drejt Perëndimit (figura 1). Këto ishin vetëm disa detaje të rëndësishme strategjike, që lidhen thellësisht me gjeopolitikën dhe me Vlorën si pasuri e çmuar e Shqipërisë. Duke qenë se ka një pozicion të tillë, ajo ka edhe një fat të paracaktuar: do të lakmohet. Rëndësia e saj ka qenë “shkaktarja” e vërtetë e Luftës së Vlorës. Dua të përmend në mbyllje një formulim që revista e njohur gjeopolitike “Limes”, e jepte pas një analize kritike për humbjen e fuqisë detare të Italisë, në rrafshin e gjerë historik: *Harresa e privilegjit gjeografik rrezikon prodhimin e dëmeve të pandreqshme*¹¹. Vlora nuk duhet harruar.




Figura 1.
Ngushticat e Mesdheut, hartë nga: Laura Canali,
 “Il mare non bagna l’Italia, - Editoriale del numero”, *Mediterranei*,
Limes 6/17– rivista italiana di geopolitica (Roma, 3.7.2017)

¹¹ “Il mare non bagna l’Italia, - Editoriale del numero”, *Mediterranei*, *Limes* 6/17– rivista italiana di geopolitica (Roma, 3.7.2017)
 Burimi elektronik: <https://www.limesonline.com/cartaceo/il-mare-non-bagna-litalia?prv=true>



ABSTRACTS IN ENGLISH

“REVISTA USHTARAKE”, ED.1, SEPTEMBER, 2021

DEFENDER EUROPE 21, our greatest commitment

Major General Assoc. Prof. Bajram BEGAJ
Chief of General Staff of the Armed Forces

ABSTRACT

The biggest military exercise “Defender Europe 21”, which recently took place in our country, was of special importance.

It was conducted in cooperation with the American partners, in the framework of the strategic partnership that our country has with the USA in the security and defense field, in which participated 26 allied and partner countries.

The participation of our Forces in this exercise enabled them to host, coordinate, exercise and train with US and NATO forces in joint operations.

The American Command has conducted exercises of this size over the years in Europe, but also in some Balkan countries such as Croatia, Slovenia, and even in North Macedonia. This was the first time that an exercise of this size was conducted in the territory of our country, in our sea and air spaces.

First, it should be emphasized the fact that the planning of this exercise in our country was the merit of our military personnel. In 2019, when this project was being discussed at the US Army Command in Europe, Wiesbaden-Germany, the US planning director did not envisage Albania as a destination to expand the “DE” map further south in Europe.

In these circumstances, within a short time, our General Staff prepared a presentation focusing on the geostrategic position of Albania, as well as the assessment on the Port of Durres. Our presentation underlined the facilities and advantages which were guaranteed by our geographical position as well as the capabilities of the Port of Durres to support the strategic American deployment, towards the Black Sea, towards Africa, etc. The strategic position of our country was taken into consideration and the American leaders approved the inclusion of our country in “DE-21” exercise.

In addition to the geostrategic position and the position of the Port of Durres, it was worth noting that Albanians are the most pro-American people in the region.

Based on the above-mentioned reasons, this exercise is expected to be followed by similar

exercises in 2022 and 2024 in the Baltic Sea region, while in 2023, 2025 it will be conducted in the region of Southeast Europe, including Albania.

Secondly, this joint exercise, conducted with the strongest army in the world, was definitely a challenge, but at the same time it was an opportunity for our Armed Forces to be trained in several disciplines and directions with multinational forces and with real-life scenarios.

Thirdly, due to the complexity of this exercise, its planning method was comprehensive. State structures have been part of the working groups which were in charge of planning and preparation of the exercise.

The legal package approved by the Parliament of the Republic of Albania and the law on the development of “DE 21” exercise in our country entered into force since April 1, 2021.

Our Armed Forces cooperated with all local authorities in the areas where the exercise took place.

Moreover, we have had an excellent cooperation with the US Command in Europe, NATO Operational Command in Naples, the US Attaché Office in Tirana, as well as with the US Cooperation Office (ODC).

Such big exercises, are great schools. For all participants who are part of them, especially for the hosts, specifically for us

Compulsory national service - a challenge for values

Brigadier General Dr. Albert MULLAI
Commander of the Academy of the Armed Forces

Colonel (R) Prof.Dr. Kristaq XHARO

ABSTRACT

As early as the first decade of the 21st century, when the idea of the Professional Army was mooted, there were differing views, for and against this current, argued, emphasizing the argument that at least part of our Armed Forces be with compulsory service effectives.

As there were arguments on the other hand, in favor of the transition to a fully professional Force.

The prevailing argument was the cost to the state budget of maintaining a conscript.

This debate naturally took place and in our country has even taken place over the years, but it is understood with the connotation that our political system had then and with the freedoms or restrictions that the system allowed about this debate. The transition in the post-war years to the volunteer army, which was the direct successor of the partisan army, emerged from the National Liberation War, came as a continuation and not as a studied

solution, while it was not only ours as a solution, but the East as a whole.

Our neighbors today, NATO members or not, have the majority of troops with conscripts. At the same time, especially in recent years, they have been equipped with the latest generation weapons, tools, and techniques, in order to protect the respective countries, seeing it as a national obligation, while the army, as a duty and as a profession.

Time is the criterion, but mainly the tangible and irrefutable proof of the justice of a decision made, so holding a position for or against the professional army would be simply simplistic.

11 years since the abolition of compulsory military service, give us all today the luxury, to weigh the pros and cons of this or that model. And since this is so, through this article we do not claim to have brought the best option for solving the problem.

Therefore, let this writing serve as a reopening of a debate, which will finally resolve the above dilemma. Whatever the solution ...

Review of strategies, the basis of the Armed Forces development

Colonel Dr. Ahmet Leka
Director of the Military Scientific Research Institute

ABSTRACT

Not only for the sake of respecting the review deadlines on the National Security Strategy and the Military Strategy, but also for many other reasons we need to address this topic.

The article states the need and some important reasons on the necessity of reviewing strategic documents, on the factors that influence the drafting of strategic security documents, on the future security challenges and finally, it provides some recommendations on the review and formulation process of these documents.

The official document of the National Security Strategy (NSS), although a seemingly theoretical booklet, is and should be the surrounding framework of the whole policy, which enables the life security to the Albanian nation, in every aspect and at every level. At the citizen level as well as at the state level.

After all, it does not matter what its title is. It is essential to emphasize the importance of this document. Anyway, it does have the proper title, as it is in most of the countries all around the world: National Security Strategy. The countries name it like this, because for the implementation of such important materials, when it comes the day of their approval,

they have to roll up their sleeves and work every single day to achieve them. It does not matter how far they go, it is important to move forward, towards the major goal they have set. Even one centimeter a day counts. But only towards the target, not in the opposite direction.

It is worth noting the fact that this booklet, must not only be designed on scientific basis, commitment and patriotism for the Nation and the state, but it also have to be a daily work plan for all state institutions.

The main strategic documents, excluding the doctrinal ones, from the hierarchical point of view and due to their significance, must be the most significant ones after the Constitution. The approval of the strategic and doctrinal documents, according to a certain order, shows the maturity of the political elite and its understanding of the importance of proper completion of the strategic doctrinal framework.

Albanians in the regional security complex

Dr. Xhavit Shala
Director of Scientific Research, The Security Academy

ABSTRACT

The scope of study and research of this article is the albanian issue and the complex of security in the Balkans, which are of interest in terms of national and regional plan.

This paper aims to prove the interrelationship between the degree of resolution of the Albanian issue and regional security. In order to prove this interrelationship, we will use among others, the theory and analysis of regional complex of security of the Copenhagen school.

At the end of the paper, it is concluded that the albanian issue in the region and its degree of resolution has continuously had an impact and continues to have an impact on the regional security and beyond.

Global security environment, geopolitics and its impact on future developments

Brigadier General (R) Msc. Muhamet Buçpapa
Staff Officer/ Specialist for Research, National Security Challenges, MSRI

ABSTRACT

The review and analysis of global security environment and geopolitics as well as their impact on future developments is of particular importance not only in terms of recognising and studying the issues that have an impact on the world, but what is more important even in the drafting and development of doctrines and strategies at every level, with the main aim at preventing the deterioration of the security environment and enhancing its improvement in the process.

The security environment is a broad and complex concept that bears heavy burdens in which multiple interests of influential actors at the global, regional and national level are interwoven and influenced by geopolitical trends and behaviours.

In this modest study, we will analyse the composition of the security environment as a whole in the political, historical and geographical context, the way actors and their interests evolve, as well as what conjunctures have inspired this environment in continuous transformation despite the ups and downs, in accordance with socio-economic developments, or other circumstances of the time influenced, or imposed by geopolitical interventions, developments and implications.

The paper addresses the geopolitics, power and ranking of actors at the global, regional and national levels and their impact on the long and complex process of shaping the current world system, and in perspective facing the intensity of geopolitical change. Our region, the so-called Western Balkans, walks today in the midst of shadows and geopolitical clashes, mainly of the first-order powers, without ignoring the regional ones.

The impact of the pandemic on national security

Senior Director, Dr. Bilbil Memaj
Director / Rector of the Security Academy

ABSTRACT

There will hardly be another threat in the last half century, compared to the Covid-19 pandemic, which has had such an impact on the well-being and safety of life across the globe. The term “pandemic” is used when referring to epidemics that cross international borders, infecting populations around the world and causing a global threat of a high

level. Despite the fact that at the moment we are talking about this pandemic is known as Covid-19, in the past such pandemics have had different names and in the future may have others. For this reason, the title of the article does not mention a specific pandemic name but addresses the concept.

The key question is: “Is a pandemic related to national security?” Based on this question, this paper elaborates on the broad framework of national and international security, raising arguments that pandemics such as Covid-19 are related to national security. These observations aim to provide a broader reflection in the future on threats related to national security and the measures to be taken against them.

Information, Technology and Operational Environment

Colonel Msc. Fatmir Neziraj
Deputy Rector of AFA

ABSTRACT

Rapid technological developments have caused the operational environment and the information environment to change constantly and unpredictably.

Capacities that have emerged as a result of the merging of technology with information have challenged traditional elements of power, including military power as well as economic and diplomatic factors. Information is a very powerful tool in the operational environment. In modern conflict, information has become as important as the power of deadly fire in determining the results of the operation.

Autonomous remote control and directing systems / robots and especially unmanned aerial vehicles / drones (UAVs) have been developed and widely used, directly affecting the transformation of the battlefield today. Once a novelty, nowadays drones have become standard military equipment. So far, at least fifteen countries have established training academies dedicated to drones, while ten countries have activated UAVs training schools in the last decade. The role and importance of drones was also confirmed in the recent war between Armenia and Azerbaijan, in which their use was crucial in determining the victory, by marking a new page in the use of air power. The computerization of society has also brought about an increase in cyber threats. Cyber security is already a key element of today's operational environment. Cyberspace is a new and constantly evolving environment with potential, unknown or poorly defined threats.

Given the rapid and unpredictable changes in the operational environment and rapid technological developments, our Armed Forces must continually evaluate them in the context of modernization and use of operational capabilities in order to fulfill their mission.

Challenges of Strategic Defense Planning - dealing with nature, threats and hybrid threats in our country

Colonel Msc David Rroku
Head of Defense and National Security Research Department, MSRI

Lieutenant Colonel (R) Msc. Kanan Himaj
Specialist at the Military Scientific Research Institute

ABSTRACT

Understanding the context in which hybrid aggression occurs, requires an approach both from the perspective of classical factors through situational analysis, and from social factors such as culture, religion, and population resistance levels, as military confrontations involve a combination of tactics, techniques and procedures, which are classical / conventional and asymmetric / unconventional. During this period, many parties involved in the conflict, consisting of state and non-state agents, are using modern weapons in their activities. As Carl von Clausewitz pointed out each era has its own kind of warfare, its own terms and limitations as well as unusual intentions, from which the conflict of modern era is characterized by the hibridity. According to some military theorists, the theory of modern conflicts represents a product of war conception with all the features derived from it, the most important of which, will be covered in this article.

Military intelligence in operations and its role in the decision-making process

Colonel Hysni Gjergji
Team leader of Research RSM, MSRI

ABSTRACT

For centuries, military strategists have valued intelligence as a key factor in recognising the enemy and as a result, as a key factor on the road to victory. The enemy or the threat has taken on different dimensions, forms, perceptions, and features in recent decades and as a result, security breaches are no longer just traditional, but have changed and continue

to change. They try to become invisible, inconceivable and unpredictable everyday “It is better to have a known enemy than a strong alliance”. We are facing many security threats in our life and not all these “enemies” “wear uniforms” or “obviously carry a gun”.

In today’s era of asymmetric war, it is the duty of intelligence service to identify the location of the threat, the agents involved and the way it is expected to act as well as the time when it can occur. The most recent threat to the global security of individual’s life, COVID-19, emphasized the advantage of an intelligence discipline, which has not been properly estimated until 2020, that of MEDICAL Intelligence.

The biological dimension of war, appeared, is present and can be developed in the future. MEDINT took on great importance in the last two years, emerging at the forefront of the intelligence disciplines and very soon will require an approach and doctrine of this “war in new dimension”.

Humanitarian interventions in cases where force is justified

Colonel MehmetMetko

Head of Department of Doctrinal Publishments, MSRI

Dr. Urim Qinami

Specialist in the Support Doctrinal Publications Group, MSRI

ABSTRACT

In this article will be covered the international reality in 1999 in terms of humanitarian interventions, on the occasion of the NATO’s 50 anniversary in Kosovo. The purpose is not to discuss the literature on the legitimacy of intervention, new humanitarianism or doctrine, under which the Air Force are able to win the war on their own. The following article aims at identifying some trends that have restricted and continue to restrict humanitarian interventions in specific cases. Furthermore, the article covers humanitarian interventions from the political, ethical, moral point of view as well as from the doctrinal point of view. Due to the limited space, the argument covered in this article, does not aim to describe, cannot describe and it is not exhaustive and complete.

Natural disasters and human security – the involvement of natural disasters in the human security agenda

Colonel Irela Nebiaj
Leader of the Research group for Strategic Analysis for SS/SSK/PM/SU, MSRI
LT Colonel (R) Alqi Nikolla
Staff officer/ Specialist for Security Policies and SU, MSRI

ABSTRACT

Human security is an approach that rejects the traditional advantage of state security and identifies the individual as the main security referent. It provides a way to expand our perspective, accepting that the main threats imposed to the individuals do not derive from interstate war, but from the emergencies that people face every day, such as: famine, disease, movement to other places, civil conflict, natural disasters, environmental degradation etc.

This article focuses on the analysis and impact of crisis or natural disasters on the weakness of social groups, their living, exploration of human security issues in terms of the process of crisis and natural disasters management. By considering human security as the most immediate issue in our efforts to manage the natural disasters, we will be able to develop better strategies, to better plan and prepare in order to avoid the natural disasters without forgetting the members of communities who are more at risk.

As a relatively new theory, the human security is being discovered and discussed by the experts and researchers. Its implementation in case of natural disasters is an important phase of further development of human security concept.

Curriculum developments in military education in the 21st century ¹

PhD. Etleva Smaçi
Deputy Dean of the Faculty of Defence and Security, AFA

ABSTRACT

Military academies have always been distinguished for their peculiarities, not only in comparison with public and private universities, but also with academies and professional colleges, with which they may have structural similarities. As a unique domain of the Armed

¹ The views expressed in this article state the personal attitude of the author; they are not the official stance of the institution where the author works, and are not related to the AFA situation or relationship.

Forces they offer a lifelong professional education that no one else can develop. They remain among the strongest pillars of public education, and so far world experience has shown that the foundations of this education are an important part of the world's defence and security policies.

Despite this individuality, the 21st century is increasingly proving that approaches to education must be comprehensive and not exclusive. Inclusion is the "backbone" of any educational reform, so military education cannot be left out of this framework because it is the domain of the Armed Forces.

The object of this paper is the analysis of curricular developments in the 21st century in military education. The argument why they should be reformed, and aligned with the curricula of public and private universities, aims to explain that military academies should abandon shaping the model of a Prussian officer, but instead, create the model of the civilian military that interacts easily, effectively, and as an equal among equals with the civilian environment.

Therefore, the recognition of curricular models in the field of pedagogy, and their combination with national interests in the field of defence and security are key to the success of preparing professionals whose course of action is not limited to the narrow spectrum of the Armed Forces, but goes beyond that circle, be it the national or international labour market force. The biggest challenge for 21st century curricular developments in military education remains to respond flexibly to the security environment, which is quite different and unpredictable from the traditional one.

Emotions and Leadership

Prof. Assoc. Dr. Edmond Braneshi
Lecturer in Military Leadership, AFA

Dr. Valbona Zeka
Head of Physical Fitness Group, AFA

ABSTRACT

During the last decade of the last century, we have witnessed the sudden increase of scientific studies in the field of emotions. The most prominent are the brain images at work, enabled by the new brain imaging technology. Science is now able to speak with competence about feelings, emotions, mental health, and to study the human heart with some precision.

The narrow view that intelligence, or Intelligence Quotient, is a genetic trait that does not change depending on life experience and that it largely determines the fate of our lives is no longer considered valid, as this argument overlooks very important questions

like: What can we change in order to improve our lives or those of our children? What factors influence when people with high IQ fail in life and those with low IQ move forward? Daniel Goleman answers this dilemma in his book *Emotional Intelligence*. He says the difference is what he calls *Emotional Intelligence*, which includes self-control, diligence, perseverance and self-motivation.

The importance of emotional intelligence rests on the connection between feelings, character, and moral instincts. There is growing evidence that fundamental ethical attitudes in human life are conditioned by emotional abilities. For a start, the tool of emotion is the impulse. The ability to control impulse is the basis of willpower and morality. In today's actuality the moral virtues of self-control and mercy are no longer necessary.

Communication of military leaders - an important element for achieving objectives and increasing cohesion

Colonel Msc. Editson Zarka
Head of the Department of Leadership and Social Sciences, AFA

ABSTRACT

Communication is a powerful tool for leaders at every level. It is undoubtedly important in the daily life of any leader in general, while for the military leader, it is often crucial. The ability to clearly communicate orally and in writing of orders, directives, instructions is a necessary feature of commanders to exercise command-control effectively with parallel and subordinate units. Since the military leader spends about 80% of his time directly with superiors, subordinates, colleagues, etc., communication remains a very important element for coping with workload, problems and complex situations.

Communication is the key element in leading military activity. It must always be in function of the mission and implementation of tasks. This communication can be a key factor in the life of the officer himself, the staff he leads, as well as their ability to succeed in operations of great importance. The leader at all times is under the watchful eye of his subordinates and his every action, or movement leaves a positive or negative mark on them. The leader is constantly faced with a vertical pressure, between the task taken from above by the superior and its implementation by subordinates. If he fails to perform his role properly to neutralize this pressure, to convince subordinates of the necessity of the task, he is prone to fail. On the contrary, if he knows how to communicate with subordinates, knows how to convey ideas, messages, knows how to lay out problems correctly, knows how to orient their interests for the accomplishment of tasks, he will be successful. So, for a leader, not only analytical and decision-making skills are enough, but also the ability to

express and communicate his goals clearly, in order for subordinates to act in accordance with them.

The involvement of the Armed Forces in missions in country and abroad, cooperation with other countries, allies and partners, the complexity of the security environment, the variety of means of communication, disinformation, etc., increase the role of the strategic level leader to communicate. The completion of the mission of the structure they lead remains the essence of their job, while the forms of communication are developed every day, along with the development of forms of communication and technology.

Military career development and contemporary challenges

Major Edval Zoto
Executive Officer in the Department of Simulation and Experimentation, MSRI

ABSTRACT

The military career constitutes an important and fundamental part of military sociology as well as of military science in general. This paper deals with the debate of the military sociology classics, such as Huntington and Janowitz on military career. It brings to attention more specific aspects expressed by later authors aiming to present a brief history of military career development, in order to identify the factors that have influenced its development, as well as to discuss the contemporary challenges to its uniqueness in general as well as to Albania.

Security in the first steps of the Albanian state

Prof. Assoc. Dr. Zaho Golemi
Academy of Security, Tirana

ABSTRACT

Albania was the last country in Balkans which gained its independence in 1912. But less than two years later, the Balkan War broke out and after that the First World War. Our

country was at a crossroads, where the not yet consolidated new state was engulfed by the greed of its neighbors and the indifference of the Great Powers. Albanians had to reawaken, regain its independence for the second time, under new conditions and circumstances after a great long and bloody war. The Albanian intellectual elite orientated the leaders towards a nationwide assembly, this time not in Vlora but in Lushnja, located at the central part of the country.

The security of the territorial space had come to the emergency level because from the first independence of 1912 until the second independence of 1920, the country had gone through a chain of sacrifices where the independence itself was put in danger. The Lushnja congress laid the foundations of the modern Albanian state, focusing on the protection of the territorial integrity, the recovery of the state and the final assurance of true state independence, through a constitutional act for full independence and elected the high council of the state - The Regency. Patriots, intellectuals, parliamentarians took and held on their shoulders the responsibility of historic decisions, which in a short time turned Albania into a free country, with Tirana as its capital, and a member of the League of Nations.

Vlora became again the national destiny of the Albanians, that unlike 1912, in the '20s the freedom, independence and security of the Albanian state was decreed and signed with the blood of the martyrs, as evidence and feature of a freedom-loving, fighting people, of "The caste of freedom fighters holding their weapons", who have personified the strong national feeling over the centuries, who know not only "to consume security", but also to provide security and values.

Strategic analysis: The Italian plan of the invasion of Albania in 1919 and the internal situation of Albania

Dr. Albert Hitoaliaj
Academy of Security, Tirana

ABSTRACT

The documentation reproduced in this material has been selected from the one stored in the Archive of the Historical Office of the General Staff of the Italian Army. The view brought by this Italian archival material enriches the point of view for the large framework of events that took place in Albania in '20 - '21 of the last century. This military and strategic analysis of 1919 sheds more light on the events that followed: The War of Vlora in 1920 and the decision of November 9, 1921 of the Conference of Ambassadors in Paris, which once again confirmed the independence of the Albanian state and its borders. In essence,

Albanian geography was the main cause that brought the Vlora War and the main threat to change the borders and the status of Albania. This geography has its roots in antiquity and will exert its influence in the future, because Vlora will continue to be the epicenter of the Albanian national power and one of the most valuable ports of the Mediterranean, together with the strategic Sazan island and its hinterland that serves as support for the naval power. This is explained in this strategic document, which we present on the pages of "Military Magazine" on the occasion of the 100th anniversary of 1921 decision.

KUJTESË PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është organ teoriko-shkencor i Akademisë së Forcave të Armatosura, në interes të FARSH. Misioni i saj është promovimi i vlerave kërkimore, i zhvillimeve të reja dhe i debatit shkencor në FA. Tematika e saj trajton çështje me karakter teoriko-shkencor e analitik, në ndihmë të veprimtarisë së FA-ve, duke ofruar zgjidhje për çështjet më të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në nivel strategjik, operacional dhe taktik, në vend, rajon e më gjerë.

Ftojmë studentët/kursantët, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FARSH të bëhen pjesë e shkrimeve në RU.

Në vijim, po japim disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët e shkrimeve.

Struktura e artikullit

Titulli. Të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere dhe të jetë fjali emërore.

Autori, bashkautori. Poshtë titullit vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe funksionin aktual i tij/saj.

Trajtesa e shkurtuar (Abstrakti). është një përmbledhje e shkurtër e artikullit. Ai tregon se për çfarë bëhet fjalë në një artikull, metodat që janë përdorur, rezultatet që janë fituar dhe çfarë impakti ka ky artikull. Mund të themi se abstrakti shërben si reklamë e artikullit.

Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht. Poshtë tij, gjenden fjalët kyçe, pra, fjalët më me rëndësi në artikull. Trajtesa nuk zëvendëson hyrjen e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes me rreth 3-4 paragrafë të shkurtër.

Përmbajtja ose pjesa kryesore e artikullit. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nënçështje, në varësi të tematikës që shtron. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë **“Hyrja”**, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, parë në këndvështrimin e interesave të FA. Shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 8-10 faqe kompjuterike.

Formati. Faqja duhet të jetë e formatit A4; lloji i shkrimit: “Times New Roman”; madhësia e shkrimit 12. Kryeradha (paragrafi i ri) përcaktohet me pt 6 (hapësira midis paragrafëve). Teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele çështjesh kryesore. Duhet të shmangen tekstet e theksuara (*bold*) apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët (*italic*) dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura.

Grafikët, tabelat dhe fotot duhet të jenë të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Nëse një foto ose grafik është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Referencat dhe bibliografia. Çdo shkrim duhet të paraqitet me referenca (*footnote*), si dhe me bibliografinë përkatëse, e cila paraqet literaturën e shfrytëzuar. *Referencat* duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare. Në to duhet të përfshihen: mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN/ISSN, *website-in* ku ndodhet artikulli. (*p.sh. Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Shënim:

1. Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.
2. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë e as qëndrime politike apo partiake.
3. Artikulli duhet të dërgohet i printuar, në adresën elektronike dhe/ose me CD.
4. Vlerësimi dhe miratimi i shkrimeve për botim në Revistën Ushtarake bëhet vetëm nga Bordi Drejtues i RU.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Departamenti i Publikimeve Doktrinare
Grupi i Redaktimit dhe Publikimit
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri
Nr. Tel: 516 /1975, 516/ 1977

